



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 2
PRILL
2016

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2016



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi
dhe **SIGURIA**

B O T I M P E R I O D I K
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR **2**
PRILL
2016

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.



Botues
AKADEMIA E SIGURISË
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR **2**
PRILL
2016

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Asc. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Fatmir TARTALE

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Vangjel LILI
Lavdim KAZAZI

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

*Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë*

Revista shkencore “**Policimi dhe Siguria**”, botohet nga “Qendra Kërkimore Shkencore” e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P È R M B A J T J A

1. **Dr. Stavri SINJARI dhe Dr. Sofokli DUKA** (*post mortem*)
August Uollmer – “babai” i policisë moderne amerikane. 8
2. **Msc Vladimir IKONOMI**
Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit. 20
3. **Doktorant Ilo Këçka**
Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA -s 30
4. **Kolonel Dr. Ruzhdi KUÇI**
Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim 36
5. **Msc Adriatik DUQI**
Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë 44
6. **Msc Qetësor GURRA**
Krimi kibernetik, efektet te siguria dhe strategjitë kundër tij 54
7. **Msc Anisa AGASTRA**
Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit, parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë 69
8. **Msc Ilia NASI**
Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes 80
9. **Msc Tonin VOCAJ**
Hetimi i krimeve kundër jetës 94
10. **Msc Arben IBRO dhe Msc Bora SELMANI**
Menaxhimi i policisë pas viteve ‘90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe rritjen e sigurisë publike 112

11.	Dr. Zihni GOXHAJ	
	Inteligjenca dhe balanca midis lirisë dhe sigurisë	129
12.	Doktorant Artur BEU	
	Policimi në komunitet dhe terrorizmi	140
13.	Msc Fran KAÇORRI	
	Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë	152
	Abstraktet në anglisht / Abstracts	160
	In memoriam / Sofo DUKA	168



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

August Uollmer – “babai” i policisë moderne amerikane



■ **Dr. Stavri SINJARI**
Akademia e Sigurisë



■ **Dr. Sofokli DUKA** (post mortem)
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

August Uollmer është një nga figurat kryesore të krijimit të policisë moderne amerikane. Si në të gjitha fushat e tjera të veprimtarisë e krijimit njerëzor edhe në fushën e policimit, kanë spikatur e janë shquar korifenjtë, të mëdhenjtë, ata që me veprat e tyre kanë bërë vend e kanë lënë një trashëgim të vyer për brezat që vinë pas. Punonjësit e studentët e policisë, studiuesit e historianët, do zbulojnë tek Uollmeri njeriun e veçantë të policisë amerikane, e ndoshta më gjerë, i cili përfaqëson fillimisht mareshalin e shefin e Postës së një qyteti, më pas presidentin e departamenteve të policisë amerikane, profesorin e themeluesin e shkollave policore, strategun e progresit të policimit, novatorin, mendimtarin, botuesin si dhe njeriun e ndershëm, më të përkushtuarin në punën e detyrën e liderit policor, me vullnet të pazakontë e karakter të fortë, që u bënë baza e karrierës së tij të pandalshme e që e ngritën Uollmerin në pedestalin më të lartë – të njohur sot në gjithë botën, edhe pas një shekulli, si “babai” i Policisë Amerikane.

Fjalëkyçe:

departament policie, shkolla verore, lëvizje e kolegjeve, poligrafi, patrullimi, policimi në afërsi, “lowman”, novacion.

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

“Puna e policit është thirrja më e lartë në botë. Njerëzit të cilët e kryejnë këtë punë duhet të jenë të shkëlqyeshëm. Ata duhet të jenë më të arsimuarit. Ata duhet të jenë të diplomuar në kolegje universitare. Kjo është ajo çka ata duhet të jenë...”¹.

A. Uollmer

Në vend të hyrjes...

Policia e SHBA-së renditet ndër rangjet e para të botës²² për modernizimin, arsimimin, reformimin, teknologjinë dhe efektivitetin e luftës ndaj krimit e sigurinë publike. Për të arritur në këtë status, fillesat e të cilit i gjejmë shumë kohë më parë, në hyrje të shekullit të kaluar, policisë amerikane iu desh kohë e gjatë. Kjo gjë, është fryt i punës e i sakrificave të mjaft njerëzve të shquar për disa dekada rresht, të personalizuar në disa emra të përveçëm, figura të mëdha të policisë amerikane, ku më të shquarin midis tyre, August Uollmer, – i thirrur “Lawman”, – Shef i Departamentit të Policisë së qytetit të Berklit të Kalifornisë, përveç të tjerave, me plot meritë, e kanë quajtur edhe “babai” i Policisë Amerikane.³

1. Fillimi i karrierës - mareshal⁴ i thjeshtë...

Augusti ose “Gus-i” siç i thërrisnin, lindi në një familje emigrantësh nga Gjermania, më 7 mars 1876, në Nju Orleans të Luizianës. Edukimi i rreptë e tradicional i tipit

¹ A. Uollmer, e cituar nga fjala e tij në Bashkinë e Nju Jorkut, 1926.

² <http://infotainworld.com/best-police-forces-in-the-world/>

³ Boren, Kerry Ross. *August Vollmer – The Great Innovator*, 2006, në: www.prospector-utah.com/vollmer.htm / August Vollmer – The Great Innovator.

⁴ Shërbimi më i vjetër në polici e SHBA, i themeluar në vitin 1789. Ndryshimi midis “polici”, “sherif” e “mareshal” qëndron në fushën e juridiksionit. Mareshalët janë zyrtarë federalë, juridiksioni i shtrihet përtej policit lokal dhe sherifit të qarkut.

Parë për herë të fundit në datë 22.3.2016, në: http://www.ehow.com/info_8510468_differences-police-sheriffs-marshalls.html

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policiimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

gjerman dhe vullneti i fortë, ishin gjithçka që ai pati trashëgim nga prindërit. Që fëmijë në shkollën fillore spikatën veti të mira të karakterit tek i riu Uollmer, që do ta shoqëronin e nderonin atë gjithë jetën. Studionte shumë, në shtëpi, në shkollë apo në punë; lexonte pa pushim, libra e literaturë rreth gjithfarë çështjesh e problemesh që i interesonin apo mund t'i dilnin para; i analizonte në thellësi dhe deri në atë masë, sa ishte në gjendje, që rreth çdo problemi mund të njihnte autorët e mëdhenj e mendimet e tyre. Leximi, etja për dije e njohuri të reja, ishin shtyllat bazë të formimit të tij intelektual, edhe pse i ri ende pa ndonjë diplomë universitare. Ky vullnet për dije të reja në çdo fushë, e bëri atë lakmues, të pathyeshëm në arritjen e synimeve të veta, gjë që do të konkretizohej më pas në fillimin e një karriere të pandërprerë në fushën e policisë.

Nju Orleansi iku shpejt, me moshën e adoleshencës, me studimet në Akademinë e qytetit për ekonomist e daktilografist, me punën si zjarrfikës e postier, por që s'ishin këto synimet e jetës së Gus-it. Të ardhmen e vet do ta projektonte e përjetonte në qytetin e Berkliut të Kalifornisë, ku u shpërngul familja e tij. Aty lindi dëshira e ëndrra e tij, të bëhej polic. Dhe që të vishte uniformën, përveç aftësisë, dëshirës e vullnetit, i duhej edhe një kohë e provë, një rrugë jo kaq e lehtë, përveç se duhej të priste, të themi, edhe rastin e “artë”.

Ishte fundi i shekullit 19-të. Sapo do të fillonte shekulli i ri që do të shënjonte statusin e ri për SHBA. Ishte koha e progresit të madh amerikan, e hopit që do e ngrinte këtë vend brenda disa dekadave, në fuqinë më të madhe të botës. Kërkohej reformë e modernizim në çdo qelizë të jetës, në të gjitha fushat, në ekonomi, arsim, shkencë, teknologji... siguri. Ëndrra e së ardhmes, e çdo individ, mund të shkrihej e të bëhej një me ëndrrën e kombit të madh, me ëndrrën amerikane. Ishte koha e “hopit të madh” që do e shndërronte SHBA-në në “njëshin” e botës. Mund, e duhej të shfrytëzoheshin mundësitë e rrethanat nga cilido njeri, amerikan, që kishte energji për të realizuar objektivat e aftësitë e veta. Që të bëhej polic, për t'i siguruar qytetit të vet rend e qetësi, nuk mjaftonte vetëm intelektu dhe vullneti. Përpos të tjerash, duhej një formim i plotë fizik e ushtarak. Në atë fundshekull, në të gjithë vendin, nuk kishte ende lëndë mësimore, programe ose shkolla apo kurse të specializuara, të mirëfillta policie.

Momenti i parë, për të pasur një përgatitje të gjithanshme ushtarake erdhi kur filloi lufta spanjollo-amerikane⁵, ku Uollmeri regjistrohet në armatë e merr pjesë në rreth 25 beteja, deri larg, në Filipine. Pjesëmarrja në luftën e vërtetë e poqi, e forcoi më tepër të riun 24 vjeçar, i cili tashmë pretendonte për t'i dhënë më shumë vendit e qytetit të vet. Por edhe realizimi i një dëshire të thjeshtë në dukje, si pranimit në radhët e policisë, nuk mund të bëhej pa plotësuar disa kriteret, e më pas të merrej vendimi nga komisioni, i cili shqyrtonte kërkesat e kandidatëve dhe në bazë të votimit të anëtarëve e zërit të qytetarëve, përzgjidhte atë që kishte shumicën e votave. Ndër kriteret kryesore të kandidatit, vlerësoheshin më tepër ato të përgatitjes fizike e ushtarake dhe ndikonin pozitivisht opinionet e qytetarëve, zërat e mirë për veprime e sjellje konkrete mbi ndonjë rol pozitiv apo qëndrim bashkëpunues me policinë. Megjithëse, në vitet e para të shekullit të kaluar, nuk mund të themi se kishte rregulla fikse apo kriteret “të forta” për rekrutimin apo pranimit në radhët e policisë, për më tepër në një qytet si Berkli, ku kishte një postë policie, dëshira për siguri e rregull rritej, krahas lulëzimit të ekonomisë, biznesit e jetës sociale. Policia e Berkliut nuk ishte në nivelin e kërkesave të publikut, –

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

⁵ Lufta spanjollo-amerikane 1898, erdhi si rrjedhojë e konfliktit të Kryengritjes Kubane dhe u përhap në gjithë kolonitë spanjolle në Paqësor. Pas fitores së 11 luftërave dhe Luftës së Parë Botërore, SHBA u afirmua si fuqi e parë në botë.

ishte pothuajse joekzistuese.

Në këtë qytet, në atë kohë, krimi ishte shumë i fuqishëm, pasiguria ishte kaq e madhe, sa edhe trenat⁶ nuk ndaloheshin në stacion prej frikës së grabitësve të armatosur. “Rasti fatlum” i erdhi Gus-it, kur u bë rastësisht hero, protagonist i shmangies së një aksidenti tragjik – përplasjes të një vagoni treni pa kontroll drejtimi, – gjë që e bëri të famshëm në qytetin e vet, duke ia ndryshuar përgjithmonë drejtimin jetës së tij. Kur në vitin 1905, qytetarët u mblodhën për të shpëtuar prej pasigurisë, krimin, shtëpive të shumta të kumarit, të opiumit e prostitucionit, – që vepronin hapur në qytetin e tyre, – të vendosur, ata zgjodhën njeriun që do të bënte këtë punë. Me shumicë votash, ky njeri ishte 29-vjeçari August Uollmer, i cili premtoi vendosjen e rregullit dhe sigurisë publike në këtë qytet.

Nga ky moment, pasi u zgjodh shef i policisë së Berklit përsëri në 1907, njëkohësisht edhe si shef i gjithë departamenteve policore të Kalifornisë, kishte filluar për August Uollmerin, rruga e pandalshme dhe e lavdishme e karrierës policore⁷.

Prej këtij viti, deri në fund të jetës në 1955, shefi i policisë së Berklit do të bëhej i njohur në gjithë SHBA dhe do të thirrej edhe “Lawman” – “njeriu i ligjit”. Cilat ishin arsyt e suksesit të karrierës së këtij njeriu, që filloi punën në polici si mareshal i thjeshtë⁸, e më pas u bë shef i shefave të gjithë policisë amerikane? Historianët e jetëshkruesit e tij, nxjerrin shumë arsye e veti që e bënë atë aq të suksesshëm e të famshëm. Sigurisht, kanë vlerësimin dhe vendin e vet ndeshjet pa kompromis me bandat, guximi, moskorruptimi, mbështetja institucionale e publike... por kryesore ishte, se me idetë e veta, me personalitetin e tij, dijet e thella, novacionet, ai ndryshoi pamjen e gjithë policisë amerikane, se punoi jo vetëm për kohën e vet, por edhe për shekullin e ardhshëm, ide të cilat kanë jehonë e vazhdojnë të jenë aktuale deri në ditët tona. Sidoqoftë, fillimisht suksesin ia mundësoi gërshetimi i dijeve me përvojën ushtarake, gjë që e bëri atë shumë shpejt shef të respektuar dhe novator në menaxhimin e situatave e aksioneve policore.

2. “Lawman”- “njeriu i ligjit”

Qyteti kishte një postë policie, thuhet të shkatërruar ose jo funksionale. Në qytet lulëzonin bandat, veset e pasiguria. Nga duhej t’ia fillonte? Natyrisht, duhej një polici ndryshe, me një mentalitet të ri, e bazuar në filozofinë e kohës, e përshtatur me praktikitetin e pragmatizmin amerikan, polici e vlerësuar, e mbështetur në arritjet e shkencës e teknologjisë së re, e mbi të gjitha, një polici e publikut. Riorganizimi i departamentit dhe novacionet që zbatoi, nisën me punën për reformimin në themel të përbërjes dhe strukturës policore, e sidomos ndryshimet për zhdukjen e korrupsionit brenda radhëve të saja – një nga aksiomat e sukseseve të policisë “uollmeriane”; zotësitë e një lideri të ri të policisë u shfaqën kudo ku duhej të zëvendësohej një rutinë e praktikë e vjetër dhe e kalbur, me një formë pune të re, me njerëz të rinj që ndiheshin krenarë për profesionin e tyre, me plot besim në detyrën që kishin marrë përsipër të bënin, midis të cilëve filloi të ndihej forca e vrulli i kohës, urrejtja për krimin e kriminelët si dhe

⁶ Shoqëria hekurudhore ndërkontinentale “Southern Kalifornia” pezulloi qëndrimin e trenave në stacionin e qytetit për shkak të grabitjes së tyre nga bandat.

⁷ Los Anxhelos, Nju Jork, Uashington, Çikago, Dallas, Detroit, Kansas, Mineapolis, Santa Barbara, Portland, San Diego deri Havanë. Uollmeri u zgjodh zyrtarisht shef i Departamentit të Policisë së Berklit nga 1909 deri 1932. Ndërkohë, në 1922 zgjidhet president i Shoqatës Ndërkombëtare të shefave të Policisë.

⁸ Në kuptimin e hapit të parë në hierarkinë e policisë amerikane.

*Sinjari, S.
dhe
Duka, S.*
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Polici
dhe
Siguria
nr.2, 2016

dashuria për vendin e njerëzit, për qetësinë e sigurinë e tyre. “Njeriu i ligjit” u shfaq në projektimin e strategjive dhe kompetencave të reja më të përshtatshme dhe efektive ndaj krimit e bandave kriminale të qytetit.

Zgjuarsia e Uollmerit për të kombinuar me mjeshtëri goditjen, si metodë kryesore të veprimeve policore, sidomos të atyre kohëve, me “trajtimin në afërsi” ose “me përkëdheljen” siç e quante ai, solli në jetë një metodë e strategji që bazohej në një filozofi të re⁹, e cila vinte në plan të parë parandalimin e krimit krahas goditjes, - zëvendësonte “sherifin pistolier”¹⁰ me policin publik, si një punonjës social, ku krahas shkopit e pistoletës i hapej rruga, i lihej vend punës parandaluese, përparësisë së autoritetit publik, të bashkësisë, si një terapi më efikase, sidomos ndaj devijancave e veseve, që në policinë moderne do të njihje si një nga format e “policimit në komunitet”¹¹. Brenda dy mandateve erdhën rezultatet e para në qytet, i cili filloi të shndërrohej nga “strofull e veseve të këqija” në “parajsën e qetësisë e sigurisë”. Ky ishte veç fillimi për shefin e ri të policisë së Berklit, i cili brenda dy dekadash do të bëhej një nga njerëzit më të njohur në gjithë SHBA-në, madje edhe përtej kontinentit. Gus-it të dikurshëm të ri, më pas kur të burrërohej do t’i ngjasinin e shtoheshin emra si “njeriu i ligjit”, “profesori i së drejtës”, “patriarku i profesionalizmit policor”, “pionier i edukimit policor amerikan,” “mësuesi i madh i policisë”, “novator i madh “babai i policisë”¹² etj. Principet kryesore të punës së Uollmerit u mbështetën në një botëkuptim të ri për policinë, ku në qendër vihej vlerësimi i merituar i profesionit dhe lartësimi i figurës së policit. Ky ishte çelësi kryesor i sukseseve të para në punën e tij, që solli transformimin jo vetëm të departamentit në qytetin ku ai drejtonte, por edhe të gjithë policisë amerikane deri në ditët tona. Me prurje të reja dhe trajnime profesionale të stafit, filloi punën në postën e policisë së Berklit. Ai këshillonte se, duhet të bëhen përpjekje që në polici të marrim njerëz të aftë, të ndershëm, aktivë në mendje dhe trup, të zellshëm, gjakftohtë, të arsimuar mirë, me përvojë në trajtimin e njerëzve, në gjendje për të zgjidhur probleme të vështira shpejt dhe të shpejtë për të vepruar në vendimet e formuara mbi bazën e sensit praktik të përbashkët dhe me gjykim të shëndoshë. Thirrja e Uollmerit u drejtohej të gjithëve, pa dallime politike, racore, gjinie, statusi. Ajo i përngjan një platforme kriteresh për njerëzit që mund të pranohen e të punojnë në polici, që të nxit, të stimulon e të bën krenar kur vesh uniformën e punon për të. Prej përpjekjeve e nismës së tij erdhën në polici për herë të parë femrat, gjë që i dha një impuls të ri e të veçantë traditës së punës së policisë. Më pas, në kundërshtim me mentalitetin racist, diskriminues të popullsisë me ngjyrë, që ishte mjaft i pranishëm dhe i fuqishëm në SHBA-në e asaj kohe, Uollmeri inkudroi në polici afroamerikanët, të cilët duke qenë më afër mjedisit me më tepër kriminalitet, rritën më tepër efektin zbulues e goditës të forcave të policisë.

Prej shef Uollmerit, opinionit publik filloi t’i bëhej e qartë, se thirrja në polici ishte më e larta thirrje në botë, që do të thoshte se në polici nuk duhej të vinin njerëz çfarëdo, por me cilësi të veçanta. Në kriteret e pranimit, krahas kriterit fizik, u vendosën testet,

Sinjari, S.
dhe

Duka, S.
“August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane”

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

⁹ Gaunt, Richard A. *Sir Robert Peel: The Life and Legacy*. New York: I. B. Tauris, 2010, (f. 3-5).

Filozofia dhe reformat e para në polici kanë filluar në Britani, nga R. Peel (1788 –1850).

¹⁰ Kuptim metaforik i sherifit, për të dhënë më qartë policimin modern (shënim i autorit).

¹¹ Policimi në komunitet tradicional- mbështetet në qasjen shtrënguese të zbatimit të ligjit. Ky lloj policimi përqendrohet në efikasitetin e ndërhyrjes së shpejtë si një mjet për të luftuar krimin dhe sjell burokratizimin e organizatës (p.sh. ndarjen e theksuar e punës). Ky lloj modeli sot rezulton jo fort i përshtatshëm për të luftuar problemet e reja të krimit dhe shqetësimet e lidhura me sigurinë dhe mirëqenien në shoqëritë e sotme, që janë dinamike e komplekse.

¹² Nga shkrime të ndryshme kushtuar A. Uollmerit.

që masnin forcën intelektuale, dijet e cilësitë psikologjike. Të tillë ishin testi intelektual, njohuri nga shkencat sociale, psikologjia, komunikimi, njohja e ligjeve, etika. Në gazetat e kolegjeve dhe universiteteve u shtua një rubrikë e re, e panjohur deri atëherë, thirrja e Departamentit të Policisë së Berkliut për kandidatë nga radhët e studentëve më të mirë, që mbasi t'i nënshtroheshin një trajnimit në shkollat verore, mund të pranoheshin të punonin në polici. Shpejt, në policinë e drejtuar nga Uollmeri, u grumbulluan studentët më të dalluar të universiteteve, të cilët iu përgjigjën pozitivisht thirrjes së tij, njerëz të rinj e të guximshëm, të aftë e të ndershëm, të cilët me pasionin për punën e të mësuarit të pandërprerë, nën kujdesin e drejtimin e vazhdueshëm të "Lawman" Uollmerit, u bënë profesionistë të shkëlqyer. Me të tillë punonjës policie, ai zbuloi, dokumentoi e shpartalloi bandat e armatosura të krimit e kapot e tyre deri dje "të paprekshëm", si në atë qytet edhe kudo tjetër ai ku drejtoi departamentet.

3. "Pionieri i edukimit policor"

Ishte i panjohur praktikisht deri atëherë arsimimi policor, si program ose shkollë e veçantë policie. Bazat e para shkollore të këtij edukimi në SHBA i hodhi Uollmeri, fillimisht, duke organizuar kurse apo shkolla verore, në përbërje të shkollave ekzistuese universitare, në të cilat hartoi programe të posaçme me lëndët më të nevojshme për kryerjen e detyrave të policisë, që nga fotografimi, ndihma e parë, procedurat e hetimit, evidentimin e dokumentimin e krimit, kriminalistikë, njohuri mbi ligjin e ligjshmërinë deri psikologjinë e krimit, etikën policore, ligjin sanitar, sociologjinë e statistikën, e më tej, deri tek përgatitja me armë e zjarri e vetëmbrojtje. Një pjesë e këtyre lëndëve zhvilloheshin në bashkëpunim me Universitetin e Kalifornisë¹³, me kolegë e profesorë të përgatitur. Një pjesë tjetër të këtyre lëndëve, profesor Uollmeri i zhvillonte vet, duke hedhur bazat e kolegjeve policore. Në kolegjet e para të Uollmerit u përfshinë, Valter Gorden – zyrtari i parë i zi i departamentit, John A. Larson – shpikësi i ardhshëm i poligrafit¹⁴, mjet që do të futej në hetimet gjyqësore për herë të parë nga Uollmeri, V. Leonard – shkrimtar i cili u bë tepër i njohur për veprat policore dhe edukator i drejtësisë penale, si dhe mjaft të tjerë, drejtues të lartë të ardhshëm.

Studimi i shumë veprave të autorëve brenda e jashtë Amerikës, e bën atë, profesor të shquar në shkencën e kriminologjisë, kriminalistikës, penologjisë, taktikat e policisë, teknikën bashkëkohore policore etj., – jo vetëm si lektor, por edhe si autor librash. Në vitet '30 të shekullit të kaluar, ai u bë profesor i Administrimit Policor dhe Procedurave Policore në Universitetin e Çikagos, në departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Kalifornisë, në Berkli, ku punoi deri kur u shkëput për shkaqe shëndetësore. Nga studentët më të dalluar të këtyre universiteteve u formuan mjaft njerëz të shquar të karrierës policore, zëri e vepra e të cilëve i kaloi kufijtë e Botës së Re¹⁵. Prej ish-studentëve të profesor Uollmerit, dolën shefat kryesorë e më të mirë të policisë amerikane. Disa u bënë shkencëtarët e parë të mjekësisë ligjore, edukatorë të shquar të së drejtës penale; një pjesë avokatë, politikanë dhe deri udhëheqës ushtarakë. Në fund të 1940-s, rreth 25 shefa të policisë së SHBA-së, ishin ish-studentë ose kishin

Sinjari, S. dhe Duka, S.
« August Uollmer – "babai" i policisë moderne amerikane »

¹³ Në vitin 1916, për herë të parë, në Universitetin e Kalifornisë, në Berkli, më pas u futën si programe edhe në universitete të tjerë. Me iniciativën e Uollmerit dhe Aleksandër Kid u themelua shkolla verore e kriminologjisë, që pas 1931 shndërrohet në shkollën e parë policore në SHBA.

¹⁴ "Lie Detector" ose poligrafi - makina e së vërtetës.

¹⁵ Kështu quhej kontinenti amerikan.

punuar nën drejtimin e A. Uollmer¹⁶. Veprat që shkroi vet apo me bashkëpunim, i përkasin tërësisht policisë. Ato i kushtohen policisë në shoqërinë e sotme, prej ku zënë fill idetë e para moderne të policimit¹⁷, për krimin dhe shtetin, për rolin e detyrat e policisë si institucion publik. Me mjaft interes është libri i tij i pabotuar, “Analiza e Punës” (“*Job Analysis*”), i cili mbart vlera të mëdha për përshkrimin e punës së policisë, me karakter formues për policët e rinj. Po kështu përmenden për vlerën aktuale veprat : “*Krimi dhe shteti policor*” (1935); “*Policia dhe shoqëria moderne*” (1936), të shkruara në bashkëpunim me A. Parkerin.¹⁸

Për këtë, iu desh, krahas operacioneve në terren, të studionte libra e autorë të shquar që t’i shërbenin formimit policor të studentëve. Uollmeri nuk u mjaftua me literaturën, ende të pakët në atë kohë, për temat e punës së policisë, të cilat i dhanë kulturën profesionale dhe e njohën me punën e përvojën legjendare të paraardhësit të tij, të famshmin, “*blackstrap*” – Allan Pinkerton¹⁹. Ai nuk u kufizua vetëm në arritjet e vendit të vet. Kishte synime më tej – të studionte arritjet më të mëdha të kohës, veprat e autorëve evropianë më në zë, të së gjitha kohërave, në veçanti në fushat e psikologjisë penale, kriminalistikës, mjekësisë ligjore, me të cilët u njoh personalisht, mbante korrespondencë e këmbente mendime, duke u bërë dhe vet një specialist i shquar, në disa prej këtyre disiplinave mësimore. Në bazë të përvojës së vet, në drejtimin, si pjesëmarrës e drejtues direkt në operacionet policore, ai diti të shkrinte idetë teorike të librave me njohuritë e fituara në praktikën e punës policore, prej investigimit të ngjarjeve në dokumentimin e veprave kriminale, në komunikimin me publikun madje bënte takime, biseda me të gjithë, edhe me autorët e shkeljeve të ligjit, deri me të dënuarit e shkallës së tretë²⁰. Ky bagazh i madh teorik e praktik, ishte baza që i dha mundësinë të krijonte e të zhvillonte më tej ide të reja mbi punën e rolin e policisë, që u reflektuan në një numër veprash të tij, të cilat do t’i jepnin atij emrin më të nderuar në polici.

Uollmeri arriti në një konkluzion të prerë mbi vlerësimin e policit dhe punës së tij. Ai konkludoi se rendi e qetësia, lufta pa kompromis kundër kriminalitetit, duhet të mbështeten dhe të zhvillohen vetëm mbi baza shkencore dhe policët i konsideronte “*luftëtarë shkencorë kundër kriminalitetit*”. Sipas tij, këto baza shkencore janë: teknika dhe teknologjia bashkëkohore policore, kriminologjia, kriminalistika, sociologjia, psikologjia, lëndë që janë të pranishme edhe sot në kolegjet e akademitë e policisë të gjithë botës. Profesor Uollmeri u bë nismëtari i një lëvizje të madhe progresive të Policisë Amerikane për edukimin, arsimimin dhe përgatitjen profesionale, që njihet si “*lëvizja për kolegjet policore*” – “*colleges cop movement*”. Kjo lëvizje, kur lindi, në hapin e parë krijoi shkollat e para amerikane të policisë, të barasvlershme me shkollat e tjera universitare, duke e bërë të detyrueshëm për çdo punonjës policie arsimimin policor në shkallën e parë “*Bachelor*”²¹ – nivel që sot, në shumicën e akademive policore

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹⁶ Fisher, Xhim. “*Pioneer Cop*”. Parë për herë të fundit në datë 20. 03. 2016, në: <http://jimfisher.edinboro.edu/forensics/vollmer.html>

¹⁷ Taçi, Pandeli, dhe I. Keçka, J. Vreka. *Fjalor Terminologjik*. Tiranë 2005

¹⁸ <http://www.bookrags.com/biography-august-vollmer-cri/> 16.03.2006. Parë për herë të fundit në datë 5. 03. 2016.

¹⁹ A. Pinkerton – (1819-1884) “*blackstrap*” - “*shiriti i zi*”. Krijuesi i Agjencisë së parë me detektivë të SHBA-së. Motoja e tij “*Ne nuk flemë kurrë*”. Agjencia Pinkerton e detektivëve privatë, në 1995, numëronte 250 zyra dhe 250 mijë nëpunës. Parë për herë të fundit në datë 12. 03. 2016, në: <http://www.pbs.org/wgbh/americalexperience/features/biography/james-agency>

²⁰ Të dënuarit për krime të rënda.

²¹ Në SHBA diploma “*Bachelor*” quhet diploma e thjeshtë universitare; në Europë zuri fill sistemi i Bolonjës pas vitit 1999.

ku është implementuar sistemi i Bolonjës, njihet si niveli i parë i studimeve, me kohëzgjatje jo më pak se tre vjet. Synimi themelor i kësaj lëvizje ishte që të arrihej kërkesa, që secili pjesëtar policie të kishte së paku një diplomë “bachelor” në shkencat policore. Uollmeri synonte dhe bëri përpjekje të mëdha, që roli i policit si profesion të ishte aktiv e krijues në shoqëri, që ai të trajtohej si një punëtor social – ide të cilat i parashtrroi në një nga artikujt e tij “*Polici si punëtor social*”²².

Pavarësisht nga kohëzgjatja dhe pengesat madhore, si Lufta e Dytë Botërore, drejtuesit e policisë e politikanët amerikanë, nuk u ndalën në lartësimin e përsosjen e figurës së policit, në atë drejtim që tregoi Uollmeri. Pikërisht në vitet ‘50, kjo lëvizje u pasua nga një “lëvizje e dytë e kolegjeve policore”, që e vinte theksin në kërkesën për vijimin dhe përfundimin nga ana e pjesëtarëve të policisë amerikane, të programeve “Master”, në disiplinat përkatëse, i cili njihet sot si program i nivelit të dytë të studimeve – “*second MSC cop movement*” – lëvizja për “Master shkencor” në Polici²³. Prej disa dekadash e sot, në SHBA ka filluar një lëvizje tjetër që prej kohës së inicimit të Uollmerit, njëqind vjet më parë, – lëvizja e tretë e kolegjeve policore, që quhet “*third Ph.D. college cop movement*”, që njihet ndryshe si “lëvizja për doktoraturën në Polici”²⁴. August Uollmeri asnjëherë gjatë jetës së tij, nuk u shkëput nga puna si polic, pavarësisht se me shumë dimensione, si drejtues departamenti, këshilltar, botues artikujsh e librash, studiues e profesor i lëndëve speciale policore. Tek ai ishte shkrirë në një, pasioni për punën, vullneti i fortë, ndershmëria dhe modestia e rrallë. Ai kërkonte nga drejtuesit, që ta fitonin me meritë dhe aftësitë e tyre mbështetjen e vartësve; të njihnin mirë profesionin e policisë se përndryshe ishin të destinuar të dështonin. Këto porosi, në formë postulatesh apo kodesh, që janë udhërrëfyese për cilindo student apo person në fillim të karrierës policore, ai i nxori pas një jete të tërë pune. Kudo ku punoi e drejtoi, ai vinte parimet në krye të gjithçkaje, – kodin etik të policisë, – dhe sidomos, çmonte ndershmërinë e aftësinë. Konkretisht, kur u ngarkua të drejtonte Departamentin e Policisë së Los Anxhelosit, kur konstatoi korrupsionin e disa drejtuesve policorë si edhe mospërkrahjen nga ana e udhëheqësve politikë atje. Pas një kohe dha dorëheqjen dhe u kthye në Berkli.

Kur konstatonte ndjeshmërinë kritike të publikut ndaj veprimeve të tejkaluara të policisë, ai dilte haptas para medieve dhe kërkonte falje, kur ato kishin të drejtë. Po ashtu, hapur, mbronte e argumentonte me guxim, veprimet e policisë, kur këto injoroheshin e madje shtrembëroheshin, për interesa të ndryshme politike apo lokaliste nga mediet e ndryshme, duke dalë vetë në emisione të drejtpërdrejta në radio, me artikuj në gazeta etj. I vlerësonte shumë mediet dhe e konsideronte detyrë të rëndësishme komunikimin reciprok me to, sepse e shihte si rrugë të rritjes së personalitetit të policit. Uollmeri vë re, që policin e diskriminojnë dhe e viktimizojnë, në art, në media, në opinion; e bëjnë objekt humori apo frike për të trembur fëmijët. Në citimin e tij në fillim të këtij shkrimi, Uollmeri pasi ngre lart thirrjen për polici, që të vinë njerëz të arsimuar e të shkëlqyeshëm, vazhdon më tej dhe bën pyetjen, se “si e gjejmë në fakt policin?”. Po ai vet, vijon me përgjigjen, “*dumbbells*”²⁵, - pra pa vlerë, pa peshë! Për ndryshimin e

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

²² Boren, Kerry Ross. *August Vollmer – The Great Innovator*, 2006, në: www.prospectator-utah.com/vollmer.htm/ August Vollmer – The Great Innovator.

²³ Sistemi i Bolonjës (në Akademinë e Sigurisë), programi “Master i shkencave” e shtrihet në jo më pak se 2 vite studim, me 120 ECTS, krahas “Master profesional” me 60-90 ECTS në 2 ose në 3 semestra.

²⁴ Doktoratura në fushën e Sigurisë sot është kualifikim i ciklit të tretë të studimeve me gradën shkencore “Doktor i Shkencave” me plotësimin e 180 ECTS, në jo më pak se 3 vite.

²⁵ Në shqip, ka disa kuptime: “memeç”, “hiç”, “gur peshe”, “gogol” etj.

Polici
dhe
Siguria
nr.2, 2016

kësaj gjendjeje rutine, ai nuk i lutet askujt që të mos keqpërdorë këtë profesion kaq fisnik, por i drejtohet në radhë të parë vetë punonjësve të policisë, që me dijet, arsimimin, kulturën e ndershmërinë që do të fitojnë, do të arrijnë lartësinë që meritojnë nga detyra e tyre. Uollmeri ishte një figurë policore shumëdimensionale – jo vetëm lider tavoline, as vetëm profesor i disa universiteteve, shkrimtar apo autor librash e artikujsh, person publik, analist, këshilltar²⁶ etj. Ai merrte pjesë vetë në operacionet më të rrezikshme të departamenteve që drejtoi. Është mjaft kuptimplotë fakti se gjatë gjithë karrierës në polici, ai u plagos dy herë dhe vetëm një herë iu desh të qëllonte me armë zjarri mbi një njeri, për vetëmbrojtje. Ishte i papajtueshëm me përdorimin e dhunës së tejskajshme, shfaqjet e brutalitetit, goditjet e tepruara e pa vend ndaj delinkuentëve apo ndaj disa lloj veprash të lehta penale si alkoolizmit, etj. Janë interesante largpamësia dhe qëndrimi i tij mosaprovues për ashpërsinë e dënimeve ndaj veprave të rënda penale. Që atëherë ai u shpreh kundër dënimit kapital. Iidetë e tij progresive në polici shfaqen në shumë forma, në artikuj, leksione, biseda, projekte e intervista mediatike – të cilat i vlerësonte shumë. Këto i shfrytëzoi në pesë dekada pune përkushtuese në polici, për rritjen e imazhit të saj në publik dhe aplikimin e arritjeve të reja shkencore e teknologjike, për të hetuar e zbuluar shpejtë e saktë autorët e krimit, gjë që i dha atij me plotë meritë emrin, “novatori i policisë”.

4. “Novator i madh i policisë”

Vepra e veçantë e Uollmerit për modernizimin e policisë amerikane nuk mund të mos vërehet edhe në risitë që ai solli në polici. Ndërtimi i një policie ndryshe, pothuajse krejt të re, që pikënisjen e pati me rindërtimin e organizimin e Departamentit të Berklit, ishte risia më e madhe që ai solli. Iidetë e tij, vizioni i tejskajshëm dhe rezultatet që pasuan, shumë shpejt e bënë atë “të kërkuar” si shef provizor “me qera”, në shumicën e departamenteve të policisë së qyteteve më të mëdha amerikane, nga Los Anxhelosi në Nju Jork e Havanë, - deri president i *Shoqatës së Shefave të Policisë Kaliforniane e Gjithëamerikane*. Ai mësoi shumë nga puna e gjatë në polici. Grumbulloi përvojë e dije, të cilat arriti t’i transmetonte tek të tjerët dhe t’i konkretizonte në praktikë. Ai mund të quhet edhe mendimtar i madh i policisë, prandaj novacionet lindnin tek ai natyrshëm. Këto aftësi të tij shfaqen hap pas hapi, në mënyrën e drejtimit e menaxhimit të situatave dhe të efektivit që drejtonte, në përdorimin e mjeteve e taktikave të zgjuara dhe efikase, në besimin dhe respektin që kishte me vartësit. Ai gjithmonë krijonte diçka të re ose më të mirë se përvoja e deriatëhershme. Kështu, nëse sot, patrullimi është një kontroll rutinë territori prej policisë së zonës, në kohën që po analizojmë, ky kontroll nuk ekzistonte. Postat e policisë në qytete qëndronin pothuaj njëlloj, si dikur kështjellat që qëndronin të rënda, e të palëvizshme, nëse sulmoheshin nga jashtë, nga forcat armike. Ndoshta Uollmeri e ideoi patrullimin, nga përvoja e vet ushtarake, kur para betejave bëhej rikonicioni, njohja e terrenit. Disa qëllime, realizoheshin njëkohësisht me patrullimin e lëvizshëm, si zgjerimi i kontrollit, policia rrinte më afër bashkësisë, rritej mundësia që ti paraprinte e ndoshta parandalonte ngjarjet kriminale, rriste më tepër perceptimin e sigurisë së komunitetit dhe shtonte besimin në publik.

Kur patrullimi filloi të bëhej rregull, për ndjekje në operacione të veçanta, me qëllim që të shtonte efikasitetin e tyre, Uollmeri shfrytëzonte në vazhdimësi risitë teknologjike,

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

²⁶ Me Edgar Hower, kur ky mori drejtimin e FBI-së, si edhe për projektligje e probleme të ndryshme me DASH etj.

pajisjet e mundësitë e kohës. Fillimisht i pajisi patrullat me kuaj, më pas me biçikleta, më tej me makinat më të shpejta. Vendosja e telefonisë fikse për njoftimet urgjente të policisë, për ngjarjet në flagrancë dhe e radiove të lëvizshme për komunikim, e shtuan më tej shpejtësinë e reagimit dhe eficientësinë e operacioneve policore ndaj veprimeve kriminale. Futi në përdorim, me iniciativën e vet, për herë të parë, poligrafën, në pyetjet e të dyshuarve dhe dëshmitarëve²⁷. Vlerësonte shumë saktësinë në procedurat hetimore, sidomos këqyrjen e vendngjarjes dhe mbledhjen e provave materiale për zbulimin e autorit të veprës penale dhe rëndësinë e vërtetimit e dokumentimit të tyre me mjete e analiza shkencore. Për këtë qëllim, paralel me ngritjen e Shkollës së Policisë, nga shkollë verore, më pas në Universitetin e Berklit, bashkë me kolegën e vet Kid, ai themeloi laboratorin e parë të kriminologjisë në SHBA. Ai porosiste se, provat e faktet e grumbulluara, të padokumentuara me analiza shkencore të pakundërshtueshme, nuk kishin vlerë dhe e çonin dëm gjithë punën e policisë në gjykatë, njëlloj si të sitje rërën në erë. Prandaj, në mësim ishte praktik, korrekt, i qartë dhe i saktë në shpjegimin e çdo situatë, sepse – sipas profesor Uollmerit, – çdo gjë që ndodh në situatat reale duhet patjetër të ndodhet diku e shkruar në librat mësimorë ose të ketë një përvojë të ngjashme me të. Ky ishte një kriter i ri, i rëndësishëm, i metodave mësimore dhe praktikave të studentëve të policisë, në shkollat e profesorit të madh, - pandashmëria e teorisë me praktikën e gjallë në terren; mbase nën frymëzimin dhe ndikimin e praktikizmit amerikan të filozofit Xhon Dju²⁸, bashkëkohës i Uollmerit.

Ai besonte se duheshin luftuar burimet dhe shkaqet sociale të problemeve që çonin në vepra kriminale, e ndërsa theksonte edhe aplikimin afatgjatë të psikiatrisë e psikologjisë për sqarimin e motiveve kriminologjike që e shtynin individin në sjellje devijante. Mbi këtë shtrat duhej ndërtuar edhe puna e policisë, kompetencat e detyrat e saj publike. Veprat penale e sjelljet devijante, kishin ndryshime të thella dhe diferencimi i tyre kushtëzonte diferencimin e autorëve, sipas shkallës së ndëshkimit të parashikuar mbi bazën e ligjit. Përveç prostitucionit e kumarit edhe prohibicionizmi²⁹ shtonte artificialisht numrin e veprave penale dhe policia duhej të përballonte mjaft persona të alkoolizuar e droguar, gjë që sillte volum pune e problemesh, shpesh edhe goditjesh të tepruara, duke devijuar përqendrimin ndaj veprave të rënda kriminale. Mbi të gjitha, kjo e fundit bënte keq më tepër, se gërryente marrëdhëniet e policisë me bashkësinë. Prandaj Uollmeri, këtë kategori personash, brenda juridiksionit të departamentit të vet, e trajtonte disi ndryshe. Ai thoshte se, me kategorinë e këtyre personave, më tepër interes e efikasitet ka policimi i butë, sepse përfitimi është më i madh. Ata dinë dhe mund të mësojnë prej tyre shpejt dhe shumë, për ngjarjet, personat me veprimtari kriminale; të mbledhësh informacione me vlerë, që vinin edhe në rrugë detektive, por me vonesa e rreziqe prej të infiltuarve. Koha, më pas, bëri vlerësimin e vet dhe krimet si, droga, trafiket e prostitucioni, morën zhvillim e përmasa të paparashikueshme, gjë që s'mund të trajtohej

²⁷ Polygraph Examination Service – Canada. "The polygraph history", në: http://www.polygraphia.ca/polygraph_history.html. "Lie Detector" ose poligrafi - makina e së vërtetës, - u krijua në 1921 nga J. Larson, profesor i mjekësisë ligjore, në Universitetin e Berklit, Kaliforni. Makina u perfeksionua nga L. Keeler dhe u përdor nga dr. Larson me sukses në 1935, në një gjyq ndaj Bruno Hauptman. Makina regjistron ndryshimet e presionit të gjakut, lëvizjet mimike, djersitjen, rrahjet e zemrës të personit që po merret në pyetje; përdoret edhe për verifikim pastërtie të figurës dhe jep saktësi 90-95% të së vërtetës.

Një poligraf modern do të përdoret në ndihmë të Byrosë së Hetimit në Shqipëri.

²⁸ Xhon Dju (John Dewey(1859-1952) - filozof amerikan i pragmatizmit. (<http://infed.org/mobi/john-dewey>). John Dewey ishte një ithtar kryesor i shkollës Amerikane të mendimit të njohur si pragmatizëm, një pikëpamje që ka refuzuar epistemologjinë dualiste dhe metafizikën e filozofisë moderne në favor të një qasjeje natyraliste që shihet si dije që del nga përshtatja aktive e organizmit të njeriut në mjedisin e vet.

vetëm me metodat e buta në afërsi. Por kjo nuk e kundërshtonte përfundimin e *policit të madh*, që kundër krimit duhet të luftojë e gjithë shoqëria e që ai duhet të goditet që në lindjen e tij prej faktorëve ekonomikë e socialë dhe të mos mbetet si ekskluzivitet i policisë. Me këtë tematikë shkroi një libër të titulluar “*Krimineli*”, në vitin 1949. Kjo mund të konsiderohet pika kulmuese dhe e fundit e studimeve të tij në këtë fushë, sepse sëmundja e rëndë e detyroi që të tërhiqet nga puna aktive deri në vitin 1955, kur u nda përfundimisht nga jeta.

5. Përfundime

• Studimi i figurave të mëdha, që me personalitetin dhe veprat e tyre kanë lënë gjurmë të rëndësishme në fushën e vet, nuk është vetëm domosdoshmëri, që historia nëpërmjet brezave të mëvonshëm e ka për detyrë ta bëjë si shpërblim për meritat e sakrificën e tyre, për atë gjë të re ç’ka ata dhanë e që i bën të dallueshëm nga të tjerët. Kudo, në art, shkencë, politikë, kulturë e sport nuk është kaq vështirë të gesh “njerëz të mëdhenj”, “koka të mëdha”, të cilët gjatë jetës së tyre kanë tejkaluar limitet e arritjeve të njerëzve të zakonshëm e janë bërë të famshëm. Pa ndihmën e librave, internetit, historisë apo bibliografëve, mund të rendisim një varg të gjatë emrash me piktorë, filozofë, shkrimtarë, fizikanë, politikanë, mbretër, e deri dashnoret e oborrit, nusët e mbesat e tyre. Por, po kaq e vërtetë është se, në disa fusha të tjera, siç është kjo e policisë, kërkimi e gjetja e korifenjve duket punë e vështirë. Kjo ndjesi lind jo vetëm te njerëzit e thjeshtë, por edhe tek vet studiuesit. Jo sepse mungojnë në historinë e policisë njerëzit e shquar, madje nuk janë kaq të pakët sa na jep perceptimi ynë, por kjo më tepër vjen nga mungesa e vëmendjes së përgjithshme ndaj tyre, nga indiferentizmi e mosnjohja e këtij profesioni e kësaj veprimtarie publike, që quhet Polici. Një boshllëk e vakuum studimesh, prej një kohe të gjatë në këtë fushë, është diçka e pafalshme për shkencat shoqërore. Madje, publiku i gjerë njih më shumë individë e kriminelë të klaneve mafioze, të tipit Al Kapone, subjekte të filmave artistik hollivudian, se sa njeh ata që luftuan e fituan me ta. Tradita ka ende ndikim në mbivlerësimin e karakterit specifik të punës së punonjësit të policisë, si një “punë e mbyllur”, e fshehtë nga publiku, që e ka ushqyer dhe e ka kthyer në një mentalitet, që kufizon njohjen dhe bëmat e tyre, të cilët thjesht i quajnë ose i vlerësojnë si “heronj të heshtur”.

• Te Uollmeri, si te liderët e mëdhenj, dallohen disa tipare pozitive të personalitetit e karakterit, – thjeshtësia, vullneti, ndershmëria, – virtyte të cilat këta liderë i përhapin kudo ku ndalojnë e punojnë, ku gjejnë miratimin e konsensusin e nevojshëm dhe atë mënyrë veprimi që u jep gjithë mundësitë e zgjidhjes së problemeve. Kudo ku punoi, që nga posta e thjeshtë e Berkliit e deri në departamentet e mëdhenj të Çikagos e Nju Jorkut, ai kishte përkrahjen e plotë të pushtetit, politikës dhe opinionit. Kur në rastin e Los Anxhelosit, pas rreth një viti, nuk mundi të ndalonte dot ryshfetet dhe korrupsionin politik të drejtuesve atje, ai dha dorëheqjen.

• I kushtonte shumë rëndësi figurës së policit, si një kusht kryesor për mbarëvajtjen e përbushjen e detyrave delikate në komunitet. Në artikujt e bisedat e tij vë në dukje si shqetësim dukurinë, e cila është aktuale për policinë edhe sot, se “polici është gjithmonë

Sinjari, S.
dhe
Duka, S.
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

²⁹ Prohibicionizmi në SHBA u aplikua për ndalimin e shitje-blerjes së pijeve alkoolike, gjë që rriti artificialisht shumë numrin e veprave penale dhe të organizatave kriminale. Në vitet '20, në Çikago rreth 60% e të ardhurave të bandave kriminale vinte nga tregtia e ndaluar e alkoolit, pjesa tjetër nga, grabitjet, gjobat, kumari, prostitucioni e droga.

i denoncuar nga publiku, i kritikuar nga predikuesit (analistët, njerëzit e letrave etj., – shënimi im, S.S.) i tallur nëpër filma, i qortuar nga gazetat, i pambështetur nga magistratët dhe gjyqtarët”.

• Figura e Uollmerit renditet krahas figurave të mëdha të policisë kudo në botë, – në atdheun e saj, Britaninë; në Francë, Austri, Kanada, Gjermani, – të cilët me kontributin e tyre kanë ideuar e strukturuar policinë moderne të kohës sonë dhe ushqejnë e edukojnë me idetë e tyre largpamëse, brezat e rinj të studentëve, në akademitë dhe kolegjet policore.

• Njohja e figurave, mendimtarëve dhe projektuesve të policisë moderne, plotëson një mungesë. Kjo mungesë reflektohet në literaturë, në arsim, në planet e programet tona mësimore. Prandaj është imperativ për pedagogët e Akademisë së Sigurisë, specialistët e drejtuesit më me përvojë të Policisë së Shtetit dhe për studiuesit e shkencave shoqërore, që t'i ndriçojnë e t'i bëjnë të njohura figurat e korifenjve të policisë moderne.

Bibliografi

1. Boren, Kerry Ross. *August Vollmer – The Great Innovator*, 2006. në: www.prospector-utah.com/vollmer.htm
August Vollmer – The Great Innovator.
2. Gaunt, Richard A. *Sir Robert Peel: The Life and Legacy*. New York: I. B. Tauris, 2010.
3. Taçi, Pandeli, dhe I. Keçka, J. Vreka. *Fjalor Terminologjik*. Tiranë 2005.
4. <http://www.bookrags.com/biography-august-vollmer-cri/16.03.2006>.
Parë për herë të fundit në datë 5. 03. 2016.
5. <http://www.pbs.org/wgbh/americanexperience/features/biography/james-agency>
6. Polygraph Examination Service – Canada. “The polygraph history”, në: http://www.polygraphia.ca/polygraph_history.html.
7. Fisher, Jim. “Pioneer Cop: A Half Century Ahead of his Time”. *A History of Police Education in the United States*. Në: <http://www.cj.msu.edu/~history/scrap/abhistoryofpoliceed.pdf/> (2005)
8. University College London. Në: <http://www.ucl.ac.uk/scs/degree-programmes/undergraduate?gclid=CMGK09yYswkCFaTncgodCNWM2Q>
9. <http://infotainworld.com/best-police-forces-in-the-world/>
10. faculty.ncwc.edu/toconnor/205/205lect04.htm/Police History/ A Brief Guide To Police History/20.07.05
11. http://www.eshow.com/info_8510468_differences-police-sheriffs-marshalls.html
12. <http://www.bookrags.com/biography-august-vollmer-cri/16.03.2006>
13. <http://www.ci.berkeley.ca.us/police/history/history/htm/BerkeleyPoliceDepartmentOurHistory/16.03.2006> dhe <http://www.prison-vollmer.htm/02.03.2006>
14. <http://www.geocities.com/hwstarlett/241Forte.htm>/August Vollmer: The Dean of Modern Policing/03.03.2006
15. <http://www.prison-vollmer.htm/AugustVollmer/02.03.2006>
16. <http://infed.org/mobi/john-dewey>

**Sinjari, S.
dhe
Duka, S.**
« August
Uollmer –
“babai”
i policisë
moderne
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit



■ **Msc Vladimir IKONOMI**
Instituti i Policisë Shkencore

Abstrakt

Trajtimi i disa aspekte të dorëshkrimeve janë të një rëndësie të veçantë për arsye të ndryshme, gjë e cila evidentohet nga rritja e publikimeve apo trajtesave të specializuara të shkruara në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë nga përhapja e rasteve të nevojshme për kryerjen e ekzaminimeve grafike, gjatë shqyrtimit të çështjeve penale dhe civile. Ekspertët gjatë ekzaminimit grafik të dorëshkrimeve, kanë mundësi të shpeshta për të vëzhguar efekte të ardhura nga sëmundje të ndryshme apo dhe të tjera të ardhura nga përdorimi i substancave narkotike apo pijeve alkoolike, të evidentuara kryesisht në linjën grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve objekt ekspertimi. Sa i përket investigimit të rasteve, kjo ndodh sidomos kur dyshohet për mundësinë që dridhjet mund të kenë të bëjnë me imitimim ose maskimin e dorëshkrimit në emër të një personi të caktuar.

Bazuar në eksperiencën kriminalistike të ekzaminimeve grafike të dorëshkrimeve, shpesh herë janë evidentuar dorëshkrime me çrregullime në linjën grafike në formën e dridhjeve. Është në kompetencën e ekspertit të fushës, të studiojë dhe analizojë karakteristikat e këtyre çrregullimeve të linjës grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve në formën e dridhjeve, duke bërë vlerësimin për shkaqet, kushtet dhe rrethanat që kanë ndikuar në formimin e tyre.

Ikonomi, V.

« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit »

Fjalëkyçe:

dorëshkrim, shkaqet e dridhjeve, dridhjet e natyrshme (“autentike”), dridhjet e simuluar, dridhje të pleqërisë, dridhje fiziologjike, dridhje mekanike, dridhje thelbësore.

Hyrje

Zhvillimi i teknologjisë në aplikimin e mjeteve të reja të së shkruarit në mënyrë të shpejtë, siç janë tekstet e përgatitura në kompjuter e të printuara me bojë me anën e printerëve të ndryshëm, nuk e ka zëvendësuar shkrimin me dorë dhe në mënyrë të veçantë konfigurimin e shkrimeve “emër mbiemër” apo formën e shkurtuar të tyre, që është nënshkrimi (firma). Megjithatë, trajtimi i disa aspekte të dorëshkrimeve janë të një rëndësie të veçantë për arsye të ndryshme, gjë e cila evidentohet nga rritja e publikimeve apo trajtesave të specializuara të shkruara në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë nga përhapja e rasteve të nevojshme për kryerjen e ekzaminimeve grafike, gjatë shqyrtimit të çështjeve penale dhe civile. Studimi i shkrimit paraqet probleme në aspekte të ndryshme, të tilla si çrregullimet në linjën grafike, të cilat kanë të bëjnë me dridhjet e shkaktuara nga sëmundje të tilla si sëmundja *Parkinsonit*¹, *Alzheimer* dhe probleme të tjera të rënda, të tilla si moshë e vjetër (*senectus ipsa Morbus*), alkooli, droga apo dhe sëmundje të tjera.

Ekspertët gjatë ekzaminimit grafik të dorëshkrimeve, kanë mundësi të shpeshta për të vëzhguar efekte të ardhura nga sëmundje të ndryshme apo dhe të tjera të ardhura nga përdorimi i substancave narkotike apo pijeve alkoolike, të evidentuara kryesisht në linjën grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve objekt ekspertimi. Sa i përket investigimit të rasteve, kjo ndodh sidomos kur dyshohet për mundësinë që dridhjet mund të kenë të bëjnë *me imitimin ose maskimin* e dorëshkrimit në emër të një personi të caktuar. Pra, kur një person simulon duke shkruar një testament *ollograf (me shkrim dore)* ose dokument tjetër që i referohet një personi të moshuar, ai përpiqet të imitojë përveç të tjerave edhe dridhjet për shkak të moshës (pleqërisë).

¹ Personi fillon të shkruajë normalisht, nga e majta në të djathtë dhe dalngadale kur shkruan ka tendencë për të shkruar shkronjat me karaktere që zvogëlohen gjithmonë e më shumë, aq sa që fjalët e fundit kanë dimensione (shkallë madhesie) më të vogla se sa të tjerat pararendëse. Dorëshkruesi nuk mundet të shkruajë duke ruajtur të njëjtin rresht dhe fjalët nuk janë të theksuara mirë dhe kur ka një dridhje të lehtë të dorës, shkrimi bëhet plotë “zhgaravina” dhe shpesh është i palexueshëm.

Ikonomi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të orëshkrimit të personit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Këto dridhje janë objekt studimi edhe për ekspertët e ekzaminimeve grafike të dorëshkrimeve, me qëllim studimin e shfaqjes së karakteristikave shkrimore të shkrimit për të identifikuar personalitetin dhe karakterin e autorit dorëshkrues të tyre. Ndërkohë theksojmë se është e ndaluar që ekspertët të bëjnë vlerësime mbi karakterin dhe personalitetin e të akuzuarit dhe në përgjithësi në cilësitë e tij mendore.² Përveç kësaj, një grafolog i cili do të hetojë - edhe pse për qëllime të identifikimit të karakterit dhe personalitetit të personit dorëshkrues të një shkrimi, nuk ka nevojë për njohuri të veçantë dhe përvojë në fushën e psikiatrisë dhe psikologjisë.

1. Shkaqet e dridhjeve në dorëshkrimin e personit

Në lidhje me shkaqet e tyre, dridhjet mund të dallohen:

- a) të rastit;
- b) të analfabetizmit;
- c) të simuluar.

a. Dridhjet e rastit

Dridhjet e rastit janë të shkaktuara nga të gjitha fenomenet të cilat ndodhin për shkak të gjendjes së çastit, forcimit të muskujve, midis të cilave gjendja nga një i ftohtë i fortë që shkakton drithërima në trupin e personit. Zakonisht të dridhura shumë të dukshëm shfaqen tek gratë, të cilët janë më të ndryshme ndaj ndryshimeve të temperaturës. Nën efektin e të dridhurave të pjesëve të trupit, shpesh dorëshkruesi merr një pozicion duke e bërë shkrimin në madhësi të ndryshme nga ai i zakonshmi. Një tjetër shkak i dridhjeve mund të jetë paqëndrueshmëria e fletës ose e suportit mbështetës në të cilin dorëshkruesi shkruan. “Nëse dikush shkruan në rrethana të pavolitshme”, p.sh në një makinë në lëvizje, lëkundjet e bëjnë shkrimin me dridhje dhe përvoja tregon se shkronjat janë përgjithësisht më të mëdha se sa në kushtet normale. Me qëllim për të neutralizuar tronditjen e automjetit, dorëshkruesi rrit automatikisht presionin e shkrimit, për të parandaluar mjetin shkruar që të shkëputet nga sipërfaqja e letrës.

b. Dridhjet e të pashkolluarve

Shkrimi i tyre në thelb ka karakteristikat e mëposhtme:

- Gjurmët e forta të presionit të shkrimit;
- me pak organike;
- intervale të shumta;
- pak ose aspak lidhje midis shkronjave;
- shtrirje të parregullt.

c. Dridhjet e simuluar

Për të identifikuar një dridhje të simuluar duke e krahasuar me dridhjet “autentike”, theksojmë se ato kryesisht mund të gjenden tek testamentet që u atribuohen personave shumë të moshuar, si dhe në dokumente të tjera të falsifikuara, duke supozuar që tek një person i moshuar konstatohet një dridhje e lartë e duarve, duke e bërë të vështirë identifikimin e tij. Dridhjet në dorëshkrim janë të simuluar kur falsifikuesi që dëshiron

³ (Neni 178 i Kodit. Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, viti 1995).

⁴ Donato, Francesco. “Ligji i katërt i Solange-Pellat”. *Kriminalistika dhe Teknikat Investigative*. Firenze: 2006, (f.73)

të imitojnë shkrimin e një personi i cili është prekur nga një dridhje, përpiket për të futur dridhje në linjën grafike pak a shumë të theksuara; bëjnë përpjekje gjithashtu në mënyrë që të fshehin shenjat e stereotipit dinamik të shkrimit të tyre, me qëllim që ai të mbetet pa identifikuar.

Megjithatë siç do të shohim, nuk është e lehtë për të dalluar dridhjen fiziologjike, e cila duket si një dridhje e shkaktuar nga një shqetësim i vazhdueshëm ose i rastit neuromuskular, me dridhje të rastit të individëve të ligështuar (*të sëmurë*) apo të shëruar, por me nerva të dobëta (*nevrrik*). Por çrregullimet në dorëshkrimin e personit mund të diferencohen me studime të kujdesshme dhe të vëmendshme, nëse kemi dorëshkrime objekte ekzaminimi të bollshme, për të përcaktuar dridhjen “*autentike*” përkundrejt dridhjes së simuluar. Shumë sëmundje dhe shumë faktorë ose disa kushte të motit, me siguri kanë efekte në linjën grafike të dorëshkruesit. Praktikisht nuk janë çrregullimet që evidentohen në linjën grafike të dorëshkrimit që diagnostikojnë sëmundjen, por sëmundja shkakton efekte të tilla tek dorëshkrimi i personave të sëmurë ose të alkoolizuar.

2. Karakteristikat e dridhjeve horizontale, vertikale dhe të përziera

Në dridhjen horizontale, luhatjet janë pingul me drejtimin e shkrimit (*linjës grafike*), d.m.th pingul me aksin e boshtit dhe këmbët e shkronjave. Në skajet djathtas dhe majtas fjalëve, dridhjet janë të theksuara. Një karakteristikë e këtij lloji tek dridhjet, evidentohet duke këqyrur në tërësi formën e përgjithshme të shkronjave. Në dridhjen vertikale, i quajtur edhe “*colpo di frusta*”⁴, drejtimi oshilacioneve paraqitet si shenja grafike paralele me aksin e këmbëve shkronjave.

Shenjat që dallojnë vërtetë dridhjet në shkrimet “*autentike*” janë:

a. Prania e oshilacioneve tepër të dendura: Kjo nënkupton të shkruarit me dridhje të vazhdueshme, d.m.th jo përmasa të mëdha, por më tepër të vogla dhe këndore. Njerëz të moshuar, që u dridhen duart, kanë tendencë për të zvogëluar madhësinë e dorëshkrimit të tyre dhe kur ata e kuptojnë, përqendrohen që dridhjet të jenë më të ulëta, duke zvogëluar hapësirën (gjerësinë) në linjën grafike të rreshtit (*Shih fig.*)



b. Rritja e presionit: Kjo ndodh për shkak të intensitetit të karakteristikës së dorës, e cila shkakton presion jo normal në shkronjat ovale si “*a*”, *e*, *o*, *d*, *q*”, etj. Megjithatë, duhen shmangur rastet e gabimeve që mund të shkaktohen sipas llojit të shkronjës, llojet ose gjendjes së mjetit shkruar. Edhe parregullsia e suportit mbështetës, e cila shkakton mos koordinimin të lëvizjeve, reflekton ndryshime shumë të theksuara në presionin e shkrimit.

⁴ “Dëmtim i zverkut”

Ikonomi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të orëshkrimit të personit »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

c. Shtypja në bazën e shkronjave ovale: Kjo ndodhë pasi dora nuk ka fuqi të mjaftueshme dhe fleksibilitet për të ndjekur format e lakuara. Prandaj, forma ovale bëhet këndore ose katrore. (Shih fig)



d. Zvarritjet: Këto shkaktohen pasi dinamika e lëvizjeve në ngjitje të mjetit shkruar nuk është automatike; mjeti shkruar stilolaps, lë në fletë edhe pjesë (*gjurme*) të vogla të lehta të bojës, goditje parazitare, që i ngajnë rretës së merimangës.

e. Sinusoida (*shtrirja dredha-dredha*): vija ideale që shkon poshtë fjalës, fjalëve ose nënshkrimit, pasqyron dredhat e saj edhe në qoftë se dorëshkruesi shkruan në letër me vija. (Shih fig)



3. Drithjet e natyrshme ose “autentike”

Mund të dallohen katër lloje të dridhura “autentike” apo të natyrshme:

- dridhje të pleqërisë (moshës së avancuar);
- dridhje fiziologjike;
- dridhje mekanike;
- dridhje thelbësore.

Karakteristikat e dridhjeve “autentike” pasqyrohen në ndryshimin në drejtim të seksionit të shkrimit, luhatjet dhe amplitudën e tyre, intensitetin dhe ndryshimet e shkaktuara nga rritja e moshës.

a. *Drithjet e pleqërisë*, janë pikërisht ato për shkak të plakjes së personit në tërësi, duke përfshirë natyrisht sistemin neuromuskular.

Me avancimin e moshës, tek të gjithë njerëzit në përgjithësi kjo anomali fillon dhe shfaqet më shenja që fillimisht mezi duken dhe më pas theksohen deri në prishjen e shkrimit duke evidentuar shenja shumë të dukshme, sidomos në karakteristikat themelore. Në drithjet e pleqërisë në fakt, linjat e drejta nuk ruhet, por shkrimi ngrihet lart ose poshtë në sipërfaqen e fletës në mënyrë të çrregullt. Në krahasim me drithjet e një natyre tjetër, ato të pleqërisë janë të përziera (*mikse*) dhe të ndërprera.

Drithjet në dorëshkrime, janë të përcaktuara në mënyrë të pashmangshme edhe

Ikonomi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

nga aksidente të ndryshme dhe sëmundje të ndryshme të shumta⁵, në të cilat mund të jetë përfshirë dorëshkruesi i tyre. Prandaj, duhet të bëjmë dallimin midis llojeve të ndryshme të dridhjeve. Në të njëjtën kategori, dallojmë ndryshueshmëri për shkak të frekuencës dhe intensitetit të “shokut” ose tronditjes.

b. *Dridhjet fiziologjike*, janë të shkaktuara nga shqetësime të përkohshme, ose të vazhdueshme neuromuskulare të organeve që marrin pjesë në shkrim. Këto janë dridhje të rastit, që ndikojnë tek njerëzit e dobësuar, në shërim e sipër apo dhe të sëmure nga nervat (nevrik). Këto dridhje mund të shkaktohen nga i ftohti ekstrem dhe i papritur, nga një emocion i fortë, me një “veprim të pa menduar” apo dhe përpjekjeve të dhunshme.

c. *Dridhje mekanike*, janë specifike kryesisht për ata që kryejnë punë shumë të rëndë dhe ata që vazhdojnë të punojnë me krahë. Dridhjet e gjymtyrëve të sipërme pikërisht shkaktojnë një efekt shumë të veçantë në shkrim.

d. *Dridhjet thelbësore* të vetë personit, janë të njohura edhe nën emrin “dridhjet neuropatike të trashëguara”⁶. Këto janë zakonisht të dukshme që në fëmijërinë apo në rininë e hershme, por edhe më vonë dhe jashtëzakonisht të dukshme madje në moshën e vjetër. Më shumë se një anëtar i familjes, shpesh mund të jetë goditur në moshën e vet.

4. Dridhjet për shkak të moshës së madhe (pleqërisë)

Përveç shkaqeve shëndetësore⁷ që sjellin çrregullime në dorëshkrimin e personit të cilat janë të lidhura me shkencën mjekësore, në fushën e kriminalistikës njihen edhe shkaqe të tjera të cilat kanë të bëjnë me moshën e avancuar⁸ të dorëshkruesit. Të dorëshkruarit është një proces që përfshin koordinimin e shumë muskujve. Kjo aftësi motorike zhvillohet tërësisht deri në moshën rreth 15 vjeç, pra deri sa arrihet në fazën e maturimit. Për ta konkretizuar evolucionin e dorëshkrimit, po i referohemi rastit të studiuesit italian *Angelo Vigliotti*, i cili ka marrë në analizë shkrimin e *Garibalidit*⁹, në periudha të ndryshme të jetës së tij deri në periudhën para vdekjes së tij (Shih fig 4)

e foglio d'un mio amico
intimo a cui devo molte
obbligazioni - Ne lo raccomando
caldamente - pro
G. Garibaldi

⁵ Efektet e disa sëmundjeve dhe kushteve të tjera në shkrim janë hetuar nga G. Caprotti. *L'identità del tremore*. Milano: 1985.

⁶ Leibl, V. M. *Grafologia psicologica*. Milano: U. Hoepli, 1935.

Kjo autore i ka thelluar studimet e Frojdit, Kretshmer, Adler dhe ka botuar shkrime të individëve me depresion, njerëzve të ngacmuar, nevrashtenik e melankolik, të histerikëve e narkomanëve.

⁷ G. Caprotti. *L'identità del tremore*. Milano: 1985.


⁸ Donato, Francesco. *Criminalistica e tecniche investigative*. Firenze: Olimpia, 2006.

⁹ Giuseppe Garibaldi lindur në vitin 1807 dhe ka vdekur në 1882 (75 vjeç).

Ikonimi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të orëshkrimit të personit »


Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

– Në shkrimin e Garibalidit, në maturimin e tij të plotë, është evidente linja grafike me një drejtim linear; shumë i rrjedhshëm, me raporte të rregullta midis hapësirave në linjën grafike midis fjalëve, rreshtave dhe germave¹⁰. Me plakjen e personit aftësia motorike ulet dhe për pasojë ndryshon tipi i shkrimit. (Shih fig)



– Në shkrimin e Garibalidit në pleqëri, evidentohen disa shenja grafike që rezultojnë të ngurtësuar, me ritëm të ngadalësuar dhe është pak i sistemuar, quajtur ndryshe “Shkrimi i çrregullt i pleqërisë”¹¹. Nuk ka asnjë person, pavarësisht se çfarë moshe ka, që nuk mund ketë probleme me të dorëshkuarin. Kjo ndodh më shpejt dhe në mënyrë të dukshme, kur ka një humbje të qelizave nervore që prodhojnë dopaminën, përgjegjësen për koordinimin e muskujve.

(Shih Fig)



– Në shkrimin e Garibalidit, një javë para se të vdiste, evidentohet shkrimi komplet i destruktuar nga ana morfologjike, me prishje të linjës grafike, me humbje të formës së shkrimit, - karakteristika të shkrimit në moshën e pleqërisë së avancuar, i quajtur ndryshe edhe “shkrimi i pleqësie me çrregullime të rënda”¹². Praktikisht ai arrin të ndjek drejtimin e rreshtit, por fjalët e shkruara janë të pakuptueshme. Dinamika e linjës grafike paraqitet me kënde dhe disa elemente grafike në gjendjen që paraqiten, “kanë humbur”.

Ikonimi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹⁰ Vigliotti, Angelo. “Grafologia Medica, Sindrome Demenziale e Analisi Della Scrittura”, në: *Rivista di neuroscienze psicologia e science cognitive*. (f. 14).

Gjendet e publikuar në adresën: <http://www.neuroscienze.net/public/pdfart/1839.pdf>

¹¹ Donato, *Criminalistica*, (f. 66).


¹² Vigliotti, Op. Cit, po aty.

Dridhjet spontane, ose “*autentike*”, shpesh shkaktohen nga shëndeti fizik dhe mendor i dorëshkruesit. Në qoftë se trupi i tij është i dobësuar, çdo lëvizje që shqetëson atë është shkaku i luhatjeve që ndodhin në shkrimet e tij. Luhatjet spontane janë lëvizje periodike reciproke pothuajse gjithmonë ritmike. Dridhjet në të shkruar pasqyrojnë një çrregullim të lëvizjeve të gjymtyrëve me të cilët personi shkruan. Kjo është një lëvizje *para e mbrapa* ose (*zik-zake*)”, që shkon nga e majta në të djathtë apo lart poshtë. Siç u përmend, dridhjet janë të ndryshme për gjerësinë e lëvizjeve të tyre dhe pse ato janë horizontale, vertikale apo të përziera. Dridhjet horizontale janë pingul me drejtimin e goditjes së stilolapsit; dridhjet vertikale janë paralele me drejtimin e lëvizjes së mjetit shkruar dhe dridhjet e përziera janë padysim ato që karakterizohen nga kombinimi i dy dridhjeve (*luhatjeve*) horizontale dhe vertikale. Dridhjet të përziera janë gjetur në pleqëri dhe tek të sëmurët me sëmundjen Graves¹³.

Njohja apo evidentimi i falsifikimit të tyre është i mundur nëpërmjet ekzaminimit me anë të mikroskopëve stereoskopik dhe gjithashtu përmes fotografisë e makrofotografisë, të cilat lejojnë apo mundësojnë zbulimin/evidentimin e gjurmëve të falsifikimit të shkrimeve dhe nënshkrimeve, si dhe pabarazitë e lëvizjes në linjën grafike. Karakteristikat e dridhjeve “*autentike*” kanë të bëjnë me ndryshimin në drejtim të seksionit shkrimit, luhatjet dhe amplitudat e tyre, intensitetin dhe ndryshimet e shkaktuara nga rritja e moshës.

5. Dridhje spontane dhe dridhje e simuluar

Një dorëshkrim quhet me dridhje kur karakteristikat e linjës grafike janë rrjedhojë për shkak të lëvizjeve të vogla dorës. Për ekspertet e shkrimit, dridhjet karakterizohen nga një ose më shumë devijime të linjës grafike që zakonisht pason një pjesë të lëvizjes të mjetit shkruar. Dridhja - siç e dimë - është karakterizuar shpesh nga një ose më shumë devijimeve të çrregullta pas një lëvizje të mjeti shkruar. Për të përcaktuar nëse një dridhje është simuluar, ajo ballafaqohet me një “*dridhje autentike*”. Në dridhjen e simuluar evidentohen, me anë të mjeteve adekuate optike dhe të fotografisë makro, pabarazitë në lëvizjen dhe diferencat thelbësore të elementëve (pjesëve) grafike ngjitëse dhe zbritëse. Ndryshe nga sa çfarë mund të evidentohet në dridhjen “*autentike*”, në dridhjen e simuluar është më e theksuar lëvizja “që shkon para dhe vjen pas ose (*zik-zake*)” në fillim dhe në fund të shkrimit. Për sa i përket kësaj të fundit janë bërë konstatime të kundërta, që tregojnë se rritja dhe rënia e dridhjeve në një dorëshkrim duhet të studiohet dhe të interpretohet me kujdes dhe vëmendje të vazhdueshëm. (*Shih fig*)



Praktikë e sektorit të Ekzaminimeve Tekniko-Grafike IPSH, viti 2015, dorëshkrim ku evidentohen dridhjet spontane.

Ikonimi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të orëshkrimit të personit »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹³ Hipertiroidizmi është një gjendje kronike e karakterizuar nga një rritje patologjike e sintezës, sekretimit dhe e niveleve të tiroksinës (T4) e triodotoninës (T3).

Së fundi, dridhjet e simuluara nuk janë të vazhdueshme, por në pjesët horizontale tentojnë të bëhen më të theksuara në raport me ato vertikale.

5.1 Dridhjet spontane


Dridhjet spontane mund të shkaktohen nga arsyt e mëposhtme: dorëshkruesi është analfabet dhe pastaj kopjon shkrimet e të tjerëve, sikur ato të ishin vizatime; dorëshkruesi është në një moshë të avancuar, ose nga arsye të tjera, të tilla si sëmundje të rënda apo pikërisht nga shenjat pleqërisë së tij; dorëshkruesi është dobësuar për shkak të përdorimit të substancave narkotike apo të pijeve alkoolike, apo të vuajtjes nga një sëmundje me origjinë nervore ose psikosomatike; kur personi është duke shkruar në një suport mbështetës në të cilin është vendosur fleta, i cili është më shumë i lartë se sa kur shkruhet normalisht, apo kur dora e dorëshkruesit mbahet nga të tjerët (siç mund të ndodhë kur një person i vjetër shkruan një testament ollograf), duke krijuar kështu një konflikt lëvizjesh në mes të dorës së personit që ka mjetin shkruar dhe dorës “udhëzuese” të personit tjetër.

5.2 Dridhjet e simuluar

Dridhjet e simuluar që evidentohen në tekstet e falsifikuara (të imituara ose maskuar), që mund të shkaktohet:

- Nga sforcimi për të imituar shkrimin e njerëzve të tjerë, një fakt i cili prodhon një dridhje të padëshiruar edhe nëse falsifikatori nuk është plotësisht i papërvojë;

- Nga imitimi i një shkrimi në të cilin është evidentuar dridhje, si p.sh kur imitohet shkrimi i një personi të vjetër ose të sëmurë rëndë (Shih fig 7)



- Nga fakti që dikush është i detyruar për të shkruar nën kërcënim duke evidentuar dridhje të rastësishme (të rastit, të rralla), të shkaktuara nga fakti se dora e dorëshkruesit është e detyruar të shkruaj tekstin e dëshiruar dhe të diktuar prej dikujt tjetër. Ekzaminimi i kujdesshëm i dorëshkrimeve mund të na lejojë për të vërtetuar se dorëshkruesi është i varur nga droga ose është momentalisht nën efektet e një drogë; që është një alkoolist; që është një person i moshës shumë të avancuar; që vuan nga depresioni apo që është një imitues. Hulumtimi i detajuar i karakteristikave shkrimore që rrjedhin nga gjendja depresive dhe studimi i dridhjeve, mund të lejojë të bëjmë supozime edhe për një “diagnozë” të kushteve patologjike në përgjithësi. Megjithatë në këtë drejtim duhet të shmangët konfuzioni i roleve për arsye të përkatësisë; kërkimi për qëllime diagnostike duhet të mbetet në kompetencë të rreptë të mjekëve, ndërsa ekspertët e dorëshkrimeve mund të sigurojnë të dhëna të dobishme, si një element mbështetës në diagnostikimin e sëmundjeve të caktuara dhe intoksikacioneve. Sëmundjet e shumta, sigurisht kanë efekte të ndryshme në dorëshkrimin e një personi. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe! Këto janë të njohura si shkrimet patologjike, në të cilat

Ikonomi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të dorëshkrimit të personit »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

evidentohen në mënyrë konstante gjurme të çrregullimeve në linjën grafike.

6. Konkluzione

1. Dorëshkrimi me dridhje të natyrshme (spontane) natyrore, karakterizohet nga prania e oshilacioneve uniforme, ritmike dhe gjerësi të ndryshueshme.

2. Disa dridhje janë të përcaktuara “*thelbësore*”, që do të thotë të natyrshme në stereotipin dinamik të personit. Këto dridhje janë të njohura edhe me emrin e dridhjeve të trashëguara, të fituara gjatë jetës apo dridhjeve nervore, që mund të shfaqen në fëmijëri ose në rinë, por edhe më vonë, kur mosha përparon. Kur mosha avancon, luhatjet bëhen gjithnjë e më të mëdha.

3. Në veçanti, dridhjet e simuluar janë të ndërprera. Në linjat horizontale ato janë më të theksuara në krahasim me ato vertikale të dorëshkrimit.

4. Pabarazia qoftë në lëvizje, në mbështetje apo qoftë dhe në pjesët zbritëse apo ngjitëse, që të marra së bashku, zbulojnë shkrimet dhe nënshkrimet me dridhje falsifikuese.

5. Në dorëshkrimin e simuluar, dridhjet konstatohen më shumë në fillim se në fund të fjalës, në kundërshtim me atë që evidentohet në dorëshkrimet në të cilat dridhja ka shkaqe patologjike, në të cilën dridhjet shtohen dalëngadalë në vijimësi të dorëshkrimit.

6. Bazuar në eksperiencën kriminalistike të ekzaminimeve grafike të dorëshkrimeve, shpesh herë janë evidentuar dorëshkrime me çrregullime në linjën grafike në formën e dridhjeve. Është në kompetencën e ekspertit të fushës, të studiojë dhe analizojë karakteristikat e këtyre çrregullimeve të linjës grafike të shkrimeve dhe nënshkrimeve në formën e dridhjeve, duke bërë vlerësimin për shkaqet, kushtet dhe rrethanat që kanë ndikuar në formimin e tyre.

Bibliografi

1. Donato, Francesco. “Ligji i katërt i Solange-Pellat”. *Kriminalistika dhe Teknikat Investigative*. Firenze:2006.
2. Leibl, V. M. *Grafologjia psikologjike*. Milano: U. Hoepli, 1935.
3. Donato, Francesco. *Criminalistica e tecniche investigative*. Firenze: Olimpia, 2006.
4. Vigliotti, Angelo. “Grafologjia Medica, Sindrome Demenziale e Analisi Della Scrittura”. *Rivista di neuroscienze psicologia e science cognitive*. Gjendet e publikuar në adresën: <http://www.neuroscienze.net/public/pdfart/1839.pdf>
5. Bloom, Floyd E. dhe Arlyne Lazerson. *Il cervello, la mente e il comportamento*. Përkthyer nga Peccaris C., Milano: Novartis, 1990.
6. Bono G. “Le demenze vascolari”. www.neurologia.net, 2008.
7. Cassano G. dhe Battista Paolo Pancheri. *Trattato italiano di Psichiatria*. Milano: Masson, 1999.
8. Psychiatric Association: DSM IV TR. *Manuale diagnostico e statistico dei disturbi mentali*. Milano: Masson, 2001.
9. Gregory, Richard. *La mente nella scienza*. Milano: Mondadori, 1985.
10. Oldham J.M. dhe Skodol A. E., Bender D.S. *Trattato dei disturbi di personalità*. Milano: Raffaele Cortina, 2008.
11. Steven, Pinker. *Come funziona la mente*. Milano: Mondadori, 2000.
12. Ramachandran V.S. *Che cosa sappiamo della mente*. Milano: Mondadori, 2004.
13. Vigliotti, Angelo. “Capacità di intendere e di volere. Analisi di un caso clinico”. *Analisi dei segni* – n° 11 1996.
14. Vigliotti, Angelo. “Il problema della mente in grafologia medica”. *Analisi dei segni* – n° 15 – 2008.
15. G. Caprotti. *L'identità del tremore*. Milano: 1985.
16. Neni 178 i Kodit. Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, viti 1995.

Ikonomi, V.
« Shkaqet që sjellin ndryshime në stereotipin dinamik të orëshkrimit të personit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA*-s



■ **Doktorant Ilo KËÇKA**
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Abstrakt

Një nga instrumentet që policitë e vendeve të rajonit, kanë përzgjedhur për të forcuar bashkëpunimin midis tyre në këto 13 vitet e fundit, është "Shoqata e Shefave të Policisë së Vendeve të Europës Juglindore" (SEPCA). Shoqata e SEPCA-s, është krijuar më 20 janar 2002, në Valbandon (Pula) të Kroacisë, nga drejtorët e policive të shteteve të Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Rumanisë, Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Policia Shqiptare, e ka vlerësuar dhe e vlerëson këtë shoqatë, jo vetëm e thjesht si shprehje deklarative e vullnetit të shefave të policisë së vendeve të këtij rajoni për të bashkëpunuar midis tyre, por e konsideron atë, si një ndër instrumentet më të rëndësishëm, mbi të cilin bazohet bashkëpunimi policor. Që nga formimi i saj, SEPCA ka pasur si mision kryesor, rritjen dhe mundësimin e një komunikimi të drejtpërdrejtë midis krerëve të policive të vendeve të rajonit tonë, me qëllim rritjen e standardeve të policimit si dhe rritjen e angazhimit dhe bashkëpunimit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet institucioneve policore. Nga muaji nëntor 2014 deri në nëntor 2015, Policia e Shtetit, e Shqipërisë, ka mbajtur presidencën e radhës së SEPCA-s. Drejtori i Policisë së Shtetit, drejtues madhor Haki Çako, ka qenë presidenti i shoqatës, me mandat një vjeçar, mandat i cili ka përfunduar në muajin nëntor 2015.

Fjalëkyçe:

bashkëpunim policor, marrëveshje, sistem i menaxhimit të informacionit, SEPCA, asambleja e SEPCA-s.

Këçka, I.
«Zhvillimi dhe
forcimi
i ambientit
bashkëpunues
në fushën e
sigurisë dhe
roli i SEPCA-s»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

* Shoqata e Shefave të Policisë së Evropës Juglindore (Southeast Europe Police Chiefs Association - SEPCA)

Hyrje

Në mes policive te vendeve të rajonit të Evropës Juglindore ekziston, tashmë, një bashkëpunim i konsoliduar policor, falë kjo dhe perspektivës së përbashkët të vendeve për integrim. Në këtë bashkëpunim policor, kanë ndikuar shumë instrumente që policitë e këtyre vendeve, kanë përzgjedhur për të bashkëpunuar, këto instrumente janë dypalëshe, rajonale dhe më gjerë. Një nga instrumentet që policitë e vendeve të rajonit, kanë përzgjedhur për të forcuar bashkëpunimin midis tyre, në këto 13 vitet e fundit është Shoqata e Shefave të Policisë së Vendeve të Evropës Juglindore (SEPCA). Kjo shoqatë, ka qenë dhe mbetet një mundësi e shkëlqyer dhe një instrument shumë i nevojshëm, për forcimin e bashkëpunimit, për vendet e rajonit tonë. Policia Shqiptare, e ka vlerësuar dhe e vlerëson këtë Shoqatë, jo vetëm e thjesht si shprehje deklarative e vullnetit të Shefave të Policisë së vendeve të këtij rajoni për të bashkëpunuar midis tyre, por e konsideron atë, si një ndër instrumentet të rëndësishëm, mbi të cilin bazohet bashkëpunimi policor. Për këtë qëllim, Policia e Shqipërisë, nga momenti i themelimit të Shoqatës, gjate presidencës së radhës, vazhdon të jetë shumë e interesuar për implementimin në praktikë të fushave të bashkëpunimit policor me të gjitha vendet anëtare.

1. Historiku i SEPCA-s

Shoqata e SEPCA-s, është krijuar më 20 janar 2002 në Valbandon (Pula) të Kroacisë, nga drejtorët e policive të shteteve të Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Rumanisë, Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës.¹ Qëllimi i krijimit të kësaj shoqate, ishte rritja e cilësisë së shërbimeve policore të vendeve anëtare të saj, në përshtatje me principet e demokracisë dhe me dëshirën për përmirësim të vazhdueshëm. Më 24 tetor 2002, në Bukuresht të

¹ SEPCA, "Three Year Strategy, Strategy & Action Plan (2011-2013)", f. 1.

Këçka, I.
« Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA-s »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Rumanisë, u nënshkrua Statuti i Shoqatës.² Në statutin e miratuar, përveç të tjerave, përcaktohet misioni i shoqatës, i cili në mënyrë të përmbledhur, është ai i të qenit një organizatë rajonale parimore për të përmirësuar dhe lehtësuar:

- zhvillimin e vazhdueshëm dhe integrimin e parimeve të policimit demokratik në rajon;
- bashkëpunimin dhe bashkërendimin e zhvillimit dhe implementimit të strategjive të policimit, të sistemeve dhe procedurave në rajon;
- zhvillimin profesional të forcave të policisë në rajon;
- masat për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe zhvillimin e partneriteteve midis policisë dhe komunitetit;
- implementimin e koncepteve të policimit në komunitet, të praktikave dhe të strategjive.

Gjatë veprimtarisë së saj, janë krijuar pesë borde ekzekutive të cilët kanë pasur si objekt luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimin dhe harmonizimin e legjislacionit, policimin në komunitet, trajnimet dhe luftën kundër terrorizmit. Selia e shoqatës, në Sofje, Bullgari, vepronte nëpërmjet sekretariatit të saj, i cili ishte i lidhur me mandatin e presidencës, mandat njëvjeçar i cili ndryshonte çdo vit. Secili vend anëtar i shoqatës, akordonte një fond anëtarësimi në këtë shoqatë, praktikë e cila është ndjekur çdo vit, që nga krijimi i SEPCA-s. Praktikisht, Policia Shqiptare ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga SEPCA dhe ka përfutur nga projektet e realizuara në këtë kuadër, ndër të cilat mund të përmendim:

- *Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Armët* - projekt që lidhet me kontrollin e armëve të lehta dhe të vogla.

- *Akademia Policore e Fëmijëve të Ballkanit (BCPA)*. Në shkurt të vitit 2012, u botua një broshurë e praktikave më të mira për bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe shoqërisë civile, për një fëmijëri të sigurt.

- *Rrjeti i Grave Oficere të Policisë (WPON)*. Sekretariati i SEPCA-s, në bashkëpunim me UNDP/SEESAC, i ka dhënë një mbështetje të plotë veprimtarive të WPON. Janë organizuar seminare të ndryshme dhe në nëntor 2012, u organizua takimi i tretë vjetor i anëtarëve të këshillit të WPON. Ky projekt është iniciuar nga SEPCA.

- *Forumi i Policimit në Komunitet*. Projekti i policimit në komunitet, është vënë në zbatim për pesë vjet me radhë dhe vendet anëtare të SEPCA-s, janë të prira që ta vazhdojnë këtë projekt. Gjatë gjithë këtyre viteve, në gjithë veprimtarinë e saj, shoqata është mbështetur nga partnerë, të cilët kanë bërë të mundur jo vetëm financimin e projekteve të ndryshme, por edhe gjetjen e ekspertizës së nevojshme dhe eksperiencave në fusha të ndryshme policimi. Ndër partnerët kryesorë, mund të përmenden:

- Në fillimet e nismës së SEPCA-s, qeveria kanadeze në bashkëpunim me *Agjencinë Ndërkombëtare Kanadeze për Zhvillim* si dhe me ndihmën e *Policisë Mbretërore Kanadeze*, kanë asistuar, në mënyrë konkrete, me shumë dashamirësi, vendet anëtare të kësaj iniciative.

- *Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)*. Përfundimi i Marrëveshjes Kuadër SEPCA-SDC:

- *Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)*.
- INTERPOL, bashkëpunimi me të cilin ka qenë i vazhdueshëm edhe pas përfundimit

² SEPCA, "Memorandumi i Mirëkuptimit" për themelimin shoqatës SEPCA, i firmosur nga drejtorët e policive të vendeve anëtare.

të projekteve BESA dhe I-24/7.

- *Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (IACP)*. Më 25 prill 2012, SEPCA dhe IACP nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të forcuar partneritetin dhe forcimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet e interesit të përbashkët. Bashkëpunimi vijon. Një delegacion i SEPCA-s ka marrë pjesë në Seminarin “Strategjitë për Reformën Globale Policore për Barazinë Gjimore të Grave Oficere të Policisë në të gjithë fushat e shërbimeve Policore”, ku u prezantua edhe projekti i SEPCA-s për WPON.

- *Iniciativa Rajonale e Migracionit, Azilit dhe Refugjatëve (MARRI)*, SEPCA mbështet MARRI-n në të gjitha veprimtaritë e tij.

- Komisioni Evropian.

- *Ministria e Brendshme Federale e Austrisë (BMI)*. Më 24 janar 2012, u mbajt konferenca e shefave të policisë, anëtarë të SEPCA-s dhe shefave të ILECU-s, në sajë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet SEPCA-s dhe BMI.

- Departamenti i sigurisë publike i Ministrisë së Brendshme të Italisë. Bazuar në “Memorandumin e Mirëkuptimit” ndërmjet SEPCA-s dhe departamentit të sigurisë publike të Ministrisë së Brendshme të Italisë, u mbajt një konferencë dyditore në Romë, me temë “Bashkëpunimi i ardhshëm ndërmjet vendeve të EJL dhe vendeve anëtare të BE”. Në analizën që ju bë ecurisë së aktiviteteve të shoqatës në kuadër të përfundimit të ciklit strategjik 2010-2013, u arrit në konkluzionin e një rikonceptimi të shoqatës. Asambleja e Përgjithshme e SEPCA-s, e cila u zhvillua në vitin 2013,³ në Banja Luka, mori vendimin për të pranuar konceptin e paraqitur nga Policia Austriake, për një proces të ri për forcimin e SEPCA-s, përmes miratimit të strategjisë së re të zhvillimit të shoqatës SEPCA, për periudhën 2014-2017, e cila do të sillte një model të ri të konceptimit dhe funksionimit si dhe forcimin e pozitës së shoqatës, si një pikë qendrore strategjike në luftën kundër krimit të organizuar në rajon. Gjatë këtij takimi, vendet anëtare të SEPCA-s, vendosën shkrirjen e shoqatës së vjetër dhe krijimin e një shoqate të re, që do të mbështetej gjatë punës së saj në dy dokumente themeltare: “Memorandumin e Mirëkuptimit”, – të firmosur nga vendet anëtare – dhe dokumentin që i bashkëngjitet, i cili quhet “Udhëzimet e SEPCA-s”.

Sipas “Memorandumit të Mirëkuptimit”, të nënshkruar nga shefat policive të Shqipërisë, Bullgarisë, Federatës së Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi, Republikës Serbe të Bosnjës dhe Serbisë, “Shoqata e Shefave të Policisë së Europës Juglindore”, është themeluar së fundmi, me bazë vullnetare, si rrjeti më i lartë profesional policor. Ajo përbëhet nga shefat e policisë së Europës Juglindore, si përfaqësues të autoriteteve të tyre policore kombëtare dhe ka për qëllim, forcimin e bashkëpunimit policor dhe identifikimin e nevojave, për krijimin e një qasje të re strategjike. Ajo synon krijimin e një rrjeti ligjor dhe të mandatuar të shefave të policisë së Europës Juglindore, me qëllim rritjen e kapaciteteve të policisë në luftimin e të gjitha formave të krimit, duke njohur nevojën për të intensifikuar përpjekjet për të ndjekur interesat e përbashkëta të sigurisë, duke rikonfirmuar vullnetin e përbashkët për forcimin e ndihmës së ndërsjellët në çështjet policore. Po ashtu, mbetet objektiv i shoqatës, intensifikimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit policor duke u bazuar në filozofinë e partneritetit në kuadrin e një strategjie afatmesme /afatgjatë. Më konkretisht, sipas memorandumit të mirëkuptimit, shefat e policive të vendeve anëtare të SEPCA-s së re, kanë rënë dakord si më poshtë:

- për të bashkëpunuar në zhvillim dhe zbatim të strategjive të policisë, procedurave

³ SEPCA, <http://www.sepca-see.eu/>, Asambleja e Përgjithshme e SEPCA-s, viti 2013, në Banja Luka.

Këçka, I.
« Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA-s »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

dhe shërbimeve në rajon;

- për të lehtësuar partneritetin rajonal dhe bashkëpunimin ndërinstytucional;
- për të promovuar konceptet, praktikat dhe strategjitë e më të mira të policisë,
- për të harmonizuar policimin në Europën Juglindore, me standarde ligjore të përbashkëta, evropiane, duke respektuar parimet e përgjithshme të kodeve të praktikës për strukturat e policisë;
- për të përmirësuar efektivitetin dhe bashkëpunimin e strukturave të policisë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit në bazë të kompetencave të tyre ligjore;
- për të krijuar një metodë të përbashkët strategjike për shmangien, dyfishimin dhe mbivendosjen e tematikave mbi çështjet e lidhura.

2. Aktivitetet e shoqatës SEPCA, gjatë presidencës së Policisë Shqiptare

Nga muaji nëntor 2014 deri në nëntor 2015, Policia e Shtetit të Shqipërisë ka mbajtur presidencën e radhës së SEPCA-s. Drejtori i Policisë së Shtetit, drejtues madhor Haki Çako, ka qenë presidenti i shoqatës, me mandat njëvjeçar i cili përfundoi në muajin nëntor 2015. Sipas parimit të rotacionit në bazë alfabeti, presidenca e SEPCA-s i kaloi drejtorit të Policisë Bullgare.⁴ Që nga formimi i saj, SEPCA ka pasur si mision të saj in kryesor, rritjen dhe mundësimin e një komunikimi të drejtpërdrejtë midis krerëve të policive të vendeve të rajonit tonë, me qëllim rritjen e standardeve të policimit si dhe rritjen e angazhimit dhe bashkëpunimit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet institucioneve policore. Për këtë qëllim, gjatë presidencës shqiptare të kësaj nisme, pavarësisht vështirësive nga ana financiare, – duke konsideruar që prej muajit nëntor 2014, shoqata mbështetëj mbi kontribute vullnetare dhe nuk ka pasur një buxhet të saj in, – u realizuan dy asamble të përgjithshme të SEPCA-s; respektivisht në datat 15 prill 2015, e para, dhe në 25-26 nëntor 2015, e dyta, si dhe tre takime të Bordit Strategjik të saj, përveç aktiviteteve të tjera të ndërmarra në kuadrin e SEPCA-s.

Ndër arritjet më të rëndësishme të presidencës së SEPCA-s, nga ana e Policisë Shqiptare, mund të përmendim anëtarësimin e Rumanisë në SEPCA, anëtarësim i cili u realizua në asamblenë e fundit të SEPCA-s, e cila u zhvillua në Tiranë, në datat 25-26 nëntor 2015. Një tjetër arritje e rëndësishme, mund të konsiderohet konkretizimi dhe përgatitja e draftit të parë të dokumentit mbi “Sistemin e Menaxhimit të Informacionit” (MIS), një instrument ky, që konsiderohet shumë i rëndësishëm dhe që në të ardhmen do të jetë në dispozicion të drejtorëve të policive të vendeve të Europës Juglindore, në të cilin do të trajtohen disa tematika të përzgjedhura dhe për të cilat ata do të kenë mundësi të diskutojnë konkretisht dhe në detaje. “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit”, konsiston në një raport vjetor që mbulon vendet anëtare të SEPCA-s, në mënyrë që t’i sigurojë një informacion strategjik mbi gjithë rajonin e SEPCA-s, drejtorëve të përgjithshëm. Ai konsiderohet gjithashtu si një instrument i rëndësishëm, mbi bazën e të cilit do të ndërtohen strategjitë e ardhshme të SEPCA-s. Ndër tematikat kryesore të cilat trajtohen në “Sistemin e Menaxhimit të Informacionit” (MIS), mund të përmendim:

- prioritetet në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, kontrabandës së qenieve njerëzore dhe krimit të organizuar
- situata rajonale për sa i përket disa fenomeneve të përzgjedhura kriminale;

Këçka, I.
“Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA-s”

Polici
dhe
Siguria
nr.2, 2016

⁴ Asambleja e Përgjithshme e SEPCA-s në Tiranë, Shqipëri, më 25 – 26 nëntor 2015.

- prirjet e fundit të ndjekura nga fenomenet kriminale në qytetet metropolitane;
- fenomenet e reja kriminale që kanë prekur vendet e rajonit të SEPCA-s, etj.

Ndër të tjera, asambleja e SEPCA-s, në takimin e fundit të saj, vendosi me unanimitet, për ftesën me statusin e vëzhguesit në asamblenë e ardhshme të SEPCA-s, që do të zhvillohej në Bullgari, të përfaqësuesve të policisë kosovare, moldave dhe të asaj kroate. Përfshirja e institucioneve policore të atyre vendeve kishte për qëllim plotësimin e asaj që mund të konsiderohet një *vulnus*, për sa i përket shkëmbimit të informacionit midis vendeve të rajonit tonë. Ndër objektivat strategjik që kjo shoqatë i ka vënë vetes për vitin 2016, objektiva të cilat u miratuan në asamblenë e përgjithshme të SEPCA-s, mund të përmendim këta:

- rritja e bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit të informacionit dhe luftës kundër terrorizmit dhe emigracionit të paligjshëm;
- përfshirjen e Kosovës dhe Moldavisë në SEPCA;
- implementimi i “Sistemit të Menaxhimit të Informacionit”;
- përfshirja e SEPCA-s në procesin e planifikimit, në kuadrin e platformës EMPACT (European Multidisciplinary Platform against Criminal Threats);
- rritja e bashkëpunimit me Europolin, për sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me luftën kundër terrorizmit si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera ndërkombëtare, të cilët trajtojnë çështjet e sigurisë publike, etj.

Bibliografi

1. “Memorandumi i Mirëkuptimit” për themelimin shoqatës SEPCA, i firmosur nga drejtorët e policive të vendeve anëtare.
2. “Udhëzimet e SEPCA-s”, dokument i bordit menaxhues të SEPCA-s.
3. SEPCA, “Three Year Strategy, Strategy & Action Plan (2011-2013)”.
4. Dokumentet e takimit të gjashtë të koordinatorëve kombëtarë të SEPCA-s, Bukuresht, Rumani, më 25-27 shkurt 2014.
5. “Asambleja e përgjithshme” e SEPCA-s, Banja Luka, 2013.
6. Seminar në lidhje me “Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit”, 03-04 prill 2014, Europol, në Hagë, në vazhdim të procesit të zhvillimit strategjik të SEPCA-s për vitet 2014-2017.
7. Takimi i 7-të i koordinatorëve kombëtarë, mbajtur në Przno, Mali i Zi, më 27-31 korrik 2014, (përcaktimi i kuadrit ligjor të SEPCA-s).
8. Mbledhje e *Jashtëzakonshme* e asamblesë së përgjithshme të SEPCA-s, 23 shtator 2014, Hagë/Holandë, (përcaktimi i procesit strategjisë të SEPCA-s).
9. Asambleja e përgjithshme vjetore e SEPCA-s, 26 nëntor 2014, Beograd, Serbi;
10. Mbledhja e përgjithshme e “Shoqatës së Shefave të Policive të Europës Lindore”, 15 prill 2015, Tiranë, Shqipëri.
11. Takimi i nëntë i Bordit Strategjik të SEPCA-s, 29-30 shtator 2015, Sofje, Bullgari.
12. Asambleja e përgjithshme e SEPCA-s, Tiranë, Shqipëri, 25-26 nëntor 2015.
13. SEPCA, <http://www.sepca-see.eu/>

Këçka, I.
 « Zhvillimi dhe forcimi i ambientit bashkëpunues në fushën e sigurisë dhe roli i SEPCA-s »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim



■ **Kolonel Dr. Ruzhdi KUÇI**
Komandant/Rektor, Akademia e Forcave të Armatosura*

Abstrakt

Koncepti i paqes tradicionalisht ka qenë i lidhur me gjendjen e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në përgjithësi, mund të identifikohen tre gjendje të marrëdhënieve ndërkombëtare: lufta, paqja dhe mungesa e luftës. Lufta është një gjendje e konfliktit të armatosur që zhvillohet midis shteteve, ndërsa paqja është ndërprerja ose mungesa e një konflikti të tillë. Fakti që gjendja e luftës nuk ekziston jo patjetër do të thotë se është vendosur paqja. Prandaj, gjendja e tretë, mungesa e luftës tregon se konflikti ose një garë armatimesh midis palëve do të vazhdojë të formojë kuadrin e marrëdhënieve të tyre konfrontuese. Përpjekjet për paqe shpesh kombinohen me përpjekje për siguri. Termi "siguri bashkëpunuese" ka marrë një përdorim të gjerë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Megjithatë nuk ka akoma një përkufizim të pranuar nga të gjithë aktorët, ai është përdorur kryesisht si pararendës i një përjasje të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në qoftë se pranojmë se konceptimi i gjerë i sigurisë përfshinë dimensionet politike, ekonomike dhe të drejtave të njeriut, atëherë sistemi i sigurisë bashkëpunuese duhet të lidhet me të gjitha këto aspekte. Siguria bashkëpunuese mund të bëhet baza për një të ardhme më paqësore dhe më të harmonishme. Ajo kombinon katër forma kryesore të sigurisë: sigurinë individuale, sigurinë kolektive, mbrojtjen kolektive dhe promovimin e stabilitetit.

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Fjalëkyçe:

Siguria bashkëpunuese, dilema e sigurisë, siguria kolektive, mbrojtja kolektive, siguria individuale, transparenca.

* Akademia e Sigurisë, duke pasur si synim edhe zgjerimin e thellimin e studimeve në fushën e sigurisë, është e hapur për kërkime dhe analiza të ndryshme ekspertësh në fushën e sigurisë. Pjesë e këtyre botimeve janë edhe materialet e botuara prej punonjësve të institucioneve të ndryshme sigurisë. Konkretisht, Akademia e Sigurisë, ka lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me qëllim realizimin sa më të suksesshëm të misionit të tyre arsimues.

Hyrje

Përpyekjet për paqe dhe siguri kanë dominuar mendimin ndërkombëtar që në kohët më të hershme të historisë së politikës ndërkombëtare. Por vetëm nga fundi i shekullit të 19-të, filloi përhapja e propozimeve për paqe, më tepër si rezultat i frikës nga fuqia shkatërruese e luftës, se sa nga pasojat e shpërthimit të saj. Kjo tendencë vazhdoi edhe gjatë shekullit të 20-të dhe shmangja e luftës si dhe ruajtja e paqes janë bërë një çështje themelore e mendimit politik. Koncepti i paqes tradicionalisht ka qenë i lidhur me gjendjen e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në përgjithësi, mund të identifikohen tre gjendje të marrëdhënieve ndërkombëtare: lufta, paqja dhe mungesa e luftës. Lufta është një gjendje e konfliktit të armatosur që zhvillohet midis shteteve, ndërsa paqja është ndërprerja ose mungesa e një konflikti të tillë. Fakti që gjendja e luftës nuk ekziston jo patjetër do të thotë se është vendosur paqja. Prandaj, gjendja e tretë, mungesa e luftës tregon se konflikti ose një garë armatimesh midis palëve do të vazhdojë të formojë kuadrin e marrëdhënieve të tyre konfrontuese. Përpyekjet për paqe shpesh kombinohen me përpjekje për siguri.

Karta e Kombeve të Bashkuara, për shembull, ka si një ndër qëllimet kryesore “ruajtjen e paqes dhe të sigurisë”. Historikisht, siguria është konsideruar si një vlerë dhe qëllim themelor i sjelljes së shtetit. Në kuptimin tradicional, siguria nënkupton që shteti të mos jetë i kërcënuar me luftë dhe të ndjehet i sigurt nga agresorët e mundshëm; të jetë në gjendje të ndjekë interesat e tij kombëtare dhe të ruajë vlerat themelore. Në këtë kontekst, situatat e mundshme kërcënuese dhe konfliktuale, çojnë në lindjen e problemeve të sigurisë kombëtare, për udhëheqësit politik. Meqenëse idetë për sigurinë përqendrohen tek shteti, politika e sigurisë lidhet kryesisht me rritjen e fuqisë ushtarake të çdo shteti dhe ruajtjen e rendit të përgjithshëm të sistemit shtetëror. Rrjedhimisht, koncepti i sigurisë është konsideruar identik me konceptin e sigurisë kombëtare. Në të njëjtën mënyrë, siguria kombëtare dhe mbrojtja kombëtare kanë qenë realisht të njëjta dhe theksi është vendosur në aspektin ushtarak të sigurisë. Mbas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe si pasojë e globalizimit, kërcënimet nuk kanë më karakter thjesht ushtarak.

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Problemet globale, shumica e të cilave janë ndërkufitare, si krimi i organizuar, terrorizmi, degradimi i mjedisit, mosmarrëveshjet për burimet natyrore, lëvizja e pakontrolluar e refugjatëve, imigracioni ilegal, varfëria dhe uria janë shndërruar në rreziqe për njerëzimin, përballja me të cilat po merr një rëndësi po aq të madhe sa edhe mbrojtja ushtarake. Prandaj, ka lindur nevoja e zgjerimit të konceptit të sigurisë për të përfshirë edhe aspektet e mësipërme. Për më tepër, gjatë viteve të fundit, nën ndikimin e krizës ekonomike globale, mjedisi ndërkombëtar, i cili po bëhet më kompleks, tregon se sfidat e sigurisë së sotme nuk mund të ndahen në ato me karakter “të brendshëm ose të jashtëm” dhe “civile ose ushtarake”.

1. Siguria bashkëpunuese

1.1 Origjina e sigurisë bashkëpunuese

Gjatë Luftës së Ftohtë, Evropa ndodhej në vijën e frontit të ballafaqimit midis Lindjes dhe Perëndimit. Problem urgjent ishte si të parandalohesh një luftë bërthamore dhe si mjet për zgjidhjen e këtij problemi, së pari u strukturua një sistem i deterrencës bërthamore, si për Lindjen, ashtu edhe për Perëndimin. Përballë rrezikut të një luftë bërthamore, në vitet 1970, lindi koncepti i sigurisë ndërkombëtare ose i sigurisë së përbashkët. Ky koncept lindi në sajë të kuptimit të ri se, në qoftë se një palë përpiqej të forconte sigurinë e saj në mënyrë të njëanshme, kjo do të çonte në *dilemën e sigurisë* dhe me shumë mundësi, do të krijonte një situatë më të rrezikshme për të gjithë sistemin ndërkombëtar. Me fjalë të tjera, ishte një koncept i formuluar nga kuptimi se duhet të ketë një masë për rritjen e sigurisë nga të dyja palët. Ky konceptim synonte rritjen e sigurisë së përgjithshme jo në mënyrë të njëanshme, por duke ndërmarrë në një shkallë të caktuar, veprime bashkëpunuese me armiqtë e mundshëm.

1.2 Ç’është siguria bashkëpunuese?

Termi “siguri bashkëpunuese” ka marrë një përdorim të gjerë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Megjithëse nuk ka akoma një përkufizim të pranuar nga të gjithë aktorët, ai është përdorur kryesisht si pararendës i një përjasje të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ai ofronte një opsion për t’u shkëputur nga strategjitë e ngushta të “shumës-zero” të Luftës së Ftohtë dhe për të adoptuar një pikëpamje më të gjerë të paqes dhe harmonisë ndërkombëtare. Sidoqoftë, koncepti i sigurisë bashkëpunuese nuk është një novacion i pas-Luftës së Ftohtë. Në të vërtetë, kjo ide është paraqitur nga Emanuel Kanti që në fundin e shekullit të 18-të, në skicën filozofike, “Artikulli i dytë përfundimtar i paqes së përjetshme”. Kanti, deklaronte se “Ligji i kombeve duhet të bazohet mbi një federatë të shteteve të lira!”¹.

Në deklaratën e parimeve të paraqitura nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Franklin D. Ruzvelt dhe Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Uinston S. Çurçill, në Kartën e Atlantikut, në 14 korrik 1941, theksohet: “... ata shpresojnë të shikojnë vendosjen e një paqeje, e cila do t’u japë mundësi të gjithë kombeve që të jetojnë në siguri brenda kufijve të tyre dhe do të krijojnë siguri, që të gjithë njerëzit në vendet e tyre të jetojnë pa frikë dhe pa varfëri...”².

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹ Kant, Emanuel. “Paqja e Përjetshme”. Në: *Klasikët e Teorisë së Politikës Moderne: Nga Makiavelli tek Mill*. London: Steven M. Cahn, 1996.

² Ruzevelt, Franklin D. dhe Uinston S. Çurçill. *Karta e Atlantikut*, Argentia Bay, Newfoundland, 14 korrik 1941.

Në fillim të viteve 1990, shumë mendimtarë të strategjisë, u kapën nga optimizmi i lindjes së një Rendi të Ri Botëror. Termi “siguri bashkëpunuese” u bë një frazë e përdorur gjerësisht për një përjasje mjaft idealiste ndaj klimës ndërkombëtare që po ndryshonte me shpejtësi. Në vitin 1992, tre strategë të njohur amerikanë – Ashton Carter, William Perry dhe John Steinbruner – flisnin për sigurinë bashkëpunuese nga pikëpamja e sigurimit të një rruge të re për paqen botërore: “Parimet kryesore si deterrenca, stabiliteti bërthamor dhe frenimi (shkurajimi) mëshironin aspiratat e luftës së ftohtë... Siguria bashkëpunuese është parimi korrespondues për sigurinë ndërkombëtare në erën e pas-Luftës së Ftohtë.”³

Në 1994, në një shkrim në revistën “Politika e Jashtme”, ish-ministri i Jashtëm i Australisë, Gareth Evans, e përshkruante sigurinë bashkëpunuese si prirje “...që thekson më tepër konsultimin se konfrontimin, më tepër qetësimin se deterrencën, më tepër transparencën se sa sekretin, më tepër parandalimin se korrigjimin dhe më tepër ndërvarësinë se njëanshmërinë.”⁴

Këto përpjekje për të përcaktuar dhe formësuar konceptin e sigurisë bashkëpunuese, në përgjithësi, ishin reflektim i pikëpamjes liberale/idealiste për të ardhmen e sigurisë botërore. Fatkeqësisht, ky vizion mori një goditje të rëndë nga një “rikthim i historisë” - i padëshirueshëm në Ballkan, në disa pjesë të ish Bashkimit Sovjetik dhe në vende të tjera. Përpunimi i një përjasje pragmatike për sigurinë bashkëpunuese është i domosdoshëm në një botë të paqëndrueshme dhe të rrezikshme, por përpara se të shikojmë si mund të ndërtohet një përjasje e tillë realiste dhe efektive mund të jetë e dobishme të shqyrtojmë shkurtimisht dy koncepte të tjera të mëdha të sigurisë që kanë lindur në shekullin e 20-të.

2. Siguria kolektive dhe mbrojtja kolektive

2.1 Siguria kolektive

Megjithëse koncepti i bashkëpunimit dhe aleancave midis familjeve, tribuve dhe shteteve, në paqe, por më tepër në luftë, ka qenë një tipar i zakonshëm i historisë së njerëzimit, termat siguri kolektive dhe mbrojtje kolektive janë karakteristika të shekullit të fundit. Të dy konceptet nënkuptojnë një angazhim zyrtar afatgjatë midis grupeve të shteteve për të mbrojtur interesat e sigurisë të shteteve anëtare në fusha të përbashkëta.

Siguria kolektive ka orientim të brendshëm dhe synon të realizojë sigurinë brenda grupit të shteteve sovraane. Organizata e parë moderne e sigurisë kolektive ishte Lidhja e Kombeve e themeluar mbas Luftës I Botërore. Anëtarët e saj ishin zotuar të mbronin njeri-tjetrin nga sulmi i një ose disa kombeve të tjera brenda organizatës. Ideja ishte e thjeshtë: një akt agresioni nga një ose më shumë anëtarë kundër një anëtar tjetër do të kundërshtohej, me forcë në qoftë se ishte e nevojshme, nga anëtarët e tjerë të Lidhjes. Për një sërë arsyesh, Lidhja e Kombeve nuk pati sukses në arritjen e sigurisë dhe të stabilitetit. Ky dështim erdhi kryesisht për shkak të asaj që Profesor Michael Mihalka e quan “...papajtueshmëria themelore midis demokracisë liberale, fashizmit dhe komunizmit që bashkeqzistonin brenda anëtarësisë së Lidhjes”⁵.

³ Karter, Ashton B. dhe Uilliam J. Perry et. al. *Një koncept i ri i sigurisë bashkëpunuese*. Washington, DC: Brookings Institute Press, 1993.

⁴ Gareth Evans, “Siguria Bashkëpunuese dhe Konflikti Ndër-Shtetëror”, “Politika e Jashtme, No. 96, 1994.

⁵ Mihalka, Mikael. “Koncepti i Sigurisë Bashkëpunuese”, studim i përgatitur për *Kursin e Lartë Ekzekutiv, Kolegji i Studimeve Ndërkombëtare dhe të Sigurisë*. Garmish-Partenkirshen, Gjermani: Qendra Evropiane për Studimet e Sigurisë, Xhorxh C. Marshall (korrik 1998).

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Në fund të Luftës së II-të Botërore, Kombet e Bashkuara, të sapoformuara, morën “mantelin” e sigurisë kolektive nga Lidhja e Kombeve. Nenet 41 dhe 42 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, parashikojnë veprimin e shteteve anëtare për ruajtjen dhe rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në vitet 1970, u krijua “Konferenca për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë”, tani “Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë”, për të realizuar sigurinë kolektive për gati të gjithë shtetet e rajonit të Euroazisë dhe atij atlantik. Megjithatë, edhe kjo organizatë ka qenë vetëm pjesërisht efektive⁶.

2.2 Mbrojtja kolektive

Një organizatë e mbrojtjes kolektive ka orientim të jashtëm dhe synon të mbrojë anëtarët e saj nga një agresion i jashtëm. Organizatat e mbrojtjes kolektive lulëzuan gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Mbas Luftës së II-të Botërore u krijuan Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Bashkimi Evropian Perëndimor (BEP), Organizata e Traktatit Qendror (CENTO), Organizata e Traktatit të Azisë Juglindore (SEATO) dhe Traktati i Varshavës. Mbrojtja kolektive angazhon të gjithë anëtarët e marrëveshjes për të shkuar në mbrojtje të njeri-tjetrit në rast se një anëtar kërcënohet ose sulmohet nga një shtet ose shtete jashtë zonës së traktatit. Traktati i Brukselit, i vitit 1948, dokumenti themelues i Bashkimit Evropian Perëndimor dhe Traktati i Uashingtonit, i vitit 1949, dokumenti themelues i NATO-s, i përmbajnë këto dispozita si temën e tyre qendrore.

3. Siguria bashkëpunuese - dy elementë të rinj

Për të qenë e dobishme dhe efektive, siguria bashkëpunuese duhet të ketë orientim të brendshëm dhe të jashtëm. Por ajo duhet të përfshijë edhe dy dimensione të tjera që nuk përfshihen, të paktën në mënyrë të drejtpërdrejtë, as nga siguria kolektive, as nga mbrojtja kolektive. Dimensioni i parë është “siguria individuale” dhe i dyti, “promovimi i stabilitetit” në rajonet fqinje, me hapësirën e sigurisë bashkëpunuese, ku paqëndrueshmëria dhe konflikti mund të ndikojnë për keq në sigurinë e anëtarëve të saj.

3.1 Siguria individuale

Siguria individuale, ose siç e quante ish-ministri i Jashtëm i Kanadasë, Lloyd Axworthy, “siguria njerëzore”⁷ është në qendër të sistemit të sigurisë ndërkombëtare dhe është e ndërtuar sipas idealeve demokratike liberale. Zhvillimi dhe ruajtja e lirive themelore të individit është thelbi nga i cili duhet të rrjedhin të gjitha format e tjera të sigurisë. Dr. Bill McSweeney, në studimin e tij për kuptimin e sigurisë, ve në dukje se “Ndryshe nga pikëpamja ortodokse e studimeve të sigurisë, siguria duhet të ketë kuptim në nivelin bazë të individit, në mënyrë që ajo të ketë kuptim në nivel ndërkombëtar”⁸. Në epokën e rritjes së ndërveprimit midis shteteve dhe popujve, shqetësimi për kushtet humane është shndërruar në një interesim të drejtpërdrejtë dhe imediat të komunitetit botëror. Shkelja e të drejtave të njeriut në një shtet, shumë shpejtë bëhet e ditur për qytetarët e

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

⁶ Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945.

⁷ Departamenti Kanadez i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare. *Siguria Njerëzore: Siguria për njerëzit në një botë në ndryshim*. Otava: prill, 1998.

⁸ McSweeney, Bill. *Siguria, identiteti dhe interesat, - një sociologji e marrëdhënieve ndërkombëtare*. Universiteti i Kembrixhit, 1999.

shteteve të tjera. Cenimi i sigurisë individuale në një vend, nga forcat e jashtme, ose më shpesh, nga forcat e brendshme, do të thotë se popujt e tjerë dhe qeveritë e tyre ndjejnë se është dobësuar edhe siguria e tyre. Shkeljet masive të sigurisë individuale në vende të ndryshme si, në Ruandë, Kosovë, Timori Lindor e të tjera, kanë pasur ndikime të jashtëzakonshme në komunitetin ndërkombëtar. Siguria individuale tani është vendosur në qendër të axhendës ndërkombëtare. Koncepti vestfalian i së drejtës absolute të shteteve, - që të veprojnë si ta konsiderojnë të përshtatshme brenda territorit të tyre - tashmë është i papranueshëm nga shtetet liberal-demokratike dhe gjithnjë e më tepër edhe nga kombet në organizata ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara. Koncepti i sovranitetit të shtetit nuk mund të jetë një perde pas të cilës të mund të kryhen shkelje masive të sigurisë njerëzore dhe të mos ndëshkohen.

3.2 Promovimi i stabilitetit

Komponenti i dytë, i ri, i sigurisë bashkëpunuese është promovimi i stabilitetit jashtë kufijve të shteteve që formojnë sistemin e sigurisë bashkëpunuese. Mungesa e stabilitetit në zona fqinje me territorin e sistemit të sigurisë bashkëpunuese, ose edhe më larg, që mund të kërcënojnë sigurinë e anëtarëve të tij, është një çështje shqetësuese. Stabiliteti mund të priset nga rreziku i konfliktit midis shteteve, por edhe nga shkelja masive e sigurisë individuale brenda shteteve fqinje, ashtu siç ndodhi në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, gjë që provokoi një reagim të fortë nga NATO dhe vende të tjera. Si duhet të zhvillohet, të rivendoset dhe të ruhet stabiliteti përreth tyre, duhet të jetë një shqetësim i vazhdueshëm i shteteve të një sistemi sigurie bashkëpunuese. Promovimi i stabilitetit mund të shikohet si një mundësi për ndërhyrje të pajustificueshme nga fuqitë e mëdha ose organizatat ndërkombëtare në punët e brendshme legjitime të shteteve të tjera, sidomos atyre të vogla. Prandaj, ndërhyrja aktive – diplomatike, ekonomike ose ushtarake – duhet të sanksionohet dhe të monitorohet me kujdes.

4. Bërthama e shteteve demokratike

Siguria bashkëpunuese duhet të ketë në qendër të saj një bërthamë të shteteve demokratike liberale që u përmbahen vlerave të përbashkëta. Natyrisht, në lidhje me këtë, ekziston pikëpamja se vetë shteti është shndërruar në një aktor më pak të rëndësishëm në fushën e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktorët joshitetërorë tani luajnë një rol kryesor në skenën moderne të sigurisë. Është e vërtetë se organizatat joshitetërore, korporatat transnacionale, grupet e presionit, madje edhe grupet kriminale dhe terroriste ndërkombëtare po e rrisin ndikimin e tyre në fushën e sigurisë. Megjithatë, nuk shikohet ndonjë perspektivë e shpejtë që si alternativë realiste të zëvendësojë sistemin e shteteve sovrane dhe institucionet që ato formojnë si dominuesi i sigurisë për qytetarët. Shtetet me demokraci të dobët dhe sigurisht ato jo demokratike mund të punojnë me shtetet anëtare të një sistemi sigurie bashkëpunuese për qëllime specifike, afatshkurtër. Megjithatë, ato mund të japin kontribute të dobishme politike dhe ushtarake për sistemin e sigurisë bashkëpunuese më mënyra specifike dhe të kufizuara. Por në perspektivë, vlerat dhe perceptimet e tyre mund të ndryshojnë si rezultat i kontaktit dhe bashkëpunimit me demokracitë liberale brenda sistemit.

4.1 Bashkëpunimi praktik dhe transparent

Siguria e vërtetë bashkëpunuese duhet t'i bashkojë shtetet në shumë mënyra. Ato duhet të jenë të angazhuara për dialog midis tyre, duke përfshirë një sërë veprimtarish

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

dhe interesash. Në qoftë se pranojmë se konceptimi i gjerë i sigurisë përfshinë dimensionet politike, ekonomike dhe të drejtave të njeriut, atëherë sistemi i sigurisë bashkëpunuese duhet të lidhet me të gjitha këto aspekte. Për aspektet e mësipërme duhet të përfshihen konsultime të ngushta dhe të vazhdueshme politike, marrëdhënie të lira dhe të hapura tregtare, politika të koordinuara të jashtme dhe të sigurisë, përfshi formacionet ushtarake të integruara ose shumëkombëshe. Mbi të gjitha, ato duhet të krijojnë mekanizma për të zgjidhur në mënyrë paqësore dhe miqësore kundërshtitë midis shteteve ose grup-shteteve brenda sistemit. Brenda një sistemi të sigurisë bashkëpunuese, shtetet individuale disa herë duhet të heqin dorë nga disa interesa kombëtare ose t'i modifikojnë ato për të mirën e përgjithshme afat-gjatë. Ato veprojnë kështu sepse gjykojnë se interesat e tyre të përbashkëta janë më të rëndësishme se interesat afatshkurtra të shteteve individuale. Ky element është themelor për suksesin e një sistemi të sigurisë bashkëpunuese.

5. Përfundime

Siguria bashkëpunuese mund të bëhet baza për një të ardhme më paqësore dhe më të harmonishme. Ajo kombinon katër forma kryesore të sigurisë: sigurinë individuale, sigurinë kolektive, mbrojtjen kolektive dhe promovimin e stabilitetit. Një sistem i sigurisë bashkëpunuese kërkon, nga shtetet demokratike që e formojnë atë, gatishmëri për bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën dhe të ndërveprojnë ose, kur është e nevojshme, të ndërhyjnë në rajone jashtë territorit të tyre, kur këto mund të cenojnë paqen dhe sigurinë e tyre të përbashkët. NATO-ja përfaqëson një model real të një sistemi të tillë të sigurisë bashkëpunuese. Ajo mishëron të katër funksionet bazë të trajtuara më lart. Në analizë të fundit, sukcesi i çdo sistemi të sigurisë ndërkombëtare varet nga një udhëheqje e fortë dhe e bashkuar, nga shpirti i kompromisit dhe nga vendosmëria dhe këmbëngulja e anëtarëve të tij. Në qoftë se këta elementë mungojnë sistemi do të dështojë. Ai do të dështojë jo detyrimisht se vetë koncepti është i gabuar, por se praktikuesit e tij nuk kanë guximin dhe urtësinë (zgjuarsinë) për të kapërcyer vështirësitë dhe mosmarrëveshjet e pashmangshme për të parë drejtë suksesit afat-gjatë. Megjithatë, në qoftë se një udhëheqje e kujdesshme dhe largpamëse mund t'i kapërcejë këto pengesa, një manifestim real dhe praktik i sigurisë bashkëpunuese mund të sjellë shpresa të reja për një botë të trazuar.

Bibliografi

1. Kant, Emanuel. "Paqja e Përjetshme". Në: *Klasikët e Teorisë së Politikës Moderne: Nga Makiavelli tek Mill*. London: Steven M. Cahn, 1996.
2. Ruzevelt, Franklin D. dhe Uinston S. Çurçill. *Karta e Atlantikut*, Argentinia Bay, Newfoundland, 14 korrik 1941.
3. Karter, Ashton B. dhe Uilliam J. Perry et. al. *Një koncept i ri i sigurisë bashkëpunuese*. Washington, DC: Brookings Institute Press, 1993.
4. Gareth Evans, "Siguria Bashkëpunuese dhe Konflikti Ndër-Shtetëror," *Politika e Jashtme*, No. 96, 1994.
5. Mihalka, Mikael. "Koncepti i Sigurisë Bashkëpunuese", studim i përgatitur për *Kursin e Lartë Ekzekutiv, Kolegji i Studimeve Ndërkombëtare dhe të Sigurisë*. Garmish-Partenkirshen, Gjermani: Qendra Evropiane për Studimet e Sigurisë, Xhorxh C. Marshall (korrik 1998).
6. Karta e Kombeve të Bashkuara, 26 qershor 1945.
7. Departamenti Kanadez i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare. *Siguria Njerëzore: Siguria për njerëzit në një botë në ndryshim*. Otava: prill, 1998.
8. McSweeney, Bill. *Siguria, identiteti dhe interesat, - një sociologji e marrëdhënieve ndërkombëtare*. Universiteti i Kembrixhit, 1999.

Kuçi, Rr.
« Siguria bashkëpunuese në një mjedis ndërkombëtar në ndryshim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë



■ Msc **Adriatik DUQI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Situata dhe nevojat për shkollim/trajnimet policore mund të ndryshojnë në vende të ndryshme europiane. Vendet europiane janë shumëplanëshe dhe të ndryshme - kështu është edhe policia². Ka disa nevoja të përbashkëta policimi në të gjithë Europën, por në të njëjtën kohë ka po aq nevoja të ndryshme në çdo rajon të veçantë. Traditat, sistemet e vlerave, historitë e totalitarizmit apo demokracisë, të luftës apo paqes, feja dhe mentaliteti ndryshojnë dhe po ashtu ndryshon edhe konteksti social për policinë dhe frika e policisë. Mënyrat sipas të cilave organizohet dhe zbatohet policimi janë gjithashtu të ndryshme, po ashtu janë edhe mënyrat se si policia e percepton veten dhe sistemet e trajnimit. Krahas këtij diversiteti dhe rrjedhimisht hapësirës që nevojitet për të akomoduar këto ndryshime si dhe për të ruajtur në këtë mënyrë identitetet e veçanta, ka edhe pika të përbashkëta. Një nga këto është anëtarësimi në Këshillin e Europës dhe në Bashkimin Europian, pra deklarimi i interesit për të ndjekur vlerat dhe standardet europiane. Si rrjedhojë, agjencitë shtetërore duhet të respektojnë parimet. Publiku ka të drejtë shprehëse se puna e policisë në të gjithë Bashkimin Europian bazohet tek standardet e përbashkëta.

Oficerët e policisë kanë të drejtë të shprehin se eprorët e tyre do t'i respektojnë këto drejtime bazë dhe do ta strukturojnë (apo rishtrukturojnë) organizatën në përputhje me këto parime dhe vlera të përbashkëta të BE-së. Një interes tjetër i përbashkët është për ta bërë punën e policisë më efektive dhe në këtë aspekt, çdo forcë policore do të ishte shumë e kënaqur nëse parimet dhe normat që i shoqërojnë këto vlera konsolidohen dhe çdo oficer pa përjashtim e pranon përgjegjësinë për to. Pikërisht për këtë arsye ishte domosdoshmëria e krijimit të Kolegjit Policor Europian si dhe një sistemi të unifikuar të kurrikulave, në mënyrë që të gjitha vendet e BE-së, vendet kandidatë dhe vendet që aspirojnë për të hyrë në BE të kenë një standardi të përbashkët arsimimi policor.

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

Fjalëkyçe:

Kolegji Policor Europian (CEPOL), BE, kurrikula të përbashkëta mësimore, programi i shkëmbimit policor europian, Akademia e Sigurisë, arsimi policor.

“Të mblidhemi së bashku është fillimi; të qëndrojmë së bashku është progres; të punojmë së bashku është sukses” - Henri Ford¹

Hyrje

Kolegji Policor European (CEPOL) është një agjenci e BE-së, që përkushtohet në sigurimin e mundësive të trajnimit dhe të nxënit për oficerë të lartë, lidhur me çështjet jetike mbi sigurinë e Bashkimit European dhe qytetarëve të tij³. Trajnimi mbulon çështje që shkojnë nga lidhshipi në teknika të përforcimit të ligjit, si edhe ato të bashkëpunimit të BE-së mbi krimin ekonomik. Aktivitetet janë destinuar të lehtësojnë shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, si edhe të kontribuojnë për zhvillimin e një kulture të përbashkët të përforcimit të ligjit european. CEPOL si një agjenci e Bashkimit European, kontribuon në bashkëpunimin policor european përmes të mësuarit në mënyrë që të përfitojnë qytetarët european. Vizioni i CEPOL-it është të njihet nga autoritetet dhe agjencitë në botën e edukimit dhe policimit, që ajo është burimi kryesor i të nxënit dhe zhvillimit në fushën e edukimit dhe trajnimit për përforcimin e bashkëpunimit dhe policimit në Europë. Ndër vlerat kryesore të CEPOL-it mund të përmenden: burimi kryesor i njohurive; respekti i diversitetit dhe besimi tek policia dhe policimi. Bordi drejtues i CEPOL-it përbëhet nga shtete anëtare të BE-së, zakonisht nga drejtorë të kolegeve të trajnimit të policive kombëtare. Çdo delegacion ka një anëtar me të drejtë vote. Kryetari i “Bordit drejtues” është përfaqësuesi i atij shteti anëtar, i cili mban presidencën e Bashkimit European. Bordi drejtues zakonisht takohet dy herë në vit dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve të strategjisë së CEPOL-it. Selia e CEPOL-it ndodhet në Budapest, Hungari.⁴

CEPOL-i shfrytëzon një metodë të mësuarit me shumë shtresa së nxëni, e cila përfshin kurse dhe seminare rezidenciale, seminare “online” (“webinar”-et), module

¹ Inxhinier dhe industrialist i shquar Amerikan, 1863-1947.

² CEPOL. *Kurrikula e përbashkët e CEPOL-it*. Versioni 1, Austri 2008; Versioni 2, 2012, Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit European, 2014.

³ www.cepoleuropa.eu (Parë për herë të fundit, shkurt 2016)

⁴ Vendndodhja e Selisë së Kolegjit Policor European CEPOL, është në Budapest, Hungari: European Police College 1066 Budapest, Óutca 27 Hungary.

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor european nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

të së mësuarit në distancë, bashkëpunim bilateral përmes “Programit të shkëmbimit europian të policisë”, konferenca shkencore dhe simpoziume. Të gjitha aktivitetet e CEPOL-it mbështeten tek “e-Net”. Platformat e të nxënit “online” të CEPOL-it shfrytëzohen përmes “e-Net”, ku përdoruesit kanë akses tek mjetet dhe burimet që mbështesin dhe zgjasin eksperiencën e të nxënit. Platforma “e-Net” mirëpret gjithashtu edhe shërbimin e ri të CEPOL-it, “e-Journals”, i cili siguron që përdoruesit e regjistruar me akses në revista shkencore ndërkombëtare, të kenë mundësi lidhjeje me praktikantët dhe shkencën policore. Aktivitetet e CEPOL-it sigurojnë mundësitë për të qenë të azhurnuar me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare dhe tendencat e policimit, sidomos lidhur me krimet përtej kufirit dhe ato ndërkombëtare të rënda. Ka shumë arsye për të studiuar në CEPOL, por mund të përmblidhen në këto kryesore: të mësuarit lidhur me zhvillimet më të fundit dhe tendencat e policimit; të mësuarit nga ekspertët; takimet me profesionistë të policisë; ndarja e praktikave më të mira; praktika e aftësisë gjuhësore; bashkimi me komunitetin “online” të CEPOL-it, për zgjerimin e eksperiencës e të së nxënit.

1. Ekspertiza e CEPOL-it

CEPOL është një agjenci europiane e cila, mbi të gjitha, ka për detyrë organizimin e trajnimeve për oficerë të lartë të policisë së shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Kjo agjenci bën bashkë oficerë të lartë policie nga e gjithë Europa, për të nxitur bashkëpunimin ndërkufitar në luftën kundër krimit dhe në ruajtjen e sigurisë publike, rendit dhe ligjit. CEPOL-i siguron trajnim dhe edukim mbi një sërë aktivitetesh që janë të rëndësishme në luftën ndaj krimit përtej kufirit, si: kundërterrorizmi, parandalimi i krimit, krimi ekonomik, bashkëpunimi me BE-në, cikli i politikës së BE-së, të drejtat e njeriut, teknikat e përforsimit të Ligjit, të nxënit dhe trajnimi, menaxhimi, krime të tjera të organizuara, hulumtime dhe shkencë. CEPOL-i e nisi veprimtarinë në vitin 2001 dhe u bë agjenci e BE-së më 1 janar 2006⁵ (u themelua me anë të Vendimit të Këshillit 2005/681/DÇB datë 20.9.2005). CEPOL ka një buxhet vjetor prej 8.3 milionë eurosh (2014) dhe financohet nga buxheti i BE-së.

CEPOL vepron si një rrjet me veprimtari – kurse, seminare, konferenca, programe shkëmbimi, module “online” dhe “webinar” – të zbatuar kryesisht në dhe nga shtetet anëtare, nëpërmjet kolegjeve kombëtare për trajnimin e oficerëve të lartë të policisë. CEPOL organizon nga 80 deri në 100 kurse, seminare dhe konferenca në vit, në tema kyçe që janë të dobishme për forcat e policisë në Europë dhe zbaton gjithashtu projekte të specializuara, si për shembull “Programi për Shkëmbimin Policor” (EPEP) i CEPOL si edhe projektet “Policia Euromed” I (2004–06) dhe II (2007–10); akoma më tej, ai krijon kurrikulën e përbashkët mësimore të dobishme për të gjithë shtetet anëtarë si edhe vepron duke përdorur një rrjet elektronik të fjalës së fundit. Çdo vit, veprimtaritë e CEPOL përfshijnë 4 000 oficerë të zbatimit të ligjit dhe tek këto veprimtari, kontribuojnë mbi 750 ekspertë, lektorë dhe trajnues. Programi i Shkëmbimit është rritur nga 290 pjesëmarrës që kishte në vitin 2011 në mbi 428 në vitin 2015⁶. Një numër i madh ekspertësh, lektorësh dhe trajnuesish janë oficerë të lartë policie, të cilët, së bashku me pjesëmarrësit, formojnë një rrjet të aftë dhe me përvojë për bashkëpunimin e policive europiane.

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »


Policimi dhe Siguria

nr.2, 2016


⁵ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. *Vendim i Këshillit të Ministrave*, 2005/681/DÇB datë 20.9.2005.

⁶ CEPOL. *Annual report, European Police Exchange Programme*, 2015.

Shiko diagramin: “Programi i Shkëmbimit Policor European” për vitin 2015 për vendet e BE-së. (me ngjyrë blu aplikantët për këtë program dhe me ngjyrë të verdhë përfutjesit nga “Programi i Shkëmbimit Policor European” për 2015.



“Programi i Shkëmbimit Policor European” për vitin 2015 për vendet kandidate të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.



Duqi, A.
 « Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

CEPOL përqendrohet veçanërisht tek lufta kundër krimit ndërkufitar nëpërmjet trajnimeve të specializuara, përhapja e praktikave më të mira dhe gjetjeve të studimeve, mundësi i shkëmbimeve dhe komandimi ndërmjet forcave të policisë, ofrimi i trajnimit për trajnuesit, hartimi i një kurrikule të përbashkët mësimore për të harmonizuar

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

programet e trajnimit, ofrimi i trajnimit për autoritetet e policisë në vende kandidatë dhe tek ofrimi i një rrjeti elektronik për përdorimin e njohurive dhe të praktikave më të mira.

Agjencia bashkëpunon me një numër të gjerë partnerësh, përfshirë këtu agjenci të tjera të BE-së si Europol, Eurojust, Frontex, Qendra Europiane e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë ndaj Drogave (EMCDDA) dhe Qendrën Europiane për Mbështetje për Azil (EASO), por edhe me organizata ndërkombëtare si Interpol. CEPOL ka marrëveshje pune me disa vende joanëtare të BE-së, sidomos me vendet partnere, vendet e pranuar, vendet kandidatë dhe vendet që janë pjesë e “politikës së fqinjësisë europiane”. Akoma më tej, CEPOL-i, ka ndërtuar marrëdhënie me një sërë universitetesh dhe institutesh kërkimore në të gjithë BE-në dhe përtej saj. CEPOL-i bashkëpunon me rrjetin e instituteve të trajnimit të shteteve anëtare dhe ju ofron atyre mbështetje administrative, buxhetore dhe logjistike. Akronimi “CEPOL” është në gjuhën frënge dhe ka kuptimin “Collège Européen de Police” - në shqip, “Kolegji Europian i Policisë”.

2. CEPOL-i dhe “Kurrikula e përbashkët mësimore”

Qëllimi i kurrikulës së përbashkët të CEPOL-it⁷ është të sigurojë rekomandime lidhur me trajnime policore mbi subjekte specifike me një dimension europian. Shtetet anëtare mund t'i përdorin më pas këto rekomandime, brenda programeve të trajnimit policor kombëtar, sipas nevojave individuale të tyre. Kurrikula e përbashkët siguron gjithashtu, ide dhe elemente bazë për kurset dhe seminarët e CEPOL-it. Subjektet e kurrikulës së përbashkët vendosen nga Bordi Drejtues dhe janë në të njëjtën linjë me prioritetet e përshkruara në mënyrë të përmbledhur në një nivel europian (Komisioni Europian, Këshilli i Bashkimit Europian, Parlamenti Europian, Shefi i Policisë Task Forcë, etj.).

Në nenin 7b të Vendimit të Këshillit që themelon CEPOL-in, thuhet se me qëllim arritjen e objektivave të tij, CEPOL-i mundet që në veçanti, “të kontribuojë për përgatitjen e kurrikulave të harmonizuara për trajnimin e oficerëve të policisë të nivelit të mesëm dhe të oficerëve të policisë në terren, në lidhje me bashkëpunimin kufitar ndërmjet forcave europiane të policisë dhe të ndihmojë në hartimin e programeve të përshtatshme e të avancuara të trajnimit”.

Me fillimet e tij në vitin 2005, zhvillimi i kurrikulës së përbashkët mësimore të CEPOL-it, ishte një përpjekje e përqendruar e ekspertëve nga shtetet anëtare të BE-së. Ideja ishte që të jepej kontribut për harmonizimin e trajnimeve të policisë ndërmjet shteteve anëtare, ndërkohë që respektohej autonomia kombëtare në lidhje me organizimin dhe kryerjen e trajnimit të policisë dhe të kurrikulave mësimore. Më gjerësisht, synimi është që të mbështeten objektivat e “Programit të Stokholmit”. Kurrikula e përbashkët jep gjithashtu ide dhe elementë për kurset dhe seminarët brenda programit vjetor të punës së CEPOL-it. Temat përcaktohen nga Bordi Drejtues në përputhje me përparësitë e dhëna në nivel europian, sidomos në “Programin e Stokholmit”.

Çdo kurrikulë e përbashkët mësimore, është zhvilluar nga një nëngrup prej pesë ose gjashtë ekspertësh nga vende anëtare të ndryshme. Hartimi dhe përditësimi i manualit/udhëzuesit për trajnuesit dhe udhëzuesi për studimin, është kryer gjithashtu nga ekspertë të shteteve anëtare dhe në varësi të përmbajtjes, me ndihmën e agjencive të tjera të BE-së. Në procesin e hartimit, ju jepet një vëmendje e veçantë përdorimit të praktikave të

⁷ CEPOL. *Kurrikula e përbashkët e CEPOL-it*. Versioni 1 Austri 2008, Versioni 2, 2012. Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Europian, 2014.

Duqi, A.

“Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë”

Policimi dhe

Siguria
nr.2, 2016

mira dhe gjetjeve të kërkimit policor. Puna për kurrikulën e përbashkët mesimore është gjithnjë e lidhur ngushtë me zhvillimin e përmbajtjes për modulet përkatëse të së mësuarit nëpërmjet internetit (“e-learning”). Që nga viti 2005 e deri më sot, janë mbuluar ose janë duke u hartuar temat e mëposhtme:

- antiterrorizmi,
- bashkëpunimi policor evropian,
- Europol,
- etika e policisë dhe parandalimi i korrupsionit,
- dhuna në familje,
- pastrimi i parave,
- trafikimi i qenieve njerëzore,
- menaxhimi i krizave civile,
- trafikimi i drogës,
- menaxhimi i diversitetit,
- Eurojust.

Plani i përbashkët mesimor ofron një dimension shtesë kundrejt trajnimeve kombëtare të policisë, që shkon përtej kufijve kombëtare të policimit dhe që është një prej karakteristikave të tij më dalluese. Njëkohësisht, ato (temat) janë të hartuara në një mënyrë të tillë që çdo shtet anëtar të mund të gjejë të përfshirë aty nevojat e veta kombëtare për trajnim. Ato mund të përshtaten për trajnim individual, sisteme të policimit dhe filozofi. Realitetet kulturore, sociale dhe juridike respektohen. Për më tepër, kurrikula e përbashkët mesimore do të ketë një orientim praktik dhe do të përditësohet në mënyrë periodike, për të pasqyruar zhvillimet dhe kushtet e reja. Synimi është që shtetet anëtare të zbatojnë kurrikulën e përbashkët mesimore të CEPOL-it në sistemet e tyre të brendshme të trajnimit, në përputhje me nevojat e tyre kombëtare. Janë marrë masat për të mbështetur shtetet anëtare në lidhje me këtë përpjekje, e cila ka qëllimin e epërm, që të përmirësojë në mënyrë të efektshme bashkëpunimin policor ndërkuftar.

3. Bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Sigurisë dhe Kolegjit Europian Policor

Akademia e Sigurisë, për realizimin e përgjegjësive të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtare dhe institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat joqeveritare të interesuara në fushën e rendit e të sigurisë publike⁸.

Akademia e Sigurisë ka një marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Policor Europian (CEPOL) që prej 15.05. 2013⁹.

Në bazë të kësaj marrëveshje, CEPOL-i merr përsipër të asistojë Akademinë e Sigurisë në hartimin e kurrikulave sipas standardeve dhe metodologjisë më të përparuar të kurrikulave të arsimit policor të BE-së. Gjithashtu në bazë të kësaj marrëveshje do ketë shkëmbime në nivel ekspertësh, lektorësh, vizita studimore ndërmjet Akademisë së Sigurisë dhe CEPOL-it etj.

Në zbatim të pikës 8 (tetë) të kësaj marrëveshje, Akademia e Sigurisë ka propozuar

⁸ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. *Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 25.02.2015*, pika 9 “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

⁹ Akademia e Sigurisë, CEPOL. *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Formimit Policor [Akademisë së Sigurisë] dhe Kolegjit Policor Europian*, dt. 15.05.2013.

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor evropian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

“Pikën Kombëtare të Kontaktit” me Kolegjin Policor European, miratuar dhe caktuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr 1671, datë 12.12.2014¹⁰.

“Pika Kombëtare e Kontaktit” me CEPOL-in ka për detyrë:

të sigurojë shkëmbimin normal dhe në kohë të korrespondencës me Kolegjin Policor European;

a. të koordinojë zhvillimin e aktiviteteve që zhvillohen, brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Kolegjin Policor European;

b. të identifikojë dhe informojë strukturat përkatëse përfituese të Policisë së Shtetit për aktivitetet që zhvillohen nga Kolegji Policor European;

c. të ndjekë procedurat për pjesëmarrjen e punonjësve, të caktuar, të Policisë së Shtetit në aktivitetet e organizuara nga CEPOL.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë kolegji, vetëm për vitin 2015 janë përpunuar dhe u janë dërguar ftesa strukturave të policisë për pjesëmarrjen në nëntëdhjetetë aktivitetet e ndryshme, të cilat zhvilloheshin “online” ose me prezencën e punonjësve të Policisë së Shtetit. Po në këtë kuadër, nëntë punonjës të Policisë së Shtetit janë trajnuar në kurse të ndryshme të organizuara nga CEPOL-i në vendet e BE-së për vitin 2015, ndërsa dy punonjës të Policisë së Shtetit, ishin pjesë e “Programit të Shkëmbimit Policor European”, organizuar nga CEPOL-i, ku u shkëmbyen në trajnime 1-javore me homologet e tyre nga Gjermania dhe Bullgaria.

4. CEPOL-i dhe “Programi i Shkëmbimit Policor European”

Çdo vit, në muajin shkurt, Kolegji Policor European (CEPOL) shpall fillimin e aplikimeve për pjesëmarrjen në “Programin e Shkëmbimit Policor European”. Qëllimi i këtij programi është shkëmbimi i praktikave më të mira policore midis vendeve të Bashkimit European, vendeve kandidatë për në BE si dhe atyre vendeve që kanë një marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Policor European. Kriteret që duhet të përmbushin oficerët e policisë për të marrë pjesë në këtë program shkëmbimi policor janë:

- Njohja, të paktën, e një gjuhe të huaj, e cila mund të jetë anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, rusishtja, spanjishtja ose italishtja.

- Të ketë jo më pak se tre vjet eksperience në profesionin e oficerit të policisë dhe ekspertize në një nga dhjetë fushat e përcaktuara nga CEPOL-i.

- Të mos ketë qenë pjesëmarrës në “Programin e Shkëmbimit Policor European” gjatë tre viteve të fundit.

- Të ketë gatishmëri dhe nevojë për të mësuar në mënyrë individuale.

- Të ketë aftësinë, dëshirën dhe vullnetin që njohuritë e marra në këtë program t'i shkëmbejë me kolegët, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel europian.

Aplikantët për në “Programin e Shkëmbimit Policor European”, duhet ta njohin gjuhën angleze sipas standardeve të kërkuara nga CEPOL-i. Pas aplikimit të kandidatëve dhe miratimit të tyre, ose jo, nga “Pika Kombëtare e Kontaktit” me CEPOL-in, sipas kriterëve të përcaktuara nga CEPOL-i, kandidaturat që miratohen i dërgohen stafit të CEPOL-it që merret me shkëmbimin policor europian. Në fund, Kolegji Policor European konfirmon nëse aplikantët do të përzgjidhen për në fazat e tjera të shkëmbimit policor,

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria

nr.2, 2016

¹⁰ Akademia e Sigurisë, CEPOL. *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Formimit Policor [Akademisë së Sigurisë] dhe Kolegjit Policor European*, dt. 15.05.2013.

ose jo. Periudha e shkëmbimit policor është pesëditore, në vendin ku oficeri i policisë do shkëmbehet, dhe pesë ditë ku homologu i vendit tjetër vjen në Shqipëri. Të gjitha shpenzimet, përfshirë këtu udhëtimin, akomodimin si dhe ushqimin (përfshirë mëngjesi dhe darka) janë të CEPOL-it. Për vitin 2015, ishin dy oficerë të Policisë së Shtetit Shqiptar që përfunduan me sukses këtë shkëmbim policor dhe në përfundim morën certifikatën e vlerësimit nga CEPOL-i.

Në bazë të këtij programi të shkëmbimit policor evropian, në varësi të numrit të oficerëve të policisë që do dërgohen nga Policia e Shtetit Shqiptar jashtë vendit, po aq oficerë policie nga vendet e tjera të BE-së apo të vendeve kandidatë për në BE, vijnë në Shqipëri. Organizatorët e CEPOL-it, për vitin 2016 njoftuan, se për herë të parë në këtë program të shkëmbimit policor Evropian, mund të marrin pjesë edhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Përfshirja e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit në programin e shkëmbimit policor evropian, si Prokuroria dhe gjykatat, është një hap shumë i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit policor ndërmjet policive evropiane dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit.

5. Përfundime

Pas një mungese prej mëse një dekade, me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 25.02. 2015, u organizua Akademia e Sigurisë¹¹, duke u rihapur keshtu institucioni i lartë arsimor i Policisë së Shtetit, duke u bazuar në eksperiencën më të mirë të vendeve të BE-së, por edhe në eksperiencën dhe traditën tonë policore. Me urdher të ministrit të Punëve të Brendshme, nr. 294, dt. 05.06.2015, u miratua organika e Akademisë së Sigurisë, me një personel prej 161 personash¹². Akademia e Sigurisë, përveç shkollimeve për rolin bazë, shkollimit “Bachelor”, trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme për punonjësit e policisë, ofron edhe kualifikime dhe specializime për agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Misioni i Akademisë së Sigurisë është: “Të zhvillojë dhe të transmetojë dijet me anën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe të sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese.”¹³

Pikërisht për këtë arsye, në përmbushje të misionit të Akademisë së Sigurisë, në kushtet që Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s si dhe një vend kandidat që aspirojnë për anëtarësim në BE, si dhe kërkesave gjithnjë në rritje të komunitetit, për një polici profesionale e korrekte në shërbim të tyre, duhet që Akademia e Sigurisë të ketë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera arsimore, evropiane e më gjerë. Për Akademinë e Sigurisë është i një rëndësie jetike bashkëpunimi me CEPOL-in, si e vetmja agjenci e arsimit policor të BE-së. Pikërisht për këtë arsye, nga personeli i Akademisë së Sigurisë kërkohet më shumë profesionalizëm, kulturë, dije bashkëkohore, dinamizëm, përkushtim për të përgatitur punonjës policie sa më të aftë teorikisht dhe praktikisht, për t’i shërbyer komunitetit me devotshmëri, paanshmëri dhe në përmbushje të plotë

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor evropian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹¹ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. *Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 185, datë 25.02.2015*, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

¹² Ministria e Punëve të Brendshme. *Urdhër i Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 294 dt. 05.06.2015*, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”, ndryshuar me Urdhër Nr.556 dt.18.02.2016 të Ministrisë të Punëve të Brendshme.

¹³ Akademia e Sigurisë. *Statuti i Akademisë së Sigurisë*, “Kreu 1: Misioni, detyrat, struktura dhe parimet e organizimit, neni 1: Misioni”. Miratuar me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve, nr. 490 dt. 21.09.2015.

të lirive dhe të drejtave kushtetuese të qytetarëve.

Akademia e Sigurisë do të përbushë në vazhdimësi dhe gjithnjë e më mirë të gjitha detyrimet për bashkëpunimin arsimor policor ndërkombëtar me agjencitë e tjera të arsimit policor ndërkombëtar. Por jo vetëm kaq, Akademia e Sigurisë do të rritë dhe forcojë bashkëpunimin me të gjitha agjencitë arsimore policore ndërkombëtare dhe në mënyrë të veçantë me Kolegjin Europian Policor. Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve kriminale, ka një karakter global dhe për këtë arsye bashkëpunimi arsimor policor ndërkombëtar nuk është një kërkesë e thjeshtë, por një nevojë shumë e rëndësishme për Akademinë e Sigurisë dhe Policinë e Shtetit. Që prej rihapjes së saj, në 25 shkurt 2015, nga strukturat e Akademisë së Sigurisë është përballuar një volum i madh e dinamikë intensive pune për hartimin e akteve ligjore e nënligjore, që burojnë dhe bëjnë të zbatueshëm ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” dhe dokumente të tjera me rëndësi strategjike, për veprimtarinë e Akademisë së Sigurisë si institucioni përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Me gjithë arritjet e kryera, sfida të tjera na presin përpara dhe Akademia e Sigurisë është e ndërgjegjshme për këto sfida si dhe është e përgatitur për të ecur në rrugën e konsolidimit të mëtjetshëm të veprimtarisë së saj. Çdo anëtar i stafit të Akademisë së Sigurisë, duke filluar nga vetvetja duhet të japë kontributin e tij/saj në këtë konsolidim dhe progres të Akademisë së Sigurisë. “Ku duhet të filloj? Bota është aq e madhe. Do të filloj me vendin tim, që e njoh më së miri. Por vendi im është aq i madh. Po filloj më mirë me qytetin tim. Po qyteti im është aq i madh. Më së miri po filloj me rrugën time. Jo, me shtëpinë time. Ah, po filloj me vetveten...”¹⁴

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

¹⁴ Elie, Wesel. *Souls on Fire*. New York: Simon and Schuster, (f.135).

Wesel, profesor dhe shkrimtar i shquar amerikan. Lindur në Rumani në vitin 1928. Autor i 57 librave dhe fitues i Çmimit Nobel për Paqe, në vitin 1986.

Bibliografi

1. CEPOL. Kurrikula e përbashkët e CEPOL-it. Versioni I Austri 2008, Versioni II, 2012. Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Europian, 2014.
2. www.cepola.europa.eu
3. CEPOL. Governing Board Decision 29/2006/GB.
4. CEPOL. Work programme 2015.
5. CEPOL. Annual Report, European Police Exchange Programme 2015.
6. Akademia e Sigurisë, CEPOL. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Formimit Policor (QFP) dhe Kolegjit Policor Europian (CEPOL) dt. 15.05.2013.
7. Policia e Shtetit. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr 1671 datë 12.12.2014 "Për caktimin e Pikës Kombëtare të Kontaktit me Kolegjin Policor Europian".
8. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. VKM nr. 185, datë 25.02.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë".
9. Ministria e Punëve të Brendshme. Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 294 dt. 05.06.2015, "Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë", ndryshuar me Urdhrin nr.556, dt.18.02.2016, të Ministrit të Punëve të Brendshme.
10. Akademia e Sigurisë. Statuti i Akademisë së Sigurisë, "Kreu 1: Misioni, detyrat, struktura dhe parimet e organizimit, neni 1: Misioni". Miratuar me Urdhër të përbashkët të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, nr. 490, dt. 21.09.2015.
11. Elie, Wesel. Souls on Fire. New York: Simon and Schuster.

Duqi, A.

« Bashkëpunimi policor europian nëpërmjet të mësuarit - CEPOL dhe Akademia e Sigurisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Krimi kibernetik, efektet te siguria dhe strategjitë kundër tij



■ **Msc Qetësor GURRA**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Në brendësi të çështjeve në shqyrtim, fillimisht kam paraqitur shpejtësinë e rritjes së industrisë së krimit kibernetik, për të kuptuar rritjen meteorike që pëson së bashku me zhvillimin e teknologjisë. Jo më kot, kam sjellë fakte nga tre vende të cilat mbartin një potencial të madh ekonomik. Në momentin që lexuesi njihet me të tilla të dhëna, kupton nevojën dhe arsyen përse kjo veprë penale trajtohet dhe duhet luftuar domosdoshmërisht. Më tej kam kryer klasifikimin e krimit kibernetik dhe llojet e veprës penale në fjalë. Në vijim kam trajtuar krimin kompjuterik në Shqipëri, duke shprehur kohën e implementimit të dispozitave të para në vendin tonë, mënyrën se si është trajtuar vepra penale, gjenden ekzistuese, vështirësitë që ndihen ndjeshëm në adaptimin e strategjive dhe objektivave themeltare, mundësitë që mbartim për të dhënë maksimumin dhe pëmbushur qëllimet e vendosura, sfidat kryesore të renditura në bazë të rëndësisë që kanë, numrin e përdoruesve të teknologjisë dhe telekomunikacionit, disponueshmërinë dhe aksesin që ka masa e gjerë ndaj pajisjeve teknoinformative, disponueshmërinë e informacionit jo të filtruar, humbjen e mekanizmit të kontrollit dhe dimensionet ndërkombëtare shqetësuese të kësaj veprë penale. Së fundi, janë paraqitur strategjitë antikibernetike, legjislacioni kibernetik si një pjesë integrale e strategjisë kibernetike, implementimi i strategjive ekzistuese midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, avantazhet dhe disavantazhet e strategjive të njëjta dhe objektivat kryesore kundrejt luftës së krimit kompjuterik nga organizmat ndërkombëtare dhe shteteve anëtare.

Gurra, Q.
« Krimi
kibernetik,
efektet te
siguria dhe
strategjitë
kundër tij »

Fjalëkyçe:

krim kibernetik, veprë penale, haking, vjedhje, kërcënim, program, abuzim, implementim, strategji, partneritet.

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Hyrje

Rritja e krimit kibernetik përbën një çështje e cila shqetëson së tepërmi shoqërinë tonë. Sofistikimi dhe rritja e formave të aplikimit të kësaj vepre penale dhe tërësia e pajisjeve teknike që përdoren për të abuzuar dëshmojnë çdo ditë e më shumë se lufta kundër krimit kompjuterik përbën një element esencial i cili duhet të eci përkrah forcimit të përshtatshëm ligjor dhe hetimit cilësor në të gjithë botën. Kjo lloj vepre penale, është një sfidë në kuptimin e plotë të fjalës qoftë për vendet e zhvilluara, qoftë për vendet në zhvillim e sipër. Anonimiteti i kësaj vepre penale, do të jetë gjithnjë një hap përpara përpjekjeve për ta zbuluar atë. Vështirësia dhe kalueshmëria e kohës fizike deri në momentin që identifikohet individi shpalos pamundësi. Si mundet të luftosh një virtualitet, i cili në këtë moment ndodhet në një pozitë gjeografike dhe në çastin tjetër në hemisferën tjetër të globit vetëm në sajë të një klikimi?

Realizimi i një “sigurie kibernetike” mbart shumë vështirësi. Zhvillimi i teknologjisë do të jetë gjithnjë e më shumë i lëvdueshëm. Rruzulli tokësor do të krijojë një marrëdhënie varësie me pajisjet teknoinformatike, ndoshta deri në atë pikë sa çdo veprimtari jetësore, e thjeshtë ose qoftë kjo edhe e ndërlikuar, nuk do të mund të imagjinohej pa to.

1. Kuptimi dhe origjina e krimit kibernetik

Krimi kibernetik është një term i cili konsiston në kryerjen e një veprimi ose akti ilegal për të cilin, ndjekja dhe njohja e veprës penale në fjalë ka nevojë esenciale për njohuri në teknologjinë kompjuterike. Është e vështirë të shprehet një përkufizim dhe një qëndrim i sinkronizuar për krimin kibernetik pasi ekspansioni i zhvillimit të shpejtë tekniko-teknologjik dhe llojet e mënyrat e shumta me të cilat kjo lloj industrie jo e ligjshme operon, e vështirëson jo vetëm luftimin e fenomenit, por dhe akordimet e përbashkëta në qëndrimin e mendimtarëve, studiuesve, specialistëve të kësaj fushe. Në

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet e sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Polici
dhe
Siguria
nr.2, 2016

vijim do të trajtohen disa ndër mendimet e tyre të koncentruara. Bazuar në “raportin për statistika” të Byrosë së Ministrisë së Drejtësisë të SHBA-ve, SRI (Stanford Researches Institute), kriminaliteti kompjuterik përkufizohet si: “Çdo krim, për të cilin kryesi duhet të ketë njohuri teknike mbi kompjuterët, që të ndërhyjë në ta”.¹

Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në Paris, në vitin 1983, ka dhënë këtë përkufizim lidhur me kriminalitetin kompjuterik: “Çdo veprim ilegal, joetik dhe sjellje e paautorizuar në përpunimin e të dhënave ose bartjen e tyre në mënyrë automatike”.² Eksperti i njohur botëror në fushën e kriminalitetit kompjuterik, Don Parker, e ka përqendruar vëmendjen e tij në trajtimin shkencor të kuptimit të kriminalitetit kompjuterik. Ky autor kriminalitetin kompjuterik e trajton si: “Çdo veprim në lidhje me përdorimin e teknologjisë kompjuterike, me të cilin viktimja përjeton ose mund të përjetojë humbje, ndërsa kryesi vepron me qëllim që vetes t’i krijojë përfitim”.³

Disa autorë mendojnë se kjo vepër penale lindi me zhvillimin teknologjik bashkëkohor ndërkohë që të tjerë arsyetojnë se si origjinë e mirëfilltë, duhet të konsiderohen përpjekjet fillestare për të ndërhyrë ilegalisht në pajisjet teknologjike. Fakti që duhet të marrë në konsideratë, është se makina llogaritëse e parë, që quhet forma antike e kompjuterit, ekziston që në periudhën 2700–2300 para lindjes së Krishtit në Indi, Japoni dhe Kinë.⁴ Megjithatë, nëse marrim në shqyrtim një pajisje të mirëfilltë kompjuterike, pavarësisht se sa bazike kjo, bëhet fjalë pikërisht për pajisjen e viteve 1752-1834, kur endësi francez, Joseph Marie Charles, arriti të krijonte pajisjen tradicionale të tezgjahut, - një risi kjo për fabrikantët e tekstitil të asaj periudhe, - e cila arrinte të prodhonte larmi dhe prodhimtari të gjerë mostrash, në pëlhura, në mënyrë automatike. Mënyra si shpikësi krijoi makinerinë në fjalë inspiroi Charles Babbage. Ai ishte një matematikan, filozof, inxhinier mekanik, i cili krijoi konceptin material të kompjuterit të programueshëm. Në atë periudhë, ka pasur një normë shumë të lartë të gabimit në llogaritjen e tabelave matematikore. Babbage kishte planifikuar një metodë të re që mund të përdorej për ta bërë llogaritjen mekanikisht, duke hequr faktorin e gabimit njerëzor. Kjo ide e kishte intriguar shumë herët që në vitin 1812.⁵ Dy elementë të ndryshëm ndikuan në këtë krijim: ai nuk e pëlqente rrëmujën dhe mungesën e saktësisë dhe ishte shumë i aftë me tabelat logaritmike. E tillë shpikje fillestare kompjuterike, ndikoi ndjeshëm në procesin e prodhimit. Reformimi i punëtorëve dhe shkurtimi i ndjeshëm i numrit të tyre solli pakënaqësi dhe revolta. Filluan përpjekjet për të sabotuar procesin e prodhimit dhe dëmtuar pajisjet e para kompjuterike të shpikura. “Krimi kibernetik” filloi të frymojë për herë të parë.

2. Llojet e krimit kibernetik

Pavarësisht se agjencitë dhe institucionet shtetërore janë duke u përpjekur të trajtojnë dhe luftojnë krimin kompjuterik ky i fundit gjithnjë e më shumë fiton terren përballë masës së gjerë. Një ndër mënyrat më të mira për të shmangur të qenit viktimë të kësaj vepre penale dhe mbrojtur informacionin delikat vetjak është duke përdorur një sistem të unifikuar

¹ Vula, Veton. “Kriminaliteti kompjuterik si formë e re e fenomenologjisë kriminale”. *Juridica*, nr. 1, Prishtinë 2011, (f. 294).

² Ibid, f. 294.

³ Ibid, f. 295.

⁴ Kojima, Takashi. *Japanese abacus use & theory*. Vermont & Tokyo: Charles E. Tuttle Company, 1990, (f. 23).

⁵ Swade, Doron. *Difference Engine: Charles Babbage and the Quest to Build the First Computer*. London: Little, Brown, 2000, (f. 52).

“software” dhe “hardware” të cilët kanë një siguri të padepërtueshme dhe shume të vështirë për tu thyer. Megjithatë mënyra më e mirë për të qenë larg një dëmi të riparueshëm ose humbjeje të mundshme është informimi se si mund të jenë llojet e krimet kibernetik.

2.1 Hakimi

Në kontekstin e sigurisë kompjuterike një haker është një individ i cili kërkon dhe shfrytëzon dobësitë në një sistem kompjuterik ose rrjet kompjuterik. Ata janë të motivuar nga arsye të panumërta, qofshin fitimi, protesta, sfida, kënaqësia.⁶ Fillimisht komuniteti i tyre është konsideruar i padukshëm, nëntokësor, por me shtimin dhe sofistikim e tij, tashmë janë një komunitet i njohur. Në varësi të qëllimeve të tyre është realizuar edhe një klasifikim i hakerave. Disa prej tyre janë:

- “Kapelja e bardhë”.

Një haker i këtillë konsiderohet një individ i cili thyen sigurinë për një arsye jo me qëllim të keq, për të testuar sistemin e sigurisë së një kompanie në të cilën është duke punuar ose në varësi të llojit të institucionit në të cilin punon⁷. Zakonisht të tillë hakera quhen etike.

- “Kapelja e zezë”.

Hakeri i “zi” konsiderohet një individ i cili cenon sigurinë kompjuterike për arsye të paligjshme ose për përfitime personale⁸. Zakonisht për të kanë etiketuar një konstatim si mëshirimi i të gjithë frikërave publike, një kriminel kompjuterik i mirëfilltë.

- “Kapelja gri”.

Hakeri “gri” është një vijë e ndërmjetme midis një kapele të bardhë dhe një të zezë. Ata mund të shfletojnë në internet ose në një sistem kompjuterik, për të njoftuar administratorin rreth një defekti të mundshëm të sigurisë⁹. Problemi qëndron tek gjetja e fakteve të rëndësishme dhe teçjimi i tyre tek masa e gjerë dhe jo te grupi i limituar i individëve të përshtatshëm. Jo domosdoshmërisht, kryhet pirateri ose përfitime personale, por kjo qasje e paautorizuar në një sistem konsiderohet e paligjshme dhe jo etike.

- “Hakerat elitë”.

Hakeri elitë simbolizon një status tejet të sofistikuar dhe të aftë i cili mund të penetrojë fuqishëm në sistemet kompjuterike duke konkluduar në pasoja fatale¹⁰.

- *Dorëshkrimi “foshnjarak”.*

Një haker “foshnjarak” është një individ i pakualifikuar, i cili thyen sistemet kompjuterike duke përdorur mjete të automatizuara, të shkruara nga të tjerët. Për këtë arsye, ai nuk përbën një rrezikshmëri të theksuar¹¹.

- “Fillestar”.

Hakeri fillestar është një përpjekës fillestar në fushën teknologjike. Megjithatë, premisat gjithnjë tregojnë se pikërisht këta të fundit, shndërrohen në “kapelat” e mësipërme¹².

- “Haktivist”.

Një haker i këtillë përdor teknologjinë për të publikuar një mesazh social, ideologjik, fetar, politik. Rrezikshmëria e këtij lloji individ i konsiston në llojin e mesazhit që dëshiron

⁶ Yar, Majid. *Cybercrime and Society*. London: Sage Publications, 2006, (f. 22).

⁷ Douglas, Thomas. *Hacker Culture*. Minneapolis: University of Minnesota Press, 2002, (f. 80-82)

⁸ Ibid.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Andress, Mandy, Phil Cox dhe Ed Tittel. *CIW Security Professional*. New York: Wiley, 2001, (f. 638).

¹² Denning, Dorothy E. “Activism, Hacktivism, and Cyberterrorism: The Internet as a Tool for Influencing Foreign Policy”. *Networks and Netwars: The Future of Terror, Crime, and Militancy* (J. Arquilla and D. F. Ronfeldt eds.), California: RAND, 2001, (f. 239-288).

të përçojë dhe përmbajtjes së tij.¹³

2.2 Vjedhja

Ky krim ndodh kur një person shkel të drejtat e autorit në muzikë, filma, lojëra dhe “software”. Ekzistojnë faqe në internet të cilat inkurajojnë piraterinë e programeve kompjuterike. Të tilla faqe në internet janë bërë shënjestër e FBI-së. Pirateria e programeve kompjuterike është një akt i paligjshëm kopjimi, shpërndarjeje. Ky biznes fitimprurës ka tërhequr vëmendjen e grupeve të krimit të organizuar në një numër të konsiderueshëm vendesh. Sipas BSA (Business Software Alliance) rreth 36% e gjithë “software”-ve në përdorimin aktual, janë të vjedhur¹⁴. Pirateria e programeve kompjuterike shkakton të ardhura të konsiderueshme të humbura për prodhuesit, çka i detyron ata të rrisin çmimet dhe ndonjëherë të jenë jo ekonomikë për konsumatorin. Zakonisht, kur blihet një paketë “software” komerciale ofrohet një marrëveshje e licencës së përdoruesit. Pirateria klasifikohet në disa lloje:

- huamarrja dhe instalimi i një kopjeje të aplikimit “software”;
- instalimi i më shumë kopjeve “software”, të cilat nuk mbartin licencën përkatëse;
- instalimi dhe shitja e kopjeve të paautorizuara, të programeve, në kompjuterët e rinovuar dhe të rinj.
- falsifikimi i shitjeve;
- pirateria në internet, e cila simbolizon shkarkimin e paligjshëm të “software”-it në varësi të llojit të veprimtarisë dhe produktit që përçohet¹⁵.

2.3 Kërcënime në internet

Forma e këtyllë e krimit kibernetik, konsiston në ngacmime në internet, ku viktimat i nënshtrohet një breshërie mesazhesh ose email-esh. Një vepër e tillë penale, përfshin akuza të rreme, monitorim, kërcënime, shkatërrime të dhënash, manipulim¹⁶. Përcjellja kibernetike, gjithashtu mund të përfshijë shfrytëzimin seksual të së miturve. Ngacmimi mund të kryhet në forma të shumta, por emëruesi i përbashkët është i padëshiruar, shpesh obsesiv dhe i paligjshëm. Përdoren mesazhe të çastit, telefonata, pajisje të tjera të komunikimit, duke marrë formën e një ngacmimi, kontakti të papërshtatshëm ose thjesht bezdisës në jetën dhe aktivitetin e përditshëm. Është e rëndësishme që të mos zhvlerësohet natyra serioze e kësaj vepre penale, pasi mund të kryhet jo vetëm nga të panjohur, por më shpesh ndeshet tek të njohurit tuaj. Zakonisht, një ish-partner, ish-mik ose dikush që dëshiron të shqetësojë individin ose familjen e tij në mënyrë të papërshtatshme. Kërcënimet kibernetike mund të jenë të frikshme, pasi mund të sjellin shkatërrimin e miqësive, karrierës, imazhit ose edhe qoftë besimit¹⁷. Kjo lloj forme veprimi, mund të realizohet vetëm për të monitoruar çdo gjë që ndodh në kompjuter ose celular, duke dhuruar fuqi të jashtëzakonshme informacioni. Për këtë arsye bëhen gjithnjë publikime dhe bëhen përpjekje, për të informuar masën e gjerë që të mbrohet nga rreziku që mund t'i kanoset.

2.4 Vjedhja e identitetit

Kjo formë manipulimi është bërë një problem i madh për individët të cilët përdorin

¹³ Ibid.

¹⁴ <http://whatis.techtarget.com/definition/piracy>, parë së fundi në datë 25.3.2016.

¹⁵ Ibid.

¹⁶ <http://us.norton.com/cyberstalking/article>, parë së fundi në datë 25.3.2016.

¹⁷ Moore, Robert. *Investigating High Technology Computer Crime*. London: Routledge, 2011, (f.129).

internetin për të kryer transaksione monetare dhe janë klientë të shërbimeve bankare. Nëpërmjet formave tejet të sofistikuara të kësaj vjedhjeje, numri i sigurimit social, llogaria bankare, numri i kartës së kreditit, të dhëna të tjera të vlefshme identifikuese në momentin që bien në duar të gabuara mund të lejojnë që persona të paautorizuar të marrin fonde nga banka të caktuara ose llogari financiare duke dhuruar jo vetëm humbje të konsiderueshme monetare por dhe borxhe të padrejta¹⁸. Në përgjithësi kjo vepër penale nuk mjaftohet veç me kaq, por sjell nevojë dhe kosto të tjera të konsiderueshme financiare, shtesë, për të rivendosur reputacionin në komunitet, ose për t'u korrigjuar informacioni i gabuar. Gjatë një rasti famëkeq vjedhjeje identiteti, një kriminel nuk solli veç një humbje të madhe monetare, por gjithashtu mori një kredi federale, bleu një shtëpi, një automjet dhe një armë të ftohtë në emrin e viktimës. Gjatë asaj kohe vjedhja e identitetit nuk përbënte një krim federal, për këtë arsye kryesi i veprës penale konsumoi veç një dënim të shkurtër për bërjen e një deklarate të rreme dhe për blerjen e armës së zjarrit, por kurrë nuk dëmshpërbleu personat në fjalë.

2.5 Programi “keqdashës”

Softwar-i “keqdashës” mund të duket si një koncept relativisht i ri, por realisht ai ka shumë vite që është praktikuar dhe ka sjellë dëme të konsiderueshme. Pavarësisht se dukej se kompjuterët e parë nuk sulmoheshin nga viruset kjo s’do të thoshte se ato ishin potencialisht të paprekshëm. Bëhej fjalë veç për fillimet e teknologjisë së informacionit, kur individët ende nuk kishin mësuar tërësisht t’i shfrytëzonin ato. Sapo teknologjia filloi të kthehej në një zakon, u shfaqën viruset e para, në vitin 1970¹⁹. Bumi famëkeq ndodhi kur këto viruse filluan të përhapeshin në kompjuterët personalë, konkretisht të krijuar në vitet 1980 nga Apple. Tashmë qëllimet keqdashëse filluan të kryesonin gjithnjë e më shumë. Interneti mund të lejojë një individ, me ose pa dashje, që të shpërndajë një virus tejet të rrezikshëm, i cili mund të infektojë një rrjet dhe sistem jashtëzakonisht të gjerë kompjuterësh. Një student i universitetit Cornell, Robert Morris, lroi një “krimb” komprometues - virusi i cili ndikoi mbi 6000 kompjuterë, duke sjellë miliona dollarë humbje për tu çrrënjësuar. Pjesë e tyre, ishin edhe kompjuterët jopublikë, të drejtuar nga qeveria e SHBA-së, duke pasuar në një ndjekje penale, - pavarësisht se në deklaratën e tij, qëllimi i subjektit në fjalë nuk ishte shkaktimi i dëmeve. Në Mbretërinë e Bashkuar, lirimi i një programi “keqdashës” është rregulluar nga dispozitat ligjore të seksionit të tretë të “aktit kompjuterik”. Theksohet, se kjo vepër penale kryhet kur shkaktohet një modifikim i paautorizuar i përmbajtjes së kompjuterit, i cili mund të dëmtojë përmbajtjen e tij.

2.6. Nxitja dhe abuzimi i fëmijëve

Kjo është një formë mjaft delikate e krimit kibernetik, ku kryesi i veprës nëpërmjet internetit dhe sistemit kompjuterik, aplikacioneve të posaçme i kërkon të miturve të bashkëbisedojë a qoftë të kenë kontakt me ta për qëllime pornografie ose abuzimi. Pavarësisht se bëhen përpjekje për monitorim të këtij fenomeni, nuk mund të evitohet gjithnjë ekspozimi i fëmijëve ndaj materialeve seksualisht eksplicite ose fyese dhe nga përdorimi i internetit prej pedofilëve. Ndoshta mund të bëhen përpjekje për ndërjegjësimi

¹⁸ <http://www.justice.gov/criminal-fraud/identity-theft/identity-theft-and-identity>, parë së fundi në datë 25.3.2016.

¹⁹ <http://www.infosecisland.com/blogview/16567-What-the-Law-Says-about-Distributing-a-Virus-or-Malware.html>, parë së fundi në datë 25.3.2016.

Guerra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet e sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

në komunitet, kufizim aksesi në internet nga mosha e mitur, rregullim i industrisë së internetit, etj., por të tilla rekomandime dhe veprime nuk mund të jenë tërësisht frytdhënëse. Në një anketim të kryer në SHBA, nga Amidoni, është konstatuar se 63% e 501 të anketuarve, nga mosha 9 deri në 17 vjeç, parapëlqejnë më shumë të kalojnë kohë në internet sesa duke parë televizor²⁰. Një anketim i kryer në Australi, nga NAPCAN, arriti në rezultat se prej 238 nxënësve, nga 7 deri në 10 vjeç, përbëjnë 66% të fëmijëve që dëshirojnë dhe përdorin rregullisht dhomat e bashkëbisedimit “online”. Një tjetër studim i kryer i kryer në SHBA, i cili përbënte 19% të kampionit përfaqësues kombëtar të përbërë prej 1501 fëmijësh dëshmoi se të paktën një herë në vit raportohen ofrim seksi nëpërmjet rrjeteve sociale²¹. Një ndër shtatë fëmijë gjithashtu u shprehën se ka pasur përpjekje për t’i kontaktuar me telefon ose postë. Vallë, përse interneti është një mjet popullor i rekrutimit të fëmijëve për qëllime seksuale? Përgjigja është tejet e thjeshtë. Lehtësia për të qenë anonim i lejon këta të fundit të eksplorojnë, të studiojnë mjedisin, të afrohen kur dhe si kanë mundësi; t’i përshtaten të miturve dhe të kapin “gjahun” e tyre.

3. Veprat penale kompjuterike në Republikën e Shqipërisë

Parlamenti Shqiptar miratoi “Konventën e krimit kibernetik” në 25 prill të vitit 2002. Duke qenë se vendi ynë aspiron të jetë përkohësisht kandidat pritës për hyrje në Bashkimin Europian, është i detyruar të respektojë dhe përmbushë të gjithë objektivat që janë të nevojshme. Bashkimi Europian është një organizim dinamik i cili gjithnjë i nënshtrohet reformave institucionale dhe ligjore. Shqipëria duhet të përqafojë denjësisht dinamikën e këtij procesi integrimi, i cili ka nevojë për stabilitet politik, ekonomik, ligjor ashtu sikurse reforma thelbësore, përshtatshmëri dhe strukturim administrativ, institucional. Një ndër detyrat që vendi ynë duhet të plotësojë, është krijimi i një klime të duhur luftimi të krimit kibernetik, duke respektuar këshillat dhe vëzhgimin intensiv të partnerëve të huaj²². Gjithsesi, duke lënë mënjanë obligimet që mbartim ndaj Bashkimit Europian, duhet të kuptojmë dhe nevojën që shoqëria shqiptare ka për siguri ndaj zhvillimit që teknologjia gjithnjë e më shumë po fiton. Kjo shoqëri ka nevojë për pajisje të përshtatshme dhe shërbime të duhura. Rritja e shpërndarjes së komunikimit teknologjik ka krijuar një botëkuptim krejt tjetër lidhshmërie, zhvillimi ekonomik. Përveç aspekteve pozitive, shtohen mundësitë për një risk potencial ndaj të dhënave dhe sistemit kompjuterik. Si rezultat, siguri i integritetit të informacionit është një sfidë tejet e madhe, ndoshta edhe një çështje sigurie fort të rëndësishme kombëtare. Shqipëria, midis shumë vendeve të tjera në Ballkan, ka pësuar një zhvillim të shpejtë të telekomunikacionit, internetit. Sipas të dhënave të publikuar nga AEPC2²³, në fund të vitit 2013, ishin 3.7 milion përdorues aktiv të internetit. Penetrimi i kartave të telefonit në aktivitetin aktiv të kartave SIM arriti në 130%. Përdorimi i internetit ka pësuar rritje galopuese dhe cilësia e tij mendohet të jetë 13% më e mirë, në krahasim me vitin 2013. Ekspozimi ndaj rrjedhjes së informacionit nga institucionet publike, financiare dhe sistemit bankar mund të shkaktojë shkreputje, dëme jetike dhe esenciale shërbimesh. Në

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet te siguria dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

²⁰ <https://aifs.gov.au/cfca/publications/child-abuse-and-internet>, parë së fundi në datë 25.3.2016.

²¹ Ibid.

²² Begaj, Eranda. “Albania’s vision towards Cyber Security”. *DCAF Young Faces 2014 – Cybersecurity Winter School for the Western Balkans*. Geneva: DCAF, 2014, (f. 1).

²³ Ibid, f. 2.

Shqipëri, zhvillimi i sigurisë kibernetike ndodhet në fazat e para, megjithatë ka përpjekje për vendosjen e standardeve europiane. Prezantimi dhe themelimi i kësaj risie kibernetike, ndodhi në vitin 2002²⁴. Në këtë dritëhije ndryshimesh autoritetet shqiptare u detyruan të kryenin ndryshime legjislative për të implementuar siç duhet propozimet e dhëna. Konventa e krimit kibernetik ka nevojë për mjetet e duhura të bashkëpunimit dhe harmonizimit me strukturat e tjera ligjore. Pas analizës së imët të ligjit, pati ndryshime në Kodin Penal: amendamente në ligjin nr. 10023, datë 27. 11. 2008 dhe ndryshime të ligjit nr 7895 të Kodit Penal; amendamente në ligjin nr. 10054, datë 29.12.2008 dhe ndryshime në ligjin nr. 7905 të datës 21. 3. 1995.²⁵

Veprat penale kompjuterike në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë: shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit; kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik; pornografia; shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobe nëpërmjet sistemit kompjuterik; fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik; mashtrimi kompjuterik; falsifikimi kompjuterik; hyrja e paautorizuar kompjuterike; përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike; ndërhyrja në të dhënat kompjuterike; ndërhyrja në sistemet kompjuterike; keqpërdorimi i pajisjeve²⁶.

4. Analizë e krimit kibernetik

Rritja me shpejtësi e krimit kibernetik përbën një çështje e cila shqetëson së tepërmi shoqërinë tonë. Ky lloj krimi, tejet i organizuar, është i lidhur ngushtësisht me aktivitete të tjera kriminale siç është droga, kumari, prostitucioni dhe terrorizmi. Grupe tradicionale të krimit, gjithnjë e më shumë po përqafojnë këtë lloj vepre penale - siç janë: Mafia italiane, Yakuza japoneze, bandat kineze, kartelet kolumbiane, grupet kriminale ruse, ato në Malajzi, etj²⁷. Gjithnjë e më shumë, këta të fundit përpiqen të punësojnë hakerat më të aftë dhe më të specializuar duke përhapur biznesin dhe aktivitetin e tyre jo të ligjshëm, kudo në botë. Vlerësimi i të dhënave paraqet një shifër prej dhjetë milionë kompjuterësh të cilët "rrëmbehen" çdo ditë. Hakerat kanë mundur të penetrojnë në Pentagon, në Shtëpinë e Bardhë, në faqet zyrtare ushtarake të NATO-s, Interpol etj²⁸. Ata kanë mundur të vjedhin kodet sekrete të burimeve të Microsoft dhe kartave të kreditit. Shërbimi sekret i SHBA-së, tashmë e quan vjedhjen e kartave të kreditit si mënyrën më të përparuar të vjedhjes së bankave në të ardhmen. Më tej, jam përpjekur të bëj një paraqitje të shkurtër të gjendjes serioze që ka zaptuar realitetin e sotëm në tre vende, të cilat përbëjnë një potencial të madh zhvillimi dhe burimi ekonomik.

4.1 Krimi kibernetik në SHBA

Një studim i kryer nga FBI Gallup, ka dëshmuar se krimi kibernetik i ka kushtuar këtij shteti pothuajse 400 miliardë dollarë, çka konvertohet në 3,4% të GDP²⁹. Gjithashtu 66% e shoqërisë është e shqetësuar vazhdimisht ose rastësisht për rrezikun e të qenit një

²⁴ Ibid, f. 3.

²⁵ Begaj, DCAF, *Young Faces*, (f. 3).

²⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

²⁷ Kshetri, Nir. *The Global Cybercrime Industry: Economic, Institutional and Strategic Perspectives*. New York, Berlin and Heidelberg: Springer-Verlag, 2010, (f. 1).

²⁸ Ibid.

²⁹ Ibid.

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet te sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

viktimë e vjedhjes së identitetit. Ankthi mendimtar është shumë më i lartë, në krahasim me 11 lloje të tjera krimesh të pyetura³⁰. Padi të drejtuar Komisionit të Federatës së Tregtisë, kundrejt mashtrimeve nëpërmjet internetit, rezultojnë të jenë 53% gjatë vitit 2004 dhe 46% në vitin 2005. Shuma e humbjeve, e llogaritur në rastet e të tilla mashtrimeve, nëpërmjet internetit, cilësohet të ketë qenë 205 milionë dollarë në vitin 2003 dhe 336 milionë dollarë në vitin 2005³¹. Ankesat e raportuara në linjën operatore të FBI-së dhe qendrës së krimeve “White Collar”, kanë konkluduar humbje prej 239 milionë dollarësh në vitin 2007, të cilat janë rritur edhe më shumë, në 265 milionë dollarë, në vitin 2008. Krimi kompjuterik dhe terrorizmi kibernetik, kanë qenë prioriteti i tretë i FBI-së, fill pas terrorizmit dhe inteligjencës.

4.2 Krimi kibernetik në Britaninë e Madhe

Madhësia e lartë e zhvillimit të industrisë kibernetike në Britaninë e Madhe është e dyta në botë. Çdo 10 sekonda dëshmojnë 1.9 milion incidente të kësaj lloji vepre penale³². Industria kibernetike ka sjellë 6 miliardë paund humbje në vitin 2008. Vrojtimet dhe anketimet e kryera shprehin se 18% e individëve nuk dëshirojnë të kryejnë më blerje “online” për shkak të eksperiencave humbëse. Për më tepër frika më e madhe ndihet përballë këtij fenomeni se sa vjedhjes “klasike”.

4.3 Krimi kibernetik në Japoni

Numri i rasteve të krimit kibernetik, të raportuara në vitin 2004³³, ka qenë 2081, ndërsa në vitin 2006 ka qenë 4425, - afërsisht 40% më shumë në krahasim me vitin fillestar të përmendur. Gjatë vitit 2008, sërish është raportuar një ngritje rreth 15.5%, - përkatësisht 6321 raste. Duke pasur parasysh madhësinë ekonomike të këtij shteti, industria kibernetike është relativisht e vogël e megjithatë është konstatuar zgjerimi i grupeve të organizuara kibernetike tejet të sofistikuar. Nga burime të brendshme konkludohet se grupe të këtilla kanë filluar të finançojnë grupe të njëjta në Malajzi dhe Rusi.

5. Rezultatet e luftës së krimit kompjuterik në Republikën e Shqipërisë

Më 14 shtator 2011 u bë themelimi i Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)³⁴ me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 766, çka ishte një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit institucional. Misioni i këtij institucioni është identifikimi, parashikimi dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen kundër kërcënimeve, sulmeve në internet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo përcakton qartë nevojën për rregullimin e duhur të legjislacionit në fushën e sigurisë kibernetike. Si pasojë, ka një hendek të madh të zbatimit korrekt të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 766,³⁵ sepse korniza ligjore në këtë fushë nuk është ende në formën e duhur. Në Shqipëri nuk ka një strategji apo politikë konkrete. Ka ende një mungesë të qartë vizioni

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet te sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

³⁰ Ibid.

³¹ Kshetri, *The Global*, (f. 2).

³² Ibid.

³³ Ibid.

³⁴ Begaj, *DCAF Young Faces*, (f. 4).

³⁵ Ibid.

dhe objektivash të veçanta qeveritare shqiptare në kontrollin e kësaj vepre penale. Megjithatë, Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, i vitit 2014, për sa i përket luftës kundër krimit kibernetik, është shprehur se është ngarkuar një grup pune për hartimin e një dokumenti politikash për krimin kibernetik. Ajo përfshin masa të tilla si:

- plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike,
- rritja e ndërgjegjësimit të sigurisë kibernetike,
- rritja e nivelit të njohurive dhe kapaciteteve të ekspertizës së sigurisë kibernetike,
- identifikimi informacionit të rëndësishëm dhe të duhur,
- mbrojtja e infrastrukturës teknoinformatike në Shqipëri,
- zbatimi i sigurisë minimale në sistemin teknoinformatik,
- forcimi i partneritetit me aktorët përgjegjës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.³⁶

Nga ana tjetër, Raporti i Progresit 2014, thekson se Policia dhe Prokuroria duhet të specializohen dhe trajnohen vazhdimisht në lidhje me këtë vepër penale. Numri i ndjekjeve penale për krimin kibernetik është rritur, por është ende i ulët³⁷. Raporti kujton që një aspekt shumë i rëndësishëm për qeverinë shqiptare, dhe element kyç, është kapaciteti administrativ në luftimin dhe parandalimin e krimit kibernetik. Për fat të keq, administrata shqiptare vuan nga mungesa e stabilitetit për shkak të ndryshimeve politike, të cilat vendosin në rrezik reformat e vazhdueshme, stafin adekuat dhe

Viti 2013

Nr.	VEPRAT PENALE	KRIME			Autorë		
		Evidentuar	Zbuluar nga të Evidentuar	Shuma	Masat e mara		
					Arrestuar	Ndaluar	Gjendje të lirë
1	2	4	5	3	21	22	23
1	Vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit	105	60	66	7	0	55
1.1	Mashtrimi kompjuterik N. 143 / b	46	26	29	5	0	22
1.2	Falsifikimi kompjuterik N. 186 / a	23	14	12	0	0	10
1.3	Hyrja e paautorizuar kompjuterike N. 192 / b	11	8	6	0	0	6
1.4	Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike N. 293 / a	0	0	0	0	0	0
1.5	Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike N. 293 / b	19	8	17	2	0	15
1.6	Ndërhyrja në sistemin kompjuterik N. 293 / c	6	4	2	0	0	2
1.7	Keqpërdorimi i pajisjeve N. 293 / ç	0	0	0	0	0	0
2	Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik	3	3	3	0	0	3
2.1	Shpërndarja kompjuterike e matjeve pro gjenocidit dhe krimeve ndaj njerëzimit N 74/ a	0	0	0	0	0	0
2.2	Kanosja me motive racore dhe ksenofobi nëpër sisteme kompjuter N 84 / a	0	0	0	0	0	0
2.3	Shpërndarja e motiveve racore ose ksenofobi nëpër sisteme kompjuter N 119 / a	0	0	0	0	0	0
2.4	Fyerja me motive racore ose ksenofobi nëpër sisteme kompjuterike N. 119 / b	1	1	1	0	0	1
2.5	Pornografia (nëpërmjet sisteme kompjuterike) N. 117 / 2	2	2	2	0	0	2
SHUMA		108	63	69	7	0	58

Guerra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet e sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Polici dhe Siguria
nr.2, 2016

³⁶ Ibid.

³⁷ Ibid.

Viti 2014

Nr.	VEPRAT PENALE	KRIME			Autorë		
		Evidentuar	Zbuluar nga të Evidentuar	Shuma	Masat e mara		
					Arrestuar	Ndaluar	Gjendje të lirë
1	2	4	5	3	21	22	23
1	Vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit	135	60	70	7	0	63
1.1	Mashtrimi kompjuterik N. 143 / b	50	14	20	1	0	19
1.2	Falsifikimi kompjuterik N. 186 / a	27	16	17	3	0	14
1.3	Hyrja e paautorizuar kompjuterike N. 192 / b	17	11	11	3	0	8
1.4	Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike N. 293 / a	1	1	2	0	0	2
1.5	Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike N. 293 / b	33	15	17	0	0	17
1.6	Ndërhyrja në sistemin kompjuterik N. 293 / c	6	2	2	0	0	2
1.7	Keqpërdorimi i pajisjeve N. 293 / ç	1	1	1	0	0	1
2	Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik	41	15	16	0	0	16
2.1	Shpërndarja kompjuterike e matjeve pro gjenocidit dhe krimeve ndaj njerëzimit N 74 / a	0	0	0	0	0	0
2.2	Kanosja me motive racore dhe ksenofobi nëpër sisteme kompjuter N 84 / a	0	0	0	0	0	0
2.3	Shpërndarja e motiveve racore ose ksenofobi nëpër sisteme kompjuter N 119 / a	1	0	0	0	0	0
2.4	Fyerja me motive racore ose ksenofobi nëpër sisteme kompjuterike N. 119 / b	0	0	0	0	0	0
2.5	Pornografia (nëpërmjet sisteme kompjuterike) N. 117 / 2	40	15	16	0	0	16
SHUMA		176	75	86	7	0	79

Viti 2015

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Zbuluar	Zbulimi ne %	Autorë të veprave penale					
					Gjithësej	Masa sigurimi				
						Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lirë	Larguar	Ndërshtime
1	2	4	5	7	8	9	10	11	12	13
G	KUNDËR KRIMEVE KOMPJUTERIKE	122	33	27	49	5	10	31	3	0
1	Vepra në fushën e teknologjisë së informacionit	55	13	23.6	16	0	1	14	1	0
2	Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik	67	20	29.8	33	5	9	17	2	0

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet te siguria dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

ekspertizën profesionale. Bashkëngjitur janë paraqitur statistikat për krimin kompjuterik për vitet 2013, 2014, 2015³⁸. Vihet re ndjeshëm vërtetësia e rekomandimeve dhe nevoja afatgjatë e tejet sistematike ndaj luftës së kësaj veprave penale

³⁸ Te dhënat janë marrë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.

6. Përfundime

Sofistikimi dhe rritja e formave të aplikimit të krimit kibernetik dhe tërësia e pajisjeve teknike që përdoren për të abuzuar, dëshmojnë çdo ditë e më shumë se lufta kundër krimit kibernetik përbën një element esencial, i cili duhet të eci përkrah forcimit të përshtatshëm ligjor dhe hetimit cilësor në të gjithë botën. Kjo lloj vepre penale është një sfidë, në kuptimin e plotë të fjalës, qoftë për vendet e zhvilluara, qoftë për vendet në zhvillim e sipër. Siguria kibernetike luan një rol të rëndësishëm në rritjen e shëndetshme të teknologjisë së informacionit. Krijimi i një interneti të sigurt është bërë një qëllim kyç zhvillimi i shërbimeve të reja teknoinformatike dhe politikës së shteteve. Edukimi i përdoruesve të internetit, për të qenë larg eksperiencës së hidhur të viktimës do të ndihmonte riskimin dhe pasojat e panumërta fatale. Axhenda globale e krimit kibernetik³⁹, si një kuadër global për dialog dhe bashkëpunim ndërkombëtar për të koordinuar punën ndaj rritjes së sfidave për sigurinë kibernetike, ndikon në rritjen e besimit për një punë të palodhur, rritjes së iniciativave dhe partneriteteve me qëllim propozimin e masave të duhura. Një mundësi mund të ishte, që strategjitë antikibernetike të aplikuar në vendet e zhvilluara, të prezantohen në vendet në zhvillim e sipër, duke shpalosur avantazhet, disavantazhet dhe duke kursyer kostot. Implementimi i strategiave ekzistuese lejon të përthithjen e njohurisë ekzistuese dhe një eksperiencë pafund. Megjithatë, ky implementim mbart vështirësitë e veta⁴⁰. Edhe pse në dukje sfidat që duhet të kalohen me sukses mund të duken të ngjashme, secili vend mbart burimet dhe aftësitë vetjake. Vendet e zhvilluara munden të kryejnë një promovim të krimit kompjuterik në një mënyrë më fleksibël, në sajë të potencialit që zotërojnë duke u fokusuar në kostot intensive të mbrojtjes teknike. Gjithashtu, mbetet të diskutohet dhe për çështje të tjera, si, pajtueshmëria e sistemit ligjor përkatës, statusi i iniciativave mbështetëse, shtrirja e masave vetëmbrojtëse, shkalla e mbështetjes së sektorit privat, etj. Diskutimi global i sigurisë kibernetike mbart shtatë pika kyçe megjithatë ajo siguri është e përqendruar në pesë drejtime:

- masat ligjore,
- masat teknike dhe procedurale.
- organizimi struktural,
- ngritja e kapaciteteve,
- bashkëpunimi ndërkombëtar⁴¹.

Në dekadat e shkuara, fokusi qendror ka qenë legjislacioni, ndërkohë që sot, theksi vendoset mbi rolin e rregullatorëve në luftën ndaj krimit kibernetik, teksa Bashkimi Europian tenton të ruajë dhe arrijë lirinë më të lartë të mundshme dhe sigurinë për benefitet që interneti i dhuron kujtdo⁴². Detyra e shteteve anëtare është që të ndërmarrin masa specifike dhe efçente për të përmirësuar gjithnjë e më tepër performancën e tyre. Këto masa janë afatshkurtra dhe afatgjata dhe përfshijnë një varietet politikash, mjetesh të posaçme dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të vendeve anëtare. Prioritetet artikulojnë në pesë objektiva kryesore:

³⁹ Gercke, Marco. *Understanding Cybercrime: A Guide For Developing Countries*. Geneva, SW: International Telecommunications Union, 2011, (f. 158).

⁴⁰ Gercke, Op. cit, f. 159.

⁴¹ Gercke, Op. cit, f. 160.

⁴² European Commission. *Cybersecurity strategy of the European Union*. Brussels: EU, 2013, (f. 4).

- arritja e elasticitetit kibernetik;
- reduktimi drastik i krimit kompjuterik;
- zhvillimi i politikës mbrojtëse kibernetike dhe sigurisë së përbashkët;
- zhvillimi i burimeve industriale dhe teknologjike;
- krijimi i një politike koherente ndërkombëtare, promovuese e vlerave thelbësore të Bashkimit Europian⁴³.

Për të promovuar “elasticitetin kibernetik” sektori publik dhe privat duhet të zhvillojnë aftësitë dhe të bashkëpunojnë në mënyrë efektive. Europa mund të mbetet e pambrojtur, pa një përpjekje të konsiderueshme për të rritur kapacitetet e duhura, burimet dhe proceset parandaluese, zbuluese për të trajtuar incidentet mbi sigurinë kibernetike. Kjo është arsyeja se përse Komisioni ka zhvilluar një politikë mbi rrjetin dhe sigurinë e informacionit. Agjencia ENISA, e themeluar në vitin 2004, ka miratuar një rregullore të re, e cila gjithnjë modifikohet nga Këshilli Europian dhe Parlamenti. Direktivat kornizë, kërkojnë që ofruesit e komunikimit elektronik të menaxhojnë në mënyrë të përshtatshme rreziqet mbi rrjetet e tyre duke raportuar shkeljet e rëndësishme të sigurisë. Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave në Bashkimin Europian kërkon gjithashtu që kontrolluesit e të dhënave për të përmbushur më së miri kërkesat e mbrojtjes së të dhënave dhe për të ndërmarrë masat e duhura në lidhje me sigurinë, fushën e shërbimeve komunikuese në dispozicion të publikut, duhet të njoftojnë incidentet që përfshijnë shkelje të së dhënave personale tek autoritetet kompetente kombëtare. Pavarësisht progresit të bazuar në angazhimet vullnetare ka ende boshllëqe në veprimet që strukturat e Bashkimit Europian kanë ndërmarrë, sidomos në aspektin e aftësive kombëtare, koordinimit në rastet e incidenteve që ndodhin jashtë kufijve dhe në aspektin e përfshirjes së gatishmërisë së sektorit privat. Kjo strategji është shoqëruar me një propozim legjislativ në veçanti:

- Të krijohen kushtet e përbashkëta minimale në nivel kombëtar të cilat do të detyronin shtetet anëtare të krijojnë mekanizma të përshtatshme parandalimi, zbulimi, lehtësimi për të shkëmbyer informacionin dhe ndihmën reciproke midis autoriteteve kompetente⁴⁴.

Këto të fundit në bazë të bashkëpunimit mbi progresin e bërë në kuadrin e “Forumit Evropian për shtete anëtarë” kanë kryer diskutime dhe shkëmbime publike duke ndikuar pozitivisht në luftën ndaj krimit kibernetik. Aktorët privatë ende nuk kanë stimuluj efektive për të dhënë të dhëna të besueshme mbi ekzistencën apo ndikimin e incidenteve, për të përqaftuar kulturën e menaxhimit të riskut ose për të investuar në zgjidhjet e sigurisë. Prandaj, legjislacioni i propozuar synon të bëjë më të sigurt lojtarët e fushave të rëndësishme siç është energjia, transporti, bankat, bursat dhe shërbimet kryesore të internetit, të cilët të munden të vlerësojnë në formën e duhur rreziqet kibernetike me të cilat duhen të përballen; të sigurojnë rrjetet dhe sistemet e informacionit, duke ofruar një kulturë kibernetike, e cila rrit mundësitë e biznesit dhe konkurrencës në sektorin privat.

⁴³ European Commission. *Cybersecurity strategy*, (f. 5).

⁴⁴ European Commission. *Cybersecurity strategy*, (f. 6).

Bibliografi

1. Ligji nr 8888, datë 25.4.2002 për ratifikimin e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës".
2. Ligji nr 9880, datë 25.2.2008 për "Nënshkrimin elektronik".
3. Ligji nr 9887, datë 10.3.2008 për "Mbrojtjen e të dhënave personale".
4. Ligji nr 9918, datë 19.05.2008 për "Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
6. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim i Këshillit të Ministrave nr 710, datë 21.08.2013 për "Krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit".
7. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Urdhër i Kryeministrit, nr. 202, datë 16.12.2005 për "Forcimin e transparencës, nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit".
8. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr 120, datë 20.03.2014 për "Dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike".
9. Këshilli i Europës. *Konventa e Këshillit të Europës mbi "Kriminalitetin kompjuterik"*. KE, 2001.
10. Begaj, Eranda. "Albania's vision towards Cyber Security". *DCAF Young Faces 2014 – Cybersecurity Winter School for the Western Balkans*. Geneva: DCAF, 2014.
11. European Commission. *Legal Aspects of Computer*. Brussels: EU, 1998.
12. European Commission. *Cybersecurity strategy of the European Union*. Brussels: EU, 2013.
13. Gercke, Marco. *Understanding Cybercrime: A Guide For Developing Countries*. Geneva, SW: International Telecommunications Union, 2011.
14. Kshetri, Nir. *The Global Cybercrime Industry: Economic, Institutional and Strategic Perspectives*. New York, Berlin and Heidelberg: Springer-Verlag, 2010.
15. Moore, Robert. *Investigating High Technology Computer Crime*. London: Routledge, 2011.
16. Vula, Veton. "Kriminaliteti kompjuterik si formë e re e fenomenologjisë kriminale". *Juridica, nr. 1*, Prishtinë 2011.
17. Yar, Majid. *Cybercrime and Society*. London: Sage Publications, 2006.
18. Douglas, Thomas. *Hacker Culture*. Minneapolis: University of Minnesota Press, 2002.
19. Andress, Mandy, Phil Cox dhe Ed Tittel. *CIW Security Professional*. New York: Wiley, 2001.
20. Denning, Dorothy E. "Activism, Hacktivism, and Cyberterrorism: The Internet as a Tool for Influencing Foreign Policy". *Networks and Netwars: The Future of Terror, Crime, and Militancy* (J. Arquilla and D. F. Ronfeldt eds.), California: RAND, 2001 (239-288).
22. Kojima, Takashi. *Japanese abacus use & theory*. Vermont & Tokyo: Charles E. Tuttle Company, 1990.
23. Swade, Doron. *Difference Engine: Charles Babbage and the Quest to Build the First Computer*. London: Little, Brown, 2000.

Gurra, Q.
« Krimi kibernetik, efektet te sigurisë dhe strategjitë kundër tij »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit, parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë



■ Msc **Anisa AGASTRA**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Sfida e policimit modern është orientimi drejt shërbimit në komunitet, duke lënë pas qasjen tradicionale të përdorimit të forcës dhe autoritetit suprem. Në këtë logjikë disiplina e sociologjisë, psikologjisë dhe kriminologjisë i vijnë në ndihmë policisë për të ndërtuar një panoramë tredimensionale të ngjarjeve apo realiteteve kriminale. Praktika amerikane gjithnjë e më shumë po nxit ndikimin e nevojshëm të këtyre disiplinave për të kuptuar më thellë kushtet në të cilat ndodh një ngjarje kriminale, shkaqet apo problematikat e shumëfishta në mënyrë që të gjenden rrugë parandaluese sa më realiste dhe efektive. Vëmendja drejtohet në çështjen e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit dhe policimit me të cilat merren degë të posaçme të sociologjisë, psikologjisë e kriminologjisë. Qasja psikologjike ndihmon në trajtimin e problemeve emocionale, psikopatologjike apo të personalitetit të individit në shoqëri. Qasja sociologjike shërben për të trajtuar problematikat, prijet apo tendencat e gjithë shoqërisë, duke sugjeruar mënyra zgjidhjeje e parandaluese të fenomeneve. Ndërsa ajo kriminologjike ka në fokus shkaqet dhe rrethanat e ndodhisë së një ngjarjeje kriminale. Ky material përmban teoritë kryesore psikologjike, psikosociale, sociologjike dhe kriminologjike të cilat lidhen me fushën e gjerë të kriminalitetit dhe policimit, analiza si dhe formula apo mendime të studiuësve klasikë apo bashkëkohorë. Studimi i shoqërisë dhe i marrëdhënieve shoqërore do të ishte shumë i dobishëm në aspektin e studimit të shkakësish, thelbit të problemeve psikologjike, sociale, ekonomike, politike etj. Kjo do të shërbente si teorikisht ashtu dhe praktikisht, në punën e përditshme të punonjësve të policisë. Për këtë arsye qëllimi i këtij shkrimi është të vëre në dukje rolin e këtyre disiplinave në funksion të kuptimit cilësor të dukurive dhe ngjarjeve dhe efektivitetit më të lartë të punës së institucioneve dhe punonjësve të policisë, në kuadër të bashkëpunimit dhe qasjeve e modeleve bashkëkohore të policimit.

Agastra, A.
«Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Fjalëkyçe:

Sociopsikologjia, kriminologjia, policimi në komunitet, modelet e policimit, psikologjia, kriminalliteti.

“Interesat bazikë të racës njerëzore nuk janë të përqendruara në politikë dhe filozofi, por në dukuri, si ushqimi, futbollit, paratë e krimi – në mënyrë specifike krimi”¹”.

Kriminaliteti dhe zgjidhja e problematikave kriminale në tërësinë e tyre janë konsideruar si një problem shoqëror që kërkon qasje ndërdisiplinore. Me zhvillimin e shoqërisë është zhvilluar dhe është përsosur edhe krimi. Kriminaliteti është fenomen shoqëror me histori të lashtë sa edhe njerëzimi. Qysh në lashtësi njerëz të shquar kanë kontribuar me mendime, ide dhe përfundime e rekomandime në rrafshin e shkaqeve dhe faktorëve që favorizojnë lindjen apo zhvillimin e kriminalitetit në një individ, shoqëri dhe komunitet për një kohë të caktuar historike². Si i tillë, ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve në mjaft disiplina, si: kriminologji, kriminalistikë, sociologji, psikologji, mjekësi ligjore, e drejtë penale etj. Në ditët tona, studimi i formave të shfaqjes së kriminalitetit, të shkaqeve dhe të rrethanave që mundësojnë atë dhe parandalimi i tij marrin rëndësi të veçantë. Që prej shekullit XX kriminologjia ka bërë objekt studimi të saj lidhjet ndërmjet faktorëve të ndryshëm të mjedisit fizik, social, psikologjik dhe kriminogjen. Elementet kryesore të organizimit shoqëror që ndikojnë në kriminalitet janë: urbanizimi, emigracioni, mobiliteti, luftërat, feja, familja, arsimimi, media, ideologjia sunduese, alkooli dhe droga.

Një ndër institucionet që ka për funksion të ndodhet gjithmonë në shërbim ndaj publikut është policia.³ Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike. Është manifestimi më i dukshëm i autoritetit shtetëror që kryen detyrat më të dukshme, më të menjëhershme dhe më imponuese për të siguruar mirëqenien e

Agastra, a.
« Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹ Lamb, Larry. Hyrja, në *Low and Order News*, nga Steve Chinball. London: Tavistock Press, 1977, (f.4).

² Papandele, Jani, dhe Ilir Mandro. *Kriminologji-Penologji*. Tiranë: Ilar, 2002, (f. 15).

³ Ligji i Policisë së Shtetit Nr. 108/2014.

individit dhe të komunitetit në tërësi. Duke qenë se në vendin tonë gradualisht po ndiqen hapat demokratikë, është parë gjithmonë e më shumë e nevojshme bashkëpunimi me komunitetin në shërbim të qytetarit në çdo fushë dhe institucion. Një ndër to është dhe policia, e cila duhet t'i përgjigjet komunitetit në tërësi dhe të përpiqet të ofrojë shërbim të shpejtë, në mënyrë të paanshëm dhe të barabartë. Në mënyrë që ky qëllim të funksionojë duhet që midis policisë dhe qytetarëve të ketë besim dhe bashkëpunim reciprok.

Njohja e shkaqeve të kryerjes së veprimeve kriminale është thelbësore në kurimin dhe, më së shumti, në parandalimin e krimit. Si rezultat, është e nevojshme dhe domosdoshme vënia në praktikë dhe ndërlidhja funksionale e disiplinës sociologjike, psikologjike e kriminologjike në kuadrin e bashkëpunimit të vazhdueshëm me forcat e policimit. Një studiuës i shoqërisë dhe marrëdhënieve shoqërore do të ishte shumë i dobishëm në aspektin e studimit të shkakësisë, thelbit të problemeve psikologjike, sociale, ekonomike, politike etj. Kjo do të shërbente si teorikisht ashtu dhe praktikisht, në punën e përditshme të punonjësve të policisë.⁴

Policia e Shtetit tonë ka disa detyra parësore siç janë: ruajtja e qetësisë publike; ligjit dhe rendit; mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit, veçanërisht e jetës; parandalimi dhe zbulimi i krimit; reduktimi i frikës; dhënia e ndihmës dhe shërbimeve për publikun. Përparimi drejt policimit demokratik arrihet kur ka një ndryshim “nga një qasje e orientuar drejt kontrollit në një qasje më të orientuar drejt shërbimit”. Qasjet moderne të policimit anojnë rreth prirjeve sociale, e sidomos psikologjike në mënyrë që policimi, policët dhe policia të shihet jo më si “forcë”, por si “shërbim” drejt komunitetit⁵. Dhe për të njohur këtë, është e nevojshme njohja e natyrës, psikikës dhe sjelljes njerëzore nga njëra anë, të cilën e studion psikologjia, dhe njohjen e shoqërisë, kulturës, prototipave, antivlerave, modelet, problematikat dhe prirjet e saj, që e studion sociologjia, në mënyrë që të njihet ambienti që na rrethon.

Një polici demokratike i zhvillon dhe i zbaton veprimtaritë e saj në përputhje me nevojat e publikut dhe të shtetit, duke i dhënë përparësi ndihmës ndaj atyre anëtarëve të komunitetit që kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme. Përmes veprimtarive të tyre, punonjësit e policisë duhet të jenë pjesë e përpjekjeve të përbashkëta të shoqërisë për të promovuar mbrojtjen ligjore dhe ndjenjën e sigurisë. Besimi dhe bindja e publikut në polici janë parakushte për një policim efektiv. Në këtë këndvështrim politikat e Policisë së Shtetit janë drejtuar drejt modeleve dhe praktikave përfundimtare, duke sjellë elemente të reja bashkëvepruese. Ndër to është ndërthurja e konceptit dhe praktikës së policimit dhe sigurisë në vendin tonë me koncepte, analiza dhe praktika sociologjike, psikologjike e kriminologjike.

Akademia e Sigurisë, nën mantelin e ofrimit të shkollimit, edukimit dhe trajnimeve profesionale të nevojshme për të gjithë personelin policor, është duke përkrahur zhvillimin e qasjeve psikosociale e kriminogjene, duke pasur vizion pozitiv për pozicione ekzistuese apo të reja të këtij profili në strukturën e saj. Dhe kjo është një risi që bashkërisht duhet ta përkrahim, në mënyrë që së pari, të njihet vlera e literaturës dhe praktikave që ofrojnë këto shkenca të profilit social dhe së dyti, të njihen mënyra të reja bashkëpunimi në ide, koncepte, veprimtari, mënyra të sjelli apo të drejtuar, forma zgjidhjeje apo parandaluese të problematikave apo rekomandimeve në fushën e policimit dhe sigurisë.

⁴ Ligji i Policisë së Shtetit Nr. 108/2014.

⁵ Lazi, Piro. *Psikologjia e Policimit*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, 2004, (f. 18).

Punonjësit e policisë të ditëve të sotme përballen me stresse, konfuzione, përjetime të forta emocionale, etj., duke u vënë shpesh përballë zgjidhjes së shpejtë të ngjarjeve të ndryshme që ndodhin në vendin tonë çdo ditë, në bazë të dispozitave ligjore dhe informacioneve të kufizuara. Kështu atyre u duhet të njohin shumë mirë sjelljen njerëzore në mënyrë që ta kuptojnë atë dhe të kenë aftësi për të krijuar skema reale të mundësisë së ndodhisë së një ngjarjeve apo shkaqeve të saj. Gjykimi i shëndoshë duhet të arrihet me anë të njohurive shkencore psikosociale dhe jo bazuar vetëm me eksperiencë. Orientimi i veprimtarisë policore drejt aspektit shoqëror të ngjarjeve të përditshme përbën pikësynim për strukturat dhe punonjësit e Policisë së Shtetit dhe në këtë prizëm është e domosdoshme dhe e nevojshme njohja e secilës prej këtyre disiplinave, të objektivave të tyre dhe ndërlidhjes efektive për të realizuar një bashkëpunim që mendohet të prodhojë refleksione pozitive të policimit, sigurisë dhe konceptit të ri arsimor policor.

Kriminologjia është një shkencë e përgjithshme e cila merret me krimin, autorët e krimeve, shkakun e krimeve dhe masat me karakter parandalues. Sipas Edwin Sutherland dhe Donald Krescit, kriminologjia është tërësia e njohurive për krimin, si dukuri sociale. Ndërkaq sipas përkufizimit sociologjik, kriminologjia studion të gjitha sjelljet antishoqërore që ekzistojnë në shoqëri, pavarësisht nga fakti se ato janë ose jo të përcaktuara në Kodin Penal⁶.

Dega e sociologjisë, e cila është e ndërlidhur me kriminologjinë, është sociologjia penale (ligjore). Duke bërë një lidhje mes kriminologjisë dhe sociologjisë penale, kriminologjia ka për objekt shpjegimin e faktorëve dhe të proceseve të veprimit kriminal, ndërsa sociologjia penale studion aspektet e reaksionit ndaj këtij veprimi. Ky konkluzion është nxjerrë nga kriminologu francez Bassin⁷. Si rrjedhim, shohim që studimet e sociologjisë penale e ndihmojnë kriminologjinë të kuptojë më mirë aspekte të veprimit kriminal dhe të personalitetit të autorit. Gjithashtu, sociologjia vëzhgon edhe problematikën dhe efektivitetin e drejtësisë penale. Ndërkaq, psikologjia ligjore e krimit trajton tema e probleme emocionale të sjelljes që kanë të bëjnë me ligjin dhe sistemin ligjor. Kjo fushë ofron këshilla për ligjvënësit, gjyqtarët, punonjësit e korreksionit, prokurorët, avokatët dhe policët⁸.

Kriminaliteti në vetvete është dukuri komplekse që studiohet nga këndvështrimi penal, kriminologjik, sociologjik, psikologjik etj. Një analist dhe politikan konservator anglez, Lord Hailsham⁹, në një fjalim të mbajtur në “Junior Carlton Club”, ndër të tjera thekson: “Të dashur zotërinj, ne jemi duke jetuar në periudha të vështira kohore. Sëmundja e epokës sonë nuk vjen më nga shkaqe ekonomike, por nga shkaqe politike, kushtetuese dhe morale dhe në vend që t’i kurojmë ato duke menduar mënyrat e zgjidhjes, duhet t’i njohim dhe t’i kuptojmë më parë ato”.

Sipas tij, motoja e botës do të ishte *kupto pastaj zgjidh*, dhe në këtë mënyrë roli i shkencave si sociologjia apo psikologjia, por edhe të tjera, është parësore në të gjitha fushat, por sidomos në trajtimin dhe kuptimin e kriminalitetit dhe mënyrave më të mira të policimit për ta parandaluar atë. Shumica e autorëve të fushës së kriminologjisë pajtohet se në objektin e kriminologjisë radhiten:

⁶ Hysi, Vasilika. *Kriminologjia*. Tiranë: Kristalina, 2010, (f. 7).

⁷ Po aty.

⁸ Blackburn, Ronald. *The Psychology of Criminal Conduct: Theory, Research and Practice*. Chichester: John Wiley & Sons Ltd, 1993.

⁹ Chinball, Steve. *Low and Order News*. London: Tavistock Press, 1977, (f. 7).

Agastra, a.

« Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

krimi - si dukuri individuale;
krimineli - (kryesi i krimimit) si autorë i veprës;
viktima e krimimit - me fokus marrëdhënien e kriminelit me viktimën;
kriminaliteti - si dukuri masive dhe reaksioni i individit dhe shoqërisë ndaj krimimit dhe kriminalitetit.

Për kriminologjinë thuhet se ajo analizon dhe studion kryesit e veprave penale, preventivën kriminale, sociologjinë e së drejtës, proceset shoqërore dhe shkaktarët e kriminalitetit. Sipas një përkufizimi, kriminaliteti paraqet grupin e të gjitha veprimeve që e rrezikojnë dhe/ose dëmtojnë vlerat themelore të njeriut (të mbrojtura me ligj)¹⁰.

Sipas botëkuptimit modern, kriminologjia duhet të orientohet më tepër në çështjen e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit¹¹ dhe për këtë ka në ndihmë qasjen psikologjike, që jep ndihmesë në profilet e personalitetit, teoritë psikokriminale për të kuptuar botën e brendshme njerëzore në lidhje me kriminalitetin dhe qasjen sociologjike, që shërben për të trajtuar problematikat, prirjet apo tendencat e gjithë shoqërisë, duke sugjeruar mënyra zgjidhjeje e parandaluese të fenomeneve. Pra, të parit e një problematike aktuale e faktike kriminojgene, së brendshmi (pikëpamja psikologjike) dhe së jashtmi (pikëpamja sociologjike) plotëson panoramën e problemit dhe lehtëson punën e punonjësve të policisë për gjetjen më të saktë dhe shumëdimensionale të shkaqeve, pasojave, aspektit kohor kronologjik, zhvillimit, prirjeve, zgjidhjeve, masave parandaluese dhe rekomandimeve në lidhje me ngjarje të ndryshme të jetës së përditshme.

Sipas studimeve të bëra, sidomos atyre amerikane, shikohet një lidhje e ngushtë midis kriminologjisë dhe sociologjisë. Sociologjia penale në kriminologjinë amerikane trajtohet si një nënfushë e kriminologjisë që ka të bëjë me rolin e forcave sociale në formulimin dhe rolin e ligjit penal në shoqëri¹².

Krimi përcaktohet si shkelje ligjore dhe konceptohet ndryshe në kultura të ndryshme. Sa më i madh të jetë numri i krimeve, aq më e ulët është cilësia e jetës. Por krimi në vetvete përbën një problem social, përderisa prek jetët e individëve dhe komunikimin me ta. Mbi këtë logjikë, duke qenë se sociologjia studion problematikën makroshoqërore, atëherë krimi është një pjesë e rëndësishme e kësaj problematike për t'u studiuar. Pra, në fushën e krimimit, sociologu ka për detyrë të kuptojë sjelljen e individit, mënyrën e tij të reagimit dhe vërtetësinë e atyre që shpreh, si dhe mbështetet në konsideratat ligjore. Kurse kriminologët përqendrohen më tepër te e drejta penale dhe procedurat ligjore, sipas neneve dhe ligjeve. Psikologët nga ana tjetër përqendrohen në zhvillimin e sistemit mendor, personalitetit, reagimin e individëve duke krijuar modele të ndryshme për sa i përket lidhjes së tyre, me vetveten, me mjedisin social dhe me kriminalitetin apo sjelljen kriminale.

Gjithashtu, rritja e kriminalitetit shpjegohet me ndikimin e shumë faktorëve. Ndër këta faktorë, theksohet rëndësia e këtyre:

- faktorëve shoqërorë, që lidhen me shtimin e popullsisë, zhvillimin e qyteteve, migracionin, zbulimet e mëdha shkencore dhe teknologjike, shtimin e lidhjeve të komunikacionit;

Agastra, A.
« Zhvillimi
i policimit dhe
i kriminalitetit
parë në dritën e
sociopsikologjisë
dhe
kriminologjisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹⁰ Sabani, Alisabri, dhe Muhamed Budimlic. *Kriminologjia*. Përkthyer nga Mustafë Reçica. Sarajevë dhe Prishtinë: Universiteti AAB Press, 2007, (f. 6).

¹¹ Po aty, f. 7.

¹² Price, Jammie, dhe Roger A. Strays, Jeffrey R. Breese (red.). *Doing Sociology: Case Studies in Sociological Practice*. Lanham, MD: Lexington Books, 2009, (f. 37-38).

- faktorëve socialë, që lidhen me grumbullimin e masave dhe mungesën e kujdesit social;

- faktorëve juridikë, që lidhen me zhvillimin e komunikimit juridik, rregullimi i degëve të jetës juridike - paraqitja e një varg veprash të reja penale;

- faktorëve psikologjikë, që lidhen me formimin e personalitetit; modelet e prototipave kriminalë; modelet e sjelljes, reagimit dhe qëndrimit të individit, çrregullimet mendore dhe në sjellje, etj.

Rëndësia e përgjithshme e shfaqjes së hulumtimeve kriminologjike të orientuara në mënyrë pozitive qëndron në njohjen dhe pranimin e rëndësisë të së gjitha dimensioneve të etiologjisë së kriminalitetit, gjegjësisht, paraqitjes dhe zhvillimit të qasjes pluraliste me rastin e shpjegimit të rrethanave dhe shkaqeve të fenomenit kriminal.¹³

Në fushën e gjerë të kriminologjisë, tri shkolla kryesore¹⁴ japin përkufizime dhe trajtesa të sakta dhe bazë për të, si më poshtë:

- Shkolla e Enriko Ferrit, e cila zhvillon një koncept imperialist të kriminologjisë duke mohuar autonominë e së drejtës penale.

- Shkolla enciklopedike austriake, sipas së cilës e drejta penale nuk përfshihej në kriminologji, por kufijtë e kriminologjisë do të zgjeroheshin duke përfshirë etiologjinë kriminale (shkenca për shkaqet e krimit), kriminalistikën dhe shkencën penitenciare (shkencën për dënimin). Sipas kësaj shkollë kriminologjia përkufizohet si shkenca e krimit dhe përbëhet nga disa disiplina të veçanta të cilat studiojnë realitetin kriminal, faktet procedurale dhe mbrojtjen kundër krimit.

- Shkolla klasike amerikane, e cila e konsideron kriminologjinë si shkenca që studion shkëlqen si dukuri sociale, proceset e ndërveprimit të ligjeve, shkëlqet e ligjeve dhe reaksionin ndaj tyre. Sipas saj, pjesë përbërëse të kriminologjisë janë: sociologjia e së drejtës penale, etiologjia kriminale dhe penologjia.

Gjithashtu ka disa përkufizime të kriminologjisë. Sipas përkufizimit juridik, kriminologjia studion vetëm veprat penale të përcaktuara në kodin penal ose në ligjet e tjera penale të një vendi. Ndërkaq sipas përkufizimit sociologjik, kriminologjia studion të gjitha sjelljet antishoqërore që ekzistojnë në shoqëri, pavarësisht nga fakti se ato janë ose jo të përcaktuara në Kodin Penal. Ndërsa sipas përkufizimit të përzier, kriminologjia studion veprimet dhe mosveprimet, të parashikuara të tilla nga Kodi Penal dhe ligjet penale të tjera në një vend, si dhe sjelljet dhe veprimet joshoqërore, ku futen faktorët socialë, psikologjikë, psikosocialë, personaliteti i personit, duke e parë sjelljen e njerëzve në një vështrim më të gjerë¹⁵.

Në disiplinën e sociologjisë janë përpunuar disa teori sociologjike që synojnë të gjejnë shpjegime për mënyrën se si njerëzit mendojnë, ndihen dhe sillen në situata të ndryshme sociale. Ato shtrojnë për diskutim çështje të tilla si: “si i formon një individ përshtypjet për të tjerët?; “cilat janë motivet që njerëzit i ndryshojnë qëndrimet e tyre?; “cilat janë shkaqet që njerëzit konformohen ose jo me rregullat e grupit?”, etj. Këto teori i bazojnë paradigmat e tyre në ndikimin e situatat sociale në përfshirjen ose jo të individit në krim. Ndër teoritë¹⁶ më të njohura përmenden:

- Teoria e asociimit të diferencuar e cila parashikon që individët mësojnë vlera,

¹³ Sabani dhe Budimlic, *Kriminologjia*, (f. 31-37).

¹⁴ Hysi, *Kriminologjia*, (f. 8-9).

¹⁵ Po aty, f. 11-12.

¹⁶ Ritzer, George, dhe Douglas J. Goodman. *Teoria Sociologjike*. Tiranë: UFO PRESS, 2008, (f. 334-350 ; 599-365).

qëndrime, teknika apo motive për sjellje kriminale nëpërmjet ndërveprimit me të tjerët.

- Teoria e të mësuarit social prezumon se individët mësojnë sjellje të reja, kriminale ose jo, nëpërmjet rificimit të tyre, dënimit ose të mësuarit vëzhgues të sjelljeve të së tjerëve. Në analogji me këto dy teori, në disiplinën e kriminologjisë, Ronald Akers dhe Robert Burgess zhvilluan teorinë e të mësuarit social për të shpjeguar deviancën duke kombinuar faktorët që nxitin apo frenojnë kriminalitetin. Sipas kësaj teorie, sjellja kriminale ndikohet më së shumti nga ndërveprimet shoqërore, kushtet ekonomike, edukimi në familje dhe masa, shpesh tësia e probabiliteti i përforsimit të sjelljes.

- Teoria e kontrollit social të krimit merret me strategjitë dhe teknikat që ndihmojnë në rregullimin e sjelljes njerëzore duke çuar në konformitet me rregullat e shoqërisë. Në këtë proces ka influencë të madhe roli i familjes, i shkollës, i moralit, i vlerave, i besimit, etj.

- Teoritë e kontrollit¹⁷ të krimit ndryshojnë nga teoritë kriminologjike sepse në vend që të shtrohet pyetja se “çfarë i shtyn njerëzit të kryejnë krime?” shtrohet pyetja se “pse shumica e njerëzve nuk kryejnë krime?”. Këtu janë të përfshira dy nënkategori: “teoria e hershme” dhe “teoria moderne” e kontrollit social. Te kjo e fundit vlen të përmendet “teoria e lidhjeve sociale”, e cila bazohet në supozimin e përgjithshëm se veprimet deviate ndodhin kur lidhjet e një individi me shoqërinë janë të dobëta apo kur ato prishen. Kjo teori përdoret në të gjitha format e kriminalitetit.

- Teoria e vetëkontrollit pohon se personat me një shkallë të lartë vetëkontrolli do të kenë më pak gjasa të kryejnë veprime kriminale dhe e anasjelltë.

- Teoria e zgjedhjes racionale¹⁸ pohon se të gjitha veprimet sociale janë të motivuara racionalisht dhe çdo gjë është e lidhur me veprimin që ndikohet nga qëllimet. Krimi ndikon domosdoshmërisht në jetën e individëve përderisa i bën ata të vuajnë, të ndjejnë dhimbje, trauma, frikë e pasiguri.

Sic shohim, teoritë e sipërpërmendura shkurtimisht kanë për qëllim të shpjegojnë sjelljen kriminale, të gjejnë shkaqet e saj dhe më tej t'i diagnostikojnë apo t'i parandalojnë ato. Ato lidhin sjelljen kriminale me bashkëveprimin shoqëror, me ndikimin e familjes, me vlerësimin e kostove dhe përfitimeve në lidhje me veprimet deviate të kryera, me vetëkontrollin, me ambientin rrethues, etj. Njohja e shkaqeve të kryerjes së veprimeve kriminale është thelbësore në kurimin dhe, më së shumti, në parandalimin e krimit. Në SHBA dhe në mjaft vende të tjera, sociologët dhe kriminologët kanë projektuar teori për të shpjeguar lidhjen midis faktorëve ekonomikë dhe rrezikut të krimit. Sipas studimeve të tyre, faktorë si: shkaqet ekonomike, paqëndrueshmëritë ekonomike dhe përhapja e pabarabartë të tyre, si dhe moshja, ndikojnë shumë në rritjen e kriminalitetit. Por, sipas studimeve të bëra në SHBA, vitet e fundit, numri i krimeve është ulur dhe ka kaluar nga qendra drejt periferisë. Në SHBA, shkenca e sociologjisë dhe e psikologjisë vlerësohet shumë, si teorikisht dhe praktikisht. Sipas tyre, kriminologjia konsiderohet si nënfushë e sociologjisë, por me juridiksion¹⁹.

Sipas Henry Maudsley (1835-1918)²⁰, përfaqësues i teorisë psikiatrike dhe psikopatologjike, shkaqet e sjelljeve deviate gjenden në psikikën e njeriut e cila në ato raste ka karakteristikat patologjike. Mirëpo edhe gjendja e shëndoshë psikike, mund të jetë shkaktare e devijimit me rastin e anomalive të mëdha të parimeve morale të individëve, e cila e nxit “marrëzinë morale” ndonëse me atë rast personat e tillë mund të

¹⁷ Hirschi, Travis. *Causes of Delinquency*. Berkeley: University of California Press, 1969, (f. 16-34).

¹⁸ Price, Strays dhe Breese (red.), *Doing Sociology*, (f. 38-40).

¹⁹ Po aty, f. 39-40.

jenë edhe shumë inteligjentë.

Disiplina e psikologjisë është mjaft e gjerë dhe përfshin fusha të tilla, si: psikologjia fiziologjike, e cila studion bazën fiziologjike të proceseve psikike që paraqesin sistemin nervor dhe atë endokrin; psikologjia eksperimentale, që bazohet në prova dhe eksperimente për të parë reagimin e individit nga ngacmues të ndryshëm të jashtëm apo të brendshëm; psikologjia zhvillimore, që studion nëpër etapa ndryshimin e sjelljes së individit me kalimin e kohës dhe moshës; psikologjia sociale, që studion ndikimin e faktorëve shoqërorë në sjelljet dhe qëndrimet midis individëve e raportet ndërmjet grupit; psikologjia e komunikimit, që studion individin dhe raportin që krijon me të tjerët nëpërmjet procesit të komunikimit, etj. Fusha e psikologjisë, e cila lidhet drejtpërdrejt me deviancën dhe kriminalitetin, është psikologjia e krimit (ligjore), - siç do të shpjegohet dhe më poshtë, - e cila ka për funksion primar të shpjegojë sjelljen kriminale²¹. Ndërkaq, ka dhe disa teori psikologjike që janë të lidhura ngushtë me kriminalitetin dhe që në mënyrë direkt ose indirekt ndikojnë në punën e policisë. Këto teori do të renditen shkurtimisht, si më poshtë:

- Teoria psikoanalitike,²² trajton metodën e trajtimit të çrregullimeve mentale dhe emocionale të cilat karakterizohen me shikim dinamik në të gjitha aspektet e jetës psikike, ku definohet edhe zhvillimi i personalitetit përmes tri fazave: “id”; ego (atë) dhe superego (mbi unin). Themeluesi i kësaj teorie është Sigmund Freud.

- Teoria e greminës,²³ është teori psikodinamike që jep shpjegimet e sjelljes së njeriut duke e ndërlidhur me krizat e identitetit individual, të cilat janë prezent në të gjitha (tetë) fazat e zhvillimit psikosocial të njeriut. Në lindjen e sjelljes delikuate të individit, ndikon sidomos kriza e fazës II (socializimit), III (periudhës së lojës), V (adoleshencës) dhe VI (krizës intime).

- Teoria e të mësuarit social,²⁴ që prezumon se sjellja delikuate, si e tillë, është e mësuar më herët nga vëzhgimi, pjesëmarrja direkt dhe mbështetja e ndryshme dhe forcat lëvizëse të sjelljes agresive mund të jenë faktorë incentivë nxitës, faktorë modelues nxitës, faktorë averzivë, etj.

- Shkolla ndërpsikologjike,²⁵ me themelues Gabriel Tarde, sipas së cilës marrëdhëniet në një shoqëri janë marrëdhënie ndërpersonale dhe se imitimi është baza e sjelljes, e kujtesës dhe e krimit. Kështu, njerëzit përfshihen në krim nga këshillat, sugjerimet dhe ndikimi psikosocial.

- Teoria e inteligjencës,²⁶ e cila e vendos fokusin në lidhjen mes nivelit të inteligjencës së një personi dhe probabilitetit të aftësive kriminale të tij. Sipas kësaj teorie, inteligjenca lidhet me aftësinë për të mësuar dhe për të kuptuar rregullat e normat e shoqërisë dhe se personat me inteligjencë (IU) të ulët e kanë më të vështirë të kontrollojnë emocionet dhe sjelljet e tyre, duke qenë më të prirë drejt kriminalitetit.

- Teoria e lidhjeve të diferencuara²⁷, e realizuar nga Edvin Sutherland, shpjegon krimin duke e lidhur atë me mjedise dhe grupe sociale të veçanta dhe duke shpjeguar se

²⁰ Monahan, John, dhe Henry J. Steadman (red.). *Violence and Mental Disorder*. Chicago: The University of Chicago Press, 1994, (f. 7-10).

²¹ Sathyanarayana, Rao TS. “Psychiatric and the science of criminology: sociological, psychological, psychiatric analysis of the dark side”. *Indian Journal of Psychiatry* 49(1); 2007: 3-5.

²² Sabani dhe Budimic, *Kriminologjia*, (f. 77).

²³ Po aty, f. 78.

²⁴ Po aty, f. 80-81.

²⁵ Hysi, *Kriminologjia*, (f. 120-121).

²⁶ Po aty, f. 121-123.

²⁷ Po aty, f. 124-125.

çdo person ka lidhje të diferencuara me njerëz të tjerë të prirë për të kryer krime dhe kjo ndikon në zhvillimin e përcaktimeve që favorizojnë krimin.

Ndërkaq, përveç këtyre, janë dhe disa teori specifike psikopatologjike të cilat kanë për qëllim të shpjegojnë arsyet e çrregullimit të ndjenjave, pengesave në kontrollin e impulsive dhe modele të së njohurit specifik, të cilat përbëjnë informacione bazë mbi profilin e një ngjarjeje apo të një individi që kryen një ngjarje. Në ditët e sotme ka pasur një zhvillim masiv të shkencës në lidhje me problemet e sistemit mendor e nervor. Në bazë të parimeve të teorive biologjike, psikologjike, patologjike, neurologjike etj., po i kushtohet gjithnjë e më shumë rëndësi implikacioneve neurologjike brenda trurit të individit të cilat përbëjnë shkaktarë bazë të reagimeve apo sjelljeve kriminale, drejtuar vetes apo të tjerëve. Në të kaluarën, por sidomos në vitet e fundit, qasjet e reja psikologjike kanë ndikuar që këto informacione të jenë gjithnjë e më të domosdoshme për punën e punonjësve të policisë.

Sociologjia fokusohet në studime të grupeve të vogla e të mëdha, prirjet e grupit me vlerat, avantazhet e disavantazhet, kurse socialpsikologjia fokusohet në studimin e një individi në raport me të tjerët, - si mendon ai për të tjerët, a ndikohet apo varet nga ta, se si individët tërhiqen nga njëri-tjetri, qëndrimet e zhvilluara brenda individit duke përdorur metodën e manipulimit të faktorëve, gjë që në sociologji nuk bëhet. Ndërkaq psikologët e personalitetit përqendrohen në funksionet e brendshme të veçanta të individit dhe dallimet mes dy individëve²⁸. Kështu, ndërsa disiplina e sociologjisë synon të trajtojë prirjet e shoqërisë për kriminalitetin në nivel mikro dhe makro, psikologjia përqendrohet mbi prirjet që pushtojnë mendimin tonë duke realizuar një analizë të gabimeve e tendencave, duke përfshirë dëshmi të drejtpërdrejta të aftësive njerëzore për arritje logjike e intelektuale. Kriminologjia nga ana tjetër synon që të studiojë dhe të shkruajë format e shfaqjes së veprave penale, mënyrën e kryerjes së tyre, në studimin e mënyrës së jetës së kriminelit, tipologjinë e tyre, strukturën, ndryshimet strukturale dhe dinamikën e kriminalitetit. Kështu, realizohet një analizë tridimensionale (sociologjike, psikologjike e kriminologjike) e një ngjarjeje apo problematike e cila në kompleksitetin e saj përbën një trajtesë të mirëkompletuar dhe të shumanshme e që rrjedhimisht do t'i shërbejë punonjësve të policisë, strukturave apo analizave e studimeve të tyre dhe marrjes së masave për kuptimin e situatës e zgjidhjen e rasteve, me anë të njohjes më të detajuar të tendencave shoqërore e individuale nga njëra anë dhe dinamikën aktuale të kriminalitetit e pasur me profile e statistika, nga ana tjetër.

Duke qëndruar në këtë linjë, sipas J. S. Stumphauzer²⁹, formula e përcaktimit të sjelljes kriminale është: "repertori kriminalistik + situatat dhe nervozat + argumentimet e perceptuara = sjellja kriminale". Kështu, policia, krahas punës në terren për kapjen e hajdutëve e vjedhësve, ushtrimit të dhunës etj., ka për detyrë të hartojë strategji, në mënyrë që të ndikojë pozitivisht në zgjidhjen e çështjes duke mos lejuar që problemet individuale të kthehen në probleme kolektive. Ata duhet të krijojnë një sistem besimi dhe të marrin informacion nga agjencitë e komunitetit. Policët dhe oficerët shpenzojnë kohë duke arrestuar individë, kurse sociologët dhe psikologët kanë për detyrë t'i shohin këta individë, jo si kundërshtarë, por si partnerë bashkëpunues. Ata, gjithashtu, ndajnë informacion me publikun dhe shqyrtojnë problemin duke e fokusuar atë si të tillë. Sociologu mundohet të kuptojë shkaqet e kriminit dhe problemet themelore, të cilat

²⁸ Myers, David G. *Socialpsikologjia*. Tiranë: UEGEN, 2003, (f. 7-8).

²⁹ Sabani dhe Budimlic, *Kriminologjia*, (f. 93).

çojnë në kriminalitet. Sipas programeve të sociologëve, policët duhet të jenë të familjarizuar me njerëzit e lagjes përkatëse dhe të mos ndikohen nga paragjykimet apo thashethemet. Sipas këtyre programeve³⁰, polici duhet:

- të identifikojë problemin dhe ta trajtojë atë;
- të bëjë sa më shumë pyetje rreth problemit;
- të zgjedhë përgjigjet të cilat i jep i identifikuari;
- të analizojë përgjigjet dhe të marrë masa për planet që duhet të ndërmerren.

Ndërkaq, psikologët kanë për funksion të identifikojnë dhe të shpjegojnë lidhjen mes kriminit apo një ngjarjeje të jetës së përditshme me çrregullimet e aspektit psikopatologjik të individit. Punonjësit e policisë duhet të njohin profilin e gjithanshëm psikologjik të personave që, më së paku, ndodhen në lagjen ku ata mbikëqyrin. Ndërkohë, ndërhyrja komunitare ndikon shumë në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e punës. Në ditët e sotme po zbatohet gjerësisht policimi demokratik, ku roli i sociologut, psikologut e kriminologut dhe ndikimi i komunitetit në punën e policisë është shumë i rëndësishëm.

Për këtë arsye, punonjësit e policisë duhet të bashkëpunojnë me sociologë e psikologë duke e konsideruar këtë, jo si ulje të aftësive të tyre, por si shtysë për të arritur bashkërisht rezultate më të mira. Në SHBA motoja është: “Asnjë agjenci nuk mund të punojë vetëm. Duke bashkëpunuar, praktika do të ketë rezultat”.³¹ Sociologët hartojnë programe për të afruar komunitetin me policinë, hartojnë studime sociologjike dhe raporte të ndryshme për të informuar edhe publikun edhe policinë. Në këto raporte evidentohen mendimet e banorëve në lidhje me departamentin e tyre të policisë, vihen në dukje problematikat kryesore, si dhe rrugët që duhen ndjekur për përmirësim. Psikologët, përveç përdorimit të metodave të tyre, mbledhin këto informacione dhe krijojnë kontakte personale në varësi të programeve, çështjeve të ndryshme për të kuptuar më tepër rreth gjendjes së brendshme të një personi. Gjithashtu, sociologjia realizon perceptimin e një situatë të caktuar dhe e shikon këtë si të rëndësishme në formësimin e sjelljeve kriminale, duke sqaruar hendekun e perceptimit, midis asaj çfarë është dhe çfarë është perceptuar.

Sipas studimeve amerikane³², bashkëpunimi polici-komunitet rrit efektivitetin e punës. Në këto studime bëhet një analogji midis edukatorit, fëmijëve e lojës që edukatori u organizon atyre dhe sociologut e psikologut, policëve dhe komunitetit. Sipas kësaj analogjie, sociologu dhe psikologu luan një rol të rëndësishëm, si edukator i policëve dhe komunitetit, duke i vënë këta në lojë e duke kuptuar çrregullimin social dhe sjelljen kriminale. Nga sa u tha më sipër, sociologët e psikologët jashtë vendit, kryesisht në SHBA luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve kriminale, duke bashkëpunuar me policinë. Madje roli i tyre shikohet në mjaft raste dhe si parësor në rregullimin e marrëdhënieve “punonjës policie –komunitet”. Vlera e tyre njihet kudo dhe është e demonstruar edhe praktikisht, duke qenë se profesioni i sociologut dhe psikologut ushtrohet pranë strukturave institucionale dhe arsimore të policisë. Gjithashtu, studimet psikologjike dhe sociologjike vlerësohen si në policimin në komunitet, në kriminologji, në media dhe në komunitetin në tërësi. Në realitetin shqiptar, deri para disa viteve, roli i këtyre disiplinave sociale në fushën e policimit dhe sigurisë

³⁰ Price, Strays dhe Breese (red.), *Doing Sociology*, (f. 42-45).

³¹ Po aty, f. 43.

³² Po aty, f. 41-42.

nuk është konsideruar fort i rëndësishëm dhe nuk u është kushtuar shumë rëndësi profesionit të sociologut apo psikologut në organizmin e punëve të tyre. Me kalimin e viteve gjërat, dukuritë apo fenomenet filluan të shiheshin me një sy tjetër, me lente ndërvepruese shoqërore për të gjetur rrugëzgjdhje sa më të efektshme dhe rezultati është që jemi duke ecur përpara të gjithë së bashku, nën gjurmët e një policimi sa më modern e Perëndimor që mbështet elementin social dhe analizën tredimensionale.

Kështu, teoritë sociologjike shpjegojnë rolin që luajnë institucionet, strukturat dhe proceset sociale në formimin e sjelljes njerëzore. Përfaqësuesit e këtyre teorive pozicionohen në marrëdhëniet midis pozitës sociale të njerëzve dhe sjelljeve të tyre kriminale. Pozita sociale, rolet dhe statusi social i individëve të cilët i studion dega e sociologjisë janë shkaktarë të sjelljeve kriminale. Prandaj është e nevojshme që kriminaliteti të studiohet nga këndvështrimi i profesional i sociologut fillimisht, për të analizuar shkaqet, rrjedhën, prekshmërinë e problemeve sociale që shkaktojnë krimin dhe sjelljet kriminale. Teoritë psikologjike të zhvillimit³³ ndihmojnë për të kuptuar ndryshimet e ndodhura gjatë jetës së njeriut në aspektin fizik, konjitiv e social të sjelljes ndërsa teoritë e personalitetit organizojnë aspektet kryesore të sjelljes, shpjegojnë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes individëve, si dhe përkufizojnë personalitetin e shëndoshë si model të dallueshëm e të qëndrueshëm sjelljesh e njohurish, që karakterizojnë përshtatjen në jetë.

Gjithashtu, një aspekt shumë i rëndësishëm i kontributit që jep disiplina e psikologjisë është në dhënien e udhëzimeve, teorive e mënyrave praktikave për menaxhimin e stresit dhe efektet pozitive në cilësinë e jetës së individit. Nga ato që kemi parë në kronikat e lajmeve nëpër televizione dhe në artikujt e gazetave, mjaft konflikte të rëndomta janë përshkallëzuar deri në vrasje e vetëvrasje si pasojë e mosmenaxhimit të stresit. Vetë populli shqiptar njihet për temperament shpërthyes dhe gjaknxehtë, por kontrolli i impulseve në momentet më kulmuese është thelbësore për jetën dhe vazhdimësinë e saj. Në këtë mënyrë, analiza fillon nga gjeneza e problemit dhe krijon mundësi për ta parandaluar atë. Nuk mund të parandalosh asnjëherë në qoftë se nuk di shkaqet themelore bazike të një problemi, në rastin konkret, të një akti apo sjelljeje kriminale. Më tej, analiza mund të vazhdohet me rolin e kriminologëve, të cilët do të studiojnë veprimet dhe mosveprimet, të parashikuara të tilla nga Kodi Penal dhe ligjet e tjera në këtë fushë në një vend, si dhe sjelljet dhe veprimet joshoqërore, faktorët e tyre. Në vijim, në aspektin praktik, do të duhej roli i policit, i cili do të zgjidhte problemin konkretisht, roli i prokurorit, i gjykatësit etj.

Në SHBA vlerësohet shumë disiplina e psikologjisë e sociologjisë dhe roli i tyre në raport me kriminologjinë, me policimin në komunitet dhe me ndikimin pozitiv në reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Mendoj që implementimi i këtyre disiplinave në mendësinë policore në vendin tonë, kërkon ende shumë punë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, por është e rëndësishme që të kuptohet fillimisht dhe të pranohet vlera që ka secila prej fushave (sociologji, psikologji, kriminologji), në funksionimin sa më të efektshëm të punës së Policisë së Shtetit si dhe vlera arsimore dhe edukuese e tyre në Akademinë e Sigurisë dhe njësitë bazë të saj, siç janë fakultetet apo Qendra Kërkimore-Shkencore; dhe, puna po ecën në drejtimin e duhur, pasi roli i profesionit të sociologut e psikologut po ndjehet gradualisht në disiplinën e kriminologjisë, policimit e sigurisë. Por, në të ardhmen, shpresoj që politikat e ndjekura në vendin tonë

³³ Lazi, *Psikologjia e Policimit*, (f. 131-149).

t'u japin mundësi dhe hapësirë sociologëve, psikologëve e kriminologëve në analizimin e akteve apo sjelljeve kriminale dhe hapjen e sa më shumë funksioneve të tilla.

Mendoj që përfshirja dhe ndërhyrja e tyre do të parandalonte shumë situata kriminale të cilat janë të një numri të konsiderueshëm. Nuk mjafton vetëm një apo dy aktorë për të zgjidhur çështjet kriminale. Duhet bashkëveprim, ndërthurje e shumë aktorëve, - sociologë, psikologë, filozofë, kriminologë, punonjës socialë, policë, prokurorë, gjykatës, avokatë etj., - të cilët, në mbështetje të kompetencave përkatëse të degës së tyre, do të mund të realizonin një punë të mirë, me sa më pak kosto ekonomike apo sociale, duke arritur një efencë të përgjithshme shoqërore.

Bibliografi

1. Lamb, Larry. Hyrja, në *Low and Order News*, nga Steve Chinball. London: Tavistock Press, 1977.
2. Papandele, Jani, dhe Ilir Mandro. *Kriminologji-Penologji*. Tiranë: Ilar, 2002
3. Ligji i Policisë së Shtetit Nr. 108/2014.
4. Ligji i Policisë së Shtetit Nr. 108/2014.
5. Lazi, Piro. *Psikologjia e Policimit*. Tiranë: Akademia e Policisë "Arben Zylyftari", 2004.
6. Hysi, Vasilika. *Kriminologjia*. Tiranë: Kristalina, 2010.
7. Blackburn, Ronald. *The Psychology of Criminal Conduct : Theory, Research and Practice*. Chichester: John Wiley & Sons Ltd, 1993.
8. Chinball, Steve. *Low and Order News*. London: Tavistock Press, 1977.
9. Sabani, Alisabri, dhe Muhamed Budimlic. *Kriminologjia*. Përkthyer nga Mustafë Reçica. Sarajevë dhe Prishtinë: Universiteti AAB Press, 2007.
10. Price, Jammie, dhe Roger A. Strays, Jeffrey R. Breese (red.). *Doing Sociology: Case Studies in Sociological Practice*. Lanham, MD: Lexington Books, 2009.
11. Ritzer, George, dhe Douglas J. Goodman. *Teoria Sociologjike*. Tiranë: UFO PRESS, 2008.
12. Hirschi, Travis. *Causes of Delinquency*. Berkeley: University of California Press, 1969.
13. Monahan, John, dhe Henry J. Steadman (red.). *Violence and Mental Disorder*. Chicago: The University of Chicago Press, 1994.
14. Sathyanarayana, Rao TS. "Psychiatric and the science of criminology: sociological, psychological, psychiatric analysis of the dark side". *Indian Journal of Psychiatry* 49(1) 2007.
15. Myers, David G. *Socialpsikologjia*. Tiranë: UEGEN, 2003.
16. Coser, Lwis dhe Larry Ridener. *Teoritë sociologjike*. Tiranë: Plejad, 2005.
17. Dragoti, Astrit. *Njohuri për shoqërinë, Edukimi ligjor*. Tiranë: LILO, 2006.
18. Fuga, Artan. *Rrota e mundimit*. Tiranë: Dudaj, 2007.
19. Giddens, Anthony. *Sociologjia*. Tiranë: Çabej, 2007.
20. Hall, Ed. James. *Policing the Crisis, Critical Social Studies*. London: Palgrave Macmillan, 1978.
21. Dragoti, Edmond. *Psikologjia Sociale*. Tiranë: R&T Advertising, 2004.
22. Cross, Steve. *Sociological theory and analysis*. London: University of London, 2008.
23. Jackson, Jonathan. *Bridging the Social and the Psychological in Fear of Crime Research*. London: Routledge-Cavendish, 2008.

Agastra, a.
« Zhvillimi i policimit dhe i kriminalitetit parë në dritën e sociopsikologjisë dhe kriminologjisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes



■ **Msc Ilija NASI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Vitet e fundit, në shumë nga vendet e rajonit, përfshi dhe Shqipërinë, po implementohet një mënyrë e re policimi, ajo e policimit në komunitet dhe për komunitetin. Pas një pune të frytshme eksperimentimi dhe implementimi, veçanërisht dekadat e fundit, të mbështetur dhe nga partnerët tanë (misionet ndërkombëtarë që kanë asistuar e ndihmojnë Policinë e Shtetit), filozofia dhe praktika e policimit në komunitet, e quajtur ndryshe edhe filozofia e partneritetit me publikun, duket se po fiton terren dhe trajta përherë e më të plota. Institucionalizimi dhe jetësimi i këtij projekti madhor, si forma e policimit të së ardhmes, është tashmë pjesë e përpjekjeve të shtetit dhe shoqërisë shqiptare për adresimin dhe implementimin e policimit komunitar, duke përbërë një nga qasjet më karakteristike të policimit demokratik në vendin tonë. Kjo evidentohet dukshëm, pothuajse në të gjitha prezantimet dhe pilotimet e kryera në kuadër të reformës strukturore e organizative të ndërmarrë në vitet e fundit.

Objektivat kryesore të policimit në komunitet përshkruhen në Strategjinë e Policisë së Shtetit 2013-2021, ku synohet integrimi dhe shtrirja e kësaj forme policimi në të gjithë komponentët e punës së policisë; ndërtimi dhe konsolidimi i partneritetit me komunitetin, me qeverisjen vendore dhe grupet e interesit; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve policore e administrative për qytetarët dhe biznesin, etj. Në substancë, nëpërmjet këtij projekti synohet të zgjidhen nevojat dhe kërkesat gjithnjë në rritje të komunitetit për një polici profesionale e korrekte në shërbim të tyre dhe ritur më tej shkallen e besimit të publikut tek Policia e Shtetit. Kjo do të vijë me rritjen e bashkëpunimit dhe mirësjelljes së punonjësve dhe patrullave të policisë në rrugë, apo në veprim, për të treguar faktin se kjo trupë ekziston për të mbrojtur qytetarin dhe shoqërinë nga keqëbërësit, si forcë që garanton sigurinë e jetës dhe të pronës publike e private.

Ekspozimi i faktit që policimi në komunitet po implementohet me problematikat e veta edhe në vendin tonë, që policimi efektiv kërkon partneritet me komunitetet të cilave u shërbehet dhe se nëpërmjet veprimtarive të tyre, punonjësit e policisë duhet të jenë pjesë e përpjekjeve të përbashkëta të shoqërisë për të promovuar mbrojtjen ligjore dhe ndjenjën e sigurisë, përbëjnë synimin e këtij vështrimi analitik të ecurisë dhe çështjeve që ndesh policimi në komunitet.

Fjalëkyçe:

policimi në komunitet, grupe interesi, qeverisje vendore, kuadri ligjor, dokumente strategjike, siguri publike.

Hyrje

Në këtë material do të mundohem të paraqes rolin dhe pozicionin e filozofisë së policimit në komunitet në Policinë e Shtetit dhe në vendet me demokraci të konsoliduar, duke paraqitur anën historike të lindjes dhe të aplikimit të filozofisë së policimit në komunitet dhe si ka evoluar kjo filozofi në disa polici të vendeve të ndryshme. Do të paraqesim se si ka ecur Policia Shqiptare në faza dhe forma të organizimit të shtetit shqiptar; se si ka evoluar kjo filozofi; se kur janë zanafillat e aplikimit të kësaj forme të policimit, ndryshimet organizative dhe ligjore për ta afruar gjithmonë e më shumë Policinë e Shtetit me këtë formë policimi; se cilat janë përparësitë dhe sfidat për këtë formë policimi për Policinë e Shtetit. Do të paraqes disa përfundime për t'i shërbyer sadopak strukturave, për të njohur realisht se sa dhe si është përfaqëuar nga Policia e Shtetit kjo filozofi, si e vetmja filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes.

Policimi në komunitet është sot forma e vetme e policimit në të gjitha vendet me demokraci të konsoliduar. Ajo është jo vetëm një trend i zhvillimit, por edhe një katalizator kryesor i performancës së shërbimit policor në garantimin e parametrave optimal të sigurisë në publik dhe kontrollin e territorit. Policimi i orientuar nga komuniteti, në thelb, është një bashkëpunim ndërmjet policisë e komunitetit, për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e sigurisë së përbashkët. Në kuptim të kësaj filozofie, policia nuk është “ruajtësi” i vetëm i ligjit dhe rendit, por të gjithë anëtarët e komunitetit supozohet të bëhen aleatë aktivë në përpjekje për të rritur sigurinë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës. Policia shqiptare e cila aspiron për një policim modern e ka më se të qartë tashmë, se në themel të këtij policimi, qëndron policimi në komunitet, si një filozofi dhe një strategji për të realizuar me sukses misionin e saj. Ajo, prej disa vitesh po rishikon mënyrën e organizimit, proceset e punës, metodat dhe praktikat e policimit,

Nasi, I.
« Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

si dhe po ndërton një kulturë të organizatës, të bazuar në filozofinë e policimit në komunitet. Policia e Shtetit gjatë viteve të fundit ka punuar për orientimin e shërbimeve policore drejt modelit të policimit në komunitet. Për implementimin e këtij modeli policimi është vlerësuar se angazhimi, partneriteti dhe ofrimi cilësor i shërbimeve ndaj qytetarëve janë elementë shumë të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi sa më të sigurt.

Sfida për çdo punonjës policie është arritja e standardeve më të larta të shërbimit, nëpërmjet rritjes së profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe transparencës, duke zbatuar me korrektësi ligjin, si dhe duke përmirësuar komunikimin me qytetarët. Sot të gjithë e pranojmë se detyrat parësore të një policie demokratike janë:

- zbatimi i ligjit, ruajtja e qetësisë dhe rendit publik,
- respektimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të individit,
- parandalimi dhe zbulimi i krimit,
- pakësimi i frikës dhe rritja e sigurisë,
- përgjigja në kohë dhe dhënia e ndihmës me shërbime ndaj publikut.

Përparimi drejt policimit në komunitet, arrihet kur ka ndryshim në mentalitetin e organizimit dhe të orientimit të shërbimeve “nga një qasje e orientuar drejt kontrollit në një qasje të orientuar drejt shërbimit” dhe ku interesi kryesor i zbatimit të ligjit mbetet i përqendruar në parandalimin proaktiv të krimit. Për të kryer këtë mision, të gjitha organizatat e policisë drejtohen nga strategji të ndryshme operacionale dhe organizative. Literatura moderne e menaxhimit policor njih një gamë të gjerë të strategjive të ndryshme operacionale dhe organizative si dhe të filozofive në të cilat bazohet puna e organizatave të ndryshme të policisë në botë. Disa nga këto strategji janë deklarata të përgjithshme mbi mënyrën se si policia duhet të konceptojë dhe t’i përqaset punës të saj, ndërsa disa të tjera janë përshkrime më specifike dhe të detajuara se si policia mund të luftojë krimin në mënyrë sa më efektive. Një pjesë e këtyre modeleve mund të kombinohen dhe zbatohen së bashku.

1. Fillimet e policimit në komunitet, në botë

Policimi në komunitet, lidhet në mënyrë të pandashme, me policimin në *Britaninë e Madhe*, megjithëse koncepti i sotëm i policimit në komunitet, si metodë moderne e policimit, ka evoluuar ndër vite dhe në vende të ndryshme të botës, studiuesit e konsiderojnë Britaninë si atdheun e policimit modern, të cilin e lidhin pandashmërisht me Sir Robert Peel. Por, çfarë bëri Sir Peel në cilësinë e sekretarit të Punëve të Brendshme (viti 1829), ndryshe nga çfarë ishte bërë nga paraardhësit e tij deri në atë kohë? Ai, hodhi këto hapa:

- udhëhoqi standardizimin e forcave policore, i organizoi ato në modelin civil dhe duke i bërë të përgjegjshme ndaj publikut;
- vendosi e ngjyrën blu për uniformat e policisë (përkundrejt asaj të kuqe, që ishte ngjyra e ushtrisë);
- konvertoi gradat, nga ato ushtarake në ato policore (bëri të mundur shkëputjen nga tradita ushtarake e organizimit të policisë);
- mundësoi marrjen e vendimit që oficerët e policisë, në vend të armëve, të mbanin vetëm një shkop druri dhe një fener (që më vonë u zëvendësua nga bilbili) për

Nasi, I.
«Policimi në
komunitet –
filozofi dhe
formë e
policimit të së
ardhmes»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

të sinjalizuar në raste nevojë për ndihmë apo mbështetje - kjo ishte një risi për atë periudhë.

Një ndër thëniet më të njohura të Sir Peel, që përbën njëkohësisht edhe thelbin e policimit në komunitet, është:

“Mbajtja, në të gjitha kohët, e një lidhjeje me publikun, që i jep vërtetësi traditës historike se policia është publiku dhe publiku është policia. Policët janë vetëm pjesëtarë të publikut, të cilët paguhën për t’u kushtuar vëmendjen dhe kohën e plotë detyrave që ka çdo qytetar në interes të ekzistencës dhe mirëqenies së publikut”¹.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zanafilla e teorisë së policimit në komunitet lidhet me Shkollën e Administrimit Policor dhe të Sigurisë Publike, Miçigan, e cila në vitin 1961 bëri një studim për efikasitetin e shërbimit policor në 168 agjenci policore dhe më pas, bazuar në gjetjet e këtij studimi, në vitin 1965 krijoi një qendër kombëtare policore për marrëdhënie komunitare. Fillimisht, teorinë e policimit në komunitet u eksperimentuan në shtete të ndryshme të SHBA-së, duke u pasuar me studime që kulmuan me ngritjen e disa stacioneve të vogla policore në vitin 1974, në Detroit.

Proceset e zbatimit të policimit në komunitet në Europën kontinentale variojnë sipas grup-shteteve. Në vendet skandinave, veçanërisht në Suedi, Norvegji dhe Danimarkë, policimi në komunitet u bë shpejt një filozofi dominuese, kurse në vende si Franca, Italia dhe Spanja, jo vetëm që është më i vonë, por paraqitet edhe në një formë tjetër. Krijim ndryshe dhe i veçantë është fillimi i formës së policimit për *Policinë Kosovare*, - e themeluar në vitin 1999, - e cila në dallim nga policitë e rajonit, nuk i është nënshtruar procesit të transformimit prej policimit tradicional në atë bashkëkohor. Qysh në krijimin e saj, drejtimi kryesor strategjik i përcaktuar ishte policimi në komunitet ose policimi në bashkësi.

2. Policia shqiptare dhe fillimet e policimit në komunitet

Duke filluar nga vitin 1992 kur kanë filluar trajnimet dhe implementimi në Policinë e Shtetit, filozofia dhe praktika e policimit në komunitet ose filozofia e partneritetit duket se po fiton statusin e traditës në Shqipëri. Prezantimet dhe pilotimet që janë zhvilluar kanë ndihmuar në përfundimin e procesit të institucionalizimit të kësaj mënyre moderne dhe të zgjuar të policimit. Ky proces po ndikon pozitivisht jo vetëm në rritjen e cilësisë së jetës në komunitet dhe në rritjen e performancës së Policisë së Shtetit, por edhe në arritjen e standardeve europiane të fushës. Suksesi në progresin e policimit në komunitet në realitetin shqiptar, lidhet sa me predispozicionin e Policisë së Shtetit ndaj modeleve më të mira të policimit, aq edhe me traditën e publikut në vendosjen e marrëdhënieve të shëndosha të bashkëpunimit me policinë. Megjithatë akoma disa forma dhe metoda të policimit në komunitet kanë ngelur thjesht teorike dhe po hasin vështirësi të ndryshme për t’u zbatuar nga aktorë dhe faktorët. Akoma nuk është gjetur ai “çelësi i artë” për ta bërë komunitetin të ndërgjegjshëm dhe të bindur për domosdoshmërinë dhe rolin e pazëvendësueshëm që ai ka për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë dhe për bashkëpunimin me Policinë e Shtetit.

Nasi, I.
« Policimi në komunitet - filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹ Manuali për Policimin në Komunitet , Kreu 1, pika1, 2, faqe 12 (Botim i programit të Qeverisë Suedeze për zhvillim dhe Policisë së Shtetit)

3. Marrëdhëniet polici-komunitet në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë shqiptare

3.1 Periudha e Republikës dhe Monarkisë, vitet 1925–1939

Zhvillimi i policisë shqiptare në këtë periudhë është kushtëzuar nga ndryshimet e formave të qeverisjeve apo të regjimit politik. Megjithatë, janë bërë përpjekje për të përqsur legjislacionin dhe strukturat policore me standardet europiane të kohës. Miratimi i ligjit “Për administratën civile” në vitin 1928, mes të tjerash, synonte të forconte marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe komunitetit, duke parashikuar detyra për pleqësitë dhe rojtaret e katundeve për sigurimin e qetësisë dhe sigurimin e nxënësve. Ligji përcaktonte gjithashtu raportet ndërmjet policisë, autoriteteve lokale dhe komunitetit. Më vonë, sipas përvojave europiane, u krijuan disa lloje policish, si: Policia Rurale, Roja Mbretërore e Kufirit, Policia Bashkiake dhe Policia e Sigurimit Publik. Çdo polici kishte ndarje të qarta të përgjegjësisve, që kishin lidhje me atributet administrative dhe gjyqësore. Këto organizime u shoqëruan edhe me përmirësime të shërbimeve policore në raport me të zgjedhurit në komuna, bashki dhe prefektura, si dhe raste episodike bashkëpunimin me komunitetin².

Për këtë periudhë nuk ka ndonjë veçori specifike ose për t’u evindentuar në lidhje me bashkëpunimin polici-komunitet, por përkundrazi kemi pasur acarime dhe raporte deri në një farë mase të cenuara, kjo për shkak se figura e policit përfaqësohej nga njerëz me kulturë të ulët, të cilët nuk kujdeseshin thujse fare për të ndërtuar dhe përmirësuar marrëdhëniet e ndërsjella.

3.2 Periudha e regjimit komunist, vitet 1945 – 1990

Gjatë kësaj periudhe, policia, si pjesë e sistemit monist, ishte organ ekzekutiv në funksion të mbrojtjes së diktaturës dhe rendit juridik socialist. Veprimtaria e saj normohej në bazë të ligjit “Për Policinë Popullore” krahas politizimit ekstrem që kishte ky ligj, e veçanta e tij është se ishte përcaktuar llogari dhënia nga funksione të caktuara të policisë në këshillin popullor të rrethit ose karshi masave, shpeshherë këto llogaridhënie bëheshin formale. Megjithatë, për hir të së vërtetës, ato plotësonin disi atë mision që kishte policia e asaj periudhe: mbrojtjen e rendit dhe luftën kundër kriminalitetit. Ekzistenca e funksioneve të tilla si “i plotfuqishmi i zonës” e më vonë “punëtori i policisë së zonës”, mundësuan prezencën e policisë pranë qytetarëve, duke parandaluar krimin dhe duke zbatuar disa elementë të policimit në komunitet. Por, pavarësisht mosnjohjes dhe mosrespektimit të së drejtave të njeriut, gjatë kësaj periudhe policia ka kryer detyra për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, jetës dhe pronës së njerëzve, duke qenë pranë qytetarëve dhe dukë ofruar shërbime.

3.3 Periudha post-komuniste, vitet 1991–1997

Kalimi nga sistemi monopartiak në sistem pluralist u shoqëruan me ndryshime drastike të formave të organizimit dhe funksionimit të shtetit. U kryen reforma të thella të shtetit e shoqërisë shqiptare, të cilat, krahas të tjerave, sollën për Policinë e Shtetit ndryshime në mënyrën e konceptimit të përgjegjësisve e të filozofisë së policisë si një

Nasi, I.
«Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

² Manuali për Policimin në Komunitet Kru2 pika 2.1 faqe 35. Botim I Programit të Qeverisë Suedeze për zhvillim dhe Policisë së Shtetit.

shërbim publik për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, këto reforma sollën ndryshime ligjore dhe strukturore, që synonin integrimin e policisë në shoqëri dhe që u bazuan në standardet e vendeve europiane. Duhet të kujtojmë se të gjitha institucionet dhe shoqëria shqiptare, deri në fund të viteve 1998 e kanë ushtruar aktivitetin duke u mbështetur mbi një paketë kushtetuese ku policia vazhdonte të mbante statusin ushtarak dhe vetëm mbas këtij viti, me aprovimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Policia e Shtetit nuk ishte më pjesë e strukturave ushtarake, por e administratës publike. Pra, ndryshoi statusi i policisë dhe në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës janë gjeneruar të gjitha kodet dhe ligjet organike; ndërmjet ligjeve të tjera edhe ligji “Për Policinë e Shtetit”, i vitit 1999, i vitit 2007 dhe deri te ligji aktual i Policisë së Shtetit, ai i vitit 2014.

Në të tre këto ligje është pasqyruar evoluimi i mentalitetit, në tërësi, te Policia e Shtetit. Këtu vlen të evidentohet fakti se si në ligjin për Policinë e Shtetit të vitit 2007 dhe në atë të vitit 2014, është përcaktuar me nen të veçantë detyrimi i strukturave vendore (drejtorive vendore) dhe i Drejtorisë së Policisë së Shtetit, që të hartojnë strategji dhe programe afatshkurtër dhe afatgjatë për policimin në komunitet. Objektivi madhor i asaj periudhe ishte shndërrimi demokratik i Policisë së Shtetit dhe në këtë kuadër, organizata vendase dhe të huaja, si Këshilli i Europës, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, fondacioni SOROS, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar etj., shkruan, përkthyen dhe vunë në dispozicion të Policisë së Shtetit shumë botime të policimit modern, si dhe u angazhuan në trajnimin dhe specializimin e punonjësve të policisë.

3.4 Fillimet e pilotimit të policimit në komunitet në Shqipëri

Elementët e parë, megjithëse fillestarë dhe të thjeshtë, të policimit në komunitet duket se filluan të zbatohen nga policia shqiptare menjëherë pas vitit 1997, gjatë fushatës për mbledhjen e armëve dhe municioneve luftarake që kishin rënë në duart e qytetarëve si pasojë e trazirave të atij viti. Prezantimi në Shqipëri i modelit të policimit në komunitet si filozofi dhe mënyrë veprimi që pason policimin demokratik, e ka zanafillën në vitet 1998-1999. RCMP (policia kanadeze), nëpërmjet një projekti rajonal, jo vetëm që prezantoi policimin në komunitet nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve, por edhe mbështeti krijimin e mekanizmave rajonale të partneritetit, siç është Shoqata e Shefave të Policive të Vendeve të Europës Juglindore, shoqatë që është ende funksionale. Në vitet që pasuan, organizata dhe projekte si DANIDA (Programi Danez i Asistencës për Zhvillim), UNDP nëpërmjet programit SSSR (Mbështetja e Reformave në Sektorin e Sigurisë) dhe IDN (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim), dhe së fundi programi “Mbështetja e Qeverisë Suedeze për Ministrinë e Punëve të Brendshme/Policinë e Shtetit për policimin në komunitet”, kanë pilotuar respektivisht gjenerimin e partneriteteve polici-komunitet.

Duke vlerësuar si të suksesshme pilotimet e ndryshme mund të përmendim: viti 2007 solli përfshirjen, për herë të parë, të policimit në komunitet në dokumentet më të rëndësishme strategjike dhe ligjore; strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013 njohu për herë të parë dhe adaptoi modelin e policimit në komunitet; një hap tjetër përpara në zbatim të strategjisë së sipërpërmendur ishte implementimi (duke filluar nga viti 2007) për herë të parë në vend, i shërbimit të “Patrullës së përgjithshme”. Ky shërbim u organizua si shërbim i ri, aktiv, i drejtpërdrejtë për kontrollin e territorit, me kompetenca në fushën e rendit, qarkullimit rrugor, duke kaluar nga modeli i policimit reaktiv në atë proaktiv, pra nga shërbimi i grupeve të gatshme, të cilat qëndronin në ambientet e

Nasi, I.
« Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

brendshme të komisariatit dhe angazhoheshin me shërbim pasi ndodhte vepra penale, në një shërbim sa më pranë qytetarëve dhe me përgjegjësi kryesore parandalimin e krimit.

Në periudhën në vazhdim, shumë elementë të policimit në komunitet janë kthyer në praktika rutinë të punës së policisë. Statusin e traditës e kanë fituar tashme aktivitetet, të tilla si:

- dita/java e dyerve të hapura të policisë, kohe kur drejtoritë/komisariatet e policisë hapen për publikun dhe qytetarët kryejnë vizita për t'u njohur me punën e policisë dhe procedurat e saj;

- takimet periodike të specialistëve të policisë në institucionet e arsimit parauniversitar, me qëllimin ndërgjegjësimin, kryesisht për reduktimin dhe parandalimin e përdorimit të drogës, si edhe për trafikun rrugor, dhunën në familje, etj.;

- takimet e rregullta me banorë të zonave të ndryshme për sensibilizimin e tyre për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike;

- partneriteti dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore dhe OJF të ndryshme në fushën e respektimit dhe garantimit të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga punonjësit e policisë gjatë përmbushjes së detyrave institucionale;

- prishja e rrethimeve prej betoni ose guri në disa institucione të policisë, të cilat të krijojnë ndjesinë e një institucioni të mbyllur, të shkëputur nga realiteti dhe të frikshëm për qytetarët dhe zëvendësimi i tyre me rrethime dekorative, që krijojnë ndjesinë që këto ambiente janë më të prekshëm dhe realisht janë të pëlqyeshëm nga komuniteti, duke krijuar institucione që nuk ngjallin frikë te qytetarët, por përkundrazi i ngjall atij besim (projekt ky, që po aplikohet me sukses në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Tiranës dhe disa komisariate dhe që do të shtrihet në të gjitha institucionet policore të vendit).

4. Filozofia e policimit në komunitet, parimet dhe drejtimit kryesore të ndërtimit dhe zbatimit të filozofisë së policimit në komunitet

4.1 Filozofia

Policimi në komunitet është, në thelb, një bashkëpunim ndërmjet policisë dhe komunitetit për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e sigurisë së përbashkët. Thënë ndryshe, *policimi në komunitet*, është edhe një filozofi (një mënyrë të menduari) dhe një strategji organizative (një mënyrë për ta vënë në jetë filozofinë), që e lejon policinë dhe komunitetin të punojnë së bashku, në mënyra të reja, për të zgjidhur problemet e krimit, parregullsitë dhe çështjet e sigurisë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së përbashkët. Kjo filozofi ndërtohet mbi besimin se njerëzit e meritojnë dhe kanë të drejtë të kenë rolin e tyre në policim në këmbim të pjesëmarrjes dhe mbështetjes së tyre. Si pak strategji/filozofi të tjera, policimi në komunitet ofron zgjidhje konkrete për atë se si policia koncepton funksionimin e saj dhe, në të njëjtën kohe, ofron mekanizma dhe instrumente specifike për ta bërë punën e saj sa më efektive.

Duhet theksuar se policimi në komunitet nuk është një alternativë përjashtuese për strategjitë e tjera, por një filozofi përfshirëse, që lë vend për integrimin e elementëve të ndryshme në këto strategji. Pikërisht, kjo është një nga arsyet kryesore që policimi në

komunitet po shndërrohet në filozofinë bazë të operimit të organizatave policore në shumë vende të botës. Ai është fleksibël dhe i hapur ndaj inovacionit dhe teknikave moderne të policimit.

4.2 Parimet dhe drejtimit kryesore të ndërtimit dhe zbatimit të filozofisë së policimin në komunitet

a. Partneriteti me komunitetin.

Partneriteti me komunitetin mund të përkufizohet si bashkëpunimi apo puna e përbashkët ndërmjet policisë dhe individëve e organizatave që ajo u shërben, me qëllim të dyanshëm: dhënien e zgjidhjeve për problemet e sigurisë dhe rritjen e besimit të policia. Policimi në komunitet njih faktin që policia nuk mund t'i zgjidhë problemet e sigurisë duke vepruar e vetme. Për këtë arsye, ajo nxit partneritetin aktiv me komunitetin.

b. Përfshirja e policisë në veprimtari komunitare.

Partneriteti me komunitetin do të thotë të adaptosh një perspektivë policimi që tejkalon përjasjen standarde të zbatimit të ligjit dhe përfshirjen në veprimtari që kontribuojnë në mirëqenien në lagje. Të tilla veprimtari mund të përfshijnë:

- ndihma dhe asistenca për viktimat e aksidenteve apo veprave penale;
- puna me banorët për të përmirësuar konkretisht kushtet në një lagje;
- dhënia e shërbimeve sociale të karakterit urgjent
- referimi i individëve në rrezik (largimi i të miturve nga shtëpia, të pastrehëve, të intoksikuarve, të sëmurëve mendorë) tek institucionet kompetente etj.

Përfshirja në këto veprimtari ndihmon për të krijuar besim ndërmjet policisë dhe komunitetit, veprimtari të tjera të punonjësit të policisë mund të jenë bisedat me përfaqësues të bizneseve lokale, për t'i ndihmuar të identifikojnë problemet dhe shqetësimet e tyre. Policia mund të vizitojë banorët në banesat e tyre apo në ambientet e përbashkëta dhe t'u ofrojë siguri dhe këshillim për rritjen e sigurisë personale; mund t'i ndihmojë ata të organizojnë mbledhje të rregullta të komunitetit etj. Kjo lloj forme është e rëndësishme, sepse rrit besimin e komunitetit të policia. Nga ana tjetër, rritja e këtij besimi i jep mundësi policisë të ketë akses në informacione të vlefshme nga komuniteti, që mund të çojnë në zgjidhjen dhe parandalimin e veprave penale, të gjenerojnë mbështetje për veprimet e policisë për kontrollin e veprave penale, si dhe të krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme pune me komunitetin. Sigurisht, krijimi i besimit është një proces që nuk ndodh brenda natës dhe që kërkon përpjekje të vazhdueshme

c. Partneriteti duke nxitur përfshirjen e banorëve në veprimtari ndihmëse të policisë.

Promovimi i bashkëpunimit mund t'i mobilizojë komunitetet që të përfshihen aktivisht në veprimtaritë për parandalimin e krimit, si dhe të zhvillojnë një ndjenjë të përgjegjësisë të përbashkëta për sigurinë publike. Shembuj të përfshirjes aktive të banorëve të komunitetit mund të ishin: veprimtaritë për të përfortuar kontrollin joformal shoqëror; ngritja e grupeve për ruajtjen e lagjes; zhvillimi i programeve të "oficerit të shërbimit në komunitet", duke lejuar qytetarë që të ndihmojnë policinë në veprimtaritë jo urgjente; adaptimi i masave vetëmbrojtëse, si dhe përdorimi i ndërmjetësimit për të zgjidhur konfliktet lokale.

Nasi, I.
« Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

d. Krijimi i partneriteteve me agjencitë shtetërore apo lokale për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në komunitet.

Policia mund të kërkojë bashkëpunimin me institucione publike apo të pushtetit vendor për zgjidhjen e problemeve që janë në juridiksionin e këtyre të fundit. Këto partneritete duhet të bazohen në shkëmbimin e informacionit me interes të përbashkët dhe në marrjen e angazhimeve për veprime konkrete për përmirësimin e situatës. Krijimi i këtyre partneriteteve është veçanërisht i nevojshëm në sektorin e infrastrukturës publike (rrugë, sinjalistika rrugore, përmirësim i ndriçimit, shërbimeve sociale, mjedisit, edukimit, etj.). Partneriteti me komunitetin mund dhe duhet të përdoret në faza të ndryshme. Përveç nxitjes së formave të pjesëmarrjes së komunitetit në veprimtari ndihmëse konkrete për sigurinë publike, të përmendura më sipër, në mënyrë të veçantë partneriteti me komunitetin mund të shërbejë për identifikimin e problemeve të sigurisë; priorizimin e reagimit të policisë; planifikimin e veprimeve të policisë apo edhe monitorimin dhe vlerësimin e punës së policisë.

Një nga praktikat më të përdorura është, p.sh., ajo e krijimit të bordeve të qytetarëve (në nivel zone policore ose komisarati), me qytetarë me influencë apo përfaqësues të bizneseve dhe organizmave të tjera shoqërore. Këto borde mund ta asistojnë policinë në identifikimin e problemeve të sigurisë; në priorizimin e tyre, duke marrë pjesë në planifikimin e veprimtarive policore, duke këshilluar policinë, por edhe në monitorimin e punës dhe veprimeve të policisë në shërbim të rritjes së përgjegjshmërisë të saj. Pra partnerët e mundshëm mund të jenë institucionale (institucione shtetërore apo lokale) dhe private; mund të jenë organizata (organizata joqeveritare, bizneset private apo media) apo individë (banorë, grupe banorësh dhe gazetarë).

e. Orientimi nga zgjidhja e problemeve.

Orientimi nga zgjidhja e problemeve është komponenti i dytë bazë i policimit në komunitet. Ai mund të përkufizohet si procesi i përfshirjes në ekzaminimin proaktiv dhe sistematik të problemeve të identifikuara të sigurisë, në një zonë të caktuar, me qëllim zhvillimin dhe vlerësimin e një reagimi/përgjigjeje efektive për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ky komponent bazohet në prezumimin që “*veprat penale dhe prishjet e rendit mund të reduktohen ndjeshëm në zona të vogla gjeografike, duke studiuar dhe kuptuar me kujdes karakteristikat e problemeve në ato zona dhe duke zbatuar pastaj burimet e përshtatshme*”.

Teoria e policimit të orientuar nga zgjidhja e problemit është e thjeshtë. Kushte të caktuara rrethana mund të krijojnë probleme të sigurisë, kushte këto, që përfshijnë karakteristika të individëve të përfshirë (autorit, viktimës dhe të tjerëve), mjedisit shoqëror në të cilin njerëzit ndërveprojnë, mjedisit fizik, si dhe mënyrat se si publiku përballlet me këto kushte. Një problem i krijuar në këto rrethana mund të gjenerojë në një ose disa incidente apo ngjarje. Nëse merremi me përmirësimin e kushteve rrethana, merremi me zgjidhjen e problemit dhe me eliminimin apo kufizimin e incidenteve apo ngjarjeve që burojnë prej tij: një bllok banesash të braktisura dhe pa ndriçim publik mund të gjenerojë akte vandalizmi; një rrugë e papërfunduar, pa sinjalistikën e nevojshme dhe me hyrje e dalje të paautorizuara për këmbësorët, mund të çojë në aksidente rrugore me pasoja të rënda. Ngjarjet që ndodhin si pasojë e këtyre mangësive janë simptomat e problemit.

Incidentet mund të vazhdojnë për aq kohë sa problemi që i gjeneron ato do të

vazhdojë të jetë i pranishëm. Në vend që t'i përgjigjemi krimit vetëm pasi ai ndodh, në thelbin e policimit në komunitet është veprimi proaktiv për të gjetur zgjidhje afatgjata mbi kushtet që favorizojnë shfaqjen e problemeve të sigurisë.

f. Komunikimi me publikun.

Komunikimi polici-publik mund të kategorizohet në:

- komunikim strategjik;
- komunikim rutinë apo të përditshëm;
- komunikim në raste krize.

Komunikimi i jashtëm *strategjik* lidhet ngushtësisht me vetë objektivat strategjike të organizatës dhe pjesë e tij janë fushatat ndërgjegjësuese, sensibilizuese, publiciteti, marrëdhëniet me medien, me synim nxitjen e bashkëpunimit dhe sigurimin e mbështetjes së publikut. Organizatat e policisë, në të gjithë botën, hartojnë dhe zbatojnë strategji të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Zakonisht, planifikimi strategjik në këtë fushë bëhet në një afat kohor njëvjeçar, por mund të jetë edhe deri në trevjeçar, duke lënë mundësinë e rishikimit në afate kohore më të shkurtra. Ndërkohë, për situatë specifike, strategjia e komunikimit mund të jetë në një afat më të shkurtër kohor, si pjesë e një fushate të caktuar.

Komunikimi i jashtëm i *përditshëm apo rutinë* konsiston në komunikimin e vazhdueshëm ndërmjet punonjësve të policisë dhe individëve të ndryshëm të komunitetit gjatë përbushjes së detyrave, patrullimeve të përditshme, ofrimit të shërbimeve etj. Ky komunikim është i një rëndësie të veçantë për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me publikun. Komunikimi i jashtëm *në raste krize*, është i lidhur ngushtësisht me një situatë të veçantë, jo të zakonitë, ku komunikimi është i nevojshëm për realizimin e një bashkëpunimi efikas, me synim garantimin e mbështetjes nga publiku për zgjidhjen e një situatë që rrezikon atë dhe mjedisin përreth tij. Nga ana tjetër, komunikimi me publikun është një fushë e gjerë, që përfshin marrëdhëniet me publikun, fushatat ndërgjegjësuese e të parandalimit të krimit, marrëdhëniet me medien, marketingun dhe reklamën, takime të përbashkëta me komunitetin, vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta, ofrimin e një shërbimi cilësor dhe etik përmes procedurave të mirëpërcaktuara dhe sa më të lehta par t'u arriret nga publiku, etj.

5. Vizioni për të ardhmen

Eksperiencia botërore tregon se policimi në komunitet nuk mundet të zbatohet me anë të një modifikimi të thjeshtë të politikave dhe strukturave ekzistuese. Ndryshime të thella duhet të mishërohen në të gjitha aspektet e një organizate policore, që nga misioni i saj, deri te politikat dhe praktikat e policimit, te procedurat e zbatimit, struktura dhe organizimi i forcave policore; proceset e menaxhimit strategjik, financiar, të burimeve njerëzore dhe së fundmi te kultura e përgjithshme e punës në organizatë. Eksperiencia botërore tregon gjithashtu, se futja e qëndrueshme e filozofisë së policimit në komunitet në një organizatë policore është një proces i gjatë dhe kompleks. Ai ka nevojë për një proces të mirëmenduar, që duhet të ndjekë disa faza:

- faza përgatitore e planifikimit,
- faza e zbatimit,
- faza e vlerësimit,
- faza e kolaudimit dhe zgjerimit.

Nasi, I.
« Policimi në komunitet – filozofi dhe formë e policimit të së ardhmes »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Secila nga këto fazat ka nevojë për kohën e vet dhe angazhimin serioz në nivel politik dhe teknik. Vitet e fundit, konstatohet me kënaqësi, se pas pilotimit të suksesshëm të disa elementëve kyç të policimit në komunitet, Policia e Shtetit ka përfunduar fazën përgatitore dhe po hyn në mënyrë graduale në fazën e zbatimit, duke vepruar në mënyrë të matur, por të qëndrueshme dhe me objektiva të qarta. Në këtë fazë, merr rëndësi thelbësore kuadri ligjor dhe strategjik i nevojshëm për sanksionimin e një koncepti të mirëmenduar dhe mirëartikulluar të policimit në komunitet. Dy vitet e fundit shënojnë një shndërrim tërësor të kuadrit ligjor dhe strategjik të Policisë së Shtetit Shqiptar, që krijojnë bindjen dhe sigurinë se rruga drejt një policimi të bazuar në policimin në komunitet është e pakthyeshme. I rëndësishëm është fakti që Policia e Shtetit, policimin në komunitet nuk e shikon si detyrë që mund të realizohet me fushata dhe si detyrë të një strukture të posaçme, por si detyrë e vazhdueshme dhe e të gjithë strukturave të policisë, nga qendra në bazë.

Ligji “Për Policinë e Shtetit” (Ligji Nr 108/2014), ka hedhur tashmë hapa të qarta dhe të sigurt në drejtim të ardhmërisë së policimit në komunitet. Ky ligj e vendos atë (policimin në komunitet) në themel të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, duke përcaktuar qartazi komponentët bazë të tij. Neni 80 i ligjit përcakton filozofinë e policimit në komunitet si bazë për menaxhimin strategjik dhe planifikimin e punës së Policisë së Shtetit, duke përcaktuar detyrimin për hartimin e strategjive vjetore për policimin në komunitet në nivel vendor. Po ky nen përcakton detyrimin për hartimin e këtyre strategjive në bashkëpunim edhe me institucione të tjera shtetërore, shoqërinë civile, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe në një proces konsultimi të institucionalizuar me komunitetin, duke e vënë theksin në parandalimin e veprave penale si objektiv themelor i punës së Policisë së Shtetit. I rëndësishëm në këtë moment është fakti i vlerësimit real të mendimeve dhe sugjerimeve që do të shprehin këta faktorë dhe, që duhet të përfshihen në strategjinë që do të hartojnë strukturat për policimin në komunitet. Formaliteti, indiferentizmi dhe mosmarrja në konsideratë janë shumë të dëmshme dhe që cenojnë e dëmtojnë punën dhe figurën e policisë në raport me ta.

Disa nene të tjera të këtij ligji (neni 76, neni 78, neni 79) sanksionojnë në nivel ligjor komponentin e dytë të policimit në komunitet, atë të partneritetit me komunitetin, shoqërinë civile dhe institucionet e tjera shtetërore dhe pushtetin vendor, me qëllim rritjen e sigurisë publike. Neni 5 dhe neni 77 përcaktojnë parimet e transparencës dhe informimit të publikut si parime të punës së Policisë së Shtetit.³

Në zbatim të këtij ligji është hartuar edhe strategjia (programi i Policisë së Shtetit). Strategjia e Rendit Publik (Programi i Policisë së Shtetit) 2015-2020, e mishëruar më konkretisht në programin dyvjeçar “Për policimin në komunitet të Policisë së Shtetit”, gjithashtu ka vënë në qendër të organizimit dhe funksionimit të policisë, filozofinë e policimit në komunitet, duke sanksionuar zhvillimin e mëtejshëm të filozofisë së policimit në komunitet, duke përfunduar vlerat e organizatës, duke përshtatur më mirë shërbimin me nevojat e komunitetit, duke aplikuar policimin proaktiv dhe duke përdorur forma e instrumente efikase bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore, shërbimet publike dhe subjekte të ndryshme të shoqërisë.

Kjo strategji, për herë të parë ka përcaktuar si moto të Policisë së Shtetit pikërisht atë që është në qendër të filozofisë së policimit në komunitet: “*Së bashku për një mjedis të sigurt dhe jetë cilësore në komunitet*”. E ka përcaktuar atë si filozofinë e organizatës,

³ Ligji i Policisë së Shtetit 108/2014 datë 31.7.2014, nenet 76, 78, 79.

duke njohur se: “Përmbushja e vizionit shtron nevojën e zbatimit të filozofisë së policimit në komunitet, duke vendosur standard për komunikimin, transparencën e llogaridhënien me punonjësit e policisë dhe qytetarët, duke krijuar partneritete midis grupeve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe forcimin e sigurisë publike”.

Duke u nisur nga përvoja e fituar si dhe në zbatim të kuadrit ligjor, Policia e Shtetit ka hartuar “Dokumentin e politikave të policimit në komunitet” dhe planin përkatës të veprimit, që pasqyron, në nivelin organizativ e procedural, disa nga masat për zbatimin e kuadrit strategjik. Ky plan strategjik i policimit në komunitet, përcakton modelin dhe rrugën që do të ndiqet për policimin në komunitet nga policia shqiptare për këtë periudhë kohore dhe ku dhe përcaktohet modeli që do të ndiqet:

- integrimi i filozofisë së policimit në komunitet në të gjithë komponentët e punës së Policisë së Shtetit;

- konsolidimi i partneritetit me komunitetin;

- përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative për qytetarin dhe biznesin.

Në bazë të këtyre prioriteteve, janë përcaktuar në dokument 10 objektiva, duke prekur të gjithë elementët e nevojshëm për sigurimin dhe thellimin e zbatimit të policimit në komunitet në policinë shqiptare. Në objektivin organizativ dhe funksional parashikohet:

a) Po t’i referohemi “Dokumentit strategjik 2015-2020 për policimin në komunitet” del e qartë se kjo strategji, kjo formë e policimit, do të jetë e suksesshme, vetëm kur të zbatohet nga të gjitha strukturat dhe jo të lihet si atribut dhe detyrë e një strukture të veçantë, sado e specializuar që të jetë ajo.

b) Rishpërndarja dhe riorganizimi i mënyrës së mbulimit të territorit duke ndërtuar institucione policore (komisariate, stacione dhe posta policie) në bazë të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor. Kjo do të bëjë të mundur shtimin dhe rritjen e kontaktit të policisë me komunitetin, ndërmjet shërbimeve patrulla të përgjithshme, policisë rrugore dhe punonjësve të strukturës të krimeve për atë zonë, me një përbërje lehtësisht të ndryshme sipas karakterit urban apo rural të zonës.

c) Riformatimi i funksionit të specialistit të policisë së zonës në funksionin e policit të

komunitetit, me organizimin e ri funksioni i tij është shërbim i policimit në komunitet me detyra specifike për përmbushjen e dy funksioneve kryesore bazë:

- Vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve të drejtpërdrejta me qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore në zonën që mbulon.

- Ngritjen e një strukturë të inteligjencës, që siguron informacion, me qëllim parandalimin e sjelljeve antishoqërore dhe veprave penale, dhe adresimin e tij pranë strukturave përgjegjëse policore. Ky riformatim konceptual do të shoqërohet edhe me shtim të numrit të punonjësve të policimit në komunitet.

d) Krijimi i strukturave të vogla, përgjegjëse për zhvillimin, nxitjen dhe monitorimin e zbatimit të praktikave të policimit në komunitet në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe drejtoritë vendore të Policisë.

6. Përfundime

Në mbyllje, nisur nga sa u tha më lartë, mund të nxjerrim si përfundim se disa nga faktorët që e favorizojnë policimin në komunitet në vendin tonë janë:

- Ekziston një bazë e rëndësishme ligjore, si dhe janë hartuar strategji që adresojnë

Nasi, I.
« Policimi në
komunitet –
filozofi dhe
formë
e policimit të së
ardhmes »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

çështjet e sigurisë në komunitet, në nivel qendror dhe vendor.

- Është krijuar një përvojë nga strukturat e policisë në nivel qendror dhe vendor për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive vjetore të policimit në qark për sigurinë në komunitet që nga viti 2009.

- Përvoja e fituar nga bashkëpunimi fillimisht me UNDP/SSSR dhe me pas SACP në aplikimin e disa praktikave bashkëkohore të policimit në komunitet.

- Mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë, qeveria suedeze, OSBE, PAMECA IV, programi ICITAP dhe partnerë vendorë në fushën e policimit në komunitet.

- Ekzistenca e eksperiencës dhe ekspertizës së fituar falë zbatimit të projekteve të zbatuara deri tani, si dhe kryerja e trajnimeve dhe vizitave studimore në vendet e BE në lidhje me policimin në komunitet.⁴

Ndërsa disa nga faktorët që përbëjnë risk janë si në vijim:

- moskuptimi i drejtë i policimi në komunitet është një atribut, detyrë e të gjithë strukturave të Policisë së Shtetit nga qendra në bazë dhe jo detyrë e një strukture të veçantë;

- rezistenca me qasje konservatore që një pjesë e personelit të policisë mund t'i bëjë kësaj mënyre policimi;

- mungesa e vullnetit të duhur nga ana e aktorëve të tjerë për të bashkëpunuar për implementimin e kësaj strategjie;

- mungesa e detyrimit ligjor për disa aktorë (pushteti vendor) për ta mbështet policimin në komunitet me një fond financiar të veçantë në buxhetin e tyre vjetor, me këtë fond të hapeshin zyrat për punonjësit e policisë në çdo njësi administrative.

- paqëndrueshmëria në detyrë e personelit policor;

- mbështetje jo e plotë financiare për realizmin e këtyre prioriteteve;

- shkalla e ulët e organizimit të qytetarëve në grupe të përbashkëta.

⁴ Policia e Shtetit, *Dokumenti Strategjik për Policimin në Komunitet, 2015-2020.*

Bibliografi

1. Ligji Nr108/2014 "Për Policinë e Shtetit", nenet 76,77,78,79,80
2. Dokumenti Policimit "Për Sigurinë në Komunitet" 2015-2017.
3. *Manuali Për Policimin në Komunitet* (material teorikopraktik në ndihmë të drejtuesve të policisë)

Nasi, I.
« Policimi në
komunitet –
filozofi dhe
formë
e policimit të së
ardhmes »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Hetimi i krimeve kundër jetës



■ **Msc Tonin VOCAJ**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Problemi i mbrojtjes së jetës së njeriut nga vrasjet, paraqet rëndësi të madhe historike, politike-shoqërore, juridike e praktike. Krimet kundër jetës janë krime të rënda që prekin të drejtën për të jetuar, si e drejta më themelore e njeriut, e mbrojtur në Deklaratën Universale të Asamblesë së Përgjithshme të OKB (1948), me Konventën Evropiane (1950) dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 21). Nga analizat statistikore rezultojnë se krimet kundër jetës kanë qenë fenomen shqetësues për shoqërinë shqiptare që nga fillimi i shtetit shqiptar. Numri i madh i vrasjeve është i lidhur edhe me prezencën e lartë të gjakmarjes në shumë territore të vendit, në mungesën e strukturave të rendit publik dhe të pushtetit gjyqësor. Gjithashtu një shkak i rëndësishëm i konflikteve e për pasojë edhe i vrasjeve kanë qenë prezencën e madhe e armëve, lëvizjet e mëdha demografike të popullsisë, si dhe mos konsolidimi i marrëdhënieve të pronësisë. Por, duhet theksuar se shkaku kryesor i vrasjeve kriminale ka qenë vetëgjyqësia në zgjidhjen e konflikteve dhe problemeve. Për një hetim sa më të plotë, objektiv dhe profesional të krimeve kundër jetës, duhet të njihet mirë mekanizmi i kryerjes së këtyre krimeve: krijimi i kushteve dhe mjeteve të vrasjes, ekzistenca e konfliktit, ekzistenca e motivit dhe qëllimit, sigurimi i mjeteve të nevojshme për kryerjen e krimit, eliminimi i pengesave, gjurmët dhe provat që gjenden në vendin e ngjarjes, evidentimi dhe pyetja e dëshmitarëve, e familjareve të viktimave, etj. Ndër objektivat kryesore të hetimit të krimeve kundër jetës, parësore duhet të jenë ato të vërtetimit të kryerjes së veprës penale nga autori, si dhe përcaktimi i motivit dhe qëllimit të kryerjes së veprës. Elementët e anës subjektive janë të rëndësishëm për të përcaktuar dispozitën konkrete, por edhe shkallën e fajit dhe të përgjegjësisë së autorit të veprës penale. Hetimet e krimeve kundër jetës janë komplekse dhe një rëndësi të dorës së parë në këto hetime, marrin aplikimi i teknikave kriminalistike, kryerja e ekspertimeve të nevojshme si dhe aplikimi i metodave bashkëkohore të analizës së të gjithë elementeve të hetimit për të nxjerrë konkluzione objektive dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të këtyre krimeve të rënda.

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Fjalëkyçe:

krime kundër jetës, kushte dhe mjete të vrasjes, tentativa për vrasje, teknikat kriminalistike, metodat analitike.

Hyrje

Në një shoqëri demokratike vihet në plan të parë mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e posaçërisht e të drejtës për të jetuar, sepse jeta është e pakrahasueshme dhe e pazëvendësueshme me asgjë tjetër. Për këtë arsye Kodi Penal siguron mbrojtje juridiko-penale të së drejtës së njeriut për të jetuar, me anën e parashikimit të disa dispozitave të llojeve të ndryshme të krimit të vrasjes dhe të dënimeve penale për secilën prej tyre. Me gjithë këtë mbrojtje të veçantë, realiteti shqiptar në këtë drejtim është i renduar me krime kundër jetës, pasi numri i vrasjeve e sidomos ato për motive hakmarrjeje është i madh, megjithëse trashëgimia kulturore e shqiptarëve është e pasur me vlera të padiskutueshme civilizimi e humanizmi. Duhet evidencuar pozitivisht fakti, se trendi i krimeve kundër jetës, pas vitit 1997, ka tendencë të qartë uljeje. Viti 2006 ka shënuar numrin më të ulët të vrasjeve, me 87 vrasje dhe 2009, me 89 vrasje. Viti 2015 ka vazhduar me një trend edhe me pozitiv, pasi ne kete vit janë evidencuar 59 vrasje, dhe padyshim është viti më me pak vrasje në 25 vitet e fundit.¹

Nisur nga sa më sipër hetimi i krimeve kundër jetës, zbulimi i autorëve, dokumentimi i plotë ligjor i veprimtarisë së tyre kriminale dhe vënja e tyre para drejtësisë, mbetet një detyrë e mjaft e rëndësishme e organeve të zbatimit të ligjit dhe në mënyrë të veçantë të organit të Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore. Hetimi i krimeve kundër jetës, është detyrë shumë komplekse kërkimore, që i besohet oficerit të Policisë Gjyqësore. Policia Gjyqësore, që heton krimet kundër jetës, duhet ta kryejë këtë detyrë duke respektuar të gjitha detyrimet dhe kufizimet ligjore të parashikuara në legjislacionin procedural penal si dhe duke u udhëhequr nga parimi i objektivitetit në hetime. Oficerët e Policisë Gjyqësore duhet të kryejnë hetime profesionale dhe të aplikojnë të gjitha procedurat dhe teknikat hetimore, të shfrytëzojnë teknikat kriminalistike, të aplikojnë me objektivitet analizën e fakteve dhe provave deri në arritjen e konkluzionit përfundimtar. Përcaktimi i drejtë i motivit dhe qëllimit të një vrasjeje është një ndihmë e rëndësishme në rezultatin e hetimeve dhe në zbulimin e vënien para drejtësisë të autorëve të këtyre krimeve të rënda.

¹ Analiza vjetore e Policisë së Shtetit.

1. Vështrim i shkurtër juridiko-penal i krimeve kundër jetës

Me vepra penale kundër jetës, sipas të drejtës penale të Republikës së Shqipërisë, kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën e personit, mbrojtur kjo, posaçërisht nga legjislacioni penal. Kodi ynë penal i klasifikon krimet kundër jetës, në: “krime kundër jetës të kryera me dashje” dhe “krime kundër jetës të shkaktuara nga pakujdesia”.² E rëndësishme është, që të kemi një kuptim të drejtë juridik të vrasjes si krimi më i rëndë kundër personit. Sipas teorisë sonë të së drejtës penale, me vrasje kuptohet ajo vepër (veprim ose mosveprim) i kundërligjshëm, me anë të së cilit i hiqet jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Krimet kundër jetës të kryera me dashje parashikohen në seksionin e parë të kreut të dytë të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Duhet evidentuar fakti se ndryshimet e bëra në Kodin Penal, me ligjin nr 144 të vitit 2013, kanë bërë një sërë rregullimesh në dispozita të veçanta të këtij seksioni, por edhe në kuadrin e përgjithshëm kanë rritur sanksionin penal për shumë dispozita të krimeve kundër jetës të kryera me dashje.

Në Kodin Penal parashikohet krimi i vrasjes me dashje, ose siç njihet në teorinë tonë të së drejtës penale, si “vrasja e thjeshtë”, edhe për faktin se kjo dispozitë nuk ka asnjë rrethanë cilësuese, por as rrethana lehtësuese.³ Nga ana objektive kjo dispozitë karakterizohet nga veprime ose mosveprime të kundërligjshme të kryera në rrethana të veçanta si: gjaknxehtësi, zënie, rrahje apo grindje e sipër ndërmjet autorit të krimit dhe viktimës. Në nenin 77 të Kodit Penal, parashikohet vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër, pra vrasja me dashje që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër. Në nenin 78, parashikohet vrasja me paramendim, pra vrasja me dashje me paramendim dhe vrasja me dashje e kryer për interes apo hakmarrje. Nga ana subjektive vrasja me paramendim kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, të paramenduar, të nxitur nga motive të dobëta si: interesi, hakmarrja, etj.⁴

Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal, me ligjin nr. 144/2013, është shtuar neni 78/a: “vrasja për gjakmarrje”; me vrasje për gjakmarrje që është kryer për të marrë gjakun e babait, të vëllait, të djalit, të xhaxhait, të nipit nga babait. Vrasjet për gjakmarrje cilësohen ato vrasje të kryera për të marrë gjakun e babait, të vëllait, të djalit, të xhaxhait, të nipit nga babai. Këto vrasje kryhen duke ju referuar rregullave kanunore sipas parimit “gjak për gjak”. Në nenin 79, parashikohet vrasja në rrethana të tjera cilësuese, vrasja me dashje e kryer: ndaj të miturit; ndaj personit me mangësi fizike apo psikike, të sëmurë rëndë apo shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit apo të palëve të tjera ndërgjyqëse; më shumë se një herë; kundër dy ose më shumë personave; në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës; në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave. Me ligjin nr. 144/2013 është shtuar neni 79/a: “vrasja e funksionarëve publikë”. Në këtë dispozitë përfshihet vrasja e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo funksionarëve të tjerë publikë. Vrasja duhet të jetë kryer gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

² Elezi, Ismet. *E Drejta Penale (Pjesa e Posaçme)*. Tiranë: Botimet Kumi, 2014. (f. 36)

³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 76.

⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

e viktimës janë të dukshme ose të njohura. Po me ligjin nr. 144/2013, është shtuar neni 79/b: “vrasja e punonjësve të policisë”. Edhe në këtë dispozitë vrasja duhet të jetë kryer gjatë detyrës ose për shkak të saj dhe cilësitë e viktimës, duhet të jenë të dukshme ose të njohura. Në nenin 79/c parashikohet vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare. Në nenin 81 parashikohet vrasja e foshnjës e kryer me dashje nga nëna menjëherë pas lindjes. Në nenet 82 dhe 83 parashikohen vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike dhe vrasja në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Në seksionin e dytë të kreut të dytë të Kodit Penal, parashikohen krimet kundër jetës të kryera nga pakujdesia. Vrasja nga pakujdesia, parashikohet në nenin 85 të Kodit Penal. Nga ana subjektive, kjo vepër penale kryhet në formën e vetëbesimit të tepruar ose me mendjelehtësi, por edhe në formën e vetëbesimit të tepruar. Po kështu kjo vepër mund të kryhet edhe në formën e neglizhencës.

2. Marrja dijani për kryerjen e krimeve kundër jetës

Në Kodin e Procedurës Penale janë përcaktuar funksionet e Policisë Gjyqësore. Në nenin 30 përcaktohet se: “Policia Gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijani për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”.⁵ Është e rëndësishme të kuptohet se Policia Gjyqësore e ka për detyrë që të kundërveprojë me iniciativë kundër çdo vepre penale dhe për ta bërë këtë, ka në dispozicion struktura të kualifikuara për të zbuluar veprimtarinë kriminale, të fshehtë apo të hapur, ka personel të mjaftueshëm, të përgatitur dhe të gatshëm për t’u gjendur menjëherë në çdo vendngjarje ku ka ndodhur një vepër penale, ka mjetet e nevojshme për të ndjekur dhe kapur autorët, për të gjetur dhe fiksuar gjurmët e krimit dhe provat materiale.

Zakonisht, njoftimin për krime kundër jetës e merr shërbimi i sallave operative. Njoftimi bëhet nga qytetarët ose subjektet tjera, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit, si telefon, e-mail, mesazh, kallëzim i drejtpërdrejtë, etj. Në disa raste krimet kundër jetës mund të konstatohen edhe drejtpërdrejtë nga oficerët e patrullave të përgjithshme të policisë ose punonjës të tjerë të Policisë së Shtetit. Pavarësisht nga rrethanat e marrjes dijani, policia është e detyruar të kryejë verifikime të menjëhershme të vërtetësisë së informacionit të marrë për kryerjen e një krimi kundër jetës. Në vendin e ngjarjes duhet të dërgohen patrulla të përgjithshme të policisë, për të siguruar vendin e ngjarjes e për të ndihmuar të plagosurit, për të ndërprerë pasojat e tjera që mund të vijnë nga vepra penale. Në vendin e ngjarjes, patrulla e përgjithshme duhet të veprojë për arrestimin e personave të dyshuar, kufizimin dhe përcaktimin e kufijve të vendit të ngjarjes, identifikimin e personave të pranishëm në vendin e ngjarjes dhe të rolit të tyre në këtë ngjarje, largimin e dëshmitarëve dhe personave të tjerë jashtë perimetrit të sigurisë, duke marrë masa për mbrojtjen e gjurmëve dhe të provave materiale nga dëmtimi, etj.

Kryerja e këtyre veprimeve nga oficerët e patrullës së përgjithshme të policisë apo nga oficerët të tjerë të policisë, japin mundësinë që të sqarohet informacioni i marrë në sallën operative si dhe të përcaktohen paraprakisht përmasat e veprës penale, pasojat e ardhura dhe lloji i veprës penale. Në disa raste mund të merren të dhëna edhe për

⁵ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

autorësinë e veprës apo mund të shpien direkt në arrestimin e autorëve të këtyre krimeve të rënda. Në vendin e ngjarjes, oficerët e patrullës së përgjithshme marrin masat e mësipërme dhe informojnë sallën operative për verifikimet e kryera si dhe për veprimet e ndërmarra prej tyre. Oficerët njoftojnë sallën operative edhe në rastet kur ballafaqohemi me informacione e telefonata të pavërteta apo, për situata që kërkojnë ndërhyrjen e policisë, që nuk rezultojnë krime kundër jetës, por vepra të tjera penale më pak të rëndësishme apo ngjarje të ndryshme aksidentale. Në rastet kur verifikohet ekzistenca e krimeve kundër jetës, salla operative është e detyruar që të marrë masat e nevojshme për dërgimin në vendin e ngjarjes të një numri të përshtatshëm të oficerëve të policisë si dhe paralelisht, të kryejë njoftimin e dërgimin në vendin e krimit, të shërbimeve të ndihmës së parë mjekësore, të shërbimit zjarrfikës apo të shërbimeve të tjera të specializuara. Dërgimi në vendin e ngjarjes i këtyre shërbimeve, bëhet në raport me përmasat dhe natyrën e ngjarjes kriminale. Salla operative është përgjegjëse për formimin dhe dërgimin sa më të shpejtë në vendin e ngjarjes të grupit hetimor, të përbërë nga oficerë të Policisë Gjyqësore të strukturave kundër krimeve të rënda, ekspert kriminalist, ekspert mjekoligjor apo ekspert të tjerë nëse është e nevojshme. Paralelisht me këto veprime, njoftohet për ngjarjen prokurori i rrethit Gjyqësor ku ka ndodhur krimi.

Përveç sa më sipër, salla operative edhe pas vajtjes në vend të grupit hetimor vazhdon të ndjekë ngjarjen dhe merr masa për:

- informimin e të gjitha strukturave policore në detyrë të karakteristikave të autorit të krimit dhe ndjek dinamikën për identifikimin, lokalizimin dhe kapjen e tij;
- njofton në mënyrë të vazhdueshme strukturat drejtuese të policisë si dhe organizon punën për dërgimin në vendin e ngjarjes të personelit dhe të mjeteve të nevojshme për grupin hetimor.
- informon drejtuesin e grupit hetimor për të gjitha të dhënat e grumbulluara nëpërmjet telefonatave apo burimeve të tjera të informacionit që ka salla operative; po kështu, informon grupin hetimor edhe për informacionet e përfituara nga shërbimet e tjera të policisë, të përfshira në ndjekjen dhe kapjen e të dyshuarve.
- informon strukturat e tjera policore (jashtë juridiksionit) për ngjarjen, për autorët e dyshuar dhe karakteristikat e tyre, të mjeteve që përdorin, të rrezikshmërisë që paraqesin dhe kërkon organizimin e menjëhershëm të postbloqeve të sigurta rrugore, veçanërisht në drejtimin e lëvizjes së autorëve të dyshuar të këtyre krimeve të rënda.

Në vendngjarjet me viktima të mbetura në vendin e ngjarjes, njoftohen agjencitë e kontraktura për transportin e kufomave për në ambientet e mjekësisë ligjore, pas vendimit të marrë për këtë qëllim nga oficeri i Policisë Gjyqësore që drejton hetimin në vendin e ngjarjes.

Në rastet e vrasjeve të ndodhura në vende publike, ku ka edhe interesim të mediave, është e nevojshme që në vend, të shkojë edhe zëdhënësi i strukturës policore, i cili duhet të japë informacion për mediet pas konsultimit me drejtuesin e grupit hetimor. Marrja dijeni për krimin dhe masat e shpejta për verifikimin e informacioneve, janë të rëndësishme për organizimin e veprimeve të shpejta hetimore dhe operative që do të shpien në sqarimin e ngjarjes dhe në kryerjen e hetimeve cilësore e rezultateve. Por duhet theksuar, se megjithëse këto veprime janë të rëndësishme, ato duhen shoqëruar me masa të tjera organizative, në caktimin e personelit kompetent dhe të trajnuar në kryerjen e detyrave në vendin e ngjarjes, caktimin e ekspertëve të nevojshëm dhe respektimin e procedurave standarde të punës në gjetjen, fiksimin dhe marrjen e provave.

3. Arrestimi i të dyshuarve

Patrulla e përgjithshme e policisë apo çdo punonjës tjetër policie që arrin i pari në vendin e ngjarjes, ka detyrimin që të arrestojë autorin e dyshuar të krimit kur ai kapet në flagrancë: kur kapet në kryerje e sipër të veprës penale; menjëherë pas kryerjes së veprës penale; kur kapet me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer krimin. Është e rëndësishme që autori i krimit të arrestohet duke treguar kujdesin maksimal, që të mos dëmtohen gjurmët që gjenden në trupin e tij. Atij duhet të mos i lejohej që t'i pastrojë duart dhe t'i largojë njollat e gjurmët. Autori i arrestuar duhet të futet në automjetet e policisë ose në ambiente të veçanta, nën vëzhgimin e oficerëve të policisë, duke treguar kujdes që të mos i dëmtojë apo asgjësojë mikrogjurmët që gjenden në trupin apo në veshjen e tij. Në të tilla raste është i rëndësishëm përdorimi i mjeteve të posaçme, si shtresat prej najloni, PVC-je etj. Këto veprime duhen dokumentuar nga oficerët e policisë që kryejnë arrestimin në flagrancë. Në ambientet e policisë shkencore, me të arrestuarin në flagrancë mund të vazhdojnë veprimet hetimore të përpunimit të mëtejshëm kriminalistik të gjurmëve dhe provave që gjenden në trupin apo në rrobat e tij. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, i arrestuari në flagrancë pyetet me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në lidhje me rrethanat e ngjarjes. Në shumë raste të krimeve kundër jetës, autorët largohen nga vendi i ngjarjes menjëherë pas kryerjes së krimit dhe oficerët e patrullës së përgjithshme që arrijnë të parët në vendin e ngjarjes, kanë detyrimin që të mbledhin të dhëna që do të shpjen në identifikimin e tyre apo të përfitojnë të dhëna nga dëshmitarët apo persona të tjerë, mbi karakteristikat fizike të tyre, veshjet, mjetet në përdorim dhe çdo të dhënë tjetër që mund të mundësojë identifikimin dhe kapjen e arrestimin e tyre. Veprimet e shpejta të patrullës së përgjithshme të policisë si dhe koordinimi me shërbimet e tjera policore nën drejtimin e sallave operative, mund të japin rezultate konkrete për identifikimin dhe arrestimin në flagrancë të së dyshuarve.

Transmetimi i shpejtë i informacionit si dhe angazhimi i forcave të nevojshme policore në ndjekjen e të dyshuarit, janë çelësi i suksesit për arrestimin e autorëve të këtyre krimeve të rënda. Kërkimi dhe arrestimi i të dyshuarve është një operacion kompleks, i cili përbën tërësinë e masave dhe veprimeve operative të lidhura e të sinkronizuara midis tyre, siç janë: kontrolli i terrenit ("krehja"), organizimi i shpejtë i postbloqeve të sigurta rrugore, organizimi i pritave dhe grackave të ndryshme, kontrolli i automjeteve dhe personave të dyshimtë, koordinimi i veprimeve me drejtoritë e policive fqinje, me struktura të policisë kufitare, etj. Nisur nga rëndësia dhe përmasat e ngjarjes varen edhe masat që do të merren dhe numri i punonjësve të policisë që do përfshihen si dhe cilat do jenë zonat dhe mjediset që do kontrollohen, etj. Është e rëndësishme, që në këtë fazë të ketë një vlerësim objektiv të çdo informacioni për drejtimin e largimit të autorit të dyshuar, për mjetet e transportit që përdor, targat, tipat dhe për ngjyrën e tyre. Po kështu, është mjaft e rëndësishme që të verifikohen lidhjet familjare, shoqërore e kriminale të autorit të dyshuar me qëllim organizimin e shërbimeve të shpejta policore për mbajtjen në kontroll të këtyre personave dhe ambienteve. Gjetja e numrave të telefonit celular të së dyshuarit dhe të lidhjeve të tij kriminale dhe vënia e shpejtë e tyre në përgjim procedural, është një veprim hetimor në drejtimin e duhur, jo vetëm për kapjen dhe arrestimin e autorit të dyshuar, por edhe për dokumentimin e plotë ligjor të krimit dhe të gjetjes së mjeteve të kryerjes së veprës penale. Në rastet kur autorët e

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

dyshuar janë të armatosur dhe paraqesin rrezikshmëri për policinë dhe publikun është e rëndësishme që në operacionet për kapjen e tyre, të angazhohen struktura të ndërhyrjes së shpejtë apo struktura të forcave speciale.

4. Sigurimi dhe ruajtja e vendit të ngjarjes

Baza ligjore që ngarkon punonjësit e policisë për të siguruar vendin e ngjarjes është ligji procedural penal, ku është parashikuar se:

“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve, të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë”.⁶

Zbulimi i veprës penale varet nga mbledhja e suksesshme e provave në lidhje me atë vepër penale të kryer. Oficeri i parë i policisë që arrin në vendin e ngjarjes, luan një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen dhe mbledhjen e provave materiale d.m.th. të “dëshmitarëve të heshtur (“memeç”)”. Është shumë e rëndësishme që oficeri i parë i policisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen nën kontroll dhe mbrojtjen e vendit të kryerjes së veprës penale dhe të vendeve të tjera ku mund të gjenden provat materiale. Prishja e paqëllimtë e integritetit të vendit të ngjarjes nga ana e punonjësve kureshtarë të policisë dhe mbikëqyrësve, paraqet një problem të madh. Në vendin e ngjarjes, në shumë raste gjenden prova të cilat çojnë në arrestimin e të dyshuarve. Por për fat të keq, në disa raste këto prova që mund të kenë vlerë shkatërrohen ose bëhen të padobishme për shkak të veprimeve të pakujdesshme në vendin e ngjarjes. Oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje ose që gjendet aty, duhet të sigurojë vendin e ngjarjes deri sa të arrijë grupi hetimor. Pas përfundimit të këqyrjes së vendngjarjes, duhet të ndërmerren masa për të rivendosur gjendjen e mëparshme. Veprimet e oficerit të policisë për sigurimin e vendit të ngjarjes, janë vendimtare për të ruajtur, siguruar dhe mbledhur të gjitha provat, të cilat mund të shkatërrohen nëse nuk sigurohen siç duhet. Oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje duhet ta sigurojë atë, t’i japë ndihmë çdo personi të lënduar, të sigurohet që provat nuk janë prishur, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të ngjarjes dhe nëse ka mundësi, të vihet në ndjekje të autorit. Një prej aspekteve më të rëndësishme të sigurimit të vendit të ngjarjes është ruajtja e vendit të ngjarjes me dëmtim minimal të provave materiale. Reagimi i parë ndaj një rasti duhet të jetë i shpejtë dhe me përgjegjësi.

Oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje, duhet t’i afrohet me kujdes vendit të ngjarjes dhe të identifikojë dhe evidencojë të gjithë personat dhe automjetet në afërsi, ose të atyre që nga vëzhgimi i tij ka konstatuar se janë larguar, apo kanë tentuar të largohen. Në rastet kur ka një kërcënim apo rrezik real për jetën dhe shëndetin e njerëzve, oficerët e policisë, kryesisht duhet të ndërmarrin të gjitha masat për të shmangur kërcënimet dhe rreziqet për jetën e tyre dhe të së tjerëve, pasurive, si dhe të pengojnë ardhjen e mëtejshme të pasojave të ngjarjes. Punonjësi i policisë në vendngjarje duhet t’u sigurojë ndihmën e nevojshme mjekësore të dëmtuarve/plagosurve dhe nëse është e nevojshme, të marrë masa për transportimin e tyre në qendrat e specializuara mjekësore. Gjithashtu, punonjësi i policisë që shkon i pari në vendin e ngjarjes, duhet të përcaktojë rrugën se nga do të kalojnë personat që do të shkojnë tek të plagosurit për t’i dhënë

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

⁶ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 300.

ndihmë mjekësore, në mënyrë që provat të mos prishen.

Kur në një vendngjarje gjendet një kufomë, policia duhet të njoftojë mjekun ligjor për të ekzaminuar trupin dhe për të përcaktuar shkakun e vdekjes. Para ekzaminimit, është e nevojshme të shënohet pozicioni i trupit, duke përdorur mjetet e duhura (shkumës, laps, tullë, ngjyra, pluhur, ngjitës, etj.). Trupi nuk do të lëvizet, derisa të arrijë mjeku ligjor dhe të kryejë ekzaminimin. Oficeri i policisë që shkon i pari në vendin e ngjarjes, duhet të informojë drejtuesin e grupit hetimor, në lidhje me ngjarjen dhe të dhënat e disponueshme që identifikojnë viktimën dhe të dyshuarin. Gjithashtu, oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje ka për detyrë t'i raportojë prokurorit/oficerit të policisë gjyqësore në lidhje me ngjarjen e ndodhur, si dhe për: çdo masë të marrë, çdo ndryshim të vendit të ngjarjes, të gjitha veprimet e kryera, dëshmitarët e evidentuar dhe nëse është prekur apo lëvizur nga vendi ndonjë send, apo nëse kanë qenë të detyruar për të hyrë në territorin e vendit të ngjarjes. Për këto të dhëna punonjësi i policisë përgatit edhe një informacion me shkrim. Diametri i vendit të ngjarjes që duhet të sigurohet, varet nga karakteri i ngjarjes, vendndodhja e ngjarjes, lloji i veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale, llojet e gjurmëve dhe mjeteve në vendin e ngjarjes kriminale, etj. Vendi i ngjarjes duhet të sigurohet sa më parë. Në rast të dyshimit, në kuptimin e hapësirës që duhet të sigurohet, duhet të sigurohet një hapësirë më e gjerë.

Vendi i ngjarjes duhet të kufizohet në mënyrë të dukshme, me shirita me mbishkrimin “skenë krimi”; “stop policia”. Në raste të veçanta dhe në varësi të terrenit, mund të përdoren edhe mjete rrethore për kufizimin e vendit të ngjarjes. Kur kemi të bëjmë me vendngjarje me diametër të gjerë, oficeri i policisë mund të aktivizojë për sigurimin e vendit të ngjarjes edhe qytetarë të besuar dhe të identifikuar prej tij. Duhet të mbahet në qendër të vëmendjes fakti se ekzistojnë faktorë të ndryshëm që mund të dëmtojnë vendin e ngjarjes dhe gjurmët e provat në vendin e ngjarjes. Faktorë të tillë si koha, të afërmit apo miqtë e viktimës, të dyshuarit apo dëshmitarët e vendit të ngjarjes, kureshtarët, punonjësit e policisë të pakujdesshëm dhe pa eksperiencë, drejtuesit e policisë që futen në vendin e ngjarjes, duhen menaxhuar me kujdes nga oficeri i policisë në vendin e ngjarjes, por edhe nga grupi hetimor që kryen këqyrjen dhe gjen e sekuestron provat. Detyra më e vështirë për oficerin e parë është që të ruajë vendin e ngjarjes nga oficerët e tjerë dhe punonjësit e shërbimeve të emergjencës, të cilët vijnë në vendin e ngjarjes. Natyrisht, disa njerëz duhet të hyjnë në vendin e ngjarjes dhe oficeri i parë që e ruan këtë vend duhet t'i identifikojë dhe të regjistrojë të gjithë personat që futen në vendin e ngjarjes.

4.1 Përcaktimi i madhësisë së hapësirës së vendit të ngjarjes

Kufiri ose rrethi i sigurisë, është kufi i cili rrethon provat e mundshme materiale që kanë të bëjnë me një vepër të kryer penale. Përcaktimi dhe kontrolli i kufijve ose rrethëve të sigurisë të vendit të ngjarjes, mundësojnë ruajtjen dhe sigurimin e vendit (vendeve) të ngjarjes. Vendosja e kufijve paraqet një aspekt shumë të rëndësishëm të kontrollit dhe paprekshmërisë së objekteve dhe materialeve që mund të shërbejnë si prova. Numri i vendeve të ngjarjes dhe kufijtë e tyre varen nga vendi (vendet) ku ndodhen provat dhe lloji i veprës penale. Kufijtë duhet të vendosen përtej shtrirjes fillestare të vendit të ngjarjes, sepse kufijtë mund të ngushtohen në rast nevojë, por nuk mund të zgjerohen lehtë. Punonjësi i parë i policisë në vendin e ngjarjes, duhet të bëjë vlerësimin fillestar për të vendosur dhe kontrolluar vendin (vendet) e ngjarjes dhe kufijtë e tyre. Ai/ajo mund të vendosë kufijtë në formë të dy rrethëve. Rrethi i brendshëm

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

do të ishte i rezervuar për grupin hetimor dhe veçanërisht për ekspertin kriminalist. Ai/ ajo mund të përcaktojë një korridor hyrjeje që të çon te viktima, të cilin duhet ta shfrytëzojnë të gjithë personat që domosdoshmërisht futen në vendin e ngjarjes.

Oficeri i policisë që arrin i pari në vendin e ngjarjes duhet të përcaktojë kufijtë e vendit të ngjarjes, duke filluar prej pikës qendrore dhe duke u zgjeruar nga jashtë, për të përfshirë:

- vendin ku është kryer vepra penale;
- vendet dhe rrugët e mundshme të hyrjes dhe daljes të së dyshuarve dhe dëshmitarëve;
- vendet nga ku viktima ose provat janë lëvizur, (kushtojini vëmendje gjurmëve me rastin e vlerësimit të vendit të ngjarjes).

Vendosja pengesat fizike (litarët, konet, shiritat për sigurimin e vendit të ngjarjes, automjetet që keni në përdorim, personelin dhe pajisjet tjera), ose përdorni kufijtë ekzistues (dyert, muret, portat, etj.) është një veprim i rëndësishëm taktik i oficerëve të policisë që sigurojnë vendin e ngjarjes. Po kështu, dokumentimi – hyrje-daljet e personave në vendin e ngjarjes pasi të keni vendosur rrathët e sigurisë, kontrolli i lëvizjes së personelit dhe kafshëve që hyjnë dhe largohen nga vendi i ngjarjes, – për të ruajtur paprekshmërinë e vendit të ngjarjes duhet kryer më shumë kujdes dhe vëmendje nga punonjësit e policisë. Punonjësit e policisë në vendin e ngjarjes duhet të ndërmarrin masa efikase për të ruajtur dhe mbrojtur provat e paqëndrueshme dhe të ndjeshme, të cilat mund të humbin ose të rrezikohen (i mbron nga shiu, bora, era dhe nga shkelja me këmbë, automjet apo lagia nga pajisjet e shuarjes së zjarrit).

4.2 Procedurat e sigurisë dhe mbrojtja e jetës

Detyrat parësore të punonjësve të policisë, të cilët mbërrijnë të parët në vendin e ngjarjes dhe ndërhyjnë ndaj kryerjes së veprës penale, janë shpëtimi i jetës së njerëzve dhe vënia nën kontroll të së dyshuarve dhe dëshmitarëve. Vënia nën kontroll të kërcënimeve fizike që mund të ekzistojnë, do të krijojë siguri për punonjësit e policisë dhe personat e tjerë të pranishëm. Pas kësaj, duke zhvendosur paksa vëmendjen, punonjësit e policisë në vendin e ngjarjes, duhet të ndërmarrin masat për të ruajtur integritetin e kufijve fizikë të vendit të ngjarjes. Siguria fizike e punonjësve të policisë dhe e individëve të tjerë në vendin e ngjarjes dhe rreth tij, janë përparësitë e para të punonjësit të policisë i cili ndërhyrë i pari. Punonjësi i policisë, i cili arrin i pari në vendin e ngjarjes, duhet menjëherë të identifikojë dhe të vërë nën kontroll situatën dhe personat e rrezikshëm, kur ata janë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Punonjësi i parë i policisë në vendin e ngjarjes duhet që të sigurohet se nuk ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për punonjësit e tjerë të policisë dhe duhet që të kontrollojnë zonën për pamjet, zërat apo erërat, të cilat mund të paraqesin rrezik për personelin (materialet e rrezikshme si benzina, gazi, etj.). Vendit të ngjarjes duhet t'i afrohen në atë mënyrë e cila zvogëlon rrezikun që i kanoset punonjësit të policisë nga ndonjë e papritur, duke rritur në këtë mënyrë edhe sigurinë e personave dhe dëshmitarëve të pranishëm.

Pas vënies nën kontroll të situatës apo personave të rrezikshëm, detyra e punonjësve të parë të policisë në vendin e ngjarjes, është që personave të dëmtuar t'u ofrohet ndihma mjekësore e nevojshme, pa dëmtuar ose me një dëmtim minimal të vendit të ngjarjes. Duke ndihmuar, orientuar e udhëzuar personelin mjekësor, gjatë ofrimit të asistencës mjekësore dhe largimit të së plagosurve, do të zvogëlohet rreziku i dëmtimit të vendngjarjes dhe në veçanti i provave. Punonjësit e parë të policisë në vendin e

ngjarjes, duhet të sigurohen se përkujdesja mjekësore do të shkaktojë dëmtim minimal të vendit të ngjarjes. Ata duhet të përpiqen gjithashtu që të bëjnë fotografimet dhe filmimet e nevojshme të zonës dhe territorit rreth vendit të ngjarjes, para se të ndërhyjë ekipi mjekësor për t'u dhënë ndihmën e nevojshme personave të dëmtuar.

5. Këqyrja e vendit të ngjarjes dhe sekuestrimi i provave

Këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor mjaft i rëndësishëm me anë të së cilit organi procedues kontrollon drejtpërdrejtë mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson, gjurmët dhe provat materiale e sqaron mekanizmin e ngjarjes dhe rrethana të tjera që kanë rëndësi për çështjen. Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprimi i parë hetimor dhe kriminalistik, me anë të së cilit hidhen themelet e hetimit të ardhshëm. Sa më të mira të jenë këto themele, aq më i plotë dhe i shpejtë do jetë hetimi. Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprim hetimor i pazëvendësueshëm dhe i papërsëritshëm. Në këqyrjet e vendit të ngjarjes në rastet e krimeve kundër jetës është e rëndësishme që të përcaktohet se: nëse ndodhemi para kriminit të vrasjes, vetëvrasjes apo të një ngjarjeje aksidentale apo natyrore; në cilin vend dhe në cilën kohë ka ndodhur vrasja; cili është identiteti i viktimës; sa autorë kanë marrë pjesë në kryerjen e vrasjes; cila ka qenë rruga e ardhjes në vendin e ngjarjes së autorit, dinamika e veprimit të tij dhe rruga e largimit; nga çfarë vendesh mund të shikohej kryerja e vrasjeve dhe nëse kanë qenë dëshmitarët në vende të tilla, që të mund të konsiderohen dëshmitarë okularë; cili është motivi i kryerjes së vrasjes; kush janë autorët e dyshuar; etj.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet verifikimit të faktit nëse vendi i gjetjes së kufomës është vendi i vërtetë i kryerjes së vrasjes. Me ndihmën e ekspertit të mjekësisë ligjore duhet të përcaktohet koha e përafërt e vdekjes së viktimës, sepse përgjigjet sa më të sakta në këto dy pyetje "të arta" të kriminalistikës (për vendin dhe kohën) mundësojnë verifikimin më të lehtë të alibisë së mundshme të personit të dyshuar.

5.1 Veprimet që kryhen në mjedisin ku është kryer vepra penale

Veprimet që kryhen nga grupi hetimor në këtë fazë kalojnë në vetvete në disa etapa. Këto veprime synojnë në këqyrjen, zbulimin dhe fiksimin e gjurmëve dhe provave materiale që lidhen me veprimet e autorit dhe mjete që ka përdorur ai për realizimin veprës penale. Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se punonjësit e policisë që kanë marrë masat për sigurimin e vendit të ngjarjes, vazhdojnë ta mbikëqyrin atë për sigurinë dhe normalitet të veprimeve që kryen në vendin e ngjarjes deri në përfundim të saj. Në etapën e parë grupi hetimor hedh një vështrim të përgjithshëm në mjedisin ku është kryer vepra penale.⁷ Më pas bëhet fotografimi orientues dhe i përgjithshëm i mjedisit, ku është kryer vepra penale, duke i përshkruar këto të dhëna dhe në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe skicës së vendit të ngjarjes. Pastaj në bazë të llojit dhe veçorive të ambientit ku është kryer vepra penale, përcaktohet pika e fillimit të këqyrjes, në qendër ose në periferi dhe një të njëjtën kohë përcaktohet edhe një pikë referimi që do t'i referohemi gjatë veprimeve që do të bëjmë në vendin e ngjarjes. Në etapën e dytë përcaktojmë mënyrën e lëvizjes në vendin e ngjarjes. Në varësi të veçorive që ka mjedisi mund të përcaktohen mënyra të ndryshme për të lëvizur në vendin e ngjarjes,

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

⁷ Begeja, Skënder. *Kriminalistika*. Tiranë: SHBLU, 2004. (f. 527).

si p.sh: “mënyrë spirale” - nga qendra në periferi ose nga periferia në qendër; “me breza” - duke e ndarë mjedisin në sektorë, etj.

Në etapën e tretë fillon këqyrja dhe fiksimi i sendeve objekteve, gjurmë dhe provave që gjenden në mjedisin ku është kryer vepra penale. Fillimisht sendet dhe objekte që gjenden në vendin e ngjarjes këqyren, përshkruhen dhe fiksohen në gjendje statike, pra: rregullisht primar në këqyrje është se grupi hetimor këqyr dhe fikson çdo gjë që perceptohet direkt në gjendjen statike dhe në asnjë rast nuk bëjmë përshkrime që bazohen në thëniet e dëshmitarëve apo të së dëmtuarit, të cilët mund të kenë lëvizur sende dhe objekte nga vendi i ngjarjes. Në këqyrjen statike të sendeve, objekteve dhe gjurmëve, përshkruajmë çdo gjë që ka të bëjë me karakteristikat e veçanta dhe të përgjithshme të tyre si: dispozicionet e vendosjes së këtyre sendeve në raport me sendet dhe objektet përreth, duke bërë dhe matjet përkatëse, të cilat pasqyrohen në skicën, fotografimin dhe filmimin që bëhet në vendin e ngjarjes.

Mbas këqyrjes statike fillon këqyrja dinamike e sendeve dhe objekteve që ndodhen në vendin e ngjarjes. Kjo lloj këqyrje është e domosdoshme, pasi këqyrja statike nuk i zgjidh të gjitha problemet që lidhen me gjurmët dhe provat, pra është e domosdoshme që këto sende dhe objekte që i janë nënshtruar këqyrjes statike të lëvizin dhe të këqyren edhe ato pjesë që nuk kanë qenë perceptuar në këqyrje statike, me qëllim kërkimin, zbulimin dhe fiksimin gjurmëve dhe provave materiale. Pra dhe në këtë nën fazë, çdo gjë përshkruhet në procesverbal, fotografohet, skicohet, dhe mund të filmohet, sipas rastit. Veprimet e mëtejshme kanë të bëjnë me mbylljen e procesit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, i cili fiksohet në procesverbalin e këqyrjes, ku shënohet ora e fillimit dhe përfundimit të këqyrjes, veprimet që u kryen për fiksimin e rezultateve të këqyrjes dhe nënshkrimi i procesverbalit të këqyrjes nga të gjithë pjesëmarrësit e grupit hetimor pasi e kanë lexuar atë. Nga përshkrimi i mësipërm del qartë se rezultatet e këqyrjes së vendit të ngjarjes fiksohen në katër mënyra:

- përshkrimi në procesverbal;
- skica e vendit të ngjarjes;
- fotografimi;
- filmimi i vendit të ngjarjes.

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes është e rëndësishme të shpjegohen edhe disa çështje të tjera të rëndësishme për hetimin, si: pozicioni i viktimës dhe autorit në momentin e vrasjes; konstrukcioni fizik i autorit dhe pamja fizike e viktimës; “çfarë gjurmësh mund të ketë lënë viktimja mbi autorin e vrasjes?”; “a është autori i dëmtuar?” dhe, nëse “po”, “në cilat pjesë të trupit?”; “a ka pasur përleshje?” dhe “a i është grisur apo dëmtuar autorit ndonjë prej veshjeve të tija?”; “a i ka viktimja sendet personale (dokumente, lekë, etj.) apo janë marrë nga autori i vrasjes?”; “autori ka vepruar në terren të njohur apo të panjohur?”; “a ka përdorur autori automjete?”, etj.

5.2 Veprimet që kryen mbas këqyrjes së vendit të ngjarjes

Mbas mbarimit të veprimeve në vendin e ngjarjes, grupi hetimit rikthehet edhe njëherë në pikën e fillimit, ku ka filluar lëvizjen në mjedisin e vendit të ngjarjes për të bërë një retrospektive të së gjithë veprimeve që janë kryer. Kjo ka për qëllim që të sigurohemi së në vendin e ngjarjes është këqyruar, fiksuar dhe vlerësuar çdo gjë, në rast të kundërt, në rast se ka rrethana që janë anashkaluar duhet të vlerësohen, duke u këqyruar dhe të fiksohen në procesverbalin e këqyrjes. Merren masa të plota dhe të sigurta për paketimin e gjurmëve, me qëllim që ato të mos tjetërsohen dhe dëmtohen

gjatë transportit dhe bëhet sekuestrimi i gjurmëve dhe provave të marra nga vendi i ngjarjes. Ky lloj sekuestrimi është kompetencë e Policisë Gjyqësore dhe duhet gjithmonë t'i paraprijë vënies në lëvizje të ekspertimit përkatës. Gjithashtu, kryhet përgatitja e materialeve për kryerjen e ekspertimit kriminalistik në varësi të gjurmëve dhe provave të fiksuara në vendin e ngjarjes si dhe hartimi i vendimeve përkatëse për të vënë në lëvizje ekspertimin kriminalistik dhe dërgimin e materialeve në laboratorin e Policisë Shkencore.

5.3 Gjurmët dhe provat në vendin e vrasjes

Në varësi me mënyrën e kryerjes, mjetet e përdorura, vendin dhe kohën e kryerjes së vrasjes dhe lëvizjes dhe sjelljes së autorit para, gjatë dhe pas kryerjes së vrasjes, si dhe faktet se: “a ka bërë rezistencë viktimja?” ose “a ka pasur përlëshje midis tyre në vendin e ngjarjes?”, është e mundur që të gjenden gjurmë dhe prova të shumëllojshme, të cilat mund të jenë të autorit apo të viktimës. Se çfarë gjurmësh do të gjenden në vendin e ngjarjes, në çfarë gjendje do të jenë dhe se sa do të jenë ato të rëndësishme, varet nga sa kohë ka kaluar nga ngjarja, koha e njoftimit të policisë për ngjarjen dhe nga ruajtja që i është bërë vendit të ngjarjes. Në vendin e ngjarjes së krimeve kundër jetës zakonisht gjenden gjurmë dhe prova si më poshtë: gjak; spermë; fije floku; pështymë; jashtëqitje; prova të tjera biologjike (sekrecione); gjurmë daktiloskopike; gjurmë këmbësh; mbetje të thonjve; gjurmë dhëmbësh; dhë; pluhur; mbetje ngjyrash, rroba apo mbetje rrobash; aroma, etj. Në vendin e ngjarjes, në krimin e vrasjes zakonisht gjendet gjurmë të gjakut të viktimës por mund të gjendet edhe gjurmë të gjakut të autorit të vrasjes, i cili mund të jetë plagosur apo dëmtuar. Në shumë raste, këto mjete gjenden në rrugëkalimin që ka përdorur autori i krimit për tu larguar nga vendi i ngjarjes. Të rëndësishme për t'u gjetur dhe ekzaminuar nëpërmjet profilit të AND-së, janë provat biologjike si: gjaku, sperma, pështyma, fijet e flokut apo qime të tjera, mbetje në thonjtë e viktimës nga përlëshja me autorin, etj.

Në vendin e ngjarjes mund të gjenden dhe të sekuestrohen me cilësinë e provës materiale, sende të autorit të vrasjes si: shkop, çantë, çadër, orë, zinxhirë, vathë, llullë, kapelë, doreza, pallto, këpucë, çizme, sandale, atlete, pulla, copa të grisura të rrobave, letra, kasete, dokumente personale, dokumente të tjera, etj. Në varësi të llojit të mjeteve të përdorura nga autori i krimit të vrasjes, në vendin e ngjarjes mund të gjenden edhe disa gjurmë e pjesë si dhe mjeti me të cilin është kryer vrasja. Në qoftë se vrasja është kryer me armë zjarri, në vendin e ngjarjes gjenden gjurmë të barotit, gëzhojave, flakës, plumba, etj. Ka raste, që në vendin e ngjarjes gjendet edhe arma të cilën ka përdorur autori i vrasjes. Me interes të madh për ekspertime të mëtejshme balistike, janë sidomos plumbi i shkrepur dhe gëzhoja. Gjurmët e goditjes së gilpërës së armës në fishek janë gjurmë identifikuese, sepse nëpërmjet ekspertizës balistike mund të vërtetohet se prej cilës armë është kryer vrasja. Në vendin e ngjarjes gjenden shumë shpesh gjurmë gjaku, të cilat mund të gjenden te vetë viktimja, në mjetet e afërta, në mure, në dysheme, në tavan, etj., por gjurmë gjaku të viktimës mund të gjenden edhe në rrobat e autorit. Gjurmë të gjakut të autorit mund të gjenden në rrobat e viktimës, në vendin e ngjarjes ose në rrugën e largimit të autorit nga vendngjarja. Në vendin e kryerjes së vrasjes mund të gjenden edhe gjurmë thonjsh, dhëmbësh, penjsh, qimesh dhe gjurmë vijash papilare të viktimës, të cilat kanë rëndësi të veçantë në qoftë se gjenden në trupin e personit të dyshuar.

Disa gjurmë të autorit mund të gjenden edhe në trupin apo rrobat e viktimës.

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Përveç gjurmëve të gjakut, gjurmë të tilla mund të jenë edhe gjurmët e qimeve, dhëmbëve, thonjve, penjve, etj., por edhe gjurmët e mjeteve të kryerjes së vrasjes, të cilat mund të jenë të ndryshme, në varësi të mjetit të përdorur. Në trupin apo në rrobat e viktimës dhe autorit, mund të gjenden edhe mikrogjurmë specifike, si papastërtia nën thonj, ku mund të ketë gjurmë të gjakut, lëkurës ose veshjes së autorit apo të viktimës. Këto mikrogjurmë janë të rëndësishme për përcaktimin e mënyrës së kryerjes së vrasjes dhe dinamikës së ngjarjes kriminale. Gjurmët dhe provat e gjetura në vendin e ngjarjes kanë rëndësi të madhe për ecurinë e hetimit dhe identifikimin dhe arrestimin e autorit të vrasjes. Këto gjurmë dhe prova, do shërbejnë si bazë për ngritjen e versioneve hetimore, por edhe për vazhdimin e ekzaminimeve të mëtejshme kriminalistike nëpërmjet kryerjes së ekspertimeve të ndryshme.

5.4 Këqyrja e kufomës

Dëshmia kryesore se gjendemi para krimit të vrasjes është trupi pa jetë që gjendet në vendin e ngjarjes, prandaj gjetjes së kufomës duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Trupi pa jetë gjendet zakonisht në vendin e ngjarjes, por mund të bëhet edhe transportimi i tij për t'i dhënë ndihmën e shpejtë dhe për pasojë trupi mund të gjendet në qendrat spitalore. Trupi i viktimës mund të gjendet edhe në vende të tjera, ku mund ta ketë dërguar autori i vrasjes, me qëllim fshehjen, asgjësimin, varrosjen, krijimin e rrethanave të rreme me viktimën, etj. Në të gjitha rastet, kufoma i nënshtrohet këqyrjes në vendin e ngjarjes, por edhe kryerjes së autopsisë në ambientet e mjekësisë ligjore ose në spitale. Të gjitha elementet e përshkrimit dhe kontrollit, evidentohen në procesverbalin e këqyrjes së kufomës dhe fotografohen. Me rëndësi të veçantë është kontrolli i jashtëm i kufomës. Ai duhet të jetë i detajuar, sepse gjatë transportimit të kufomës për në morg mund të ndryshojnë ose të asgjësohen gjurmë të rëndësishme, të cilat mund të mos jenë gjetur gjatë këqyrjes, por duhet kujdes edhe që të mos shfaqen gjurmë të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale të vrasjes dhe autorin e saj, të cilat mund të ndikojnë negativisht në rrjedhën e hetimeve dhe në ngritjen e versioneve hetimore.

Në vendin e ngjarjes ndërmerren masa për përcaktimin e identitetit të kufomës, në përputhje me procedurat kriminalistike për këtë qëllim, sepse ky fakt është i rëndësishëm për krijimin e versioneve dhe për planifikimin e rrjedhës së mëtejme të përpunimit kriminalistik. Vendi i gjetjes së kufomës duhet të fiksohet saktë në procesverbalin e këqyrjes dhe në skicën e vendit të ngjarjes. Është i domosdoshëm edhe përshkrimi i detajuar i pozicionit në të cilën është gjetur kufoma, sidomos i pozicionit të duarve e këmbëve. Është me interes të veçantë që të përshkruhen edhe gjërat që mund të gjenden në duart e viktimës, si dhe gjendja e rrobave dhe e këpucëve. Pasi bëhet fiksimi i kufomës në procesverbal, eksperti kriminalist duhet ta fotografojë kufomën në kuadrin e përgjithshëm të vendit të ngjarjes, pastaj ta fotografojë kufomën me gjurmët e dukshme, duke pasur kujdes që gjurmët të fotografohen me fotografi të veçanta. Këqyrja e kufomës bëhet sipas rregullave kriminalistike të përshkrimit të personit dhe duhet të përmbajë gjininë, gjatësinë, moshën, ngjyrën dhe formën e flokëve, hundës, syve, veshëve dhe syve. Qëllim i këqyrjes së kufomës është gjetja e gjurmëve dhe provave materiale që mund të gjenden në trupin apo në rrobat e tij. Vëmendja përqendrohet në gjetjen e gjurmëve të autorit të krimit, si dhe të gjurmëve të dheut në këpucë, duar apo rroba të viktimës, me qëllim të përcaktimit të vendit të gjetjes së kufomës dhe vendit të kryerjes së vrasjes. Mjeku ligjor përshkruan në mënyrë

Vocaj, T.

« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

të detajuar të gjitha dëmtimet e dukshme tek viktimat, si dhe prezencën e njollave kufomore ose të shtangimit të kufomës. Dukuritë kufomore të hershme, si ftohja e kufomës, tharja e saj, njollat kufomore, shtangësia kufomore dhe autoliza kufomore si dhe dukuritë kufomore të mëvonshme, si: kalbëzimi i kufomes, mumifikimi, sapunifikimi, regjia tërbore kanë edhe vlerë mjekësore edhe vlerë kriminalistike.⁸ Mjeku ligjor, për shkak të ndryshimeve të jashtme të kufomës, mund të përcaktojë kohën e përafërt të vdekjes, gjë që është me rëndësi të madhe për planifikimin e veprimeve të mëtejshme hetimore. Është e njohur, se trupi i njeriut ftohet pas vdekjes rreth 1 gradë Celsius në orë, gjë që mund të jetë me interes vetëm deri të barazimi i temperaturës së kufomës me temperaturën e ambientit.

Njollat e vdekjes e përfshijnë gjithë sipërfaqen e trupit 34 orë pas vdekjes, ndërsa gjurmët e presionit shfaqen 10-12 orë pas vdekjes. Shtangimi ndodh zakonisht 24 orë pas vdekjes, por manifestohet plotësisht 8-10 orë, lirohet gradualisht pas 24-48 orësh, ndërsa lirohet plotësisht pas tri deri katër ditësh. Me këqyrjen e kufomës dhe autopsisë, mund të marrin përgjigje një sërë çështjesh në interes të hetimit si:

- Cili është shkaku i vdekjes?
- Çfarë dëmtimesh e plagësh eksitojnë, përveç dëmtimeve e plagëve vdekjeprurëse?
- Me çfarë mjeti janë shkaktuar dëmtimet?
- Cilat dëmtime janë shkaktuar kur trupi ka qene i gjallë dhe cilat pas vdekjes?
- Kur ka ndodhur vdekja?
- A ka dëmtime që mund të jenë shkaktuar gjatë përleshjes apo mbrojtjes?
- A ka qenë viktimat në gjendje të dehur?
- A ka vuajtur viktimat nga ndonjë sëmundje dhe cili ka qenë ndikimi i saj në vdekje?
- A janë gjetur në duar apo nën thonj mikrogrurmë dhe, çfarë?
- A ka viktimat dëmtime ose ndryshime specifike që mund të jenë indikativë në raport me autorin (gërvishtje me thonj, kafshim me dhëmbë, fije flokësh, mjekre, etj)?

5.5 Identifikimi i viktimës

Identifikimi i viktimës është një veprim mjaft i rëndësishëm hetimor, i cili i hap rrugë vazhdimet të suksesshëm të hetimeve në tërësi, por dhe ngritjes së versioneve hetimore në veçanti. Në këtë kuadër zakonisht viktimat identifikohen në vendin e ngjarjes nga dëshmitarët, të afërmit apo persona të njohur. Shpesh herë viktimat kanë me vete dokumente identiteti që lehtësojnë identifikimin e tyre. Për identifikimin e viktimave përdoren metoda kriminalistike ku krahasohen shenjat juridike, faktike dhe biologjike sipas të cilave një person dallon nga të tjerët. Çdo person merr shenja juridike në bazë të dispozitave ligjore (emrin, mbiemrin, gjendjen familjare, shtetësinë, vendbanimin, etj.). Këto shenja mund të zbatohen në mënyrë të njëjtë ashtu si janë fituar. Njeriu i fiton shenjat faktike që në lindje (datën e lindjes, vendin e lindjes, përkatësinë nacionale, etj.). Edhe këto shenja janë plotësisht të pavarura nga vullneti i njeriut. Në kuptimin kriminalistik, rol kryesor ka përcaktimi i identitetit të personit në kuptimin biologjik, nëpërmjet të ashtuquajturit identitet biologjik. Shenja me karakter biologjik janë

⁸ Begeja. *Kriminalistika*. (f. 529).

përmbajtje materiale të identitetit të individit dhe qenia e identitetit të tij.

6. Zbulimi i autorit të vrasjes

Për zbulimin e autorit të veprës penale të vrasjes, menjëherë pas njoftimit për kryerjen e saj është e rëndësishme, që nga strukturat e policisë përgjegjëse për hetimin e krimeve të rënda, të kryhen veprime hetimore e gjurmuese, objektive dhe të shpejta. Suksesin e zbulimit të autorit të vrasjeve dhe arrestimin e tyre, varet shumë nga veprimet urgjente dhe të njëkohshme e masave dhe veprimeve të caktuara gjurmuese dhe hetimore, me qëllim, zbulimin e autorit, në njërin anë, dhe sigurimin e gjurmëve dhe provave materiale, në anën tjetër. Puna për zbulimin e autorit të vrasjes, varet shumë edhe nga koha e kaluar prej kryerjes së vrasjes deri tek marrja në dijeni nga strukturat e policisë për ngjarjen. Në rast të njoftimit të shpejtë për vrasjen, d.m.th. gjatë kryerjes së vrasjes ose menjëherë pas kryerjes, organizohen menjëherë kufizimet e zonës, vendosen postblloqe të sigurta rrugore, organizohet puna për ndjekjen e autorëve që largohen, mbahen në kontroll vende e ambiente që mund të frekuentohen nga të dyshuarit, mbahen në kontroll persona të caktuar, grumbullohen informacione dhe bëhen verifikime të nevojshme, orientohet veprimtaria e policisë në kontrollin e automjeteve, bagazheve dhe udhëtarëve me qëllim të gjetjes së gjurmëve që mund të zbulojnë autorin e krimit, bëhen kontrole të personave, banesave e hapësirave të tjera, organizohen prita në vende të caktuara dhe informohet struktura policore për karakteristikat e autorit, të mjeteve në përdorim, të drejtimit të largimit, etj., bashkëpunohet me struktura të policisë kufitare, me qëllim zbulimin dhe kapjen e autorit të vrasjes.

Paralelisht me organizimin e këtyre masave, kryhet këqyrja dhe ndërmerren masa për gjetjen e gjurmëve e provave materiale që lidhin autorin me kryerjen e vrasjes. Në këtë operacion përfshihen të gjitha strukturat e policisë së Rendit, Rrugore, Kufitare dhe vendosen lidhje me të gjitha komisaritet dhe drejtoritë vendore të policisë, bëhen verifikime të ndryshme operative dhe ndërmerren veprime të tjera, në varësi edhe të peshës dhe kompleksitetit të krimit të ndodhur.

Në rastet kur policia merr dijeni për vrasjen pasi ka kaluar një kohë të konsiderueshme, nuk është e nevojshme ndërmarrja e këtyre operacioneve masive dhe vënia në lëvizje e një numri të madh forcash dhe mjetesh. Në raste të kësaj natyre, veprimet hetimore, por edhe gjurmuese fillojnë me këqyrjen e vendit të ngjarjes, këqyrjen e kufomës, pyetjen e dëshmitarëve si dhe me kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore që do hedhin dritë mbi rrethanat e ndodhjes së krimit. Mbi bazën e fakteve dhe provave të grumbulluara krijohen versionet hetimore dhe planifikohet e gjithë veprimtaria gjurmuese për verifikimin dhe ndjekjen e versioneve të ngritura. Është e rëndësishme që në raste të kësaj natyre të bëhet identifikimi i kufomës dhe të analizohet veprimtaria e viktimës dhe mënyra e jetesës, konfliktet e mundshme, arsyet se përse viktima është gjendur në këtë vend, lidhjet shoqërore dhe kriminale të mundshme të viktimës, numrat e telefonit dhe aparatet telefonike në përdorim.

Merren të dhëna për personat që e kanë parë së fundmi viktimën, për personat që kanë komunikuar së fundmi në telefon si dhe për personat që e kanë gjetur viktimën në vendin e ngjarjes, rrethanat e gjetjes, etj. Me qëllim që të sqarohet fakti nëse kemi të bëjmë me vrasje, vetëvrasje apo ngjarje aksidentale, është e nevojshme që të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të kryhen ekspertimet kriminalistike, por nëse është e nevojshme edhe eksperimente hetimore që do të bëjnë të mundur sqarimin e

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

dilemës së mësipërme. Është shumë e rëndësishme që grupi hetimor të punojë *unison* dhe të kryhen analiza të vazhdueshme për të arritur në konkluzione të drejta dhe objektive.

Puna gjurmuese operative është shumë e rëndësishme për zbulimin e autorëve të vrasjes dhe realizohet nga specialistët e krimeve kundër jetës, në drejtoritë vendore të policisë dhe në komisaritet e policisë të rretheve gjyqësore. Është shumë e rëndësishme që në ngjarje të tilla të përfshihen në kryerjen e detyrave gjurmuese edhe specialistët të tjerë të policisë e kryesisht, të specialistëve të policisë që mbulojnë territorin. Aktivizimi i sa më shumë burimeve të informacionit, është i rëndësishëm për zbulimin dhe dokumentimin ligjor të këtyre krimeve të rënda. Të afërmit e viktimës janë një burim i pazëvendësueshëm informacioni dhe vendosja e marrëdhënieve korrekte me ta si dhe ndihma e mbrojtja e tyre në çdo rast, duhet të vlerësohet nga strukturat që merren me hetimin dhe gjurmimin e krimeve të rënda.

Nëse vrasja është kryer në ndonjë objekt të njohur ku ka qarkullim të madh të njerëzve si: park, hotel, motel, parking, garazh, etj., është e nevojshme që të grumbullohen të gjitha të dhënat, të cilat mund të jenë me interes për hetimin e vrasjes dhe zbulimin e autorit. Gjithashtu, është me interes të merren masa që të sigurohen të dhëna mbi të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur në atë vend në periudhat e mëparshme, të cilat mund të kenë lidhje me ngjarje, qoftë sipas mënyrës së kryerjes, qoftë sipas kohës dhe mjeteve të përdorura. Në rastet kur autori i vrasjes është parë nga ndonjë dëshmitar okular dhe është njohur prej tij, siç theksuam edhe më lartë, ndërmerren masa të shpejta dhe të gjithanshme për kapjen dhe arrestimin e tij. Ndërsa, nëse dëshmitari okular e ka parë autorin, por nuk e ka njohur, është e rëndësishme që në pyetjen e këtij dëshmitari të merren karakteristika sa më të detajuara të autorit të vrasjes. Shumë e rëndësishme për vazhdimin me sukses të hetimit, është edhe kryerja e verifikimeve mbi të dyshuarin ose mbi të dyshuarit nëse kemi më shumë se një të tillë. Në këto verifikime, vëmendja përqendrohet në studimin e personalitetit të së dyshuarit, rrethanat familjare, gjendjen ekonomike, aktivitetin me të cilin merret, qëndrimet morale, mënyrën e jetesës, sjelljen, veset, etj. Po ashtu, duhet të verifikohet nëse ka qenë i dënuar apo i proceduar penalisht e të verifikohet nëse ka informacione në ngarkim të tij për veprimtari kriminale.

Në rastet kur nuk kemi asnjë dëshmitar që të ketë parë autorin e vrasjes, vëmendja duhet përqendruar në studimin e personalitetit të viktimës, evidentimin e konflikteve të mundshme si dhe në marrjen më verifikimi të informacioneve për autorët e mundshëm të kryerjes së vrasjes.

Versionet hetimore duhet të ngrihen dhe të ndiqen mbi bazën e fakteve dhe provave të grumbulluara dhe jo të ngritura apriori dhe pa baza reale. Ngritja e versioneve të gabuara ndikon negativisht në punën e grupit hetimor dhe harxhon kohë dhe energji të panevojshme të punës së strukturave të Policisë Gjyqësore. Është e rëndësishme që versionet hetimore, të ndiqen paralelisht dhe për këtë është e nevojshme që të aktivizohen disa oficerë të Policisë Gjyqësore që merren me hetimin e krimeve të rënda. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që në versionet hetimore të sqarohet nëse viktima është njohur me autorin dhe kjo mund të sqarohet nga dinamika e ngjarjes, vendi ku ka ndodhur vrasja, koha e kryerjes, nga dëshmitarët që kanë parë ngjarjen ose që kanë parë viktimën në shoqërinë e personave të tjerë para vrasjes, etj.. Sqarimi i faktit të mësipërm do ndihmojë punën hetimore dhe gjurmuese për ngushtimin e rrethit të personave të mundshëm për kryerjen e vrasjes.

Vocaj, T.

« Hetimi i krimeve kundër jetës »

Policimi dhe Siguria nr.2, 2016

Në rastin kur viktimia nuk ka njohje me autorin, pra kur vrasja ka ndodhur në takimin e tyre të parë, vështirësitë për individualizimin e një apo disa të dyshuarve janë të mëdha. Në këto raste vëmendja duhet të përqendrohet në studimin e dinamikës së krimit, njohjen e detajuar të vendit të ngjarjes, mjetet e përdorura në krim, konstruktin fizik të autorit, rrugën e ardhjes dhe largimit të autorit nga vendi i ngjarjes, mjetet e transportit të përdorura prej tij si dhe mundësitë e veprimtimit fizik viktimës mbi autorin dhe të mbartjes në trupin apo mjetet e tij të gjurmëve të krimit. Në këto raste, ngushtimit të rrethit të dyshuarve i shërben edhe studimi i personalitetit të viktimës, i lidhjeve shoqërore, i prirjeve dhe veseve të tij, etj. Po kështu, në rastet e hetimit të vrasjeve, është e rëndësishme të përcaktohet itinerari i lëvizjeve dhe takimeve që viktimia ka pasur në ditën e ngjarjes, pasi nëpërmjet këtij veprimi do evidentojmë dëshmitarë të rëndësishëm për hetimin. Analiza e tabulateve telefonike të viktimës, për të përcaktuar vendet ku viktimia ka qenë jo vetëm në ditën e vrasjes por edhe me gjerë, personat me të cilët ka komunikuar, ka shkëmbyer mesazhe, etj, janë mjaft të rëndësishme për hetimin si dhe për verifikimin e ndjekjen e versioneve hetimore. Sqarimi i motivit të vrasjes, është mjaft i rëndësishëm për zbulimin dhe dokumentimin e autorësisë së vrasjes. Puna për sqarimin e motiveve duhet të mbështetet në studimin e personalitetit të viktimës, por edhe të të dyshuarit.

Vrasjet me pagesë paraqesin vështirësi në punën për zbulimin dhe dokumentimin ligjor të veprimtarisë kriminale të autorëve të këtyre krimeve. Në këto raste kemi të bëjmë me një formë specifike të bashkëpunimit dhe është shumë e rëndësishme ngritja dhe ndjekja e versioneve për vrasjet me pagesë. Është e rëndësishme, që edhe në këto vrasje t'i kushtohet vëmendje vendit të ngjarjes dhe të gjitha rrethanave që lidhen me dinamikën e krimit. Po kështu, përcaktimi sa më i saktë i karakteristikave të autorit dhe puna për zvogëlimin e rrethit të personave me këto karakteristika, është një hap i rëndësishëm drejt suksesit të hetimeve. Verifikimi i informacioneve për persona konkretë që përdoren si vrasës me pagesë, si dhe analizimi i vendndodhjes së tyre në ditën dhe orën e ngjarjes është një veprim i rëndësishëm hetimor dhe operativ për zbulimin e autorëve. Analiza hetimore kriminale, është një proces i identifikimit të personalitetit dhe karakteristikave të sjelljes të një ose shumë autorëve të krimit, mbi bazën e krimeve që ai ka kryer. Profili që rezulton nga kjo lloj analize, parashikon jo rrallë një identifikim të autorit dhe furnizon oficerët e Policisë Gjyqësore me një portret trupor dhe psikologjik të sjelljes së autorit. Krahas analizës hetimore kriminale, në hetimin e vrasjeve, me mjaft efikasitet përdoren edhe analizat e të dhënave analizat e tabulateve telefonike etj. Në grupin hetimor tashmë është bërë e domosdoshme përfshirja e analistëve me njohuri të posaçme në këtë fushë, por edhe me mjetet e infrastrukturën e nevojshme në dispozicion të tyre.

7. Rekomandime

1. Në hetimin e krimeve kundër jetës, është e rëndësishme mënyra e reagimit të strukturave policore në momentin që merr dijeni për krimin.

2. Ruajtja e vendit të ngjarjes, evidentimi i dëshmitarëve dhe ndjekja e autorëve janë veprime hetimore dhe operative që ndihmojnë në kryerjen e hetimeve të suksesshme.

3. Këqyrja e vendit të ngjarjes, gjetja dhe sekuestrimi i gjurmëve dhe provave të tjera materiale është një veprim i rëndësishëm hetimor që duhet kryer duke respektuar

Vocaj, T.

« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

procedurat hetimore dhe, nga oficerë të Policisë Gjyqësore e ekspertë të kualifikuar.

4. Ngritja dhe ndjekja e versioneve hetimore duhet të mbështet në provat e sekuestruara dhe në informacionet konkrete.

5. Puna në grup dhe aplikimi i metodave të analizës është domosdoshmëri për hetime të suksesshme dhe dokumentim të plotë të veprimtarisë kriminale.

Bibliografi

1. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë: [i përditësuar]*. Tiranë: Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2010.
2. *Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. [i azhornuar]*. Tiranë: Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2014.
3. Elezi, Ismet. *E Drejta penale (pjesa e posaçme)*. Tiranë: Botimet Kumi, 2014.
4. Islami, Halim, dhe Ilir Panda, Artan Hoxha. *Procedura penale:komentar*. Tiranë: Morava, 2003
5. Skënder Begeja. *Kriminalistika*. Tiranë: SHBLU, 2004.
6. Hysi, Vasilika. *Kriminologjia*. Tiranë: Kristalina-KH, 2005.
7. Hysi, Vasilika. *Penologjia*. Tiranë: Kristalina-KH, 2012.

Vocaj, T.
« Hetimi
i krimeve
kundër
jetës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

111

Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe rritjen e sigurisë publike



■ **Msc Arben IBRO, Msc Bora SELMANI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Menaxhimi, përveç të tjerave është një nga elementët thelbësorë të punës së çdo drejtuesi në tërësi, ashtu sikurse është e tillë edhe për drejtuesin e policisë të çdo niveli. Prej tij varet në masë të konsiderueshme suksesi dhe dështimi në punën e drejtuesit të strukturës policore, prandaj për të qenë i suksesshëm, çdo drejtues duhet të njohë konceptin mbi menaxhimin modern, funksionet dhe stilet e tij dhe të jetë në gjendje t'i aplikojë ato në veprimtarinë policore konkrete. Referimi, për të analizuar menaxhimin e policisë, – në këtë periudhë, – është bërë për arsye se kjo periudhë karakterizohet nga ndryshime të vullshme të shoqërisë shqiptare e për rrjedhojë, edhe të policisë shqiptare. Kjo edhe për faktin tjetër, se kjo periudhë është e mbushur me ngjarje historike dhe vepra të rënda kriminale si dhe me eksperiencë, pozitive dhe negative të policisë për menaxhimin e tyre. Për efekt studimi, analizën e menaxhimit të policisë në këtë periudhë e kam ndarë në disa faza kohore, duke identifikuar secilën prej tyre, si:

Faza e parë, menaxhimi i policisë në periudhën 1990-1996, koha kur në Shqipëri u përmbyl sistemi totalitar, u shpall pluralizmi politik dhe vendi hyri në rrugën e proceseve demokratike e reformave të thella institucionale (duke përfshirë këtu edhe policinë).

Faza e dytë, menaxhimi i policisë në periudhën 1996-1997, si një nga periudhat më të vështira, jo vetëm për shoqërinë shqiptare, por edhe për policinë dhe ekzistencën e saj, koha kur në Shqipëri për shkak të rënies së firmave piramidale dhe pakënaqësisë së akumuluar, u evidentuan ngjarje të rënda kriminale, cenime masive të rendit publik, trazira të brendshme civile dhe anarki, ku institucionet shtetërore, (edhe policia), për një kohë ishin inekzistente.

Faza e tretë, menaxhimi i policisë në periudhën pas vitit 1997, koha kur Shqipëria la pas dramën e madhe të ngjarjeve të vitit 1997 dhe u fut në rrugën e transformimeve të mëdha në gjithë jetën e vendit e për rrjedhojë dhe të zhvillimeve të rëndësishme në Policinë e Shtetit në drejtim të misionit, organizimit, legjislacionit, rritjes së nivelit profesional, duke e përafuar atë me policitë e vendeve të përparuara evropiane dhe duke e shndërruar atë në shërbim publik.

Fjalëkyçe:

ruajtje e rendit, siguri publike, misioni policisë, shërbim publik, rol parandalues, rol investigues, planifikim strategjik, menaxhim policor.

IBRO, A. dhe SELMANI, B.
«Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Hyrje

Në historinë e policisë shqiptare, zanafilla është 13 janari i 1913-ës, ku menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Qeveria e Vlorës, përveç të tjerave, mori masa edhe për sigurimin e qetësisë dhe sigurimin e rendit publik në vend. Vendimi i qeverisë për krijimin e Forcave të Rendit më 13 janar 1913¹, e konfirmon këtë, vendim, i cili ishte me vlera të konsiderueshme, sepse jo vetëm sanksionoi krijimin e këtyre forcave, jo vetëm tregoi mënyrën e organizimit e të funksionimit të saj, por ai hodhi bazat organizative e institucionale të forcave kombëtare të rendit. Që nga ky moment e deri në ditët e sotme, policia shqiptare ka pësuar ndryshime të mëdha e të rëndësishme në pikëpamje të misionit, detyrave, organizimit, funksionimit dhe të menaxhimit të saj. Këto ndryshime janë kushtëzuar nga forma e regjimit apo tipi i shtetit që ka pasur shteti shqiptar në periudha të ndryshme të historisë së tij, në vartësi të së cilit kanë ndryshuar edhe format, metodat dhe mënyra e menaxhimit të policisë. Analiza e veprimtarisë së periudhës pas viteve '90, ka për qëllim që të evidentojë mënyrën e menaxhimit të policisë si dhe të evidentojë faktin se si ka ndikuar mënyra e menaxhimit të saj, në ruajtjen e rendit dhe në rritjen e sigurisë publike. Mbështetur mbi këtë bazë, do nxjerrim përfundime e do të japim rekomandime për të ardhmen. Kjo analizë, është bërë duke e ballafaquar mënyrën e menaxhimit të policisë, përkatësisht me dy koncepte të rëndësishme, me konceptin mbi *misionin e policisë* dhe mbi atë mbi *menaxhimin modern* të saj.

1. Misioni i Policisë së Shtetit në shoqërinë demokratike

Përpara se të bëj këtë analizë, është e nevojshme që të rikujtoj *misionin e policisë*

Ibro, A. dhe Selmani, B.
« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

në shoqërinë demokratike dhe konceptin mbi rendin e sigurinë publike, kjo sepse, analiza e një procesi, siç është ai i menaxhimit të policisë, duhet të bëhet në raport me misionin e policisë, për të parë nëse është përmbushur ai apo jo, çfarë ka ndikuar në realizimin ose jo të tij dhe çfarë duhet bërë në të ardhmen, - në të kundërt analiza do të jetë empirike, nuk do të jemi në gjendje të konkludojmë nëse mënyra e menaxhimit të policisë në këtë periudhë, ndikoi në ruajtjen e rendit e në rritjen e sigurisë publike apo bëri efektin e kundërt.

Misioni i Policisë së Shtetit (*neni 2, ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"*)², është: "Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut".

Nisur nga sa më sipër, "*rendi dhe siguria publike*", është elementi themelor i misionit të policisë, nga realizimi i të cilit varen elementët e tjerë përbërës të tij. Në se do të jemi të qartë për të, do të jemi në gjendje të ndërtojmë punën për të përmbushur misionin. Rendi dhe siguria publike është një nocion i gjerë që përfshin disa kategori, si: siguria ekonomike, politike, e shëndetit, e ambientit, personale, e komunitetit, etj., kategori këto, që kanë lidhje të ngushtë me zbatimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Siguria e individit apo e komunitetit janë të ndërvarur nga shumë faktorë, por më kryesorët veçohen: programet që zhvillohen nga strukturat shtetërore për zhvillimin ekonomik-shoqëror si dhe gjendja e institucioneve shtetërore që merren me garantimin e zbatimit të ligjit. Në këtë kontekst, përgjegjësia e shtetit dhe e institucioneve përkatëse, është : *të mbrojtë personin dhe komunitetin për të mos u rrezikuar nga shkeljet e ligjit, për të mbrojtur e zhvilluar më tej liritë e të drejtat e tij*. Pra, misioni i policisë në një shtet demokratik është shumë i rëndësishëm dhe për këtë Policia e Shtetit duhet të gjenerojë me shërbimet e veta mbrojtje, rend e siguri si dhe të garantojë në çdo kohë zbatimin e ligjit për qytetarët, për të mbrojtur shtetin dhe shoqërinë³. Për të kuptuar më mirë misionin e policisë, duhet t'i referohemi edhe detyrave të saj, (*neni 17, ligj nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"*) dhe në mënyrë të përmbledhur janë: mbrojtja e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private, ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, bashkëpunimi me komunitetin dhe institucionet e tjera shtetërore, administrimi i informacionit dhe kryerja e detyrave të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi⁴.

Siç shikohet nga detyrat, policia, si institucion i administratës shtetërore, është ngarkuar me detyra të rëndësishme, të cilat në përmbajtje kanë të bëjnë me mbrojtjen e individit, të shoqërisë e me garantimin e zbatimit të ligjit dhe Policia e Shtetit, si institucion i administratës shtetërore, është e destinuar për t'i shërbyer qytetarëve duke mbrojtur dhe zbatuar ligjin. Pra, policia është *shërbim publik*, natyra dhe përmbajtja e të cilit rrjedh sa nga pozicioni i saj si pjesë e administratës shtetërore, aq edhe nga misioni i përcaktuar në ligj. Si shërbim publik, detyra themelore e të cilit është mbrojtja dhe siguria e qytetarit dhe e shoqërisë. Parë në këtë aspekt, ky shërbim publik, në raport me shërbimet e tjera që realizon shteti, merr rëndësi të veçantë. Lindin pyetjet: "*Si e realizon misionin dhe detyrat Policia e Shtetit; cili është roli i saj;*

Libro, A. dhe Selmani, B.
«Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹ Shkëmbi, Hasan. *Legjislacioni i Policisë Shqiptare*. Tiranë: Geer, 2004, (fq. 53-54).

² Ligj "Për Policinë e Shtetit", neni 2, *Fletore Zyrtare nr. 137/2014*, (fq. 6336).

³ Yzeiri, Bajram. *Menaxhimi i Policisë*. Tiranë: Akademia e Policisë "Arben Zylyftari", 2003, (fq. 13-14).

⁴ Ligj "Për Policinë e Shtetit", neni 17, *Fletore Zyrtare nr. 137/2014*, (fq. 6340).

çfarë atributesh i janë dhënë dhe cilat janë veprimtaritë e saj?” Për këtë, ligji i ka dhënë policisë atributet e ruajtjes së rendit dhe ato të policisë gjyqësore dhe nëse analizojmë me kujdes përmbajtjen e shërbimit, rolin dhe veprimtarinë e policisë, do të dallojmë rolet dhe veprimtaritë e policisë, që mund të përmbliken në:

Së pari, roli parandalues (administrativ) – që ka të bëjë me veprimtarinë e policisë për të marrë masa e për të realizuar me shërbimet e veta; mbrojtje e siguri për shtetin e qytetarët, kontrollin e territorit, mbikëqyrjen zbatimit të ligjit, veprimtaritë që organizohen për të mësuar mbi përgatitjet për kryerjen apo veprat penale të kryera, mbledhjen e informacionit, për të parandaluar e për të dhënë asistencë psikologjike, juridike, shoqërore, mjekësore, fizike, etj., ndaj njerëzve që rrezikohen nga krimi apo nga fatkeqësi të ndryshme natyrore apo nga njeriu.

Së dyti, roli investigativ (i policisë gjyqësore) – që ka të bëjë me detyrimin ligjor që ka Policia

e Shtetit për të parandaluar, zbuluar, hetuar veprat penale, me punën që bën policia për mbledhjen, administrimin, klasifikimin, analizën e i formacionit policor, përdorimin e formave dhe metodave të ligjshme, duke respektuar procedurat ligjore dhe liritë e të drejtat e njeriut. Në funksion të përmbushjes së misionit dhe detyrave të saj, Policia e Shtetit kryen disa lloje veprimtarish, të cilat, bazuar në qëllimin dhe përmbajtjen e tyre janë: *shërbime administrative, të kontrollit të territorit, të emergjencës dhe shërbimet e zbulimit dhe hetimit të krimit.*⁵

Si përfundim, në mënyrë të përmbledhur, misioni i policisë në një shoqëri demokratike është mbrojtja dhe siguria e individit e shoqërisë, garantimi i zbatimit të ligjit dhe funksionimit normal të institucioneve shtetërore.

2. Mbi menaxhimin dhe menaxhimin policor - përkufizime, mendime dhe opinione

Analizën se si është menaxhuar policia në këto vite, përveçse në raport me misionin e policisë, e kemi bërë në raport edhe me kërkesat që ka menaxhimi modern, me konceptet, me funksionet, stilet dhe parimet kryesore të tij, me qëllim që të evidentojmë se “si është bërë?”, “çfarë nuk është bërë?” dhe “si duhet bërë në të ardhmen menaxhimi i policisë?”, me qëllim që policia të jetë efiçente në përmbushjen e misionit të saj. Të bësh këtë analizë, është një ndërmarrje e vështirë, për faktin se:

Së pari, bëhet fjalë për një periudhë të gjatë kohore, - rreth çerek shekulli veprimtari policore, - me uljet dhe ngritjet e saj, ku në 10-12 vitet e para ka qenë dominues “drejtimi militar i policisë”. Ndërkohë, edhe pse në gjysmën tjetër të kësaj periudhe është implementuar menaxhimi modern i policisë, nuk mund të themi se ka dominuar, pasi ende ka ende nevojë për të përgatitur menaxherë të zotë të policisë, nga nivelet më të ulëta e deri te nivelet e larta të saj.

Së dyti, është një periudhë ku janë evidentuar ndryshime të vullshme në shoqëri, për rrjedhojë edhe në policinë shqiptare. Kjo sepse ndryshimet në shoqëri, diktuan nevojën e ndryshimeve edhe të statusit ligjor të policisë dhe shndërrimin e saj nga forcë militare në shërbim publik, gjë që nuk ishte e lehtë të bëhej sepse kërkonte një menaxhim të mirë të policisë, që përveç të tjerave pengesë ishte dhe mentaliteti që ekzistonte brenda radhëve të policisë dhe sidomos nga drejtues që ishin futur në polici pa respektuar

Ibro, A. dhe Selmani, B.
« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹¹ Yzeiri, *Menaxhimi*, (fq. 15-18).

kriteret e rekrutimit apo të ardhur nga ushtria. Këta dhe elementë të tjerë, e bëjnë këtë analizë të vështirë, megjithatë, jemi përpjekur që të hedhim dritë mbi një përvojë të policisë në drejtim të menaxhimit të saj në një periudhë kohore, por dhe pa pretenduar që kjo analizë do të jetë e vetme. Qëllimi është që mbi bazën e saj të nxirren përfundime e të jepen rekomandime sadopak të vlefshme për të ardhmen.

Gjithashtu, kjo analizë nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do t'u referoheshim disa prej përcaktimeve më të spikatura mbi menaxhimin si proces, të bëra nga autorë të ndryshëm, të cilat do i risjellim në kujtesë, ashtu sikurse me kënaqësi do t'u referoheshim edhe mendimeve të shprehura nga specialistë me përvojë, në drejtimin e Policisë Shqiptare në këto vite, por edhe më parë, - mbi menaxhimin e policisë. Kjo do të ndihmojë për të kuptuar më mirë se si është menaxhuar policia shqiptare në këtë periudhë. Lidhur me termin "*menaxhim*", janë dhënë përkufizime të shumta, por që në thelb ato konvergojnë me njëra-tjetrën dhe janë shumë të përafërta, si p.sh:

Brech (1975), e përcakton menaxhimin si "*një proces social që ka përgjegjësi për planifikimin dhe rregullimin efektiv dhe ekonomik të operacioneve të një organizate me qëllim që të arrihet një objektiv apo një detyrë e dhënë*"; P. Drucker (1977), ka thënë se: "*Menaxhimi ka tre detyra kryesore, të cilat janë: të realizojë qëllimin dhe misionin specifik të organizatës, ta bëjë punën produktive dhe punëtorin që ta arrijë atë, si dhe të menaxhojë impaktet dhe përgjegjësitë sociale*". F. Luthanas dhe R. Hodgets (Luthanas & Hodgets, Business 1992), japin një përkufizim të menaxhimit, si: "*Menaxhimi është procesi i përcaktimit të objektivave dhe e koordinimit të përpjekjeve të punonjësve për t'i arritur ato*". Disa studiues të tjerë e japin përkufizimin e menaxhimit në formë më adekuate, duke mbetur brenda thelbit të tij kur thonë se: "*Menaxhimi është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative*". Henri Fayol (H.Fayol, 1917) shprehet se: "*të menaxhosh do të thotë të parashikosh e të planifikosh, të organizosh, të komandosh, të koordinosh dhe të kontrollosh*".⁶

Nga përcaktimet e mësipërme vërehet se, menaxhimi është një proces kompleks, që nënkupton veprimtarinë e planifikimit, të organizimit, të drejtimit dhe të kontrollit të realizimit të objektivave që ke përcaktuar më parë. Nga përcaktimet e mësipërme, e sidomos të H. Fayol, janë formuluar dhe aplikohen edhe sot funksionet e menaxhimit.

Shumë specialistë të policisë shqiptare, jo që vetëm kanë shërbyer në këtë drejtim, por edhe kanë hedhur në letër eksperiencën e tyre, të botuar në buletine e revista periodike të Akademisë së Policisë, duke dhënë kështu një kontribut të veçantë në drejtim të menaxhimit. Ndër ekspertët me përvojë në Policinë e Shtetit është edhe dr. Bajram Yzeiri, i cili në librin e tij "*Menaxhimi i Policisë*" (2003), duke u mbështetur në konceptet bazë të menaxhimit modern dhe në përvojën e tij personale, trajton me profesionalizëm koncepte të menaxhimit të policisë, argumenton nevojën e konceptimit dhe aplikimit të parimeve të menaxhimit modern edhe në fushën e policimit; argumenton nevojën e ngritjes së nivelit të drejtimit e menaxhimit në polici, në përshtatje me rrethanat e reja të një shoqërie demokratike dhe sipas standardeve të policimit modern; argumenton shkencërisht ndikimin që ka menaxhimi modern në performancën e shërbimit policor dhe për rrjedhojë, në ruajtjen e rendit dhe rritjen e sigurisë publike. Vlerat e koncepteve të dhëna në këtë libër, konsistojnë në ndihmesën e madhe për krijimin e bazave teorike dhe praktike të artit të menaxhimit modern

⁶ Mazreku, Ibish. *Bazat e Menaxhimit*, (fq. 2-13).

politor duke dhënë njëkohësisht një kontribut të rëndësishëm për brezat e ardhshëm të punonjësve të policisë shqiptare.

Fakt është se, në policinë shqiptare termi “menaxhim” ka filluar të futet në fund të vitit 1999, pasi deri atëherë, në polici përdorej termi “komandim dhe drejtim”, gjë që kushtëzohej nga statusi që kishte policia dhe nga praktika e organeve tona administrative. Ndër vite është kultivuar mendimi dhe është zbatuar praktika që të njohim e të zbatojmë aktet ligjore e rregulloret si dhe të hartojmë programe pune të karakterit deklarativ, të cilat ishin të vështira që të mateshin për masën e zbatimit të tyre. Gjithashtu është fakt, se deri në fund të 1999-ës, në Akademinë e Policisë nuk kishte programe për menaxhimin edhe pse ishte nevojë shumë e domosdoshme, ashtu siç nuk kishte as literaturë profesionale për të njohur eksperiencën e policive Perëndimore. Programet mbi menaxhimin kanë filluar të zhvillohen në fund të vitet 1999, nga misionet policore që asistonin policinë shqiptare si, MAPE (i BEP-it) dhe ICITAP (i SHBA-së), të cilat filluan trajnimin me koncepte të planifikimit strategjik dhe “menaxhimit policor, të cilat vazhdojnë edhe sot.

Menaxhimi, konsiderohet si shkencë, prandaj çdo menaxher apo drejtues policie i çdo niveli duhet ta studiojë e të vërë në zbatim parimet e tij, ndërsa si praktikë, ai konsiderohet edhe si art, sepse gjithmonë duhet të gërshetohen aftësitë praktike dhe gjykimi personal i vetë drejtuesit. Ashtu sikurse duhet kuptuar, se menaxhimi nuk lind njëkohësisht me diplomimin apo emërimin e punonjësit të policisë në detyrë, por ai mësohet nëpërmjet shkollimit, trajnimit dhe eksperiencës praktike. Elementët më të rëndësishëm të menaxhimit policor janë: kualifikimi i vazhdueshëm, eksperiencia e punës, aftësitë e mira organizuese e drejtuese dhe cilësitë e mira të personalitetit, të cilët janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe duhen përsosur në vazhdimësi. Mosfunksionimi i njërit prej tyre, dëmton punën e policisë.⁷

Hierarkia e menaxhimit në polici është e ndërtuar në vartësi të organizimit të strukturave dhe personelit të policisë. Personeli policor ndahet në disa nivele, ndarje që është bërë duke marrë për bazë detyrat, funksionet dhe atributet e secilit punonjës. Bazuar në këtë ndarje, bëhet edhe ndarja e menaxhimit në disa nivele. Bazuar në strukturën e sotme të Policisë së Shtetit, dallojmë tre nivele menaxhimi:

Niveli i parë (grada nënkomisar, komisar) - mbikëqyrësit e punonjësve të policisë të gradës inspektor. Aftësia më e rëndësishme në këtë nivel është *aftësia mbikëqyrëse* dhe *kontrolluese*, pasi ata kanë përgjegjësinë e drejtimit direkt të trupës së policisë e të kontrollit mbi të.

Niveli i dytë (grada kryekomisar, drejtues, drejtues i parë) – ata që kanë përgjegjësi për të hartuar plane taktike e operative në zbatim të planeve të menaxhimit strategjik. Aftësia më e rëndësishme është *aftësia njerëzore* për të realizuar bashkëpunimin midis nivelit të parë e të dytë, për të marrë vendime e për të realizuar detyrat. Këtu merr rëndësi dhe *aftësia konceptuale*, pasi atyre u duhet të analizojnë probleme dhe të bashkëpunojnë me nivelin e tretë, i cili kërkon informacione, sugjerime, ndërsa në fundi vijnë *aftësitë teknike*.

Niveli i tretë (drejtues i lartë dhe drejtues madhor) - përfshihen funksionarë të policisë të rolit të lartë e madhor, të cilët kanë përgjegjësi për të planifikuar punët e strukturës policore, për t'i organizuar ato, për të marrë vendime e për të udhëhequr policinë. Këtu merr përparësi *aftësia diagnostikuese* dhe *konceptuale*, sepse duhen

ibro, A. dhe Selmani, B.
« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

⁷ Yzeiri, *Menaxhimi*, (fq. 35).

kuptuar e analizuar problemet e fenomenet e brendshme të policisë, të situatës së rendit publik e të mjedisit shoqëror dhe duhen përcaktuar strategjitë dhe alternativat e zgjidhjes dhe më pas vijnë *aftësia njerëzore* dhe *aftësia teknike*.

Pra siç kuptohet, menaxhimi si proces nuk është e drejtë dhe detyrim vetëm i drejtuesve të niveleve të larta, por ai është e drejtë dhe detyrim për çdo drejtues policie, të çdo niveli, sepse të gjithë punonjësit e policisë, në çdo pozicion, bëjnë menaxhim gjatë kryerjes së detyrës. Këtë mund ta themi edhe por punonjësit e gradës inspektor. Për sa më sipër dhe bazuar në përcaktimet për menaxhimin në tërësi dhe në opinionet e specialistëve të policisë të trajtuara më lart, mendoj se: *Menaxhimi policor* është procesi që përfshin *analizën e gjendjes së rendit publik, të organizatës së policisë, të faktorëve pozitivë dhe negativë që ndikojnë në aktivitetin e saj, veprimtarinë e planifikimit të vizionit, misionit dhe objektivave që do të arrihen, organizimin e punës me personelin, nxitjen dhe motivimin e tij, udhëheqjen për realizimin e objektivave të planifikuara dhe mbikëqyrjen e realizimit të tyre*. Pra, si elementët kryesorë të menaxhimit policor janë: analiza e gjendjes së rendit publik, analiza e gjendjes së organizatës policore dhe realizimi i funksioneve të menaxhimit.

3. Menaxhimi i policisë në periudhën e pas viteve '90

Analizën e menaxhimit të policisë shqiptare në periudhën e pas viteve '90, për lehtësi studimi, e kemi bërë të ndarë në tre faza, duke identifikuar çdo fazë si më poshtë.

3.1. Faza e parë: Menaxhimi i policisë shqiptare në vitet 1990-1996

Menaxhimi i policisë shqiptare në vitet 1990-1996 – si periudha e ndryshimit të sistemit politik, ekonomik e shoqëror në Shqipëri dhe hyrjen e vendit në rrugën e proceseve demokratike e reformave të thella institucionale. Pas përmbysjes së sistemit totalitar në vitet 1990-1991 dhe shpalljes së pluralizmit politik, Shqipëria hyri në rrugën e proceseve demokratike e të reformave të thella institucionale, duke përfshirë këtu edhe policinë. Ndryshimet për të, filluan menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 1991 dhe synonin organizimin e strukturimin e shpejtë të policisë në të gjitha nivelet, sipas përvojës së policive të vendeve të evropiane dhe krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për policinë e njëkohësisht përshtatjen e tij me ndryshimet që kishin ndodhur në Shqipëri. Këtij qëllimi i shërbyen ndryshimet në fushën e organizimit dhe strukturimit të policisë, në nivel qendror e atë vendor, krijimi i MRP me struktura e përqsaje Perëndimore, miratimi i disa ligjeve, si, ai për depolitizimin dhe departizimin e policisë, ligji për Policinë e Rendit, etj, - ndryshime këto, që përbënin një bazë të mirë për startin e policisë shqiptare drejt afrimit me policitë evropiane.⁸

Po në këtë periudhë, pas protestave, gjendja në vend në pikëpamje të rendit publik, ishte ende e pastabilizuar: në shumë zona kishte ende kaos dhe anarki; strukturat vendore ishin të paqarta për detyrat në situatën e krijuar; legjislacioni, me gjithë ndryshimet nuk gjente zbatim; policia ishte në tërësi inefficente; kishte braktisje të detyrës, krizë identiteti dhe publiku ishte skeptik për rolin dhe efikasitetin e policisë; kishte mungesë mjetesh dhe përvoje nga policia. Kësaj gjendje i shtohej edhe kriza e

libro, A. dhe Selmani, B.
«Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

⁸ Shkëmbi, Hasan. Buletini Shkencor. Tiranë: Akademia e Policisë "Arben Zylyftari", gusht 2000, (fq. 51-52).

⁹ Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë, (DCAF-2012), (fq. 47).

përgjithshme ekonomike, sociale, politike që përjetonte shoqëria shqiptare pas përmbyesjes së sistemit komunist.

Kjo situatë, është karakteristikë e vendeve në tranzicion, vende të cilat kalojnë ndryshime të shpejta dhe rrënjësore dhe zakonisht një transformim i tillë është kryesisht politiko-social, kur kalohet nga një lloj diktature në një demokraci, në lindje. Një problem tjetër që vihet re, po në këtë periudhë, është se ndryshimet e shpejta shoqërore dhe politike shoqërohen me rritje të kriminalitetit dhe faktet e kohës flasin për rritje të veprave penale dhe shtim të autorëve të tyre, gjë që përbënte një fenomen shqetësues e të rrezikshëm për shoqërinë demokratike në fillimet e saj. Në këto kushte, autoritetet ligjzbatuese reagojnë ndaj këtij fenomeni, jo duke përcaktuar shkaqet e një situatë të tillë, por duke shtuar në mënyrë thelbësore numrin e punonjësve të policisë duke cenuar apo mosrespektuar standardet e rekrutimit⁹ (një gjë e tillë ndodhi edhe në vendin tonë në vitet 1994-1996, por edhe në vitin e mbrapshtë 1997).

Analizën e policisë dhe mënyrën e menaxhimit të saj në këtë periudhë, e kemi bërë duke e vështruar në dy periudha kohore: *e para*, në vitet 1992-1994 dhe *e dyta* në vitet 1994-1996, të cilat, ndryshojnë nga njëra tjetra. Në vitet 1992-1994, qeveria e dalë nga këto zgjedhje parashikoi në programin e saj masa të shpejta në dy drejtime kryesore: reformimin e thellë të institucionit të policisë dhe stabilizimin e situatës së rendit publik. Megjithëse pa një strategji të qartë, ajo filloi punën për reformimin e policisë shqiptare, duke ristrukturuar në një kohë të shpejtë MRP, policinë në qendër e atë vendore, ndryshime që u pasuan nga rinovimi i personelit të policisë në të gjitha nivelet, në qendër e në bazë (kryesisht drejtuesit) si dhe në drejtim të legjislacionit. Në këto vite, përveç punës së gjithanshme për ristrukturimin e policisë, po i kushtohej vëmendje e veçantë edhe punës për sigurimin e rendit publik, luftës kundër krimit dhe cenimeve të rendit duke e shtrirë këtë aktivitet gradualisht në gjithë territorin e vendit. Puna e bërë në këtë drejtim nga policia, bëri që brenda një kohe të shkurtër ajo të dominojë krimin, të eliminojë kaosin e anarkinë dhe të rrisë sigurinë për qytetarët. Në këtë drejtim ndikuan disa faktorë, të cilët janë:

- nga drejtuesit e MRP e të Policisë, u synua në menaxhimin e policisë, edhe pse kjo gjë u bë me shumë mangësi, për shkak të mungesës së përvojës;
- motivimi i policisë, nëpërmjet rritjes së pagës e shpërblimeve për rezultate pozitive;
- pranimi i zgjidhjes së re politike nga të gjithë aktorët politike e shoqërorë të kohës;
- qetësimi i situatës dhe distancimi i njerëzve nga cenimet e rënda të rendit, shkeljet e ligjit;
- dëshira e njerëzve për një jetë të qetë e normale dhe për të pasur siguri për jetën;
- prania ende, e specialistëve të policisë kryesisht në strukturat vendore të saj.

Ndërsa, në vitet 1994-1996, evidentohet një situatë krejt tjetër, ku performanca e policisë u dëmtua rëndë, gjë që ndikoi në situatën e rendit publik dhe në thellimin hendekut polici-publik. Shkaku kryesor i kësaj situatë ishte se drejtuesit e policisë nuk respektuan kërkesat për menaxhimin e saj. Përveç këtij shkaku, faktorë të tjerë që ndikuan në krijimin e kësaj situatë ishin se: *së pari, u shkëlën kërkesat në drejtim të rekrutimit dhe administrimit të personelit* (revanshi që u vu re në largimin e personelit ekzistues pa bërë diferencime midis tyre, emërimi në funksione drejtuese i personave

Libro, A. dhe Selmani, B.
« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹⁰ "Rebelimi i vitit 1997", sipas medias së kohës.

të pa arsim profesional apo të paarsimuar (rreth 70 % e personelit drejtues të policisë ishte pa arsim policor), të korruptuar, pa reputacion, pa vlera intelektuale e profesionale, rekrutimi në polici nëpërmjet mashtrimit (diplomave false), rryshfetit, korrupsionit, kritereve politike, nepotizmit, krahinorizmit dhe angazhimi hapur i punonjësve të policisë në fushatat elektorale të partive politike. *Së dyti, u shkelën kërkesat në drejtim të formimit profesional të personelit të policisë*; u vu re paaftësi e theksuar profesionale në radhët e punonjësve të policisë, - kjo për shkak të mosrespektimit të kritereve të rekrutimit, mungesë e trajnimit të vazhdueshëm, etj.) - duke sjellë si pasojë që strukturat policore, kryesisht ato vendore, në ngjarjet e vitit 1997, të mos rezistonin, e të braktiseshin. Policia doli jashtë misionit të saj, u gjend e dobët dhe nuk mundi të përballonte dot sfidat. Kjo bëri që policia të futej në “ringun e kaosit e të anarkisë së vitit 1997, e papërgatitur, e për rrjedhojë dështoi në kryerjen e misionit të saj.

3.2 Faza e dytë: Menaxhimi i policisë shqiptare në vitet 1996-1997

Menaxhimi i policisë shqiptare në vitet 1996-1997 - periudha që korrespondon me anarkinë, trazirat civile, me ngjarje të rënda kriminale, me cenimet masive të rendit publik dhe me rënien e institucioneve shtetërore në Shqipëri. Në zgjedhjet për deputetë të vitit 1996, u evidentuan elementë të komprometimit të rëndë të procesit zgjedhor (të cilat tashmë janë të njohura), komprometim që kulmoi me dhunën policore ndaj opozitës më 26 maj 1996. Kjo situatë dhe sinjalet e forta që vinin për humbje të parave në firmat piramidale, ishin prologu i asaj që e priste Shqipërinë dhe policinë shqiptare në vitin 1997. Kjo bëri që në Shqipëri të shpërthenin protesta, të cilat gradualisht u bënë masive dhe të dhunshme, duke u bërë shkak për cenime të rënda të rendit publik, situata që po precipitonin me shpejtësi dhe po paralajmëronin atë që Shqipëria do të përjetonte: një nga dramat më të mëdha e më të rënda të historisë së saj. Përshkallëzimin më të madh në drejtim të cenimit të rendit publik, Shqipëria e përjetoi në mesin e muajit janar të vitit 1997 (24 janari i 1997-ës evidentohet si data e fillimit të rebelimit masiv)¹⁰, ku si rezultat, në shumë qytete të vendit ndodhën cenime të rënda të rendit dhe të sigurisë publike, bllokime të rrugëve nacionale e deri në sulme të organizuara ndaj institucioneve të ndryshme shtetërore. Për të bërë analizën e kësaj periudhe, kemi shtruar për përgjigje pyetjen: “Çfarë stili menaxhimi u adoptua nga policia në fillim dhe gjatë trazirave, pse policia nuk u bëri dot ballë kësaj situatë, pse institucionet e policisë u shkatërruan menjëherë dhe pa rezistencë?”.

Faktorët që do të rendisim më poshtë, të cilët janë evidentuar nga analiza e veprimeve të policisë në ngjarjet e viteve 1996-1997, janë edhe përgjigja e pyetjes së mësipërme. Rezulton se:

- policia nuk studioi turmat dhe psikologjinë e tyre, por zgjodhi rrugën e ushtrimit forcës represive dhe brutale ndaj protestuesve, duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtat dhe lirive themelore të njeriut;
- drejtuesit e policisë aplikuan stil ushtarak policimi, që kushtëzohej statusi ligjor i saj;
- mungesa e aftësive menaxhuese bashkëkohore të policisë;
- mosvlerësimi në perspektivë i ngjarjeve të vogla në dukje, mosnjohja më parë e situatave të tilla dhe i elementëve të menaxhimit të tyre;
- impakti fals dhe i paefektshëm i reformave, në vitet 1996-1997, në policinë shqiptare.

Libro, A. dhe Selmani, B.
 «Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike»

Policimi dhe Siguria
 nr.2, 2016

- tendenca e drejtuesve të policisë për të kufizuar të drejtën, për të protestuar nëpërmjet dhunës dhe presionit, jo vetëm nuk i shmangu ato, por shërbeu si bumerang ndaj rendit e sigurisë publike, madje edhe ndaj institucioneve qeverisëse;
- mungesa e motivimit në punë, kriza e besimit e kultivuar në radhët e policisë sidomos në vitet 1990-1996, frika, braktisja në masë e detyrës me fillimin e trazirave;
- lëvizjet pa kriter të personelit apo për motive politike kultivuan ndjenjën e përkohshmërisë në detyrë;
- në drejtim të menaxhimit të personelit u vu re rekrutimi i një numri të madh i personelit policor nga ushtria, e cila e shtoi akoma më tepër karakterin ushtarak të policisë.

Prania e elementëve të mësipërm tregon për keqmenaxhimin dhe keqpërdorimin e policisë nga pushteti dhe drejtuesit e policisë. Masat e marra, bazuar në “parimet” e keqmenaxhimit, jo vetëm që nuk ndikuan në ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, por bënë efektin e kundërt, shkaktuan acarimin e turmave, cenimin e rëndë të rendit publik, bënë që institucionet shtetërore e të policisë të shkatërrohen, duke sjellë si pasojë humbje të konsiderueshme jetësh njerëzore (shumë nga vetë policia) dhe dëme të pallogaritshme materiale.

3.3 Faza e tretë: Menaxhimi i policisë shqiptare pas vitit 1997

Menaxhimi i policisë shqiptare pas vitit 1997 - si periudha që korrespondon me zhvillimet në Shqipëri pas anarkisë dhe me transformimet e mëdha të policisë shqiptare dhe shndërrimin e saj në institucion të administratës shtetërore. Periudha, pas anarkisë së vitit 1997 e gjeti vendin tonë me institucione të rrënuara, me mungesë të theksuar rendi dhe sigurie, kriminalitet të lartë, mbizotërimin të bandave të armatosura, - të cilat kishin bllokuar rrugët nacionale e grabisnin apo terrorizonin njerëzit, - me një popullsi të superarmatosur deri dhe me armë të sofistikuara e eksplozivë. Gjatë trazirave të këtij viti humbën jetën rreth 3800 shtetas shqiptarë. Në këtë situatë, qeveria e dalë pas zgjedhjeve të qershorit 1997, përcaktoi si objektiva prioritare: ringritjen dhe riorganizimin e policisë në të gjitha nivelet, normalizimin e situatës së rendit dhe sigurisë publike në të gjithë territorin si dhe çarmatimin dhe grumbullimin e armëve që ndodhej në duart e popullatës.¹¹

Në raport me institucionet e tjera ligjzbatuese, policia pësoi dëme të mëdha, jo vetëm materiale. Më i madh e i më i ndjeshëm ishte dëmi njerëzor, humbja e jetëve të punonjësve të policisë. Në ngjarjet e vitit 1997, u dogjën dhe u shkatërruan plotësisht 10 komisariate të policisë, kurse pjesa tjetër pësoi dëme të mëdha si dhe u vodh apo u dëmtua mbi 80% e teknikës dhe automjeteve të policisë. Rikuperimi i dëmeve materiale kërkonte buxhet të fuqishëm, burime njerëzore të paimplikuara e të kualifikuara si dhe kohë të mjaftueshme. Sipas fakteve të kohës, rezultoi se: brenda dy vjetësh përfundoi rindërtimi i godinave të dëmtuara, ndërsa pajisja e policisë shqiptare me mjete e logjistikën e nevojshme u realizua nga ndihma e vendeve donatore të BEP-it dhe Turqisë.

Prioritet i parë, ishte *rikrijimi i strukturave policore* që kishin të bënin me luftën kundër krimit, të çarmatimit, forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë, grupet e gatshme. Pjesë e këtij procesi ishte edhe riaktivizimi i strukturave të mëparshme, të

Libro, A. dhe Selmani, B.
 « Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹¹ Shkëmbi, Hasan. *Buletini Shkencor*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zyllyftari”, gusht 2000, (fq. 59-61).

paralizuara. Një hap pozitiv në këtë drejtim ishte organizimi i policisë në nivelin periferik, me krijimin e drejtorive të policive të Qarqeve, bazuar edhe në sugjerimin e bërë nga misionet e asistencës policore ndërkombëtare. Ringritja e strukturave policore kishte të bënte edhe me përcaktimin dhe vendosjen në krye të tyre të punonjësve të policisë të aftë profesionalisht, me eksperiencë, të vendosur, me integritet e të përgjegjshëm. Bazuar në këto kërkesa dhe duke pasur parasysh “masakrën” që kishte ndodhur në vitet e mëparshme, me personelin e policisë si dhe duke iu referuar të dhënave të përmendura në trajtesat e mësipërme ku 80% e personelit policor ishte pa arsim e kualifikim policor, prioritar ishte jo vetëm rekrutimi i kandidatave me formim profesional, por edhe hapja e zhvillimi i kurseve për trajnimet dhe kualifikimet profesionale. Mbi këtë bazë, filloi puna për ndryshimin e stafëve drejtuese të policisë sipas niveleve paralelisht me rekrutimin në polici, gjë që solli rikthimin e shumë specialistëve të policisë, të aftë e të kualifikuar dhe njëkohësisht filloi puna me kurset për trajnimet dhe kualifikimin e personelit të rekrutuar apo ekzistues nga misionet që asistonin dhe këshillonin policinë shqiptare si, MAPE, ICITAP, INTERFORCE (të cilat deri në vitin 2000 kishin trajnuar rreth 4000 punonjës policie).

Masat e marra në këtë kohë tregonin se *drejtuesit e rinj të policisë shqiptare* po i kushtonin vëmendje të veçantë dhe po kthenin sytë në drejtim të kualifikimit të personelit, me koncepte dhe parime mbi menaxhimin policor, si një nga faktorët thelbësorë që do të ndikonte drejtpërsëdrejti në përmirësimin e shpejtë të gjendjes së organizatës policore dhe të situatës së rendit dhe rritjen e sigurisë publike dhe do të hidhte themelet e sigurta, që ngjarjet e 1997-ës të mos përsëriteshin më. Prioritet i dytë, po aq i rëndësishëm sa i pari, ishte dhe *lufta ndaj kriminalitetit*, i cili dominonte pjesën dërrmuese të territorit. Në këtë kuadër ishin dhe veprimet e ndërmarra nga strukturat policore, në qendër dhe në bazë, të mbështetura dhe nga forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë për rivendosjen e rendit publik dhe me synim rritjen e sigurisë publike. Në këtë periudhë vëmë re elementët e parë të policimit në komunitet, siç ishin thirrjet që policia i bënte publikut për të mbështetur atë, për tu distancuar nga shkeljet e ligjit e veprimet kriminale e për të denoncuar shkeljet e ligjit, duke nënkuptuar se bashkëpunimi me komunitetin, jo vetëm që do të ishte një ndër faktorët kryesorë që do të shpejtonin përmirësimin e situatës së rendit publik, por do të krijonte edhe terrenin e favorshëm për thellimin e bashkëpunimit polici-komunitet. Mbështetja e qeverisë dhe faktorit ndërkombëtar për policinë, veprimtaria e kualifikuar e policisë nëpërmjet një menaxhimi të mirë dhe bashkëpunimit me komunitetin, ishin një trinom përcaktues që bëri të mundur, që deri në fund të vitit 1999, të arrihet që të përmirësohet dukshëm gjendja e organizatës së policisë dhe situata e rendit në të gjithë territorin.

Në analizën e periudhës pas vitit 1997, si periudha që shënon kthesën dhe transformimin rrënjësor të policisë shqiptare dhe shndërrimin e saj në shërbim publik, do të ndalemi në evidentimin e faktit të menaxhimit pozitiv të policisë në tërësi, duke u nisur nga konceptet dhe parimet e menaxhimit modern. Duke argumentuar se pse drejtuesit e policisë vlerësuan si faktor themelor *menaxhimin e policisë*, do të evidentojmë rezultatet pozitive që çuan në transformimin e policisë, rezultate që erdhën si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e procesit të mirëmenaxhimit.

Pas analizave të kryera mbi menaxhimin e policisë, në të gjitha aspektet, - gjatë viteve 1990-1997 -, e defekteve të konstatuara, të cilat ndikuan në situatën e rendit publik, ishte e domosdoshme që të merreshin masa që ato të mos përsëriteshin në të ardhmen. Në këtë kuadër, drejtuesit e Policisë hartuan strategjitë e zhvillimit të policisë,

Libro, A. dhe Selmani, B.
 «Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike»

Policimi dhe Siguria
 nr.2, 2016

me qëllim eliminimin e mangësive dhe transformimin e saj, pasi këtë e kërkonte, gjendja e rendit publik, përmirësimi dhe rritja e sigurisë për qytetarët, funksionimi i institucioneve dhe garantimi i zbatimit të ligjit, gjë që përputhej me qëllimin imediat të Qeverisë, të MRP dhe Policisë së Shtetit. Këto ishin njëkohësisht edhe arsytet që diktuan kryerjen e reformave për transformimin e policisë, reforma të cilat u iniciuan nga qeveria shqiptare e u konkretizuan në VKM, nr. 384, datë 28.7.1999, i cili jo vetëm që doli në një moment shumë të rëndësishëm për të ardhmen e policisë, por ishte një shans i favorshëm për një ndryshim koherent dhe të përshpejtuar të policisë.

Dokumenti bazë, i hartuar për këtë qëllim në vitin 1999-2000, quhej “*Strategjia e Reformës në Polici*”, filozofia kryesore e të cilës ishte shndërrimi i policisë shqiptare në institucion të administratës shtetërore, të shërbimit ndaj komunitetit bazuar në parimet e policimit demokratik. Dokumenti i hartuar ishte një ekspertizë e kualifikuar e gjendjes së këtij institucioni, e mjedisit ku ai vepron, e vlerave që ka ruajtur në tranzicion, e mangësive që ka demonstruar në vitet e mëparshme si dhe përcaktoi me rigorozitet profesional vizionin, misionin, synimet dhe objektivat për reformimin e tij.¹² Kjo strategji ishte afatmesme (2000-2003) dhe kishte si objektiva të saj: krijimin e një infrastrukture ligjore e nënligjore moderne, krijimin e një policie të aftë profesionalisht për të mbrojtur rendin dhe sigurinë publike, të paanshme politikisht, fleksibël dhe dinamike në veprim, përcaktimin e standardeve të reja të rekrutimit, formimit e kualifikimit, forcimin e marrëdhënieve të policisë me komunitetin, bashkëpunimin me jashtë dhe ngritjen e standardeve të punës dhe teknologjisë së policisë.

Asnjë ndryshim nuk do të kishte ndodhur në policinë shqiptare nëse qeveria, drejtuesit e MRP e të Policisë nuk do të vlerësonin menaxhimin, si faktor themelor për ngritjen, përmirësimin e performancës dhe futjen e policisë në rrugën e ndryshimit të domosdoshëm. Këtij vlerësimi iu shtua edhe mbështetja nga misionet që asistonin policinë shqiptare, në drejtim të kualifikimit të personelit, të ngritjes së strukturave policore efçente dhe të suportit logjistik. *Faktorët negativë* të evidentuar në veprimtarinë e policisë, të cilët ndikuan që procesi i menaxhimit modern policor të vlerësohej si faktor themelor për përmirësimin rrënjësor të situatës së brendshme të organizatës së policisë dhe për rrjedhojë edhe të situatës së rendit publik, ishin:

a. *Mangësitë në drejtim të legjislacionit policor.* Këto konsistonin në faktin se në legjislacionin ekzistues nuk përcaktohej qartë pozicioni i policisë në raport me institucione të tjera të shtetit. Misioni i saj, kishte boshllëqe, si pasojë e mungesës së eksperiencës, krijonte kushte për mungesë përgjegjësie në kryerjen e detyrave, nuk motivonte punonjësit e policisë dhe krijonte kushte për korrupsion në radhët e saj, etj.

b. *Statusi ligjor i policisë.* Statusi si forcë e armatosur, i jepte asaj karakter militar, paraqitej në publik si forcë shtypëse e represive, ishte ndërtuar mbi principet e jetës së kazermës, duke qenë e tillë nuk mund të ushtronte atributet e saj në mjedise publike, në formacione të vogla dhe shpesh herë nga një individ, nuk krijonte mundësi për vetëveprim dhe autonomi në vendimmarrje, etj.

c. *Pasojat e rënda për rendin publik nga vetë sjellja e policisë.* Për shkak të mungesës së përvojës në drejtim të menaxhimit të saj, kishin ardhur pasoja jo vetëm për rendin publik, por edhe për vetë organizatën e policisë sepse policia ishte shmangur nga misioni i saj, ishte larguar nga komuniteti, ishte kthyer në një shkelëse e të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ishte shfaqur si polici e varur politikisht; sjellja brutale e saj kishte

Ibro, A. dhe Selmani, B.
« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

^{1 2} Shehu, Besnik. *Buletini Shkencor*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, dhjetor 2000, (fq. 7-19).

acaruar marrëdhëniet me komunitetin, gjë kishte ndikuar së tepërmi në cenimin e rendit e të sigurisë publike.

ç. *Mungesë e theksuar besimi e publikut te policia.* Për shkak të sjelljes së policisë, në periudha të caktuara u vu re se policia i shërbente pushtetit dhe jo individit, pra, nuk ishte shërbim publik.

d. *Mangësi në kriteret e rekrutimit të personelit të policisë.* Boshllëqet në legjislacion, janë shfrytëzuar për të futur në radhët e policisë persona pa integritet, pa arsim policor, të inkriminuar e me dokumente të falsifikuara, gjë që solli pasoja shumë të rënda e të dukshme në gjendjen e rendit e sigurisë publike.

dh. *Mangësi në drejtim të kualifikimit të personelit të policisë.* Kishte mungesë kualifikimi profesional dhe veçanërisht mungesë eksperience në drejtim të menaxhimit policor, eksperiencë që filloi të futej në policinë shqiptare nga misionet këshillimore evropiane në fund të 1999-ës. Duke pasur parasysh këta dhe faktorë të tjerë, qeveria, MRP dhe Policia e Shtetit morën masa e përcaktuan detyra për transformimin rrënjësor të policisë. Dy nga rezultatet dhe treguesit më të rëndësishëm të ndryshimit thelbësor të policisë shqiptare dhe veprimtarisë së saj, janë:

1. *Ndryshimet thelbësore në legjislacionin për policinë.* Miratimi i ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” ishte një hap cilësor sepse ai solli shndërrimin e policisë shqiptare nga forcë militare në institucion të administratës shtetërore, pra në shërbim publik. Ky ligj kishte shumë rëndësi sepse, jo vetëm që për herë të parë përcaktoi se Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, por për herë të parë përcaktoi misionin e saj në një shoqëri demokratike, misioni i së cilës ishte “të mbrojë rendin dhe sigurinë publike, si dhe të garantojë zbatimin e ligjit”.¹³ Ligjet për Policinë e Shtetit, të vitit 2007 dhe 2014, përmirësuan dhe konsoliduan më tej rolin e policisë shqiptare si shërbim publik si dhe përmirësuan misionin saj.

2. *Përmirësimi në vazhdimësi i situatës së rendit publik.* Si rezultat i menaxhimit të mirë të policisë, suportit të vazhdueshëm nga misionet e asistencës pranë policisë shqiptare, - MAPE, PAMECA, ICITAP, INTERFORCE, - kualifikimit të vazhdueshëm të personelit të saj, shmangies gjithnjë e më shumë të saj nga ndikimi politik dhe udhëheqjes vetëm nga ligji, u mundësua që pasojat e shkaktuara në vitin 1997, 1998 e 2000 të minimizoheshin. Fokusimi, gjithnjë e më shumë te lufta kundër kriminalitetit e veçanërisht kundër trafikëve të paligjshme, bashkëpunimit më të mirë me institucionet ligjzbatuese, (prokurori, gjykatë), pushtet lokal dhe me komunitetin, bëri që policia deri në fund të vitit 2000 të ushtronte autoritetin e saj në gjithë territorin e vendit.

Disa tregues të tjerë jo më pak të rëndësishëm të transformimit të policisë, ishin:

- Rritja e nivelit profesional të policisë. Policia e Shtetit përcaktoi me ligj kriteret rigoroze për formimin dhe kualifikimin e personelit që merrej rishtas apo atij ekzistues. Deri në fund të vitit 2000 nga misionet e asistencës policore në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, rezulton se ishin trajnuar mbi 4000 punonjës policie.

- Përcaktimi i kriterëve rigoroze për përzgjedhjen e personelit. Kriteret për rekrutimin e personelit policor u bënë rigoroze (neni 16, ligjit 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”) me qëllimi që në radhët e policisë të mos futeshin më persona pa arsim përkatës policor, të inkriminuar, pa integritet moral, etj., siç kishte ndodhur

¹³ Ligj “Për Policinë e Shtetit”, nr. 8553, datë 25.11.1999, (nenet 1,16).

më parë.

- Ndikimi i politikës në veprimtarinë e policisë u ul ndjeshëm. Si rezultat i përmirësimit të legjislationit dhe ndikimit të misioneve këshillimore që asistonin policinë shqiptare u ul ndjeshëm ndikimi i politikës në Policinë e Shtetit, nëpërmjet përcaktimit me ligj të detyrimeve në lidhje me normat e sjelljes politike për punonjësit e policisë.

- U rrit bashkëpunimi ndërkombëtar dhe asistenca e misioneve këshillimore. Ndhima dhe asistenca nga misionet e huaja policore, si rezultat i ndryshimeve që pësoi policia shqiptare, u shtua dhe vazhdon aktualisht, duke qenë një kontribut i madh në rritjen e aftësive profesionale e të performancës së policisë dhe me qëllim thellimin e luftës së përbashkët kundër trafikëve të paligjshme dhe të krimit ndërkufitar.

- Implementimi i sistemeve moderne në polici. Implementimi i sistemeve moderne në policinë shqiptare, si TIMS, MEMEX, E-GJOBA, RIMS, ADAM, SIMA, Komisariati DIGITAL, etj., të cilat japin një kontribut shumë të madh për rritjen e efikasitetit të strukturave policore në luftën kundër krimit dhe trafikëve. Sistemi TIMS, ishte nga të parët që u implementua në vitin 2004 e me vonë, sistemet e tjerë.

- U rrit besueshmëria e publikut te policia, si rezultat i veprimtarisë së “policimit në komunitet”, i cili filloi të zbatohet dhe hapat e parë i kemi në vitet 1997-1998, veprimtari që u intensifikua në vitet 2000 dhe po implementohet në gjithë veprimtarinë e policisë edhe sot, me mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtarë, - duke qenë një formë policimi e përhapur dhe e efektshme në Europë .

- Përcaktimi i qartë rolit të policisë në zgjedhje. Duke pasur parasysh sjelljen e policisë në vitet e mëparshme, në legjislationin e ri u përcaktua qartë roli dhe detyrave të policisë në procesin zgjedhor, gjë që solli si rezultat që në 10-12 vitet e fundit të mos ketë asnjë ankesë për shkelje të ligjit “Për Kodin Zgjedhor” dhe të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” nga punonjësit e policisë.

4. Përfundime

Nga analiza e mënyrës së menaxhimit të policisë, në periudhën pas viteve ‘90 dhe ndikimit në përmbushjen e misionit të saj, ruajtjen e rendit dhe rritjen e sigurisë publike, arrijmë në përfundimin se në vitet 1990-1997, në mënyrën e menaxhimit të policisë u evidentuan shumë mangësi, të cilat treguan mungesë njohurish, aftësish dhe përvoja në drejtim të menaxhimit policor, sepse:

- në situatën e krijuar pas përmbyesjes së sistemit totalitar, nuk u analizuan shkaqet e rritjes së kriminalitetit dhe nuk u përcaktuan masa konkrete policore për t’ju përgjigjur kësaj situatë, sepse policia ishte ineficiente dhe e paqartë për rolin e misionin e saj;

- në shumë raste e sidomos në fund të vitit 1996 nuk u vlerësuan si duhet dhe në dinamikë elementët bazë të situatës se rendit dhe tendencat për përshkallëzimin e saj.

- për shkak të statusit si forcë policore dhe mungesës së përvojës në menaxhim, policia nuk zgjodhi rrugën e bashkëpunimit me komunitetin, por atë të dhunës e represionit;

- sjellja e policisë, drejtimi i saj nga personel pa arsim policor dhe pa eksperiencë e njëanshmëria politike e disa drejtuesve të saj, çuan në acarimin e publikut duke ndikuar jo në ruajtjen e rendit, por në cenimin e rëndë të tij;

- nuk u vlerësua dhe nuk u analizua gjendja e organizatës policore në kushtet e reja të krijuara si dhe cilët ishin faktorët të brendshëm e të jashtëm, pozitivë dhe negativë që ndikonin në veprimtarinë e saj;

Libro, A. dhe Selmani, B.

« Menaxhimi i policisë pas viteve ‘90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

- mungesa e kualifikimit të vazhdueshëm profesional dhe mungesa e motivimit;
- shkelja e kriterëve të rekrutimit solli që në polici të futeshin njerëz pa arsim profesional dhe të inkriminuar e pa integritet;
- lëvizjet pa kriter apo me motive politike krijuan ndjenjën e përkohshmërisë në detyrë, thelluan krizën e besimit dhe bënë që policia të mos ishte kompakte, e dobët e të mos përbalonte dot situatat.

Pas vitit 1997 e në vazhdim, lidhur me mënyrën e menaxhimit të policisë, si rezultat i reflektimit mbi atë që kishte ndodhur deri në vitin 1997 dhe duke vlerësuar procesin e menaxhimit policor si faktor themelor në veprimtarinë e policisë, evidentohet një pamje tjetër e policisë, për shkak se:

- ndryshimet e thella në legjislacionin, për policinë, sollën ndryshim cilësor të statusit të Policisë së Shtetit, sepse ajo u shndërrua nga forcë militare në institucion të administratës shtetërore, pra në shërbim publik;
- statusi i ri i policisë, krijoi kushtet për një menaxhim më të mirë të policisë, sidomos të personelit të saj duke përmirësuar trajtimin dhe motivimin e policisë;
- u përcaktuan kriterë rigorozë për pranimin në polici dhe njëkohësisht u intensifikua puna për kualifikimin e saj, sidomos në drejtim të menaxhimit;
- u ul ndjeshëm ndikimi i politikës në polici si dhe u përcaktua qartë roli i policisë në zgjedhje;
- filloi udhën strategjia e re e policimit siç është ajo e policimit në komunitet;
- u rrit bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, etj.

Rezultat i mirëmenaxhimit ishte se në këtë periudhë kohore, policia jo vetëm përmirësoi shpejt situatën e rendit, por ruajti rendin publik të rivendosur dhe gradualisht rriti më tej sigurinë për individin e shoqërinë duke garantuar në vazhdimësi, funksionimin normal të ligjit e të punës së institucioneve shtetërore. Treguesit e kriminalitetit, nga viti në vit kanë ardhur duke u ulur, ndërsa janë rritur treguesit e performancës së saj, gjë që tregon se sot Policia e Shtetit është në rrugën e duhur.

5. Rekomandime

Menaxhimi i policisë është një çështje shumë e rëndësishme që ndikon drejtpërsëdrejti në efikasitetin e punës së policisë në kryerjen e misionit të saj. Kjo konfirmohet edhe nga fakti se në “Strategjinë e Rendit Publik për vitet 2015-2020 dhe në Planin e veprimit për vitet 2015-2017”, parashikohet se *përsosja e menaxhimit të brendshëm në polici* është një nga prioritetet dhe objektivat e kësaj strategjie. Qëllimi i këtij objekti është që të ndryshojë niveli i menaxhimit brenda organizatës së Policisë nëpërmjet zhvillimit e përsosjes së procesit të planifikimit, organizimit, drejtimit e kontrollit, i cili do të japë impaktin e vet në realizimin e detyrave¹⁴.

Duke pasur parasysh se nëpërmjet aplikimit të koncepteve të menaxhimit modern në polici ndërtohet një institucion me rregulla të qarta përgjegjësie, varësie e detyrash konkrete për çdo shërbim e punonjës policie, bëhet harmonizimi i faktorëve dhe nevojave të mjedisit të jashtëm me burimet dhe veprimtarinë e policisë, ndiqet në

¹⁴ VKM, nr. 702, datë 26.8.2015 "Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015-2020 dhe të planit të veprimit 2015-2017, Fletore Zyrtare, nr. 155, viti 2015, (fq.11155).

vazhdimësi funksionimi i policisë si institucion dhe në struktura të veçanta si dhe realizimi i objektivave të planifikuara, duke çuar në rritjen e treguesve të parandalimit dhe të goditjes së veprimtarisë kriminale, por edhe të zhvillimit në vijimësi të nivelit të shërbimit policor ndaj komunitetit, rekomandojmë që:

1. Menaxhimi policor, ashtu siç është përfshirë si lëndë më vete në programin e studimeve “Bachelor”, “cikli i parë” në Akademinë e Sigurisë, duhet të bëhet pjesë e programeve të trajnimeve të vazhdueshme afatshkurtra dhe e kualifikimit të drejtuesve të policisë, duke filluar nga nivelet e ulëta, deri te nivelet e larta; të bëhet pjesë e veprimtarisë së përditshme të tyre, sepse ndikon drejtpërdrejt në gjendjen e rendit e të sigurisë publike dhe në performancën e strukturës policore.

2. Si element thelbësor i menaxhimit në tërësi, menaxhimi i burimeve njerëzore, nga drejtuesit e policisë të çdo niveli, duhet të konsiderohet si një faktor determinant për kryerjen e detyrave nga Policia e Shtetit, për ruajtjen e rendit, rritjen e treguesve të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit dhe funksionimin normal të institucioneve shtetërore.

3. Të punohet në drejtim të kualifikimit të personelit të policisë, por sidomos atij drejtues të çdo niveli, lidhur me konceptet e menaxhimit të trazirave dhe tensioneve të brendshme, me synim aftësimin e tij në drejtim të analizës së situatës, faktorëve frymëzues dhe organizues të saj, në hartimin e planeve të veçanta dhe të mënyrës së veprimit, në zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në përdorimin e forcës dhe në ndalimin e përdorimit arbitrar të saj e në mënyrë masive ndaj njerëzve.

Bibliografi

1. Shkëmbi, Hasan. *Legjislacioni i Policisë Shqiptare*. Tiranë: Geer, 2004.
2. Ligj “Për Policinë e Shtetit”, *Fletore Zyrtare nr. 137/2014*.
3. Yzeiri, Bajram. *Menaxhimi i Policisë*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, 2003.
4. Mazreku, Ibish. *Bazat e Menaxhimit*, Dispensë. Prishtinë: 2010
5. Shkëmbi, Hasan. *Buletini Shkencor*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, gusht 2000.
6. Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë, DCAF-2012.
7. Shehu, Besnik. *Buletini Shkencor*. Tiranë: Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, dhjetor 2000.
8. Ligj “Për Policinë e Shtetit”, nr. 8553, datë 25.11.1999.
9. VKM, nr. 702, datë 26.8.2015 “Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015–2020 dhe të planit të veprimit 2015–2017”, *Fletore Zyrtare, nr. 155*, viti 2015.

Ibro, A. dhe Selmani, B.

« Menaxhimi i policisë pas viteve '90 dhe ndikimi i tij në ruajtjen e rendit dhe forcimin e sigurisë publike »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Inteligjenca dhe balanca midis lirisë dhe sigurisë



■ **Dr. Zihni GOXHAJ**
Akademia e Forcave të Armatosura

Abstrakt

Roli i informacionit sot, si shoqëri e informacionit, padyshim që është jo vetëm i madh por edhe i domosdoshëm. Sot informacion prodhojnë organet e specializuara, shërbimet inteligjente, por edhe ato të hapura, veçanërisht media e shkruar dhe elektronike si dhe interneti. Duke qenë se është rritur gama e prodhimit të dhënies së informacionit, shoqëria e sotme kërcënohet nga rreziqet e shumta si shkelja e privatësisë, e dezinformimit, apo e dekonspirimit. Dilema kryesore për shërbimet e inteligjencës në të gjithë botën ka të bëjë me shqetësimin sesi ajo duhet të veprojë si një mbrojtëse e demokracisë nga njëra anë dhe të angazhohet në operacionet e fshehta që nuk mund të jenë të hapura për publikun, nga ana tjetër.

Në të gjitha shoqëritë demokratike, të gjitha shërbimet janë të detyruara të përballen me problemin se si të arrijnë një ekuilibër mes fshehtësisë operationale dhe hapjes ndaj publikut, i cili duhet të dijë si mbrohen të drejtat dhe si përdoren paratë nga taksat e tij. Si një ndër specialistet e fushës së inteligjencës, veçanërisht asaj ushtarake, sot kur keqpërdoret apo keqinterpretohet informacioni e ndjej të arsyeshme të jap një pamje të realitetit social dhe teknik të vlerësimit dhe sigurisë që ka shoqëria jonë në këto kushte të shfrytëzimit të informacionit të sotëm, duke e vënë inteligjencën në balancën midis lirisë dhe sigurisë. Njëkohësisht ftoj për angazhim dhe tërheqje opinionesh, në këtë organ (revistën "Policimi dhe Siguria"), specialist të fushës së inteligjencës si atë shtetërore, ushtarake, policore dhe asaj civile, me qëllimin e hapjes ndaj publikut, lirisë, por dhe ruajtjes dhe sigurisë.

Goxhaj, Z.
« Inteligjenca
dhe balanca
midis lirisë dhe
sigurisë »

Fjalëkyçe:

"Privacy", OSINT, ELINT, informacion, zbulim, inteligjencë.

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

HYRJE

“Nëse inteligjenca vihet në kontakt të ngushtë me vendimmarrësin, rrezikon të korruptohet prej tij.”¹ Abuzimi më i madh me shërbimet e inteligjencës ka ndodhur në shtetet totalitare, ku përdorimi i atyre që sovjetikët kanë quajtur “organet e sigurimit të shtetit” kanë kryer shumë detyra jashtë një misioni inteligjence. Rreziku i politizimit, potenciali i komunitetit të inteligjencës për të shtrembëruar informacionin ose gjykimin, me qëllim që të kënaqen autoritetet politike është i vërtetë. Ky rrezik nuk mund të eliminohet plotësisht, veçanërisht kur analistët janë të përfshirë në procesin politik. Sfida qëndron në aftësinë e zhvillimit të protokolleve të tilla, të cilat u bëjnë të mundur prodhuesve të inteligjencës dhe konsumatorëve politikbërës të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Drejtuesit e nivelit të lartë mund të urdhërojnë shërbimet civile dhe ushtarake të fokusohen në objektiva të veçanta dhe mbi bazat e një termi afatgjatë, sidomos kur bie fjala për disiplina të grumbullimit teknik, mund t’i japin përparësi mjeteve të grumbullimit nëpërmjet burimeve buxhetore në favor të një disipline, krahasuar me një tjetër, një sistemi dhe jo një tjetri, etj. Grumbullimi i informacionit nuk është e vetmja fazë e cila duhet të ketë prioritet; analistët duhet të dinë nga t’ia fillojnë në atë që quhet fluks informacioni.

Prioritetet në grumbullimin e inteligjencës duhet të reflektojnë interesin kombëtar dhe prioritetet politike, si dhe duhet të bazohen në konsiderata të tjera. Veçanërisht, duhet të demonstrohet papërshtatshmëria e burimeve të tjera alternative, përjashtuar rastet e rralla, inteligjenca nuk duhet të konfirmojë atë çka dihet. Në qendrat e gatishmërisë së çdo agjencie, televizori duhet të qëndrojë gjithmonë i sintonizuar te televizionet kritike të qeverisë. Nëse lajmet e para mediatike mund të jenë të fragmentizuara, OSINT përbën një element të fortë që i shërben ngritjes së gatishmërisë

Goxhaj, Z.
«Inteligjenca
dhe balanca
midis lirisë
dhe sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹ Wright, Peter. *Spycatcher*. New York: Viking Penguin, 1987, (f.65)

dhe paralajmërimet, por jo analizës së situatës në aspektin e inteligjencës. “Gazetarët dhe spiunët kanë shumë të përbashkëta, me shumë se ç’ mund ata vetë ta dinë dhe pranojnë këtë fakt; të dy palët tentojnë të zbulojnë çfarë është e fshehtë, të dyja palët punojnë në kohë të përcaktuar dhe të dyja palët punojnë me burime dhe mbrojnë burime të tyre të informacionit.”²

Prioritetet e grumbullimit të informacionit nuk duhet të jenë vetëm subjektet që kanë rëndësi politike, por edhe ato që kanë informacion, të cilin komuniteti i inteligjencës mund ta shfrytëzojë në avantazhin e tij, duke pasuruar “database”-in dhe informacionin bazë të agjencisë. Marrëdhëniet midis inteligjencës dhe politikës janë të vështira dhe në disa raste liderët injorojnë inteligjencën apo e konkurrojnë atë sipas oreksit të tyre. “Injorimi i inteligjencës i heq një element të rëndësishëm liderëve, duke i shndërruar ata vulnerabël në tunelin e vizionit të tyre strategjik”³

Një aspekt tjetër që ia vlen të përmendet është dallimi midis inteligjencës aktuale dhe asaj afatgjatë. Por pikërisht, atëherë, kur bëhet fjalë për analiza në terma afatgjatë rreth subjekteve të njohura dhe prirjeve me spektër të gjerë, informacioni sekret ka tendencën të jetë më pak kritik dhe në këtë pikë, analistët qeveritarë nuk janë shumë të ndryshëm nga akademikët dhe sektori privat. I parë në këtë këndvështrim, informacioni i medieve është ai për të cilin janë të interesuar politikbërësit. Analizat e termit afatgjatë duhet të jenë të sakta, koncize dhe të japin mesazhin e duhur. Ato duhet të paraqiten si çdo punim akademik ose si vlerësim i pritshmërisë. Ruajtja e një shkalle transparence për opinionin publik, është mënyra më e mirë për të siguruar përgjegjshmëri dhe kontroll demokratik, të cilat janë të domosdoshme për ngritjen e vetëdijes publike dhe mbështetjes për inteligjencë, pasi nga intelijenca publike rrjedhin politikat publike. Ekspertët e rinj të inteligjencës pranojnë se, në demokraci është publiku i arsimuar ai të cilit i duhet drejtuar dhe që duhet të mbahet i informuar.

Nxjerrja e vlerësimit vjetor të kërcënimeve strategjike, kur është e nevojshme, si dhe e vlerësimeve operacionale të kërcënimeve në opinionin publik është bazë për të gjitha aktivitetet e tjera të planifikuara.

1. Privatësia e njeriut, liria dhe e drejta e garantuar në një shoqëri të hapur

“E keqja është se akademikët nuk u tregojnë qytetarëve se çfarë kanë bërë agjencitë e inteligjencës në të kaluarën dhe çfarë duhet të presin qytetarët nga këto agjenci në të ardhmen”⁴

Tashmë, 25 vite në një shoqëri të demokracisë, ku si pjesë e pandarë e “lirive dhe të drejtave të njeriut” është edhe privatësia, që e sjell personin pranë njëshiti njerëzor si institucioni individ. T’ia prekësh qytetarit këtë gjë intime, krejt të vetën dhe të kufizuar në ato hapësira që morali dhe ligji i mbron si krejt personale, do të thotë që ndaj tij të gabosh moralisht e në raport me drejtësinë të kesh punë me ligjin. “Jeta e personit mbrohet me ligj”⁵

² Omand, David. “Intelligence Secrets and Media Spotlights: Balancing Illumination and Dark Corners”, në Dover, R. M. & Goodman M. S.(Red.) *Spinning Intelligence*. London: Hurst, 2009, (fq.37)

³ Rovner, Joshua. H-Diplo/ISSF, Roundtable Reviews, Vol. III, No. 17 (2012)

⁴ May, Ernest R. “Studying and Teaching Intelligence”. Në: *Studies in Intelligence* 38, no. 5 (1995): 5

⁵ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr. 65, dt. 10.12.1999

Privatësia “u vra e u dogj” në sistemin ideologjik komunist, sepse pseudoshkenca u quajt shkencë, e vërteta personale u kolektivizua dhe privatësia individuale u stigmatizua si një sakrilegj antiideologjik që mund të penalizohet deri në heqje lirie, sepse përbënte daljen nga rreshtimi politik-klasor. Në atë ambient shoqëror totalitar vetëm kriptokultura dhe kriptoreligjionizmi si privatësi, e ndihmuan njeriun që të ruante humanizmin, duke mbajtur një raport të fshehur me të vërtetat, që nuk i shërbenin sistemit, që ngrihej mbi gënjeshtër ose pseudo të vërteta të stisura. Gërmimi për të “*hyrë atje ku nuk të takon*” është jo vetëm i palejueshëm, por jo rrallë edhe me pasoja. Për më tepër, kur në këtë lloj gjurmimi ndërthehen interesa gjithfarësh, nga ato komerciale deri tek ato politike e partiake të ngushta. Është shkuar deri në skaje të tilla, kur përballë një presioni të tillë nga opinion apo media, njerëz me sedër të lënduar të mos e përballojnë situatën dhe t’i japin fund jetës me vetëvrasje. Dëshmorja e kohëve moderne, në mbrojtje të *privatësisë*, është Lady Diana! Ajo u vra nga “hijet” që i shkonin pas!

Nëse njeriu është një individ pa post dhe detyra publike e shtetërore, askush nuk e vret mendjen dhe nuk harxhon kohën t’ia njohë atij privatësinë. Ka interes dhe mund të bëhesh objekt i kësaj mbikëqyrjeje, shpesh bezdisëse, kur je person me funksione publike, je i punësuar dhe paguhesh nga taksapaguesit, ose je i zgjedhur dhe të janë deleguar sovranitetet e zgjedhësve. Në këto rrethana, vigjilenca mbi ty, mbi çdo veprim apo sjellje tënden, duket sikur vjen përmes një lupe zmadhuese që këtë lloj ridimensionimi e ka sëmundje, jashtë së cilës nuk jeton dot. Dy janë thembrat e dobëta “*akiliane*” të një njeriu me pushtet apo imunitet: pasuria materiale dhe ajo ekonomike-financiare, si dhe marrëdhëniet morale familjare dhe raportet seksuale jashtë martese.

Kur Jul Cezari u shpall senator, nuk u gëzua. “Më mungojnë dy gjëra.” - i tha së ëmës - “Paraja dhe pushteti!”. Paraja dhe lavdia tek njeriu, për njerëzit që përfundimisht e kanë braktisur idealizmin, që është “i pashtershëm dhe pa rrezik”, bën që ata të mbeten peng të një realiteti që nxit pa pushim një “pafundësi të këqijash”. “*Pasuria është si uji i kripur, - sa më shumë të pish aq më shumë ke etje. Kjo vlen edhe për lavdinë*”.

Të dish të sillesh moralisht dhe ligjërisht me privatësinë si individ apo si institucion civil i ligjit, kjo është pjesë e demokratizimit të përgjithshëm si kulturë njerëzore. Vetëm një sistem i tillë, që rrugëton përmes “*demokratizimit të demokracisë*”, e ruan individin dhe kujdeset për të. Edhe kur loja me privatësinë e kalon masën dhe mbetet pre e teorisë apo abuzimit, e gjithë kjo situatë është edhe si produkt edhe si argument i (pa)pjekurisë së demokracisë në shoqërinë në tërësi. Kështu, jemi të gjithë në provë pjekurie, si njerëz dhe si institucione. Do të duhet të edukohemi për t’u çliruar nga pengesat që shekujt na kanë lënë.

Historikisht popujt kanë luftuar për lirinë. Në radhë të parë, ata kanë dashur që kjo liri të ishte e sanksionuar diku, në një normë juridike. Pra, e gjithë lufta e popujve për lirinë ka qenë e lidhur ngushtë edhe me njohjen formale të lirisë nga aktet me rëndësi juridike e madje, me rëndësi juridiko-kushtetuese. Kjo njohje formale afirmonte lirinë e qytetarëve përballë aparatit autoritar të shtetit dhe pushteteve publike. Kështu liritë siguroheshin nëpërmjet një mosndërhyrjeje nga ana e shtetit dhe e pushteteve publike në sferën private. Njohja e lirive dhe e të drejtave të qytetarëve, si dhe vetëkufizimi i shtetit përballë qytetarëve të tij, shënon edhe kalimin nga shteti autoritar e absolut, në shtetin liberal ose shtetin e së drejtës. Kjo u shoqërua edhe me njohjen e qytetarisë. Fituan qytetarinë ata që më parë ishin konsideruar si “*të bindurit*” dhe “*të nënshtruarit*” e mbretit. Kjo njohje juridike e të drejtave nuk do të ishte e mjaftueshme pa u shoqëruar edhe me garancitë e drejtpërdrejta që vendosnin kufijtë e autoritetit shtetëror në akte

Goxhaj, Z.
«Inteligjenca
dhe balanca
midis lirisë
dhe sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

ligjore. Një nga këto garanci ka qenë e parashikuar që nga kushtetutat e shekullit të 19-të. Kjo është quajtur “rezerva ligjore”, e cila siguron dhe mbron qytetarin nga veprimet arbitrare, sidomos nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe mekanizmave të tij, ku njëri nga këto është shërbimi inteligjent ushtarak dhe civil.

Kjo rezervë ligjore konsiston në dy aspekte kryesore:

Së pari vetë dispozitat që përmban kushtetuta janë një garanci për të drejtat dhe liritë themelore të individit. Parlamenti nuk mund të nxjerrë ligje që bien në kundërshtim me të drejtat kushtetuese të qytetarëve.

Së dyti, kufij mbi këto të drejta kushtetuese mund të vendosen, por jo në mënyrë arbitrare. Këta kufij mund të vendosen vetëm me ligje të miratuara nga Parlamenti. Janë vetë dispozitat e kushtetutës ato që përmbajnë rezervën e ligjit.

Origjina historike e rezervës së ligjit buron që nga koha e parlamenteve të parë mesjetare, qysh atëherë kur kompetencat e mbretit u kufizuan (Magna Charta Libertatum; Petitions of Rights, etj.). Pushteti dhe kompetencat për marrjen e vendimeve, lidhur me pasurinë personale të qytetarëve, ose të bindurve të tij, iu atribuuan parlamenteve të zgjedhura. Karakterin e rezervës ligjore e patën në shtetin e së drejtës edhe afirmimi i parimit të ndarjes së pushteteve; njohja dhe kujdesi për të afirmuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në katalogun përkatës në kushtetutë. Si rezervë e ligjit mund të merren disa nene të njohura si: neni që sanksionon parimin “Ligji nuk ka fuqi paravepruese”, neni klasik i garancisë nga arrestimet arbitrare etj. Megjithatë, në kartat kushtetuese të shekullit të kaluar, funksioni garantues i të drejtave të njeriut nuk i njohu nivelet e sotme. Dikur parashikohej një numër i kufizuar lirish e të drejtash. Mjaft të drejta e liri nuk parashikoheshin shprehimisht dhe i liheshin qeverisë për të vendosur për to. Për më tepër kushtetutat ishin shumë fleksibile.

Legjislacionit i njiheshin mundësi të mëdha në interpretimin e rezervës së ligjit. Ndodhte që, rezerva e ligjit të përcaktonte vetëm një pjesë të së drejtave dhe pjesa tjetër i lihej pushtetit ekzekutiv për ta trajtuar. Përkundrazi, në kushtetutat e sotme, funksioni garantues i rezervës së ligjit rezultoi i forcuar. Ka kohë që është kufizuar mjaft ndërhyrja e legjislatorit të zakonshëm, duke përcaktuar qartë qysh në kushtetutë, fushat, ku ai mund të ndërhyjë. Edhe në ligjin për SHISH, i cili e kryen veprimtarinë e tij në përputhje me kushtetutën dhe ligjet në Republikën e Shqipërisë “...*Ligjshmëria, objektiviteti, sekreti dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, janë parimet bazë të punës së këtij organi.*”⁶

Nga shteti në shtet, funksioni garantues i rezervës ligjore është i ndryshëm. Në një shtet social, që ndërhyt në zhvillimin e ekonomisë, legjislatorit i janë rezervuar zgjidhje politike. Atij i është dhënë detyra e përcaktimit të programeve e të kontrolleve të nevojshme, me qëllim që, jo vetëm aktiviteti publik, por edhe ai privat, të drejtohet e të kontrollohet, për t’u arritur qëllimi social. Gjithashtu, rezerva e ligjit parashikohet edhe për marrjen dhe adoptimin e masave konkrete e sidomos nëpërmjet fakteve administrative. Deklarata franceze e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit 1789, përkufizonte lirinë si “*mundësinë për të bërë gjithçka që nuk i sjell dëm tjetrit*”. Kushtetutës i mbetet vetëm të përcaktojë se cilat do të jenë kufizimet dhe në ç’mënyrë. Kur afirmon parimet e përgjithshme të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, kushtetuta e vitit 1998 thekson se, këto të drejta kufizohen (neni 17). Ajo plotëson më mirë rastet, mënyrat dhe kushtet e këtyre kufizimeve dhe i referohet ligjit.

⁶ Ligji nr. 9400, datë 12.5.2005, “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”.

2. Llojet e rezervës ligjore në të drejtën kushtetuese shqiptare

Kanë ekzistuar mjaft mëdyshje në të drejtën kushtetuese në lidhje me rezervën e ligjit. Kur flasim për rezervën e ligjit kemi parasysh vetëm ligjet e parlamentit apo edhe aktet që marrin fuqi ligjore; vetëm ligje të përgjithshme apo edhe aktet ligjore rajonale? Në botë mjaft pyetjeve që lindin u jepet përgjigje nga aktiviteti i Gjykatës Kushtetuese. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese luajnë rol në identifikimin e këtyre problemeve, p.sh., nga doktrina kushtetuese është bërë e mundur të identifikohen disa kritere, si dhe të afirmohen disa tipa të rezervës ligjore. Midis tyre dallojmë rezervën absolute të ligjit dhe rezervën relative të ligjit:

Kushtetuta shqiptare vendos se, të drejtat dhe liritë themelore janë “...*të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme*”,⁷. Megjithatë përvoja kushtetuese botërore ka afirmuar se, nuk *ekzistojnë të drejta të pakufizuara*, të gjitha të drejtat kanë kufizime të tyre. Edhe vetë përkufizimi i parë që është dhënë për lirinë në një akt juridik, ka përcaktuar si element thelbësor, kufizimin e saj. Megjithatë në radhë të parë kufizimet burojnë nga vetë kushtetuta. Në disa nene, ajo evokon shprehimisht një tërësi kufizimesh, por veç kësaj, kushtetuta përmban edhe kufizime të pashprehura drejtpërdrejt. Si të tilla mund të konsideronim kufizimet që burojnë nga respektimi i parimeve themelore kushtetuese. Pra, ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk mund të shtrihet derisa”... *të cenojë vlerat e mëdha kushtetuese, shtetin e së drejtës, shtetin demokratik e social, dinjitetin e personalitetin njerëzor, paqen, mirëqenien, kulturën, solidaritetin njerëzor, sovranitetin e popullit dhe sigurinë e individit apo sigurinë kombëtare etj*”.⁸ Vlera këto, që afirmohen me madhësi në preambulën dhe parimet themelore të kushtetutës.

Këto vlera e parime përbëjnë kufizime të rangut të parë ose më mirë kufizime absolute. Megjithatë këto kufizime nuk mund të ekzistojnë në mënyrë abstrakte e solemne. Ato konkretizohen e plotësohen në kushtetutë si dhe me ligj. Kushtetuta aktuale disiplinon, se këto kufizime, mund të vendosen në rastet kur është fjala “... *për të mbrojtur një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të së tjerëve*.”⁹

Dy aspektet kryesore që diktojnë nevojën e vendosjes së kufizimeve, paraqiten me: 1. *Konceptin vertikal* dhe 2. *Konceptin horizontal të së drejtave të njeriut*. Koncepti vertikal i të drejtave dhe lirive na bën t’i konsiderojmë ato si përcaktuese të raporteve midis individëve dhe pushteteve publike. Por në shoqërinë bashkëkohore, të drejtat dhe liritë e njeriut nuk kërcënohen të shkelen vetëm nga sjellja e organeve publike, por edhe nga shkelja e personave të tjerë (koncepti horizontal i të drejtave të njeriut). Në vijim të analizës të nenit 17 të Kushtetutës, nuk mund të mos përmendim faktin se, këtu vendosen kushte të reja, përveç atyre klasike, në lidhje me kufizimin e të drejtave dhe lirive. Përveç faktit, kufizimi i të drejtave të sanksionuara në kushtetutë, bëhet vetëm me ligj. Ajo vendos se:

1. Kufizimi i të drejtave duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Kufizimet nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të së drejtave themelore.
3. Kufizimet e vendosura me ligj nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara

⁷ Kushtetuta e RSH (neni 15/1) Viti 2009.

⁸ Kushtetuta e RSH, bot. 2009.

⁹ Kushtetuta e RSH (neni 17).

në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Janë këto tre kushte që shteti shqiptar duhet të mbajë parasysh kur nxjerr ligje që kufizojnë të drejtat e njeriut, ato na paraqiten si tre kushte-garanci për mbrojtjen e të drejtave. Rezerva ligjore na lejon të kuptojmë se ligji (pavarësisht nëse është ligj i përforcuar në bazë të nenit 82/1, ose i zakonshëm) është plotësisht kompetent për të vendosur rregulla që lidhen me të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Një problem që shfaqet nga përmbajtja e nenit është: kush vendos se do të konsiderohet interes publik kaq i rëndësishëm saqë duhet të kufizohen vetë të drejtat e njeriut? Në radhë të parë është Kuvendi ai që vendos nëse ka interes publik. Por nuk përjashtohet edhe gjyqtari, i cili duhet t'i bëjë pyetje vetes nëse kemi një interes të tillë publik. Këto kufizime duhet të jenë në përpjesëtim me vetë të drejtën.

Ka një marrëdhënie të tillë: *Sa më e rëndësishme të jetë e drejta individuale, aq më i rëndësishëm duhet të jetë interesi publik për hir të së cilit ai duhet të kufizohet.* Prandaj, që të jetë me të vërtetë kushtetues, kufizimi duhet të kalojë disa prova. Prova e parë dhe më e rëndësishme është ajo e interesit detyrues. Kjo është prova më e vështirë dhe lidhet me interesin detyrues publik ose qeveritar. Në këtë rast kufizimi i të drejtave të njeriut duhet të jetë në atë masë, sa të mbushë interesat publike qeveritare. Kjo provë përdoret kryesisht për të drejtat më të rëndësishme, ato mund të kategorizohen në rangjet e para, si liria e fjalës, e shtypit, e besimit fetar, liria dhe siguria personale etj. Për të drejtat që mund të përfshihen në rangje më të ulëta, nëse do të bënim një kategorizim të tyre, mund të përdoret edhe prova e arsytueshmërisë.

Gjithashtu çdo legjislator duhet të mbajë parasysh që, ai nuk mund të nxjerrë ligje që kufizojnë të drejtat e liritë, duke cenuar thelbin e tyre. Ka disa kufizime, të cilat nuk mund të vendosen asnjëherë, pasi ato cenojnë thelbin e vetë liritë. Kështu p.sh., pavarësisht nga interesi detyrues që krijohet, Parlamenti nuk mund të nxjerrë një ligj që ta detyrojë të gjithë popullin shqiptar të besojë vetëm në fenë katolike, sepse kështu cenohet liria e besimit në thelbin e saj. Me një rast të tillë është përballur edhe Gjykata Kushtetuese Shqiptare në çështjen me objekt: *"Papajtueshmëria e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje"*. Në vendimin e saj, kjo gjykatë ka përdorur provën e interesit detyrues kur arsyeton se, në rastet përjashtuese legjitimohet heqja e jetës së njeriut, p.sh., në dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë institutin e mbrojtjes së nevojshme, apo në ligjin nr. 8290, dt 24.02,1998 *"Për përdorimin e armëve të zjarrit"*, apo në dispozitat që lejojnë dënimin në kohë lufte. Por në kushtet kur mungon një interes i madh detyrues, pra në kohë paqeje, gjykata me të drejtë arsyeton se, dënimi me vdekje e cenon thelbin e të drejtës për të jetuar. Duke interpretuar nenin 21 të Kushtetutës në lidhje me nenin 17/2 të saj, ajo arrin në konkluzionin se, *"... dënimi me vdekje është i papajtueshëm në vetë thelbin e kësaj të drejte. Ai konsiderohet si një mohim i të drejtës për jetën."*¹⁰

Kështu, Kushtetuta e thërret drejtpërdrejt "Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut", e cila në këtë rast jo vetëm që ka fituar statusin e saj në vendin e dytë të hierarkisë së ligjeve, si një marrëveshje ndërkombëtare (neni 116), por ajo ka fituar një vlerë juridike të barabartë me Kushtetutën, duke u bërë e zbatueshme drejtpërdrejt në të drejtën e brendshme shqiptare. Ajo përbën maksimumin e kufizimeve të së drejtave të njeriut, por, në të njëjtën kohë, përfaqëson *"Minimumin e mbrojtjes së garantuar, të pakapërcyeshme nga ligjet që përbëjnë kufizime ndaj liritë dhe të drejtave themelore*

¹⁰ Gjykata Kushtetuese (vendimi 65, dt 11.11.1999).

të njeriut”¹¹. Pra vihet re një aspekt i dyfishtë. Duhet të nënvizojmë se, kjo konventë nuk shënon kufijtë maksimalë të zhvillimit të së drejtave të njeriut në vendin tonë. Çështja e sanksionimit kushtetues dhe e mbrojtjes të së drejtave të njeriut mori një rëndësi të veçantë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë periudhë, komuniteti ndërkombëtar miratoi dy akte themelore në fushën e të drejtave të njeriut, të cilat ruajnë edhe sot vlerën aktuale “*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*”, miratuar në 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithësime e OKB-së, si dhe “*Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Njeriut dhe Lirive Themelore*”, e miratuar nga Këshilli i Evropës, e cila u nënshkrua në Romë më 1950 dhe hyri në fuqi në vitin 1953.

“*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*” (1948) (më tej Deklarata Universale) ruan vlera të dukshme po të mbajmë parasysh faktin se, kjo deklaratë është hartuar e miratuar nga një organizëm i të Drejtës Ndërkombëtare, në të cilën aderojnë pjesa më e madhe e shteteve të Botës, përfaqësues të së gjithë kontinenteve dhe për më tepër, me regjime politike të ndryshme. Deklarata afirmon të drejtat më themelore të njeriut.

3. E drejta për të gëzuar një jetë private të fshehtë

“*Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë*”¹²

Në radhë të parë do të sqarojmë se çdo të kuptojmë me rezervim ose ruajtje të intimitetit të së dhënave rreth personit. A do të barazohet kjo me përmbajtjen “*ta lësh tjetrin vetëm*”, të respektosh sferën e tij të intimitetit. Duke vështruar shoqërinë e sotme, po bëhet gjithmonë e më e vështirë që individi të izolohet nga bota e jashtme. Ndoshta ka pasur një kohë kur individi punonte brenda mureve të shtëpisë, të cilat e linin atë të kishte marrëdhënie me familjarët dhe sendet e tij. Por sot nuk shtrohet fare problem i “*lënies vetëm të njeriut*”.

Në të ashtuquajturën shoqëri teknologjike në të cilën jetojmë është më e mundshme se kurrë që të dhunohet jeta private, pasi ekzistojnë instrumente që nuk e lejojnë njeriun të zhvillojë plotësisht sferën e intimitetit të tij. Telefoni, radioja, televizioni, interneti, masmedia dhe në përgjithësi me dhjetëra e mijëra skeda personale që ekzistojnë në arkivat e Ministrisë së Brendshme, *shërbimeve të inteligjencës* dhe aparaturat fotografike të sofistikua, janë mjete të mundshme përmes së cilave mund të dhunohet intimiteti i jetës private. Në këto kushte, sanksionimi i të drejtës “*privacy*” në kushtetutë dhe përcaktimi i rregullave të hollësishme ligjore është mundësia e vetme për të respektuar këtë të drejtë kushtetuese. Për ekzistencën e një të drejte mbi “*privacy*”-në, të garantuar konstitucionalisht, ka pasur mendime të ndryshme në të drejtën juridike. Në kushtetutën italiane p.sh., nuk ka një nen të drejtpërdrejtë që ta garantojë këtë të drejtë, por një konkluzion i tillë arrihet nga disa formulime të tjera. Kushtetutat që janë relativisht të reja e sanksionojnë këtë të drejtë shprehimisht në kushtetutë. E drejta për të gëzuar një jetë private të fshehtë është e lidhur drejtpërdrejt me disa të drejta themelore të përcaktuara në kushtetutë. Në fakt, kjo fshehtësi nuk duket gjëkund në kushtetutë, megjithëse pjesë të veçanta të saj përqipen të mbrojnë interesa të individit për fshehtësinë p.sh., kjo duket qartë në nenin 35, i cili i njeh individit lirinë që të bëjë publike të dhënat rreth personit të tij, kur ai dëshiron dhe nuk mund ta detyrojë askush ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë, kushtetuta njeh edhe raste përjashtuese, kur në bazë të ligjit personi

Goxhaj, Z.
«Inteligjencia
dhe balanca
midis lirisë
dhe sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹¹ Konventa evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 16.

¹² Holder, Eric et al. *Transcript of Senate Judiciary Committee Hearing on Justice Department Oversight*. United States Government Printing Office, 4 maj 2011.

mund të detyrohet të bëjë publike të dhënat rreth tij. Koncepti i fshehtësisë shfaqet në tërë vizionin e tij edhe në nenet 36 dhe 37 të Kushtetutës me të cilat mbrohet fshehtësia e banesës nga ndërhyrjet joligjore dhe të paautorizuara të policisë së shërbimeve të inteligjencës apo fshehtësia e korrespondencës. Gjithashtu, një shembull mjaft domethënës është garancia që i jep kushtetuta personit që të mos vetëinkriminohet. Kjo është e drejtë që i jepet prej saj individit, që të mbajë sekret për vete disa informacione sipas zgjedhjes së tij të lirë.

Kultura e hapjes përkundrejt asaj të sekretit total, po bëhet trend i nevojshëm për institucionet e inteligjencës në shoqëritë demokratike. *“Në fund, ata që kërkojnë transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe nga ana e shërbimeve të inteligjencës, duhet të marrin parasysh të mirat që sjell me vete kultura e sekretit në fushën e inteligjencës dhe të sigurohen se hapja (transparenca), të mos ketë efektin bumerang”*¹³

Sa më lart, në dritën e shoqërisë demokratike edhe shërbimet e inteligjencës në Shqipëri janë duke u përballur me këto sfida dhe kërkesa të reja. Ligjet e shërbimeve të inteligjencës dhe Policia e Shtetit përcaktojnë në mënyrë të qartë arsyen, mënyrën, mjetet, thellësinë, administrimin dhe kushtet në të cilat ndërhyhet në privatësinë e personit. Duhet theksuar fakti që, si rezultat i respektimit rigoroz të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare nuk ka asnjë çështje apo rast të konstatuar të shkeljes së lirisë së individit në Shqipëri nga shërbimet e inteligjencës. Përcaktimi i prokurorit, si personi i cili duhet të krijojë bindjen e përdorimit të teknikës që shkel privatësinë e personit; është një hap shumë i rëndësishëm përpara, krahasuar me të kaluarën represive të sigurimit të shtetit. E drejta për të gëzuar një jetë private të fshehtë lidhet ngushtë me të drejtën e organizimit e të asocimit. Kjo ka të bëjë me të drejtën që ka çdo person për t'u organizuar lirisht pa qenë i detyruar ta deklarojë këtë lidhje. Prandaj në përgjithësi ndalohet çdo lloj hetimi nga ana e shtetit, për përkatësinë në organizata, me përjashtim kur ka ndonjë interes shtetëror.

4. Vendosja e balancës mes sigurisë dhe lirisë

*“Parimet e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes janë ligjshmëria, objektiviteti, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, depolitizimi, bashkëpunimi ndërinstitucional, ruajtja e informacionit të klasifikuar, si dhe kontrolli e mbikëqyrja e veprimtarisë së saj”*¹⁴.

Kjo është “thembra e Akilit” të shërbimeve të inteligjencës. Transparenca duhet të bëhet me shumë kujdes në mënyrë që hapja ndaj publikut të mos e dëmtojë aftësinë e shërbimeve të inteligjencës për të kryer misionin e tyre. Sigurimi i një lidhjeje mes shërbimeve të inteligjencës për të kryer misionin e tyre. Sigurimi i një lidhjeje mes shërbimeve të inteligjencës e sigurisë dhe publikut të gjerë arrihet përmes deklaratave të këtyre komisioneve. Si rregull i përgjithshëm, inteligjenca duhet të mbajë plotësisht të informuar Komisionin e Mbikëqyrjes mbi aktivitetet aktuale; t'i sigurojë Komisionit, në bazë të kërkesës, informacionet apo dokumentet që ka në zotërim; të raportojë mbi aktivitetet që janë të paligjshme ose të parregullta, si dhe mbi veprimet korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara. Inteligjenca është një nga fushat e vetme të aktivitetit të qeverisjes, ku duhet të inkurajohet marrja në sy e rrezikut dhe e të menduarit krijues

¹³ Lowenthal, Mark M. *Intelligence from Secrets to Policy*, 5th Edition. Washington, DC: Congressional Quarterly Press, 2012, (f. 22).

¹⁴ Ligji nr. 117, datë 13.12.2012, “Për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes”, neni 4.

(novator). Inteligjenca është një fushë që mbështetet kryesisht në gjykimin profesional dhe sinqeritetin e personelit të inteligjencës, por që është jashtëzakonisht e varur nga bashkëpunimi i agjencive të tjera, qeverive të huaja dhe individëve.

Ndërsa Komisioni është natyrshëm i etur për të treguar se mbikëqyrja e tij është efektive, ai duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm për rrezikun e përhershëm që deklaratat dhe veprimet e tij mund të shtrembërojnë perceptimin e publikut për inteligjencën, të krijojnë një përshtypje jo të mirë në radhën e burimeve potenciale, agjencive të bashkëpunimit, shërbimeve dhe qeverive të huaja, si dhe të dëmtojë moralin e personelit të inteligjencës. Për këtë arsye, mbikëqyrja legjislativë duhet të jetë pa diskutim jo partiake dhe e matur dhe gjykimet duhet të jenë të drejta (të ndershme). Mbikëqyrja duhet të jetë më shumë investiguese sesa kundërshtuese si dhe komisioni duhet të zgjerojë fushën e mbikëqyrjes përtej shërbimeve të inteligjencës, deri te përdoruesit e inteligjencës. Praktikrat më të mira janë:

- shërbimet e inteligjencës ta kufizojnë veten si të kufizuara nga Kushtetuta dhe ligjet, duke përfshirë edhe obligimet e traktateve dhe të së drejtës ndërkombëtare, në të njëjtën mënyrë siç janë të kufizuara nga urdhrat ekzekutivë, udhëzimet dhe direktivat qeveritare.

- të krijohen udhëzime për inteligjencën e brendshme, të miratuar teorikisht nga Prokurori i Përgjithshëm, që rregullojnë grumbullimin, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për qytetarët vendas dhe qytetarët e huaj rezidentë.

- të ketë udhëzime për inteligjencën e jashtme që të kufizojnë përdorimin e personelit nga organizatat humanitare, ICRC dhe Organizatat e Kryqit të Kuq Kombëtar, punëtorët e ndihmës dhe zhvillimit, klerit, personelit të medias, etj.

Sfidat me të cilat përballen shtetet në tranzicion. Shumë shpesh ekziston një mungesë e profesionalizmit, aftësive të pakta strategjike dhe analitike, si dhe koordinim i pamjaftueshëm, kryesisht mes shërbimeve të ndryshme të vendit-kjo e fundit me sa duket është problemi universal i shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë. Duke pasur parasysh se strukturat organizative në shumicën e shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë mbeten të pamjaftueshme, është e nevojshme përdorimi shumë më i madh i aftësive të menaxhimit dhe praktikës moderne. Qeverisja e dobët, mungesa e efektshmërisë dhe paaftësisë bëjnë që këto shërbime të jenë nën ndikimin e politikës, të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo, nga ana tjetër, shkakton destabilitet dhe pasiguri, gjë që bën që investimet, si ato që vijnë nga brenda dhe ato nga jashtë vendit, të shihen si të pasigurta, duke krijuar mundësi për korrupsion të mëtejshëm.

Profesionalizmi inkurajohet nëpërmjet një sërë masash, të cilat mund të jenë: rekrutimi i hapur dhe i kujdesshëm, trajnimi, planifikimi i përcaktuar i karrierës dhe udhëheqjes frymëzuese. Krijimi i një shkolle të vetme të inteligjencës, duke siguruar një program bazë për kandidatët nga të gjithë shërbimet, duke i shërbyer tre qëllimeve:

- përcjelljes së idealeve të profesionalizmit;
- rrënjosjes së përkushtimit ndaj shërbimit publik;
- rritjes së bashkëpunimit midis shërbimeve.

Promovimi dhe detyra duhet të reflektojnë vullnetin e një oficeri inteligjence (personeli), për të vepruar si brenda fushave të zgjedhura në mënyrë demokratike në interes të sigurisë kombëtare, ashtu dhe në mënyra të pranueshme demokratike. Duhet të përzgjidhen menaxherë frymëzues që reflektojnë profesionalizëm të ri dhe që mbajnë përgjegjësi për motivimin e personelit, veprimtari në interes kolektiv të kombit, imponimin e standardeve të larta të performancës, përputhjes personale me detyrimet

Goxhaj, Z.
«Inteligjenca
dhe balanca
midis lirisë
dhe sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

morale strikte dhe rregullat etike të profesionit të inteligjencës dhe disiplinës. Nëse është e nevojshme, të ndryshojë legjislacionin ekzistues me shpejtësi, në mënyrë që të përcaktojë qartë vizionin e shtetit për inteligjencën dhe kuadrin ligjor, duke reklamuar në publik dhe brenda shërbimeve të inteligjencës, në mënyrë efektive, elementet thelbësore të organizimit të ri të inteligjencës. Duhet të zhvillohet dhe forcohet aftësia dhe kompetencat menaxhuese për t'u mundësuar shërbimeve kapërcimin e vështirësive të transformimit dhe profesionalizimit. Krijimi i një sistemi të qartë detyrash, standardesh të miratuara për të arritur rezultate si dhe për pajtueshmëri me ligjin dhe politikat. Individët në nivelet administrative, që vijnë nga shërbime dhe modele jo të duhura, të vjetra, duhet të kontrollohen sistematikisht dhe të ndalohen nëse ata punojnë kundër qëllimeve apo jashtë parametrave të organizatës së re. Çdo "incident" i ri, abuzimi ose shkelje, që të kujtojnë sjelljet e së kaluarës, duhet të përdoren si një mundësi për të përshpejtuar ndryshimet, reformat dhe profesionalizimin. Komisionet afatshkurtra të hetimit ose grupet e punës të ministrive, mund të jenë mjete të përshtatshme dhe efektive për hetimin e abuzimit dhe për definimin e ndryshimeve dhe reformave më të qarta. Grupi i punës mund të përdoret në periudha afatshkurtra, për të ndihmuar ministrat që të fokusohen në zhvillimin e direktivave të ministrive, të cilat do të ndihmojnë për të parandaluar që ndryshimet të bëhen pak e nga pak dhe në mënyrë të pakoordinuar.

Zbatimi i kontrollit dhe përgjegjësisë është shumë i rëndësishëm. Kështu çdo financim i aktiviteteve, për të cilat nuk ekzistojnë prova bindëse mbi nevojën e tyre, duhet të ndërpritet menjëherë. Duhet të zbatohet një kontroll profesional i cilësisë, nëse është e nevojshme të përmirësohet cilësia, rëndësia, dobishmëria dhe për këtë arsye edhe mënyra e përdorimit të prodhimeve të inteligjencës për hartuesit e politikave. Dilema kryesore për inteligjencën, në të gjithë botën, ka të bëjë me shqetësimin se si ajo duhet të veprojë si një protektorat i demokracisë, kur, në të njëjtën kohë, angazhohet në operacionet e fshehta që nuk mund të jenë të hapura për publikun. Në të gjitha shoqëritë demokratike, të gjitha shërbimet janë të detyruara të përballen me problemin se si të arrijnë një ekuilibër mes fshehtësisë dhe hapjes ndaj publikut. Ruajtja e një shkalle transparence është mënyra më e mirë për të siguruar përgjegjshmëri dhe kontroll demokratik, të cilat janë të domosdoshme për ngritjen e vetëdijes publike dhe mbështetjes për inteligjencë. Nga inteligjencat publike rrjedhin politikat publike. Ekspertët e rinj të inteligjencës, pranojnë se në demokraci është publiku i arsimuar, ai të cilit i duhet drejtuar dhe që duhet mbajtur i informuar. Nxjerrja e vlerësimit vjetor të kërcënimeve strategjike dhe – kur është e nevojshme – e vlerësimeve operacionale të kërcënimeve në opinionin publik, është bazë për të gjithë aktivitetet e tjera të klasifikuara.

5. Përfundime

– Prioritetet në grumbullimin e informacionit, duhet të reflektojnë interesat dhe politikat kombëtare, por edhe burime të ndryshme që kanë informacion, duke pasuruar "database"-in e strukturës së agjencisë. I parë në këtë këndvështrim, informacioni i medieve është ai për të cilin janë të interesuar politikëbërësit.

– Nxjerrja e vlerësimeve vjetore të kërcënimeve strategjike, kur është e nevojshme, si dhe e vlerësimeve operative të kërcënimeve, është bazë e aktiviteteve të planifikuara.

– Në një shoqëri demokratike, ku si pjesë e pandarë e "lirive dhe të drejtave të njeriut", është privatësia; t'ia prekësh këtë gjë intime qytetarit, krejt të vetën dhe të kufizuar në atë hapësirë që morali dhe ligji i mbron si krejt personale, do të thotë që ndaj

tij të gabosh moralisht e në raport me drejtësinë, të kesh punë me ligjin.

– Dilema kryesore për inteligjencën, në të gjithë botën, ka të bëjë me shqetësimin se si ajo duhet të veprojë si një protektorat i demokracisë, kur, në të njëjtën kohë, angazhohet në operacionet e fshehta që nuk mund të jenë të hapura për publikun. Në të gjitha shoqëritë demokratike, të gjitha shërbimet janë të detyruara të përballen me problemin se si të arrijnë një ekuilibër mes fshehtësisë dhe hapjes ndaj publikut.

Bibliografi

1. Archick, Kristen et al. "European Approaches to Homeland Security and Counterterrorism". *CRS Report for Congress* s (24 korrik, 2006).
2. Dulles, Allen W. *The Craft of Intelligence*. Westport, CT: Greenwood Press, 1977.
3. Wisner, Frank G. "On the Craft of Intelligence". CIA, Center for the Study of Intelligence Studies Archive Indexes, vol. 8, no. 1.
4. Matschulat, Austin B. "Coordination and Cooperation in Counterintelligence." *Studies in Intelligence* 13/1 (Spring 1969): 25-36.
5. National Counterintelligence Executive (NCIX). *The National Counterintelligence Strategy of the United States*. NCIX, 2007.
6. US Department of the Army. *Field Manual 36-40: Counterintelligence*, (1995).
7. US Department of Defense. *Joint Publication 1-02 Department of Defense Dictionary of Military and Associated Terms*, (2007).
8. Joint Chiefs of Staff. *Joint Publication 2-0: Intelligence*, (2007).
9. Kahn, David. *The codebreakers: The story of Secret writing*. London: Macmillan, 1974.
10. National Security Agency. *The Venona Story, Collection, 1944*.
11. Suvorov, Victor. "Chapter 4, Agent Recruiting". *Inside Soviet Military Intelligence*. London: MacMillan Publishing, 1984.
12. Gleghorn, Todd E. *Exposing the seams: the Impetus for reforming US Counterintelligence*. Monterey, CA, Naval Postgraduate School, 2003.
13. Herman, Michael. "Foreword", Swenson Russell G. Dhe Susana C. Lemozy (Red.), *Intelligence professionalism in the Americas*. Washington DC: Joint Military Intelligence College, 2004.
14. Koçollari, Irakli. *Historia e Shërbimeve Sekrete*.
15. Herman, Michael. *Power of intelligence in peace and war*. Cambridge, University Press, 1996.
16. Clausewitz, Karl Von. *On war*. Përkthyer nga J. J. Graham. London: N. Trubner & CO.
17. Wright, Peter. *Spycatcher*. New York: Viking Penguin, 1987, (f.65)
18. Omand, David. "Intelligence Secrets and Media Spotlights: Balancing Illumination and Dark Corners", në Dover, R. M. & Goodman M. S.(Red.) *Spinning Intelligence*. London: Hurst, 2009.
19. Rovner, Joshua. H-Diplo/ISSF, Roundtable Reviews, Vol. III, No. 17 (2012).
20. May, Ernest R. "Studying and Teaching Intelligence". *Studies in Intelligence* 38, no. 5 (1995).
21. Gjykata Kushtetuese, *Vendimi nr. 65*, dt.10.12.1999.
22. Ligji nr. 9400, datë 12.5.2005, "Për Shërbimin Informativ Shtetëror".
23. Kushtetuta e RSH (neni 15/1) Viti 2009.
24. Gjykata Kushtetuese, *Vendimi 65*, dt 11.11.1999.
25. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 16.

Goxhaj, Z.
«Inteligjencia dhe balanca midis lirisë dhe sigurisë»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

Policimi në komunitet dhe terrorizmi



■ Doktorant **Artur BEU**
Drejtoria e Policisë së Shtetit

Abstrakt

Në ditët e sotme, një nga sfidat më të vështira është ajo e luftës kundër terrorizmit të së gjithë formave. Kjo vjen edhe si rezultat i një globalizmi që ka pushtuar të gjithë botën. Sulmet e fundit në Paris treguan qartë se parandalimi i fenomenit të terrorizmit, kërkon një përpjekje kolosale në drejtim të punës së inteligjencës dhe policisë. Në këtë drejtim, filozofia e policimit në komunitet, duket se ka një përparësi në parandalimin e fenomeneve të terrorizmit, duke filluar nga elementët tregues të tij. Procesi i aktivizimit, radikalizmit dhe terrorizmit kanë një sërë indikatorësh të cilët duhet të pikasen që në fillesat e tyre në mënyrë që të parandalojmë aktet terroriste të së gjitha llojeve. Në këtë punim, synohet nxitja e rritjes së kapaciteteve të oficerëve të policisë që janë në bazë dhe të profesionistëve të policimit në komunitet, - që tashmë, me ligjin e ri të Policisë së Shtetit, janë të mirëstrukturuar, - me qëllim njohjen e indikatorëve që të drejtojnë drejt radikalizmit. Gjithashtu, synohet edhe njohja në lidhje me mbledhjen e informacionit inteligjent në komunitet, me synim parandalimin e përhapjes së mëtejshme të ideve të dhunshme të radikalizmit, gjë që sjell edhe rritjen e kapaciteteve. Të gjitha këto kontribuojnë në ndërtimin e marrëdhënieve dhe të partneriteteve me komunitetet lokale dhe përdorimin e policimit në komunitet për parandalimin e radikalizmit dhe terrorizmit.

Beu, A.
« Policimi
në komunitet
dhe
terrorizmi »

Fjalëkyçe:

policimi në komunitet, radikalizmi, terrorizmi, informacioni inteligjent.

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Hyrje

Sipas Strategjisë Kombëtare, të fundit, kundër terrorizmit të dhunshëm dhe planit të saj të veprimit¹, niveli i kërcënimit duhet të fokusohet tek shkatërrimi i rrjeteve terroriste ekzistuese, duke parandaluar rekrutimin e anëtarëve të rinj. “Krijimin e besimit dhe besueshmërisë dhe rritjen e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet si pjesë të strategjisë së saj shtatëvjeçare², Policia e Shtetit në Shqipëri e përfshiu në modelin e “policimit në komunitet”, për zbatim në të gjithë vendin. Zgjidhja proaktive e bashkëpunuese e problemeve, e përqendruar në parandalim, është me dobi veçanërisht kur trajtohen kërcënimet që kanë lidhje me ekstremizmin e dhunshëm. Për rrjedhojë, zgjerimi dhe rritja e aftësive të policimit në komunitet, duke e vendosur theksin te parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, do të vendoset si përparësi përmes veprimit vijues: a) shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve të policimit në komunitet, në zonat problematike të synuara; b) fuqizimi i shoqërisë civile për të forcuar qëndresën e komunitetit³.” Në këtë strategji⁴, policimi në komunitet shihet si një mjet vital për parandalimin e radikalizmit dhe të rekrutimit e potencialëve ekstremistë të dhunshëm. Policimi në komunitet dhe partneriteti lokal, shoqëruar edhe me marrëdhëniet e mira ndërmjet policisë dhe publikut është një kërkesë paraprake për mbledhjen e informacionit në komunitet dhe parandalimin e radikalizmit. Kërkimet kanë treguar se kontakti pozitiv ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe komunitetit rrisin besimin dhe pritshmërinë publike. Një besueshmëri më e madhe ndaj policisë, rezulton, që ta kenë komunitetet që janë më të predispozuar për të kooperuar me policinë në hetimet kriminale si edhe në programet e parandalimit të krimit.

¹ Vendim i Këshillit të Ministrave, nr 930, datë 18.11.2015.

² “Strategjia e Policisë së Shtetit”, 2007 – 2013.

³ “Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit të Dhunshëm”, (f. 13).

Parë për herë të fundit, janar 2016, në adresën:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf

⁴ Po aty.

Strategjitë e policimit në komunitet - të suksesshme në të kaluarën - tanimë nuk janë të mjaftueshme. Objektivat e synuar, si p.sh. rritja e perceptimit të sigurisë në sensin e ngushtë të fjalës, sigurisë në përgjithësi dhe të mirëqenies, nuk mund të arrihen duke përdorur metodat dhe taktikat e policimit tradicional. Me një vëmendje të veçantë ndaj terrorizmit dhe kundërterrorizmit, sulmet në Nju Jork⁵, Madrid⁶, Londër⁷ dhe Paris⁸ kanë demonstruar se nevojitet një “rinovim” i strategjive policore efektive për të ndaluar këto fenomene.

Ndryshe nga kriminelët e zakonshëm, si hajdutët dhe të varurit nga drogat, të cilët janë të angazhuar në krime me nivel të ulët organizimi ose motivimi, vihet re se përveç përfitimit financiar, anëtarët e grupeve terroriste janë shpeshherë të disiplinuar, të organizuar dhe të motivuar nga besime të forta fetare dhe/ose politike. Kështu që, ka arsye të forta që të besojmë se oficerët e linjës së parë mund të mbledhin informacion të mjaftueshëm për të ndërhyrë para se aktiviteti terrorist të ketë arritur stadin e tij taktik. Mos besoni se vetëm policimi në komunitet do të mund të eliminojë sulmet terroriste, por mbledhja e informacionit inteligjent është një komponent thelbësor i çdo programi të kundërterrorizmit. Rrjedhimisht, përdorimi i taktikave të komunitetit të orientuara e të hartuara për krijimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet oficerëve të policisë dhe publikut duhet të konsiderohen si një mjet i mbledhjes së informacionit inteligjent të kundërterrorizmit.

Megjithatë, policimi në komunitet, nuk është një grup programesh të posaçme. Ai përfshin ndryshime të procesit të vendimmarrjes dhe krijimin e kulturave të reja brenda departamenteve policore. Ai është një strategji organizative që mundëson vendosjen e prioritetëve dhe të mjeteve se si t’i arrihet ato gjerësisht, për qytetarët dhe policinë, e cila, i shërben komuniteteve të tyre.

Premisa thelbësore është se niveli i pjesëmarrjes në komunitet, për të rritur sigurinë dhe rendin social dhe zgjidhjen e krimeve përkatëse të komunitetit, duhet të ngrihet, meqë policia nuk mund ta arrijë e vetme këtë objektiv. Në mënyrë që të kryhet ky partneritet, policia do të ishte më mirë të integrohej në komunitet, të forconte legjitimitetin e saj nëpërmjet policimit me anë të konsensusit dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj publikut. Kështu që ata duhet të jenë të dallueshëm dhe aksesibël për publikun; të njohin dhe të njihen nga publiku; t’u përgjigjen nevojave të komunitetit; të dëgjojnë preokupimet e tyre; të angazhojnë dhe të vënë në lëvizje komunitetet; të jenë të përgjegjshëm për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e këtyre aktivitetëve.

Bazuar në praktikat më të mira të vendeve Perëndimore⁹, strategjitë kyçe për

⁵ Morgan, Matthew J. *The Impact of 9/11 on Politics and War: The Day that Changed Everything?*. London: Palgrave Macmillan, 2009. (f. 220-225)

⁶ IISS, The International Institute For Strategic Studies. “Islam and Terrorism: What We Can Learn from the Madrid and London Bombings” në forumin: *An IISS Forum in cooperation with the Wyndham Place Charlemagne Trust*, 25 maj 2006. Parë për herë të fundit në shkurt 2016 në adresën: <http://www.iiss.org/conferences/counterterrorism-series/islam-and-terrorism/>

⁷ BBC. “Police appeal for bombing footage”, 10 korrik, 2005. Parë për herë të fundit në shkurt 2016 në adresën: http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/4668675.stm

⁸ Nossiter, Adam dhe Rick Gladstone. “Paris Attacks Kill More Than 100, Police Say; Border Controls Tightened”. *The New York Times*, (13 November 2015). Parë për herë të fundit në shkurt 2016 në adresën: <http://www.nytimes.com/2015/11/14/world/europe/paris-shooting-attacks.html>

⁹ *Strategia della Svizzera per la lotta al terrorismo*. Parë për herë të fundit në shkurt 2016 në adresën: <https://www.admin.ch/opc/it/federal-gazette/2015/6143.pdf>

<http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?f=ST+14469+2005+REV+4&I=it>

Ministria italiane e Mbrojtjes, *Strategia nazionale*. Parë për herë të fundit, janar 2016, në adresën:

http://www.difesa.it/Informazioni/DellaDifesa/periodico/IIPeriodico_AnniPrecedenti/Documents/La_nuova_strategia_nazionale_Statu_512massa.pdf

vënien e këtyre principeve në praktikë do të përfshijnë: krijimin e zonave (lagjeve) gjeografike të përcaktuara, me oficerë policie të caktuar në mënyrë permanente; krijimin e figurave të oficerëve të policisë dhe strukturave policore të dallueshme dhe lehtësisht të aksesueshme; ristrukturimin e aktiviteteve patrulluese për të theksuar shërbimin jo të emergjencës; angazhimin e komuniteteve; futjen e një qasjeje proaktive të zgjidhjes së problemeve; përfshirjen e të gjitha agjencive dhe shërbimeve qeveritare; përfshirjen e të gjithë sektorëve të policisë.

Rritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe punonjësve të vijës së parë duhet të vijë nga rritja e aftësisë së profesionistëve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me individët që rrezikohen nga radikalizmi, domethënë, punonjësit e vijës së parë, si mësuesit, punonjësit socialë, oficerët lokalë të policisë dhe institucioneve të riedukimit, për të vlerësuar e mbështetur personat që tërhiqen nga ekstremizmi i dhunshëm.

Policimi në komunitet përfshin një varietet filozofie dhe përqasje praktike e cila është duke evoluar në mënyrë të rrufeshme. Strategjitë¹⁰ ndryshojnë në varësi të nevojave dhe kundërpërgjigjeve të komuniteteve të përfshira; megjithatë, disa principe dhe konsiderata bazë janë të përbashkëta për të gjitha përpjekjet e policimit në komunitet.

1. Çfarë është radikalizmi?

Termi “radical” (nga latinishtja *radix* do të thotë rrënjë) është përdorur nga fundi i shekullit të 18-të nga mbështetësit e Lëvizjes Radikale¹¹. Ai më vonë u bë një term i përgjithshëm për ata që kërkonin reforma politike të cilat përfshijnë ndryshime rrënjësore në rendin publik. Nuk është e lehtë të biem dakord për një përkufizim të qartë sepse radikalizmi është një proces i komplikuar dhe multidimensional që reflekton kompleksë ndër stade dhe faktorë ndërhyrës. Në manualin “*Radikalizmi radikal: dallimi dhe kundërpërgjigja ndaj fenomenit nga ana e grupeve profesioniste të interesuara*”¹² (2008), duke analizuar përkufizimet e dhëna nga agjencitë e ndryshme të vendeve evropiane, del se radikalizmi mund të përkufizohet si më poshtë:

- dëshira gjithnjë e në rritje për të mbështetur ndryshime të gjithanshme në shoqëri, të cilat ndofta edhe mund të synojnë në shkatërrimin e rendit ligjor demokratik të mirëvendosur dhe mund të përfshijnë përdorimin e metodave jodemokratike;

- një proces që shpie një individ apo një grup të pranojë, mbështesë apo të inkurajojë përdorimin e dhunës si mjete politike;

- një proces zhvillimesh personale për të cilin një individ përkrah më shumë ide dhe objektiva politikofetare ose politikoekstremiste, duke u bindur se arritja e këtyre objektivave justifikon metodat ekstremiste.

- një proces i miratimit të një sistemi ekstremist të besimit dhe të gatishmërisë së përdorimit, mbështetjes apo të lehtësimit të dhunës dhe frikës, si një metodë e ndryshimeve efektive në shoqëri. Ky proces ka të bëjë me vënien në praktikë të ideve.

Radikalizmi i dhunshëm në strategjinë kombëtare kundër terrorizmit të dhunshëm¹³

¹⁰ po aty

¹¹ <http://www.thefreedictionary.com/radical>, Parë për herë të fundit, shkurt 2016.

¹² *Manual on radical radicalism*, 2008; Parë për herë të fundit, shkurt 2016, në adresën:

<http://infed.org/mobi/saul-alinsky-community-organizing-and-rules-for-radicals>

¹³ Kryeministria e Kosovës; *Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit të Dhunshëm*, (f. 13249);

Parë për herë të fundit, janar 2016, në adresën:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

përkufizohet si: “Një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin. “Ekstremizëm i dhunshëm”, përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politikë. “Kundërradikalizimi”, një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t’i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t’i drejtohen terrorizmit. “Qëndresë”, faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t’i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë. “Luftëtarë të huaj terroristë”, individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përfitim të trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur”

Ai është një fenomen i atyre që përkrahin opinione, pikëpamje dhe ide të cilat mund të shpien drejt akteve të terrorizmit siç edhe janë përkufizuar në nenin 1 të “Vendimit të Kuadrit mbi Luftimin e Terrorizmit”. (Rekrutimi i terroristëve: duke adresuar faktorët që kontribuojnë drejt radikalizimit të dhunshëm (2005)).

Ekstremizmi: duhet të përkufizohet vetëm në lidhje me një ideologji të përgjithshme që vepron, p.sh. në kontekstin e nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstremist dhe ekstremizmit fetar. Karakteristika përcaktuese e ekstremizmit është kundërshtimi i një apo më shumë parimeve bazë të ideologjisë kryesore. Një nationalist i cili konsideron anëtarët e një kombi tjetër inferior, apo nuk pranon bashkëzistencën, apo që beson se të tjerëve duhet t’u heqim lirinë e të drejtat, përfaqëson një ekstremizëm nationalist. Një besimtar fetar që dënon liderët apo shumicën e anëtarëve të fesë së tij është një ekstremist. Ekstremistët nuk janë detyrimisht të dhunshëm.

Xhihad, xhihadist: edhe pse fjala “xhihad” përdoret shpesh në islamin qendror ajo do të thotë “luftë shpirtërore”. Një xhihadist është një mysliman i cili ka vendosur të përdorë fuqitë e tij në shërbim të besimit fetar.

Salafi, salafizmi: përshkruan një person, një grup apo një besim brenda islamit i cili imiton gjeneratën e parë të myslimanëve (“salaf”) dhe vendosjen e fesë së kulluar. Shumica e salafistëve janë të dhunshëm dhe shumica e tyre shmangin angazhimet politike të së gjitha llojeve, megjithëse ka edhe disa që janë aktivë në politikë. Një pakicë e tyre janë ekstremistë të dhunshëm apo xhihadistë.

2. Çfarë është terrorizmi?

Përkufizimet mbi terrorizmin janë tepër të kontestuara. Për shembull publikimi i dytë i “Fjalorit të terrorizmit”, nga J. R. Thackrah¹⁴ përmend më shumë se 90 interpretime. Një studim i vitit 2003, në Ushtrinë Amerikane, numëroi 109 shpjegime të terrorizmit që mbulonin një total prej 22 elementësh të ndryshëm përkufizues. Përkufizimet më të përdorura të terrorizmit i referohen vetëm atyre akteve të dhunshme të cilët synojnë të krijojnë panik, me dashje objektivojnë sigurinë e civilëve dhe kryhen për objektiva ideologjike.

Përdorimi i dhunës me qëllime të shkakimit të terrorit në popullatën civile.

¹⁴ Thackrah, John Ritchard. *Dictionary of terrorism*, 2004.

Parë për herë të fundit, janar 2016, në adresën:

<https://www.questia.com/library/107562215/dictionary-of-terrorism>

Terrorizmi është një lloj i ekstremizmit të dhunshëm. Krimet terroriste janë ato lloj krimi që janë nxjerrë në listën që përfshin gjerësisht krimet e rënda kundër individit dhe pronës të cilët “duke parë natyrën apo kontekstin e tyre”-, mundet, të dëmtojnë një vend apo një organizatë ndërkombëtare në mënyrë të konsiderueshme kur kryhen me qëllim: përhapjen e panikut të rëndë në popullatë; detyrimin në mënyrë të jashtëligjshme të një qeverie apo një organizate ndërkombëtare që të ndërmarë apo të abstenojë ndaj të vepruarit të ndonjë akti; çekuilibrimin e rëndë ose shkatërrimin e strukturave themeltare politike, konstitucionale, ekonomike apo sociale të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare. Grup terrorist do të thotë një grup i strukturuar i më shumë se dy personash, i formuar në një hapësirë kohore dhe që vepron në harmoni për të kryer krime terroriste. “Grup i strukturuar¹⁵” do të thotë një grup që nuk është formuar rastësisht, për kryerjen e një krimi “të porositur” në mënyrë të befasishme dhe që nuk ka nevojë të ketë role të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësi të anëtarësimit apo të strukturës së zhvilluar.

3. Si ndodh procesi i radikalizmit?

Fjala akademike ka lindur mes një mori teorish të cilat kërkojnë të shpjegojnë procesin e radikalizmit. Voctoroff¹⁶ publikoi një artikull sqarues mbi modelet e radikalizmit dhe terrorizmit. Ai mbërriti në konkluzionin e pashmangshëm se asnjë teori e vetme mund të formulojë një përgjigje të përgjithshme ndaj pyetjes “Cilat janë shkaqet e origjinës së radikalizmit?”. Megjithatë, ai mbërriti në konkluzionin se procesi i radikalizmit përbëhet nga stade të ndryshme.

Shërbime dhe agjenci të ndryshme¹⁷ kanë dhënë shpjegime të stadeve të procesit të radikalizmit dhe ndryshimeve në sjelljen e individëve. Edhe pse shumica e studimeve janë fokusuar në procesin e radikalizmit në ideologjinë xhihadiste, teoria është gjithashtu e vlefshme/aplikueshme për fenomenet e tjera.

Së pari, duhet të kemi parasysh se jo të gjithë kalojnë nëpërmjet çdo stadi dhe shpenzojnë të njëjtën kohë në çdo stad. Shumë prej tyre heqin dorë në një stad të caktuar dhe riintegrohen në shoqëri ose, ulin ritmin e rrugëtimit të radikalizmit. Ata që kalojnë të gjitha stadet e procesit, ka gjasa që të përfshihen në ndonjë akt terrorist, por mund të bëhen edhe udhëheqës shpirtërorë.

Sipas manualit të CoPPRA¹⁸, procesi i radikalizmit kalon nëpër katër stade: 1) preradikalizmi; 2) identifikimi/konvertimi; 3) indoktrinimi; 4) veprimi.

Në stadin e preradikalizmit, një person mund të influencohet nga faktorë të jashtëm apo të brendshëm, si p.sh. një krizë identiteti, dëshpërim, një traumë personale, diskriminim, perceptim padrejtësie, presion familjar apo shoqëror, mungesë debati të moderuar, takim me një lider karizmatik etj. Nuk është kurrë vetëm një faktor, por një kombinim i disa faktorëve që shkakton futjen në proces. Mundësitë ose vendet potenciale janë të shumëllojshme. Hapësirat e takimeve në xhami, por gjithashtu edhe “pub”-et, shkollat, klubet sportive dhe ato të rinisë, vendet e punës apo burgjet japin mundësinë

Beu, A.
«Policimi
në komunitet
dhe
terrorizmi»

¹⁵ Kombet e Bashkuara. *Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional* (15 nëntor 2000), UN Doc. A/45/49, neni 2.

¹⁶ Voctoroff 2005

¹⁷ Europol, FBI, Departamenti i Policisë së Nju Jorkut, Policia Metropolitane e Londrës, Policia Holandeze Korps Landelijke Politiediensten.

¹⁸ CoPPRA, *Manual* 2011

e vënies në kontakt me persona në procesin e radikalizmit. Mënyra më e shpejtë dhe më anonime është interneti. Mund të bëjmë një dallim ndërmjet katër motivacioneve apo llojeve të konvertimit: dështakët/të papranuarit, ata që kërkojnë të pranohen, protestuesit dhe riinterpretuesit (ata që janë jashtë kontureve), të cilët kanë potenciale më të mëdha për t'u bërë aktivistë të dhunshëm.

Gjatë stadi të identifikimit, një person pranon një ideologji radikale, duke toleruar e inkurajuar, justifikuar veprimet e tij. Personi merr distancat nga jeta e tij e mëparshme. Grupi i ri i të barabartëve i siguron atij një identitet të ri social, i cili do ta izolojë atë më tej nga pjesa tjetër e botës. Ndjenja e të qenit “të zgjedhur” dhe të lidhjes së grupit, përforcon pozitën dhe besimin e tij gjithashtu. Ndosht që një individ do t'i duhet të provojë dedikimin e tij ndaj grupit dhe ideologjisë së re duke marrë angazhime të posaçme. Udhëtimet apo kurset jashtë shtetit përdoren si nxitje për dedikim, por ato ofrojnë gjithashtu mundësi të tjera për t'u takuar dhe identifikuar me individë të huaj që kanë të njëjtat ide. Eksperiencat paramilitare të tilla si, seksione të lojës së “paintball” (një lojë në të cilën mund të garosh me skuadra apo individualisht për të eliminuar kundërshtarët duke i qëlluar me armë me bojë) mund të shpjegohen edhe si krijim skuadrash për integrimin e anëtarëve të rinj në grup.

Stadi i radhës është indoktrinimi. Ideologjia radikale është tashmë e pranuar. Individu është i anëtarësuar plotësisht në grup dhe kërkon pjesëmarrje aktive. Ai ndjek të gjitha udhëzimet e liderëve (shpirtërorë) dhe humb çdo lloj këndvështrimi kritik. Atij fillojnë dhe t'i besojnë gjithnjë e më shumë përgjegjësi të ndryshme në grup kështu që ai vë re se asgjë nuk ka ndryshuar, por ai njihet me potencialin e tij dhe bindet se janë të nevojshme veprime të mëtejshme. Duke udhëtuar jashtë, disa herë edhe në zona me konflikte, në grupime të vogla apo edhe individualisht, forcohen bindjet e tij. Rekrutuesit do t'i tregojnë më tej rrugën nëpërmjet indoktrinimit ideologjik më të lartë dhe trajnimit fizik e ushtarak.

Stadi final është ai i veprimit në emër të çështjes. Këto aktivitete përfshijnë një sërë punësimesh, intelektuale si edhe operative, kriminale ose jo, të dhunshme ose jo... Objektivi përfundimtar i këtyre aktiviteteve është që të ndihmojnë çështjen që të godasë shoqërinë apo komunitetin kundërshtar. Individët janë të angazhuar enkas në këto aktivitete dhe thirren në sajë të aftësive dhe njohurive të tyre të veçanta në emër të çështjes. Strukturat mbështetëse janë po aq të rëndësishme sa edhe ato operacionale dhe kërkojnë më shumë bashkëpunim se ekzekutorët vetë.

Para së gjithash, procesi i radikalizmit nuk është detyrimisht linear. Ai mund të jetë i butë dhe në disa raste i nxitur nga faktorë të jashtëm (p.sh. lider karizmatikë). Por gjithashtu ai mund të zhvillohet si një proces i brendshëm, i ashtuquajtur “autoradikalizëm” i nxitur për shembull nga interneti.

Modeli që vijon është një përshtatje e “Modelit të Shkallës” i zhvilluar nga Moghaddam¹⁹.

Moghaddam përdor metaforën e shkallëve që të shpien drejt akteve të terrorizmit në katin e fundit të godinës. Shkallët të shpien për në katet e larta. Që një person të mund të mbetet apo të mund të vijojë për më lart varet nga mundësitë që i ofron kati. Sapo individët ngjiten nëpër shkallë ata shikojnë gjithnjë e më pak zgjidhje, deri sa rezultati i vetëm mbetet shkatërrimi i të tjerëve, apo i vetvetes, apo i të dyve bashkë.

¹⁹ Fathali Moghaddam, 2008. Profesor dhe Drejtor i Programit të Zgjidhjes së Konflikteve në Universitetin e Xhorxhtaun (SHBA)

Kjo lloj peme e vendimeve të konceptimit të sjelljes, ka vërtetuar të jetë një mjet i fuqishëm në psikologji. Në çdo shoqëri ju do të gjeni njerëz të pakënaqur, të cilët ndjehen të deprimuar apo të keqtrajtuar. Nga ky grup, një numër i caktuar do të kërkojë drejtësi. Ata do të organizojnë mitingje, demonstrata...

Në shoqërinë tonë demokratike, kjo është gjë e lejuar, derisa nuk shfaqen akte kriminale të kryera gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve. Një numër i madh i këtyre individëve do të qëndrojnë në këtë nivel dhe do të vazhdojnë të luftojnë për drejtësi në mënyrë ligjore. Megjithatë, një grup i vogël, ngjitet në një nivel më të lartë sepse veprimet e tyre nuk kanë dhënë rezultatet që ata kishin shpresuar. Ata bëhen të dëshpëruar dhe fillojnë të shikojnë rreth e rrotull për persona të tjerë me të njëjtat ide dhe opinione. Kjo është pikërisht faza kur këta persona bëhen anëtarë të grupeve radikale. Në këtë nivel, ata mund të futen me anën e rekrutuesve, predikuesve apo të personave karizmatikë, të cilët i ofrojnë atyre shpjegime në lidhje me dëshpërimet dhe mlllefet e tyre, një shpjegim që shpesh akuzon autoritetet e civilizimit Perëndimor. Së fundmi, një grup fare i vogël, do të ngjitet në nivelim më të lartë, stadin e kryerjes së aktit terrorist. Sipas këtij modeli, të bëhesh radikal është një proces. Çdo person duhet të kalojë përmes këtyre stadeve. Por është fare e qartë se ky nuk është një proces automatik. Kjo do të thotë se në çdo nivel një pjesë e madhe e grupit mund të qëndrojnë në po atë stad apo edhe të kthehet në një nivel më të ulët. Vetëm një grup fare i vogël kalon të gjithë procesin.

4. Indikatorët e radikalizmit

Çdo ditë oficerët e policisë dhe anëtarët civilë të organizatave të policisë takojnë shumë njerëz të ndryshëm në situata të ndryshme. Gjatë këtyre takimeve ata mund të vënë re diçka që tregon se personi është duke u radikalizuar, duke radikalizuar të tjerët apo që është duke u planifikuar një aktivitet i dhunshëm apo madje edhe me natyrë terroriste. Oficerët e policisë mund të përballen me këto fenomene edhe kur janë duke kryer shërbimet e tyre të përditshme në trafik, gjatë bastisjeve, ndërhyrjeve, survejimit etj. Ajo që është e rëndësishme, qëndron tek fakti se oficerët e policisë duhet të jenë të vetëdijshëm, që një pikasje apo një raportim i tyre, mund të bëjë diferencën. Të dish se si të njohësh këta indikatorë të parë dhe se si mund t'i kundërpërgjigjesh atyre, parandalon një akt të mundshëm terrorist ose mund të ndalojë një person në procesin e radikalizimit.

Lista e indikatorëve është padyshim jo e plotë, por është e plotësuar nga rishikimi i ngjarjeve terroriste që kanë ndodhur nëpër botë dhe në bazë të eksperiencave të fundit në praninë e radikalizimit. Çdo indikator ka një vlerë të vetën, por nuk është një qasje specifike. Disa nga indikatorët apo aktivitetet janë të pafajshme, bile ndonjëherë edhe normale. Indikatorët duhet të konsiderohen në një kontekst të gjerë për të përcaktuar nëse nevojiten hetime të mëtejshme apo nëse është rasti për t'u alarmuar. Është gjithashtu e rëndësishme, që të theksohet se prezenca e njerit apo më shumë prej indikatorëve nuk do të thotë medoemos që një person është duke përgatitur një akt terrorist apo është në shtegun e radikalizimit. Këta indikatorë duhet të inkurajojnë oficerët e vijës së parë që të jenë më proaktivë dhe për të raportuar gjer në detaje preokupimet e tyre kundrejt një individi apo një grupi. Detyra e oficerëve të policisë së vijës së parë është që të vrojtojnë dhe të raportojnë dhe jo që të gjykojnë.

4.1 Grupime të ndryshme të indikatorëve

Kur njerëzit gjenden në proces radikalizmi apo përgatitje për sulme terroriste, ka dy

Beu, A.
«Policimi
në komunitet
dhe
terrorizmi»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

procese që duhen dalluar nga njëri-tjetri, që megjithatë nuk duhen ndarë. Kështu, ne kemi krijuar dy grupime të ndryshme indikatorësh:

1. Grupimi i parë përshkruan indikatorët që lehtësojnë identifikimin e një procesi të radikalizmit.

2. Grupimi i dytë liston gjashtë indikatorë para incidentit, të cilët mund të shpien në njohjen e përgatitjes së një aktiviteti terrorist.

Një faktor kyç për parandalimin e terrorizmit në përgjithësi, është parandalimi apo ndalimi i procesit të radikalizmit. Indikatorët e njohjes së rënies brenda në procesin e radikalizmit janë të ndarë në tre kategori të përgjithshme: identiteti, ideologjia, sjellja. Indikatorët e përgjithshëm këtu të listuar mund t'i atribuohen njëres apo më shumë prej këtyre kategorive. Ato nuk i shtohen një profili specifik por janë shenja që janë vënë re në individë të cilët më vonë janë bërë radikalë. Vetëm fakti se dikush ka dhënë prova të prezencës së njërit prej indikatorëve si p.sh rritja e mjekrës, nuk tregon një proces të radikalizmit të menjëhershëm, dhe aq më shumë s'mund të etiketohet si "terrorist". Duhet që të vëmë re kuadrin e përgjithshëm të ndryshimeve të dukshme. Këto indikatorë mund të dallohen nga dikush që ka qenë në dijeni të sjelljes së mëparshme të individit dhe të ndryshimeve që ka pësuar. Procesi i radikalizmit ndryshon nga njëri person tek tjetri dhe për këtë arsye shenjat e mundshme duhet të vlerësohen në kontekstin e tyre më të gjerë. Për të vlerësuar në mënyrë korrekte indikatorët, është themelore të kalojmë përmes një procesi të njohurive dhe eksperiencash. Nëse indikatorët vlerësohen gabimisht, puna e policisë në vend ta kthejë mbrapa do ta çojë përpara procesin e radikalizmit. Është shumë e vështirë për oficerët e policisë që të identifikojnë një proces në zhvillim të radikalizmit, pa pasur një trajnim të posaçëm.

Natyrisht që duhet marrë në konsideratë se asnjë nga indikatorët e mëposhtëm nuk mund të shërbejë si provë për të vërtetuar se një proces radikalizmi është në zhvillim. Në të njëjtën kohë, prezenca e tyre do të shpjerë në një rritje të vëmendjes dhe në një monitorim të mëtejshëm. Lista e mëposhtme nuk është një listë gjithëpërfshirëse e të gjithë indikatorëve të mundshëm. Ndryshime në pamjen e jashtme personale dhe në sjellje:

- ndryshimi i emrave – duke përdorur "alias";
- ndryshim në mënyrën e të veshurit, shpesh për të identifikuar të njëjtin model;
- ndryshim në pamjen e jashtme fizike, si p.sh. mënyra e rruajtjes apo rritja e flokëve/mjekrës;
- tatuazhe (të fshehta), shenja apo simbole;
- kërkimi i kontakteve apo frekuentimi i shpeshtë i liderëve të grupeve radikale;
- zotërimi i materialeve propagandistike – fletëpalosje, libra, DVD;
- ndryshim në praktikat fetare;
- pjesëmarrje në takime të mbyllura;
- përdorimi i internetit dhe i "chat-room"-ve me përmbajtje radikale;
- mbulimi me lavdi i martirizimit dhe i dhunës;
- ndryshim në zakonet e udhëtimit apo qëndrimi në vende specifike (d.m.th. në zona me konflikte);
- të folurit gjithnjë e më shumë hapur duke shprehur pikëpamje ekstremiste (d.m.th. pjesëmarrje në demonstrime radikale – dëgjimi I muzikës së grupeve radikale)
- izolim social dhe anëtarësim në grupet e të barabartëve, d.m.th. qëndrimi larg shkollës dhe klubeve rinore;
- ndryshim të zakoneve kundrejt dhe në ndërveprim me të tjerët – përdorimi i një

terminologjie specifike radikale;

- kryerja e krimeve të lehta duke përcëmuar qeveritë dhe shoqëritë.

4.2 Rast i studiuar në proces të radikalizmit²⁰

Marku është 23 vjeç. Ka lindur dhe rritur në zonën periferike të një kryeqyteti evropian, nga prindër jofetarë. Marku u rrit me të atin, por kishte dy vëllezër nga ana e mamasë. Ai filloi të kishte interes për fenë në fundin e viteve të adoleshencës dhe përfundoi me konvertim në fenë islamike. Megjithëse nuk i kishte të gjitha përgjigjet e shkakut të konvertimit të tij në mysliman, ai e përshkruan veten si një njeri që gjithnjë ka pasur problem dhe që është ndërjet gjithnjë si i humbur, gjë që e ka bërë të kërkojë mbrojtje tek feja. Kur kish lexuar mbi islamin në internet ai ishte vënë në kontakt me individë udhëheqës në një rrjet islamikësh radikalë, të cilët shpesh janë në kërkim të së rinjve të konvertuar së fundmi dhe kërkojnë t'i rekrutojnë ata. Pas një kontakti fillestar "online", Marku u ftua në shtëpitë e këtyre individëve dhe rrjedhimisht filloi të frekuentonte edhe xhaminë. Ai ndjehej shumë rahat në këtë ambient dhe filloi të kalonte gjithnjë e më shumë kohë në xhami, deri në pikën kur ai u zhvendos dhe filloi të jetonte praktikisht atje.

Lidershipi në këtë xhami e bindi Markun se ata ishin të vetmit myslimanë të "vërtetë" dhe të vetmit të cilët kishin kurajën për t'u ngritur për Islamin duke njohur dhunën dhe terrorizmin si mjete që justifikojnë qëllimin përfundimtar. Në këtë pikë, Marku ndërpreu kontaktet me miqtë e tij të vjetër dhe pranoi plotësisht mesazhin e marrë në xhami. Lidershipi gjithashtu i inkurajon ndjekësit e tij të shkojnë në zonat me konflikte për të luftuar për Islamin. Marku që tashmë ishte tepër i vullnetshëm për të shkuar në Irak për të luftuar por, sipas planit të dorëzuar nga njëri prej liderëve, duhej të shkonte më parë në Egjipt për të kaluar ca kohë atje, para se të vazhdonte për në Irak. Megjithatë, meqë Marku ishte vetëm 17 vjeç në atë kohë ai ishte larguar nga vendi i tij pa lejen e prindërve, atë e kthyen mbrapsht.

Mirëpo, sapo mbushi 18 vjeç, Marku u kthye në Egjipt. Ai filloi të ndiqte shkollën atje, ku njëri prej mësuesve e bindi atë që të ndryshonte qasjen e tij ndaj Islamit dhe ai e braktisi ideologjinë ekstremiste të promovimit të dhunës me të cilën ishte trajnuar deri në atë moment. Si rrjedhojë ai filloi të ndiqte rrymën e salafistëve, sipas të cilës dhuna e xhihadi është e legjitimuar vetëm në disa raste. Pasi kaloi ca kohë në Egjipt, Marku u largua për në Arabinë Saudite për të marrë arsimim të mëtejshëm në lidhje me Islamin. Deri tani ai është i fokusuar në versionin salafist të Islamit dhe kalon kohën me njerëz që e mendojnë në të njëjtën mënyrë të cilët nuk e pranojnë dhunën ekstremiste. Ai studio në Medina për dy vjet dhe mësoi më tepër rreth fesë dhe takoi myslimanë anëmbanë botës. Gjatë kësaj periudhe ai vizitoi edhe vendlindjen e tij disa herë, por nuk kontaktoi miqtë e tij të vjetër. Mirëpo, ai tani udhëton shumë duke u përpjekur të shpërndajë mesazhin e salafistëve.

5. Përfundime dhe rekomandime

Radikalizmi dhe terrorizmi janë bërë një sfidë e madhe e komuniteteve moderne evropiane. Edhe pse këto kërcënime kanë kryesisht një komponent kombëtar apo edhe ndërkombëtar, policia lokale ka një rol kritik për të luajtur, duke punuar me

Beu, A.
«Policimi
në komunitet
dhe
terrorizmi»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

²⁰ Community Policing Preventing Radicalism and Terrorism project, 2011.

komunitetet lokale, duke rritur elasticitetin e tyre ndaj radikalizmit dhe duke ndërhyrë në mbështetje të individëve në rrezik të ekstremizmit të dhunshëm. Policimi në komunitet shikohet si një mjet vital për parandalimin e radikalizmit dhe të rekrutimit të kriminelëve të mundshëm.

Kontakti pozitiv me autoritetet e zbatimit të ligjit, qytetarët dhe komunitetet, rrit besimin dhe kënaqësinë në publik. Ato komunitete që janë më të predispozuar të bashkëpunojnë me policinë në hetime kriminale dhe në programe të parandalimit të krimit, rezultojnë se kanë besim më të madh. Sistemi i policimit në komunitet mund të përshtatet anëmbanë Evropës për të pasur efekte dhe rezultate pozitive. Kjo është një mënyrë reciproke e ndërtimit të besimit dhe e shkëmbimit të informacionit inteligjent. Procesi i radikalizmit dhe i përgatitjes së sulmeve terroriste konsiston në një sërë grupimesh e treguesish. Ata mund të lehtësojnë identifikimin e procesit të radikalizmit. Treguesit para incidentit mund të na udhëheqin për të njohur përgatitjen e një aktiviteti terrorist. Kur kryejnë detyrat e përditshme të rutinës policore, oficerët e policisë mund të ndeshen dhe të zbulojnë disa nga këta indikatorë. Disa prej treguesve do të mund të pikasen vetëm nga komuniteti apo nga individë që kanë lidhje të ngushta me personat në fjalë. Kështu që është thelbësore, që oficerët e policisë të kenë përfituar besimin e publikut duke zbatuar policimin në komunitet brenda komunitetit, në mënyrë që atyre t'u ofrohet informacion inteligjent në bazë vullnetare nga këta individë.

Nuk ka asnjë teori që i jep një përgjigje pyetjes “Çfarë e shkakton radikalizmin e dhunshëm?”. Megjithatë, është pranuar gjerësisht se procesi i radikalizmit përbëhet nga stadi të ndryshme. Një ide e përgjithshme është se procesi i radikalizmit përfshin katër faza, të cilat përshkruhen si pararakizmi, identifikimi/konvertimi, indoktrinimi dhe veprimi. Megjithëse shumica e studimeve më të fundit janë fokusuar në procesin e radikalizmit të ideologjisë xhihadiste, teoria mund të aplikohet edhe për rrymatë tjera të radikalizmit të dhunshëm. Për individët, procesi i radikalizmit është futje në linjë dhe mënjanim nga shoqëria. Në këtë stad, një person kërkon një drejtim dhe një mision për të ardhmen e tij, që në rastin më të keq, është bërja terrorist.

Duhet theksuar se procesi i radikalizmit nuk është domosdoshmërisht linear. Ai mund të jetë i qetë dhe në disa raste i nxitur nga faktorë të jashtëm (p.sh. një udhëheqës karizmatik). Por gjithashtu ai mund të zhvillohet si një proces i brendshëm, i ashtuquajtur “vetëradikalizëm”, i nxitur p.sh., nga interneti. Duhet të theksojmë se jo të gjithë personat kalojnë të gjitha stadiet dhe shpenzojnë të njëjtën kohë në çdo nivel. Megjithatë, është krejt e qartë se ky nuk është një proces automatik. Vetëm një grup i vogël do të kalojë përmes gjithë procesit. Modelet e paraqitura në këtë shkrim synojnë që të shfaqin të gjithë procesin e radikalizmit. Ka tregues të ndryshëm, të cilët mund të tregojnë se një person është duke u bërë radikali. Për shembull, në përballjet e shumta që oficerët e policisë së linjës së parë ndeshen çdo ditë ata mund të pikasin diçka që tregon se një person është në proces të radikalizmit, duke radikalizuar të tjerët apo që një aktivitet i natyrës së dhunshme apo edhe terroriste është duke u përgatitur. Duke ditur se si të njohësh këto shenja paralajmëruese dhe mënyrën se si të reagosh ndaj tyre mund të parandalohet një akt të mundshëm terrorist apo të ndalohet një person në proces radikalizmi.

Bibliografi

1. "Community Policing Preventing Radicalism and Terrorism project, 2011.
2. D J Rowe. Selections from the papers of this central figure in London radical politics, now housed in the British Library. Originally published by London Record Society, London, 1970.
3. Europol, FBI, Departamenti i Policisë së Nju Jorkut, Policia Metropolitane e Londrës, Policia Holandeze Korps Landelijke Politiediensten.
<https://www.europol.europa.eu/content/te-sat-2014-european-union-terrorism-situation-and-trend-report-2014>.
4. Moghaddam, Fathali M. Rom Harre dhe Naomi Lee. *Global conflict resolution through positioning analysis*. New York: Springer, 2008.
5. Moghaddam, Fathali M. *How globalization spurs terrorism*. Westport, CT: Praeger Security International, 2008.
6. *Guide to the Political Parties of South America*, Pelican Books, 1973.
7. Hloušek, Vít; Kopeček, Lubomír Origin. *Ideology and Transformation of Political Parties: East-Central and Western Europe Compared*. Ashgate, 2010.
8. <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?f=ST+14469+2005+REV+4&l=it>
9. Ministria italiane e Mbrojtjes. *Strategia nazionale*.
http://www.difesa.it/Informazioni/DellaDifesa/periodico/IIPeriodico_AnniPrecedenti/Documenti/La_nuova_strategia_nazionale_Statu_512massa.pdf
10. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf
11. <http://www.thefreedictionary.com/radical>
12. IISS, The International Institute For Strategic Studies. "Islam and Terrorism: What We Can Learn from the Madrid and London Bombings" në forumin: *An ISS Forum in cooperation with the Wyndham Place Charlemagne Trust*, 25 maj 2006
13. BBC. "Police appeal for bombing footage", 10 korrik, 2005.
14. Nossiter, Adam dhe Rick Gladstone. "Paris Attacks Kill More Than 100, Police Say; Border Controls Tightened". *The New York Times*, (13 November 2015).
15. Morgan, Matthew J. *The Impact of 9/11 on Politics and War: The Day that Changed Everything?*. London: Palgrave Macmillan, 2009.
16. <https://www.admin.ch/opc/it/federal-gazette/2015/6143.pdf>.
17. Interpol: <http://www.interpol.int/Crime-areas/Terrorism/CBRNE>.
18. Interpol: <http://www.interpol.int/Crime-areas/Terrorism/Terrorism>.
19. Smith, Julie. *A sense of liberty*. Liberal International, 1997.
20. Konventa e Palermos,
(Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit Transnacional, 2000).
21. *Liberale und radikale Parteien in Klaus von Beyme: Parteien in westlichen Demokratien*. München, 1982.
22. Ligji "Për Policinë e Shtetit" nr. 108/2014
23. *Manual on radical radicalism*, 2008;
<http://infed.org/mobi/saul-alinsky-community-organizing-and-rules-for-radicals/>
24. Kryeministria e Kosovës. *Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit të Dhunshëm*.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf
25. Ministria e Punëve të Brendshme. *Strategjia e Policisë së Shtetit, 2007 - 2013*.
26. "Strategy on prevention of violent extremism and radicalization leading to terrorism 2015-2020". Prishtina, 2015
27. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr 930, datë 18.11.2015.
28. Vendimi i KM nr. 930 datë 18.11.2015, "Strategjia kombëtare kundër terrorizmit të dhunshëm dhe plani i saj i veprimit".
29. Thackrah, John Ritchard. *Dictionary of terrorism*, 2004.
30. CoPPRA, Manual 2011.
Community Policing Preventing Radicalism and Terrorism project, 2011.

Beu, A.
«Policimi
në komunitet
dhe
terrorizmi»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë



■ **Msc. Fran KAÇORRI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Migracioni është një ndër dukuritë që vazhdon të dominojë njerëzimin. Sot, më shumë së kurrë, vlerësimi dhe vëmendja në fushën e sigurisë, kanë angazhuar Shqipërinë, mbarë rajonin, por edhe Evropën e më gjerë. Shqipëria është një ndër vendet me emigracion më të zhvilluar, duke numëruar rreth 30% të popullsisë në emigrim. Ndërkohë, vitet 2008-2015 kanë shënuar një trend në rritje të imigracionit dhe veçanërisht atij të parregullt, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Imigracioni i parregullt, për nga përmasat dhe format e tij të zhvillimit, ndër të tjera duhet vlerësuar dhe si një rrezik potencial për sigurinë. Flukset migratore të vendeve të Afrikës drejt Evropës, vitet e fundit rrezikuan arritjen më të madhe të Evropës “Shengenin” dhe kjo vetëm sepse këto flukse rrezikuan seriozisht aspektet e sigurisë. Tendencat për të mbështetur fushën e turizmit apo ekonominë, motoja për lehtësimin e qarkullimit të njerëzve dhe mallrave nëpërmjet kufijve, nganjëherë largojnë vëmendjen nga çështjet e sigurisë. Mosbalancimi sa e si duhet i dy përbërëseve të motos “kufij të lirë dhe të hapur”, por “të kontrolluar dhe të sigurt” ndikon direkt në fushën e sigurisë. Ndërkohe që ka një “fluks” të studimeve mbi migracionin, ekziston një numër i vogël punimesh të mirëfillta të ndikimit të migracionit në fushën e sigurisë, apo në punimet e shumta mbi migracionin, ndikimi i tij në fushën e sigurisë zë një vëmendje të dorës së dytë. Ky punim tenton të sjellë një risi analize së normatives migratore në përgjithësi dhe asaj imigratore në veçanti, - tashmë, jo më vetëm si faktor zhvillimi, por krahas saj, atë të ndikimit në fushën e sigurisë.

Kaçorri, F.
«Imigracioni në
Shqipëri në
vitet 2008-2015
dhe ndikimi i tij
në fushën e
sigurisë»

Fjalëkyçe:

migracion, siguri, zhvillim, emigrim, migrim, siguri e brendshme

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

Hyrje

Sot, më shumë se kurrë, vlerësimi dhe vëmendja në fushën e sigurisë kanë angazhuar jo vetëm Shqipërinë, por mbarë rajonin, Evropën e më gjerë. Flukset migratore të vendeve të Afrikës Jugore drejt Europës, vitin e fundit rrezikuan arritjen më të madhe të Europës, - “Shengenin”, - dhe kjo, vetëm sepse këto flukse rrezikuan seriozisht aspektet e sigurisë. Terrorizmi ndërkombëtar është shndërruar gjithashtu në një faktor vendimtar për politikën e shteteve mbi hyrjen e të huajve në vend. Veçanërisht, pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, akteve terroriste në Francë, e jo vetëm, - shumë shtete europiane, individualisht e më pas me një politikë të përbashkët, kanë ndërmarrë zbatimin e masave të rrepta të kontrollit ndaj të huajve. Çështjet e sigurisë shpesh po përdoren si alibi për të kufizuar apo pezulluar të drejtat e emigrantëve. Me zgjerimin e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe terrorizmit, është shtuar doza e dyshimit ndaj emigrantëve. Në këto kushte, balancimi i çështjeve të sigurisë me respektimin e të drejtave të migrimit, është çelësi i suksesit të menaxhimit të drejtë të migracionit. Ndërkohë që ka një “fluks” të studimeve mbi migracionin, ekziston një numër i vogël punimesh të mirëfillta të ndikimit të migracionit në fushën e sigurisë; ose në punimet e shumta mbi migracionin, ndikimi i tij në fushën e sigurisë zë një vëmendje të dorës së dytë. Objekti themelor i këtij studimi, i referohet politikave migratore, të shprehura nëpërmjet normave migratore dhe rolit të tyre në fushën e sigurisë. Objekti i këtij punimi do të jetë gjithashtu përshkrimi i rolit të Shqipërisë në fushën e sigurisë së brendshme dhe asaj globale.

1. Migracioni dhe raporti i tij me emigracionin si dy komponentë të migracionit

1.1 Konceptet e imigracionit si pjesë përbërëse e migracionit

Imigracioni, si pjesë përbërëse e migracionit është: “Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve të huaj, me qëllim qëndrimin afatgjatë për motive punësimi, studimi, bashkimi familjar,

Kaçorri, F.
« Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

etj”. Për nga mënyra e hyrjes dhe e qëndrimit, imigracioni ndahet në *imigracion të rregullt* dhe *imigracion të parregullt*¹. *Imigracioni i rregullt*, përveç kriterit që, i huaji duhet të hyjë dhe qëndrojë në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotësojë dhe kriterin e qëllimit dhe kohës së kërkuar të qëndrimit e cila duhet të jetë afatgjatë. Të huajt, të cilët hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në Republikën e Shqipërisë, për një afat të shkurtër deri në 90 ditë në 180 ditë, nuk konsiderohen imigrant².

Dy janë format e zhvillimit të imigracionit të parregullt:

a. hyrja në mënyrë të parregullt dhe qëndrimi në mënyrë të parregullt;

b. hyrja në mënyrë të rregullt dhe më pas qëndrimi në mënyrë të parregullt.

Hyrja në mënyrë të parregullt dhe qëndrimi në mënyrë të parregullt, janë rasti klasik i migracionit të parregullt, ndikimi i të cilit në fushën e sigurisë është me i drejtpërdrejtë. *Hyrja në mënyrë të rregullt dhe më pas qëndrimi në mënyrë të parregullt* përbën sot gjithashtu një shqetësim real të së gjitha vendeve. Kjo ka ndikuar dhe në “shtrëngimin” ose thënë ndryshe, në forcimin e kontrollit të kushteve të hyrjes apo politikën e vizave³.

1.2 Historiku i zhvillimit të imigracionit në Shqipëri dhe tendencat e shfaqura në vitet 2008-2015

Nëse emigracioni shqiptar është shfaqur dhe zhvilluar shumë herët, ashtu si në të gjithë botën, imigracioni në Shqipëri është një dukuri migratore e cila ka njohur zhvillim pas viteve 1991, vite të cilat përkojnë me ndryshimin e sistemit. Nëse gjatë viteve të izolimit 50 vjeçar, një numër shtetasish shqiptar arritën të *emigronin* ilegalisht nëpërmjet kufirit drejt vendeve të ndryshme, duke shtuar numrin e diasporës së hershme shqiptare nëpër botë, *imigrimi* në Shqipëri në këto vite, ishte pothuajse një mundësi e pamundur. Hapja e Shqipërisë pas viteve ‘91, heqja e regjimit të vizave për një numër të konsiderueshëm të vendeve apo ofrimi i mundësive të pajisjes me vizë pa një sistem kontrolli e verifikimi për pjesën tjetër të vendeve disa vite pas ndryshimit të sistemit, mos kontrolli, sa e si duhet, i imigracionit në vend, problematika e madhe që shkaktonte në këto vite emigracioni ilegal nga Shqipëria, drejt vendeve të BE-së dhe vëmendja e madhe e strukturave përgjegjëse në Shqipëri, vetëm drejt emigracionit dhe nganjëherë “harresa” e trajtimit dhe të imigracionit me të njëjtën përgjegjësi, jo vetëm që nuk shënojnë modelin e ngritjes së një sistemi efikas të menaxhimit të imigracionit, por imigracioni as që konsiderohej se ekzistonte. Imigracioni i rregullt në Shqipëri nga viti 2008 -2015 paraqitet në rritje, përkatësisht: 5079 të huaj, në vitin 2008; 5578 të huaj në vitin 2009; 3892 të huaj në vitin 2010; 4273 të huaj në vitin 2010; 4273 të huaj në vitin 2011; 4870 të huaj në vitin 2012 dhe 5937 të huaj në vitin 2015⁴.

Imigracioni i parregullt në Shqipëri, i identifikuar, për vitet 2008-2015 gjithashtu ka shënuar rritje dhe konkretisht: në 108 të huaj, në vitin 2008; 64 të huaj në vitin 2009; 89

Kaçorri, F.
«Imigracioni në
Shqipëri në
vitet 2008-2015
dhe ndikimi i tij
në fushën e
sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.2, 2016

¹ IOM (International Organization for Migration). *E drejta migratore*. Tiranë, 2009.

² Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. *Strategjia Kombëtare për Migracionin* (2005-2010). Vendimi Nr. 760, datë 19.11.2004, Tiranë.

³ Direktiva e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”.

⁴ IOM. *Profilet e Migracionit të Shqipërisë, 2007-2009*.

të huaj në vitin 2010; 476 të huaj në vitin 2011; 1 167 të huaj në vitin 2012 dhe 1978 të huaj të parregullt në vitin 2015⁵.

2. Ndikimi i imigracionit në fushën e sigurisë

Imigracioni i parregullt ka një ndikim të theksuar negativ në fushën e sigurisë, pasi personat të cilët hyjnë dhe qëndrojnë apo tranzitojnë nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit nuk janë të kontrolluar dhe monitoruar. Megjithatë historia ka treguar se elementë terroristë, të cilët i kanë sjellë kërcënime të mëdha jo vetëm vendeve të veçanta, por kanë rrezikuar dhe rrezikojnë njerëzimin, janë emigrantë të ligjshëm.

Ndikimi i migracionit ilegal në fushën e sigurisë mund të jetë si në vendin e origjinës, vendet transit nga ku kalojnë emigrantët e paligjshëm drejt vendit të destinacionit, ashtu edhe në vendin e destinacionit. Padyshim që në vendin e destinacionit, emigracioni i paligjshëm, i cili konsiderohet si imigracion në vendin e destinacionit, ka një ndikim të madh në fushën e sigurisë. Imigrimi ilegal përbën rrezik në fushën e sigurisë në vendin e destinacionit si në kuptimin e ngushtë të konceptit “cenim të sigurisë” ashtu dhe në kuptimin e gjerë të tij. Në kuptimin e ngushtë, ky rrezik për cenimin e sigurisë qëndron në faktin se elementët kriminal, terroristë apo të tjerë në çdo kohë janë të mbrojtur në aktivitetin e tyre nga faktori “i panjohur”. Në kuptimin e gjerë të konceptit të cenimit të sigurisë, imigrimi ilegal ka ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm të sigurisë publike, por dhe atë të cenimit të tregut të punës apo sigurisë ekonomike, të sigurisë së mjedisit, sigurisë kulturore, fetare etj.

3. Normativa imigratore shqiptare

3.1 Normativa rregullatore e hyrjes dhe qëndrimit të së huajve në Republikën e Shqipërisë

Normativa rregullatore imigratore e Republikës së Shqipërisë, si pjesë përbërëse e normativës migratore në tërësi, është relativisht e re dhe ka kaluar në një poqes përmirësimi të vazhdueshëm nën ndikimin e flukseve migratore të shqiptarëve kryesisht pas viteve '90, si dhe në përputhje me evoluimin e normativës migratore të BE-së gjatë këtyre viteve. Ligji “Për të huajt” 108/2013, solli përmirësime të ndjeshme në legjislacionin mbi të huajt në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, edhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji kanë sjellë një përmirësim të dukshëm të trajtimit të së huajve në Republikën e Shqipërisë si dhe në përgjithësi atë të menaxhimit të migracionit⁶.

Normativa rregullatore e hyrjes dhe qëndrimit të së huajve në Republikën e Shqipërisë në vitet 2008-2015 ku përfshihen aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat përcaktojnë dhe rregullojnë kushtet, kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshme që duhet të plotësojnë të huajt për të hyrë në Shqipëri, si dhe më pas ato të qëndrimit, ku dispozitat mbi lejet e qëndrimit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kësaj normative⁷.

Kjo normative, krahas plotësimi të standardeve ndërkombëtare dhe veçanërisht atyre të BE-së nga njëra anë, nga ana tjetër synon garantimin e lirisë së lëvizjes dhe qarkullimit të njerëzve, dhe mallrave, pa cenuar sigurinë e brendshme dhe garantuar drejtësinë. Vetëm nëse garantohet trinomi “liri-siguri-drejtësi” mund të themi se

⁵ IOM. *Profillet e Migracionit të Shqipërisë*, 2010-2013.

⁶ Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”.

⁷ Ligji nr 108/2013 “Për të huajt”.

Kaçorri, F.
« Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

normativa imigratore është në pozita favorizuese, pozitive dhe në interes të përgjithshëm. Kushtet e përgjithshme për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve, si: të mos jetë subjekt i një urdhri largimi, dëbimi apo ndalimi për hyrje ose qëndrim në Republikën e Shqipërisë; të mos përbëjë kërcënim për rendin ose sigurinë publike, për sigurinë kombëtare; të mos cenojë marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë me vende të tjera; të mos jetë shpallur person i padëshirueshëm, sipas këtij ligji, - janë kushte të përcaktuara vetëm për qëllim të garantimit të mosndikimit negativ të imigracionit në fushën e sigurisë.

Kriteret, veçanërisht ato të përcaktimit apo të ndarjes së shtetasve të vendeve që hyjnë me vizë dhe atyre që hyjnë pa vizë, domosdoshmëria e regjistrimit në strukturat rajonale të migracionit të shtetasve të huaj pas hyrjes në Shqipëri, etj., në vetvete, synojnë që të mundësojnë një kontroll të diferencuar ndaj të huajve që kërkojnë të hyjnë në Shqipëri, pikërisht në bazë të *rrezikshmërisë*, ku ndikimi në fushën e sigurisë është një element i rëndësishëm vlerësimi⁸.

Procedurat e bashkëpunimit mes strukturave të MPJ-së, MB-së dhe SHISH-it në plotësimin e kushteve për hyrje dhe qëndrimin në Shqipëri, kryesisht të së huajve që hyjnë me vizë, synon në kontrollin e gjithanshëm dhe në aspektin e identifikimit dhe parandalimit të hyrjes në Shqipëri të elementëve, të cilët do të ndikonin negativisht në sigurinë e brendshme. Verifikimi nga strukturat e sipërpërmendura, për elementë terroristë në bankat e tyre të së dhënave, por edhe të të dhënave të Interpolit, apo të publikimeve të OKB-së, BE-së, etj, të masave ndaluese për një numër të konsiderueshëm personash nga më shumë se 25 vende të botës, synojnë pikërisht garantimin e mosndikimit negativ të hyrjes dhe qëndrimit të kësaj kategorie e të huajsh në Shqipëri. Aplikimi i disa standardeve në pajisjen me lejeqëndrimi të së huajve në Republikën e Shqipërisë si, bashkëpunimi me strukturat e *kartotekës kriminale* në Policinë e Shtetit dhe asaj të SHISH, *dëshmia e penaltetit*, si dokument i cili kërkohet për çdo të huaj që aplikon për herë të parë në Shqipëri për lejeqëndrimi, janë synime të lidhura direkt me garantimin e mosndikimit negativ në fushën e sigurisë të së huajve që qëndrojnë në Shqipëri, apo të imigracionit në Shqipëri⁹

3.2 Normativa rregullatore e luftës kundër imigracionit të parregullt

Ligji “Për të huajt” 108/2013, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligji “Për Kufirin shtetëror” përbëjnë normativën rregullatore dhe të luftës kundër migracionit të parregullt. “Kodi Penal” i Republikës së Shqipërisë përbën pjesën më represive të legjislacionit penal, me ndikim në fushën e migracionit në përgjithësi, por edhe të asaj imigratore si pjesë përbërëse e migracionit. Shqipëria ka ashpërsuar masat ndëshkimore ndaj atyre që japin ndihmë apo favorizojnë migracionin e paligjshëm duke parashikuar dënime 1-4 vjet burgim, shoqëruar dhe me 3-6 milion lekë gjobë dhe, kur kjo sjell pasoja për jetën, dënim jo më pak se 15 vjet burg, deri në burgim të përjetshëm. Parashikimet në legjislacionin për të huajt i një sërë masash administrative si: gjobë në vlera deri në 400 000 lekë ndaj të huajve që shkelin këtë legjislacion, por jo vetëm ndaj tyre, por dhe të shtetasve shqiptar që i ndihmojnë ata apo ju mundësojnë ose ofrojnë shërbime, i punësojnë apo strehojnë ata, si dhe ndaj kompanive të transportit që mundësojnë transportimin e tyre, - plotësojnë politikën reaguese ndaj imigracionit të paligjshëm. Nëse një emigrant

Kaçorri, F.
«Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

⁸ Ligji Nr. 9284 data 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e Krimin të Organizuar”.

⁹ Ligji nr 108/2013 “Për të huajt”.

i paligjshëm nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së mund të konsiderohet si një mundësi eksportimi pasigurie nga Shqipëria drejt këtyre vendeve, një imigrant i paligjshëm nga vende të tjera drejt Shqipërisë duhet të konsiderohet gjithashtu si një premisë importimi pasigurie në Shqipëri¹⁰.

3.3 Normativa rregullatore e largimeve dhe dëbimit

Normativa e largimeve dhe dëbimeve është e lidhur ngushtë me dispozitat rregullatore ligjore në fuqi, të hyrjes dhe qëndrimit si dhe atë të luftës kundër migracionit të paligjshëm dhe, madje largimi dhe dëbimi i të huajit është rrjedhojë apo produkt i mosrespektimit të kushteve të hyrjes dhe qëndrimit nga ana e tyre apo ndryshe, të imigrimit të paligjshëm. Dispozitat ligjore në fuqi të largimit dhe dëbimit të së huajve, të cilat përbëhen nga përcaktime ligjore të *largimit vullnetar*, të *dëbimit*, si dhe ato të *ndalimit në qendër të mbyllur* apo zbatimit të *masave alternative të ndalimit*, synojnë në shumicën e rasteve, luftën kundër imigracionit ilegal, ku indirekt, kjo luftë ka ndikim edhe në fushën e sigurisë. Por, në disa raste, kjo politikë është e drejtuar dhe e fokusuar direkt në interes dhe për qëllim të garantimit të sigurisë kombëtare. Njohja e vendimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, apo institucioneve të Bashkimit Europian, lidhur me personat e shpallur si të padëshiruar në vendet e Bashkimit Europian dhe ato në rrafshin ndërkombëtar, nuk janë vetëm një risi e ligjit nr 108/2013 “Për të huajt”, por, në vetvete, janë përcaktime ligjore me ndikim pozitiv dhe me interes në fushën e sigurisë, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar¹¹.

4. “Lëvizja e lirë” dhe ndikimi në fushën e sigurisë

4.1 Politikat lehtësuese të lëvizjes dhe ndikimi i tyre në fushën e sigurisë

Në dokumentet strategjike të Republikës së Shqipërisë, në të cilat është përcaktuar politika e lëvizjes së njerëzve, ideve, mjeteve dhe mallrave nëpërmjet kufijve, përcaktohet se vizioni ynë është: “*Kufij të hapur, të lirë, por të sigurt dhe të kontrolluar*”. Regjimi i vizave, nga njëra anë synon të lehtësojë lëvizjen e njerëzve, ndërsa nga ana tjetër kërkon kontribute për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Lehtësimi i regjimit të vizave apo liberalizimi i vizave në vetvete do të thotë “tërheqje” nga politika e kontrollit apo verifikimit paraprak të personave, të cilët kërkojnë të hyjnë në vend, bazuar në konsideratën e përgjithshme, se një vend i caktuar ka plotësuar pikërisht standardet që lidhen me sigurinë. Praktika e BE-së, lidhur me lehtësimin e vizave dhe më pas liberalizimin e vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë, është modeli më i qartë i cili provon një gjë të tillë¹².

Vitet e fundit, Shqipëria ka ndjekur një politike disi liberale në këtë drejtim, ndikuar kjo nga nevoja e industrisë së turizmit për t’u “ushqyer me lëndë të parë”, apo nga marrëdhëniet tradicionale me disa shtete të tjera si Turqia, apo vetë rrethanat e një kombi me Kosovën. Heqja e regjimit të vizave për shtetasit e disa vende për sezonin turistik të verës, e ndikuar kjo nga industria e turizmit në Shqipëri, jo vetëm që ka qenë

Kaçorri, F.
« Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë »

¹⁰ Ligji nr 108/2013 “Për të huajt”.

¹¹ Ligji nr. 10060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

¹² Direktiva 2009/52/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 18 qershor 2008 “Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm”.

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

në këto vite në qendër të kritikave të progresraporteve të BE-së, por në vetvete, ka qenë edhe një potencial serioz për cenimin e sigurisë në vend; dhe eksportimin më pas të këtij kërcënimi, drejt vendeve fqinje apo atyre vendeve më të targetuara nga elementë me prirje negative ndaj BE-së¹³.

Interesi ekonomik për të lehtësuar sa më shumë politikën e lëvizjes apo atë të liberalizimit të vizave me vende potencialisht me interes, për sektorë të ndryshëm duhet të balancohet gjithmonë me interesin kombëtar në fushën e sigurisë ose se paku, çdo “hapje” për interesa ekonomike duhet të shoqërohet me rritje dhe forcim të kapaciteteve për të kontrolluar këtë “hapje”, deri në atë shkallë ku të garantohet edhe siguria e brendshme. Eksperienca e viteve të fundit, jo shumë pozitive, e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, ka vënë jo pak herë në pikëpyetje kthimin e regjimit të vizave, pikërisht për shkak të cenimit të sigurisë së qytetarëve të BE-së nga shtetasit e vendeve të rajonit, si rezultat i keqpërdorimit të mundësive që ka ofruar liberalizimi i vizave¹⁴.

4.2 Flukset migratore dhe ndikimi i tyre në fushën e sigurisë

Flukset migratore nga vendet e Afrikës Veriore dhe nga Lindja e Mesme, drejt vendeve të BE-së, kanë prekur ndjeshëm territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllim tranzitimi. A do të këtë ndikim në fushën e sigurisë një fluks i mundshëm imigrator në Shqipëri, qoftë dhe imigracion transit, në përmasa që ka prekur vendet tjera të rajonit? Imigrimi i paligjshëm lë gjurmë dhe ka ndikim në fushën e sigurisë dhe në vendet transit. Gjatë kësaj kohe, qëndrimi apo tranzitimi, mund të sjellin të njëjtat probleme në fushën e sigurisë, njëjloj si në vendet e destinacionit. Madje nganjëherë, prirja e tyre për t'u përfshirë në aktivitetet kriminale në tranzitim është më e madhe, nisur nga fakti që janë përkohësisht në këto vende dhe kanë mundësi më të pakta për t'u zbuluar nga strukturat e luftës kundër krimit. Tabloja e këtyre flukseve, - veçanërisht e dy-tre viteve të fundit në Shqipëri, - ka tërhequr vëmendjen jo vetëm të strukturave lokale dhe qendrore të Kufirit dhe Migracionit, por edhe të autoritetit të Policisë së Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe të strukturave përgjegjëse për sigurinë kombëtare në vend. Eksperienca negative në vendet e tjera të rajonit, janë një kamberë alarmi.

4.3 Roli i politikës migratore të Shqipërisë në fushën e sigurisë së brendshme dhe asaj globale në kuadër të proceseve integruese Euro-Atlantike¹⁵

Siguria kombëtare është pjesë integrale e sigurisë, e sigurisë rajonale dhe në përgjithësi e asaj globale. Garantimi i sigurisë në kufijtë e brendshëm të vendit, është kontribut në garantimin e kufijve të jashtëm të vendeve me të cilat kufizohemi dhe në mënyrë të veçantë të kufijve të jashtëm të Bashkimit Europian. Politika migratore me dy përbërësit e saj, politikën emigratore dhe atë imigratore, synon në forcimin e Shqipërisë si një aleat dhe partner i sigurt i rajonit, BE-së dhe më gjerë, në fushën e sigurisë¹⁶.

Kaçorri, F.
«Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë»

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

¹³ Direktiva 2008/115/KE e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008 “Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt”.

¹⁴ Vendimin Kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002 “Për forcimin e kuadrit penal me qëllim forcimin e ndalimit të hyrjeve të paautorizuara, transitit dhe qëndrimit”.

¹⁵ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2007-2009). Tiranë, 2007.

¹⁶ Direktiva e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”.

Për sa i përket anëtarësimit në NATO, politika migratore e Shqipërisë e hartuar dhe zbatuar në përputhje me politikën migratore të BE-së, luajti një rol në plotësimin e standardeve për anëtarësim. Po ashtu në procesin e liberalizimit të vizave, një kapitull i posaçëm i detyrimeve që u kërkua për tu plotësuar, ishte mbi politikën migratore. Në procesin e anëtarësimit në BE, plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kapitulli 24 lidhur me politikën migratore, është shumë i rëndësishëm.

5. Përfundime

1. Migracioni i paligjshëm është një fenomen me ndikim direkt në fushën e sigurisë. Ashtu siç migracioni shtrihet në më shumë se në një vend dhe ka karakter global, ashtu edhe ndikimi në fushën e sigurisë, ka karakter global dhe prek me shumë se një vend.

2. Ngritja dhe forcimi i partneriteteve mes vendeve, mbi migracionin, do të thotë gjithashtu, ngritje dhe forcim i partneriteteve në garantimin e sigurisë së përbashkët.

3. Në kushtet e “hapjes”, balancimi i çështjeve të sigurisë me respektimin e të drejtave të migrimit është çelësi i suksesit të menaxhimit të drejtë të migracionit.

4. Harmonizimi i politikave migratore të vendeve të origjinës me vendet e destinacionit, përfshirë dhe ato transite, ndikon drejtpërsëdrejti në unifikimin e një politike të përbashkët për të garantuar *krijimin gradual të një zone lirie, sigurie dhe drejtësie*.

Bibliografi

1. *Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2007-2009)*. Tiranë, 2007.
2. *Strategjia Kombëtare për Migracionin (2005-2010)*. Tiranë, 2004.
3. Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” (i shfuqizuar).
4. Ligji nr 108/2013 “Për të huajt”.
5. Ligji Nr. 9284 datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar”
6. Ligji nr. 10060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.
7. IOM. *E drejta migratore*, Tiranë, 2009
8. IOM. *Profilet e Migracionit të Shqipërisë*, 2007, 2008.
9. Ministria e Punëve të Brendshme. *Profili i Migracionit i Shqipërisë për vitin 2010*.
10. Ministria e Punëve të Brendshme. *Profili i Migracionit i Shqipërisë për vitin 2013*.
11. Direktiva 2009/52/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 18 qershor 2008 “Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm”.
12. Direktiva e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimin të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”.
13. Direktiva 2008/115/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 dhjetor 2008 “Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtarë për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt”.
14. Direktiva e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004 “Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët”.
15. Direktiva e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004 “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”.
16. Vendimin në Kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002 “Për forcimin e kuadrit penal me qëllim forcimin e ndalimit të hyrjeve të paautorizuara, transitit dhe qëndrimit”.

Kaçorri, F.
« Imigracioni në Shqipëri në vitet 2008-2015 dhe ndikimi i tij në fushën e sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.2, 2016

ENGLISH

ABSTRACTS

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 2, APRIL, 2016

August Vollmer – the “father” of American Modern Police

Dr. Stavri SINJARI, Dr. Sofokli DUKA (*post mortem*)

ABSTRACT

August Vollmer is one of the main figures in the creation of the American modern Police. Like in any other fields of human creation activity, even in the policing field, there are distinguished the great heads, those that through their work in the country has left a valid heir for the generations to come. The Police students and employees, researchers and historians, would discover in Vollmer the special man of the American Police and beyond, who represents at first the marshal and head of the city post, and later the president of the American Police departments, the professor and founder of the police schools, the strategist of the police progress, the professor and publisher as a honest man, very dedicated at the work of the police leader, one who had an extraordinary will and strong character, which became the base of his unstoppable career, which put Vollmer at the highest position – known today in all the world, even after a century, as the “father” of the American Police.

Reasons that bring about vibrations in the dynamic stereotype of individual's handwriting

Msc. Vladimir IKONOMI

ABSTRACT

The study of some aspects of handwriting is of particular importance for several reasons which have become obvious due to the increase of publications and written professional papers approaching the issue in general or tackling special aspects arising from the need of conducting graphic examinations in the process of penal and civil cases. During the graphic examinations of manuscripts, the graphologists can observe effects deriving from different deceases or the use of narcotic substances or alcoholic drinks, noticed mainly in the graphic line of the manuscripts and the signatures that are subject of expert analysis. The investigation of specific cases is conducted when there is reasonable doubt that the graphic line vibrations are related to a forgery or concealing of the original handwriting of a given person. According to the forensic experience of graphologists, there have often been identified manuscripts with graphic line fluctuations in the form of vibrations. It is the responsibility of the graphologist to study and analyze the features of fluctuations of the graphic line in manuscripts and signatures and establish the causes, conditions, and circumstances that have influenced and contributed to their creation.

Development and enforcement of the cooperative environment in the field of security and the role of SEPCA

Dr. Ilo KËÇKA

ABSTRACT

One of the instruments that the regional countries police have chosen to enforce cooperation between them in the last 13 years is the “Society for the Police Head of the Countries of South-East Europe” (SEPCA). SEPCA is created on January 20, 2002, in Valbandon (Pula) Croatia, from the directors of the police in countries like Albania, Bulgaria, Croatia, Rumania, Serbia and Bosnia-Herzegovina. Albanian Police has valued and values this organization, not only and simply as a declarative expression of the

will of police heads of the countries of this region in order to cooperate among them, but also considers it, one of the most important instruments, over which is based police cooperation. Since its formation, SEPCA has had as the main mission, the growth and making it a reality the direct communication between the heads of police of the countries of our region, with the aim of growing the police standards and an increasing engagement and cooperation in the field of international relationship between the police institutions. From November 2014 to November 2015, the State Police of Albania has kept the presidency in row of SEPCA-s. The State Police Director, Great Leader Haki Çako, has been the president of this organization with a yearly mandate, which expired in November 2015.

Cooperative security in a changeable international environment

Dr. Ruzhdi KUÇI

ABSTRACT

Peace concept has traditionally been linked with the state of international relationship. In general, there may be identified three international relationship states: war, peace and war absence. War is a state of armed conflict that happens between states, whereas peace is interruption or lack of such a conflict. The fact that the state of war does not exist does not necessarily mean that peace is established. That is the reason why a third state, lack of war shows that the conflict or an armoring race between the parties will continue to form a framework of their confronted relationships. Attempts for peace are often combined with attempts for security. The term “cooperative security” has had a wide use since the end of the Cold War. However, there is not yet a definition accepted from all the actors that it is used mainly as a precedent of a new approach in international relationships. If we are to accept that the wide concept of security includes the political, economical dimensions and human rights, then the cooperative system of security must be linked with all these aspects. Cooperative security may become the base for a peaceful and more harmonized future. It combines four main forms of security: individual security, collective security and defense as well as the promotion for stability.

European Police Cooperation through learning – CEPOL and the Academy of Security

Msc. Adriatik DUQI

ABSTRACT

The situations and needs for police schooling and trainings may be different in different European countries. European countries are multifaceted and different – and so is Police. There are certain police common needs for all Europe, but at the same time there are also same different needs for every special region. Traditions, systems and values, histories of totalitarianism or democracy, of war or peace, religion and mentality are different, as well as it is different also the social context for police and police fear. The ways through which policing is organized and applied are also different, as well as the ways how police sees itself and the systems of trainings. Beside this diversity and consequently the space needed to accommodate such differences, as well as to preserve in this way special identities, there exist certain common grounds. One as such is the membership into European Council and European Union, which in turn means the declaration of interest to follow the European values

and standards. As a consequence, the state agencies must respect such principles. The public has the right to hope that the police work in all the European Union is based on certain common standards.

The police officers have the right to hope that their superiors will respect such basic directions and structure (or re-structure) the organization in compliance with such principles and common values of EU. Another common interest is to make the Police work more effective and in this respect, every police force would be very content if the principles and norms accompanying such values are consolidated and every officer without any exception accepts the responsibility over them. That was the exact reason of the indispensability for the creation of the European Police College, as well as a unified system of curricula, in order for all the EU countries, candidate countries and those inspiring the enter EU, to have a common standard of police education. Police officers had the right

Cybernetic crime, effects upon security strategies against it **Msc. Qetësor GURRA**

ABSTRACT

Inside the issues concerned, at first I have introduced the speed for the growth of the cybernetic crime industry, in order to understand the meteoric growth that happens together with the development of technology. It was not in vain the facts I brought about regarding three countries which hold a great economical potential. At the moment that the reader comes to know such data, they understand themselves the need and reason why such penal offence needs to be treated and fought indispensably. Further on, I made a classification of the cybernetic crime and types of penal offence mentioned. Then, I treated the computer crime in Albania, explaining the time of implementation for the first dispositions in our country, the way how a penal act is treated, the existing state, difficulties that deeply felt upon in the adaptation of the basic strategies and objectives, possibilities that possess to give the maximum and fulfill the established aims, main challenges ranked according to the importance they have, number of users for technology and telecommunication, disposability and access that the wide audience has against the techno-informative equipments, the disposability of non-filtered information, lost of the control mechanism and the concerned international dimensions of such penal act. Lastly, I introduced some anti-cybernetic strategies, the cybernetic legislation between developed countries and those developing ones, advantages and disadvantages of similar strategies and main objectives against the computer crime war from the international organisms and member countries.

Police development and criminality seen under the light of socio-psychology and criminology **Msc. Anisa AGASTRA**

ABSTRACT

The challenge of modern policing is an orientation towards the service in community, leaving behind the traditional approach of using the force and supreme authority. Under this logic the sociological, psychological and criminology discipline come to help to the police in order to construct a three-dimensional panorama of events or criminal realities. American practices is more and more increasing the necessary

affect upon such disciplines, in order to understand deeply the conditions under which the criminal events, causes or manifold problems are happening, so that there may be found preventing ways which are realistic and effective. Attention is led toward the issue of social reaction against criminality and policing with which special branches of sociology, psychology and criminology deal with. Psychological approach helps in treating the emotional, psychopathological or personality related problems in the society. The sociological approach serves to treat problems, tendencies or trends of all the society, suggesting ways to solve and prevent phenomena. Whereas that criminological one has in its focus the causes and circumstances of what happened during a criminal event. This material contains the main psychological, psychosocial, sociological and criminological theories, which are related to the wide field of criminality and policing, analysis, as well as formulas or thoughts of classical or contemporary researchers. The study of society and social relationships would have been very valuable within the aspect of causation, essence of the psychological, social, economical, political problems, etc. That would have served theoretically as well as practically, in the everyday work of the police employees. That is the reason why in this piece of writing is noticed the role of these disciplines under the function of the qualitative understanding of the phenomenon and events, as well as the high effectiveness in the work of the police institutions and employees, within the framework and approach of contemporary policing modules cooperation.

Community Policing – the philosophy and way of future policing **Msc. Ilia NASI**

ABSTRACT

Many countries of the region, including Albania, have recently implemented a new way of policing, community policing. After a successful experimentation and implementation, especially in the last decades, and supported by our partners (international missions that have assisted and aided State Police), the philosophy and practice of community policing, also referred to as the philosophy of partnership with the public, seems to be gaining ground and identity. The institutionalization and carrying out of this major project, as a form of the future policing, have already become part of the efforts of the Albanian state and society in addressing and implementing community policing, comprising one of the most characteristic approaches of democratic policing in our country. This has become notably evident in almost all presentations and pilot projects carried out within the framework of the recent structural and organizational reforms.

The main objectives of community policing are expressed in the State Police Strategy 2013 – 2021, which aims at integrating and extending this form of policing in all components of the police work; building and consolidation of a partnership with the community, local governance, and groups of interests; improving the quality of administrative and police services to citizens and businesses, etc. In essence, this project aims at meeting the needs and the increasing demands of the community for a correct and professional police service by further enhancing the level of public confidence in the State Police. It will be accomplished through an increased cooperation and amicable attitude of the police employees and patrols on service or in action, revealing with their presence their goal to protect the citizens and the society from wrongdoers, and ensure the safety of life and public and private property. The purpose of this analytical view of the issues that community policing is faced

with is to expose the problems that the implementation process of community policing in our country is coping with and define that effective policing requires partnership with the communities and that police employees should be part of the joint efforts of the society to promote legal protection and the sense of security.

Investigation of crimes against life

Msc. Tonin VOCAJ

ABSTRACT

The issue of human life protection from murder is of a historical, socio-political, legal, and practical importance. Crimes against life are serious crimes that affect the right to live, as the most fundamental human right protected by the Universal Declaration of the General Assembly of the UN (1948), the European Convention (1950), and the Constitution of the Republic of Albania (Article 21). According to the statistical analysis, crime against life has been a disturbing phenomenon for the Albanian society since the creation of the Albanian state. The large number of killings is also associated with the presence of high blood feud in many parts of the country due to the absence of public order and the judicial structures. Other important reasons of the presence of conflicts and consequently, of the murders, have been the high presence of weapons, the demographic movements of the population, and the unsolved problem of property ownership. However, it should be noted that the main cause of criminal homicide, has been self justice in resolving conflicts and problems.

In order to have a thorough, objective, and professional investigation of the crimes against life, you should know well the mechanism these crimes are committed with; rebuilding the circumstances and means of murder, the existence of conflict, the existence of the motive and purpose, the necessary tools to commit the crime, elimination of obstacles, traces and evidence found at the crime scene, identifying and questioning the witnesses and family members of victims, etc.

Among the main objectives of the investigation of crimes against life, of prior importance is to establish the commitment of the offense by the author, as well as to determine the motive and purpose of committing the offense. The subjective elements of the investigation are important to determine the specific provision but also the degree of guilt and responsibility of the offender. Investigations of crimes against life are complex and it is of utmost importance to apply the forensic techniques, conduct the required tests, as well as to apply the contemporary methods of the analysis of all elements of the investigation in order to draw objective conclusions and bring the perpetrators of these serious crimes before justice.

Police Management after the '90-ies and its impact on the assurance of public safety and order

Msc. Arben IBRO, Msc. Bora SELMANI

ABSTRACT

Management is one of the key elements of every leader's work in general, and very much so of the police leader of any level. The successes and failures at the police work depend to a considerable degree on their leaders. Hence, a successful police leader must have a comprehension of the concept of modern management, its functions and arrays, and must be able to apply them in the daily police activity.

The reference to this period in analyzing police management was singled out due to

the intense changes the Albanian society, consequently the Albanian police, were undergoing. Other reasons are the historic events and serious criminal offences, as well as the positive or negative police experiences in managing them.

For study purposes, the analysis of the police management of this period is divided into several stages, each bearing distinguishing features. The first stage analyzes the police management during 1990 – 1996, the time when the totalitarian system in Albania was overthrown, the political pluralism declared, and the country embarked on the road of democratic processes and the profound institutional reforms (including the police). The second stage, studies the police management during 1996 – 1997, as one of the most difficult periods not only for the Albanian society, but also for the police and its existence. It is the time when in Albania, due to the collapse of the pyramidal schemes and the cumulative discontent, took place and were identified serious criminal occurrences, serious violations of public order, civil unrest and total anarchy, and a brief inexistence of the state institutions (including police). The third stage explores the police management period following 1997, the time when Albania put behind her back the events of 1997 and embarked on the path of major transformations in all the fields of the life of the country and, consequently, of significant developments of State Police with regard to its mission, structure, legislation and increase of professional level, aligning it with the police forces of European countries and transforming it into a public service.

Intelligence and balance between freedom and security **Dr. Zihni GOXHAJ**

ABSTRACT

The role of information today as an information society, is without any doubts not only great but also indispensable. Today information is produced by specialized organs, intelligent services, but also those open institutions and especially the written and electronic media, as well as internet. Since the specter of producing given information has increased, the today's society is threatened from the manifold risks like the privacy offence, misinformation or revelation of information. The main dilemma for the intelligent services in all the world has to do with the concern that how it must act as a protector for the democracy on one hand and engage in secret operations that are not opened to the public, on the other hand. In all the democratic societies, all the services are obliged to face the problem of how to achieve equilibrium between the operational discrepancy and opening it up to the public, who must know how to defend their rights and how is the money of their own taxes used. As one of the expert in the intelligence field, especially that military one, today when the information is misused and misinterpreted, I feel as being logical to give a view of the social and technical reality for the evaluation and security that our society has under such conditions of using the today's information and putting in turn a balance between freedom and security.

Subject: Community policing and terrorism **PhD Candidate Artur BEU**

ABSTRACT

Fight against terrorism of all forms is, presently, one of the most difficult challenges. That is partly a result of the worldwide globalization. Recent attacks in Paris clearly

proved that prevention of the phenomenon of terrorism requires enormous efforts by the intelligence community and police. In this respect, the philosophy of community policing seems to have an upper hand in the prevention of terrorism, starting with its indicatory elements. The process of activation, radicalization, and terrorism are characterized by a range of indicators that should be identified since their early stages in order to prevent terrorist acts of all kinds. This paper aims at promoting the capacity building aspect of police officers at operational level and the professionals of community policing – who, with the implementation of the new law on the State Police, are well-structured – in order to identify the indicators that lead to radicalization. It also aims at defining the community intelligence gathering work, in order to prevent further spread of the ideas of violent radicalization, which also brings about an increase of capacities. All the above contribute to building relationships and partnerships with local communities and the application of community policing in preventing radicalization and terrorism.

Immigration in Albania during 2008 – 2015 and its impact on public security

Msc. Fran KAÇORRI

ABSTRACT

Migration is a phenomenon that continuous to dominate humanity. Presently, more than ever, the consideration and awareness on the issue of security have demanded the commitment of Albania, the whole region, Europe, and beyond. Albania is one of the countries with a high rate of immigration, counting up to 30% of its population. Meanwhile, the years 2008 – 2015 marked a growing trend of immigration, particularly of the illegal immigration, in the territory of the Republic of Albania. The illegal immigration, with regard to the extent and nature of its development, should be assessed, among others, as a potential threat to security.

Migratory flows from African countries towards Europe, have recently threatened the greatest achievement of EU, “Schengen”, mainly because they seriously endangered the security aspect. The tendency to support tourism or the economy, the motto to facilitate the movement of people and goods across the border, have sometimes diverted the attention from the security issues. The lack of balance marked between the constituents of the motto “free and open borders”, but “controlled and safe” impacts directly the field of security. Even though, there is a “stream” of studies on migration, the papers tackling the impact of migration on security comprise a minor and second hand attention. This paper attempts to bring forth an innovative analyses of the traits of migration in general and immigration in particular, - not only as developing factors but of their impact on the security as well.



IN MEMORIAM

PROFESORIT TË AKADEMISË SË SIGURISË DHE NJERIUT QË LA GJURMË TË PASHLYESHME

SOFOKLI PILO DUKA, 1955-2016

Prej rreth tre muajsh mungon dhe nuk është më midis nesh, miku dhe kolegu ynë, drejtuesi i parë i Policisë së Shtetit, përgjegjësi i departamentit të Formimit Profesional në Fakultetin e Hetimit të Krimit, doktori i shkencave Sofokli Duka, i biri i Pilos dhe i Lenos, lindur më 25.12.1955 në Labovë të Vogël, Gjirokastrë dhe banues në Tiranë. Ai u nda nga jeta më 21 mars 2016, nga një goditje e beftë kardiake, duke lënë në hidhërim të thellë familjen, vëllezërit e të afërmit, por edhe miqtë e shumtë dhe kolegët.

Profesor Sofua, siç thirrej nga ish-studentët dhe kolegët, studimet e mesme i kreu në gjimnazin “Asim Zeneli” në Gjirokastrë, në vitet 1970-1974; studimet universitare në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 1974-1978 dhe studimet e dyta të larta, për gjuhë e letërsi, në Institutin Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në vitet 1978-1982.

Veprimtarinë e tij, ai e nisi si specialist i shërbimeve inteligjente në Elbasan, ku spikati profesionalizmi, kultura dhe fryma atdhetare në ushtrimin e përgjegjësi, të cilat përshpejtuan promovimin e tij në strukturat akademike të kohës duke e emëruar pedagog në SHLMPB, në vitin 1985. Pas mbarimit të studimeve pasuniversitare, në vitin 1990, Sofua mbrojti doktoraturën në fushën e sigurisë dhe shërbimeve inteligjente dhe mori gradën “Doktor i shkencave”.

Prej vitit 1976 e deri ditën që u nda nga jeta, pavarësisht se në 15 nga 25 vjetët e fundit, dr. Sofua u përball me papunësinë dhe emigracionin. Nuk rreshti asnjë ditë së menduari e punuari për rritjen cilësisht dhe zhvillimin intensiv të veprimtarisë së shërbimeve inteligjente dhe forcimin e karakterit ligjor e institucional të strukturave të luftës antikrim. Në jëtëshkrimin e gjatë spikatin shumë vepra, ndër të cilat veçojmë:

- Bashkautorësinë në hartimin e ligjeve për “Shërbimin Informativ Kombëtar”,

të viteve 1991 e 1998, të ligjit për “Informacionin e klasifikuar”, viti 1999, të ligjit për “Të huajt”, viti 1999 dhe të ligjit për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme”, në vitin 2014.

- Autorësinë e bashkautorësinë në hartimin e dy teksteve mësimore profesionale në vitin 1987, redaktor shkencor i një fjalori terminologjik profesional, në vitin 2002; cikël leksionesh për inteligjencën; disa recenca dhe oponenca për punime shkencore, studime, analiza, artikuj shkencorë për përdorim të brendshëm, apo të botuara në faqet e revistave, si dhe artikuj publicistikë në shtypin periodik të kohës me tematikë parandalimin kriminalitetit.

- Vepra të botuara: “Pas 10 vjetësh” dhe “Goditje e përpiktë”, - të dyja novela artistiko-profesionale, për përdorim të brendshëm dhe “Vetëvrasja dhe motivet për të jetuar”, studim social, penal dhe kriminologjik.


- Krijimtari artistike, poezi, prozë, etj, e botuar në shtypin periodik “Zëri i Rinisë”, “Në shërbim të Popullit”, “Luftëtari”, “10 Korriku”, “Albapol” “Zëri i Popullit”, “Shkumbini”, “Odria”, “Ndryshe”, “Panorama”, “Ballkan”, “Shekulli”, etj.

E gjithë veprimtaria kërkimore, shkencore e botuese, e rreth 40 vjetëve aktivitet, të gjitha punimet metodiko-profesionale, por edhe tërë krijimtaria e publicistika e Sofos, nga kritika e kohës dhe lexuesit, vlerësohet për origjinalitet dhe fryme të lartë inovative, larg mediokritetit, plagjiaturave dhe dogmatizmit.

Shënime përkujtimore për një mik

Prof. Asc. Dr. Pandeli TACI

"Policimi dhe siguria",
rev. shkenc.
nr. 2, prill 2016,
ISSN 2413-1334.
Botues: Akademia e Sigurisë,
Policia e Shtetit, RSH
Përmasa: 160X240 mm



AKADEMIA E SIGURISË
Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

